

# RAZI BRAHIM

BIBLIOTEKA

8JH.09

B 82

phenime  
letrare

## FILLIMET E LETERSISE SONE TE REALIZMIT SOCIALIST

Dhjetë vjet më parë ishte ende herët të flisje për historinë e letërsisë së realizimit socialist. Ahere ajo hidhte hapat e para në jetë dhe, si qdo art i ri që hedh hapat e para pas një përbëysje të madhe revolucionare në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vëndit, nuk mund të kërkohej prej saj që të ishte e përsosur, as e gjerë dhe as e përfaqësuar nga aq shumë autorë dhe aq shumë vepra sa sot.

Sot ne mund të pohojmë me plot gojën, që kemi një letërsi të zhvilluar, plot forca jetësore, një letërsi të lidhur me popullin dhe me kohën, një letërsi me perspektiva të mëdha për vëndin tonë. Dhe të gjitha këto janë arritur, para së gjithash, si frut i triumfit të revolucionit populor, i ndërtimit të socializmit në Shqipëri dhe i udhëheqies së urtë leniniste të Partisë sonë të Punës... Të gjitha sukseset krijonjëse të shkrimtarëve tannë janë të lidhura ngushtë me sukseset e popullit, me përvetësimin nga ana e tyre e botëkupti-

mit materialist dialektik dhe me ndihmën e gjithanëshme që u ka dhënë atyre Partia. Kështu ka ndodhur që letërsia jonë *ka hyrë në fazën e pjkurisë* dhe të zhvillimit të saj të plotë.

Në rrethana të tillë studimi i çështjeve të përgjithëshme të historisë së letërsisë sonë të re, si edhe studimi i problemeve të veçanta që dalin prej saj në fazë të ndryshme, mer rëndësi të veçantë dhe, po të bëhet, do të ndihmojë në përparrimin dhe zhvillimin e jetës sonë letrare.

Në këtë artikull do të meremi me një çështje historikisht të përfunduar, me çështjen e fillimeve të letërsisë sonë të realizmit socialist, ose siç mund të thuhet ndryshe, me fazën e hedhjes së themelive të kësaj letërsie. Kjo nuk është një çështje aq e thjeshtë sa ç'mund të kujtohet, prandaj edhe mendimet që janë shprehur apo mund të shprehen është më mirë të përfshihen në kategorinë e diskutimeve.

Periudha e filimeve të letërsisë sonë të realizmit socialist shtrihet në një kohë relativisht më të gjatë nga çështë thënë deri tanë. Ajo, siç e përfytyroj unë, nis me vitet njëzet-tridhjet e përfundon afërsisht rrëth vitit 1952, domethënë zgjat afro njëzetë vjet dhe ndahet në tri faza: faza e krijimit të premisave të lindjes dhe e shkëndajave të para të kësaj letërsije (vitet njëzetë-tridhjetë), që lidhet drejtpërdrejt me depërtimin e edeve socialistë në Shqipëri dhe me fillimin e lëvizjes komuniste në vendin tonë; e dyta, faza e letërsisë së luftës Nacional-Çlirimtare, që nis me themelimin e partisë (1941) dhe zgjat deri në cilimin e Shqipërisë dhe pak më vonë (ndoshta deri në fund të 1945-ës), e treta, faza e hedhjes së kapave të para të letërsisë së realizmit socialist

*në kuptimin e platë së fjalës, që përfundon rrëth viti 1952. Pas vitit 1952 (datat në raste të tilla janë, kurdoherë aproksimative) letërsia jonë hyn në rrugën e madhe të zhvillimit me një bazë të shëndoshë dhe me forca të shumuara e me pretendimet e një letërsie të zhvilluar. Këtu nis periudha e dytë e zhvillimit të saj, periudha e pjekurisë dhe e lulëzimit.*

Mendojmë se ndarja e letësisë sonë të re në periudhat që shënuam më lart i përgjigjet të vërtetës historike dhe është i drejtë për disa arësye.

Së pari, deri në vitin 1952, (aproksimativisht), letërsia jonë e re bënte përpjekjet e para për t'u zhvilluar, jo vetëm si letërsi e realizmit socialist, po edhe si letërsi në kuptimin e gjerë të fjalës. Gjatë luftës Nacional-Çlirimtare nuk pati *asnje* përfaqësonjës të njohur të letërsisë sonë të mëparëshme që të vazhdonte krijimtarinë e vet dhe të hidhte hapat e para drejt realizmit socialist. Nga ana tjetër, koha ishte tepër e shkurtër dhe ngjarjet aq të vrullëshme, sa që talentet e reja nuk arritën të zhvillohen plotësisht, megjithëse gjatë atyre viteve u krijuan edhe vepra të bukuria.

Së dyti, gjer më 1952, shkrimitarët tanë kryesorë sapo kishin botuar veprat e tyre të para, sapo kishin përcaktuar rrugën e tyre krijonjëse, sapo ishin kristalizuar veçoritë e tyre artistike dhe ishte kuptuar plotësisht se ç'ishte letërsia e realizmit socialist, të cilën po e krijonin me veprat e tyre. (Teorikisht, për realizmin socialist është folur për herë të parë në shtypin tonë letrar më 1946-1947.)

Së treti, para 1952 nuk mund të flitej, në

kuptimin e vërtetë të fjalës, për një zhvilim të gjithanshëm të letërsisë sonë të re, akoma nuk mund të thuhej se kishim një prozë, një dramaturgji e një poezi të zhvilluar. Romani mungonte. Tregimet e gjata, vëllimet me tregime, përmbledhjet me vjersha dhe veprat dramatike numuroheshin me gishtat e dorës. Prej të dhënave bibliografike del, se gjer më 1952, ishin botuar rrëth 50 vëllime të 22 autorëve, prej të cilëve 10 kishin botuar nga një vepër, tre nuk shkruan më vonë dhe vetëm 9 kishin botuar nga dy e, më rralle, nga tre vëllime.

Së katërti, edhe në raport me historinë e ndërtimit socialist të vëndit tonë, ky periodizim duket i drejtë për arësy historike të njoitura. Më 1952 ka nisur periudha e planeve ekonomike pësëveçare, pasi kanë përfunduar reformat e mëdha ekonomike e shoqërore, pasi ka marë fund me kohë rindërtimi i vëndit dhe kudo ka nisur sulmi në stil të gjërë për ndërtimin e bazave të socializmit.

Në frontin e letërsisë është zhvilluar konferanca e tretë kombëtare e shkrimitarëve, ku u shtruan probleme shumë të rëndësishme të letërsisë sonë.

Po të shpreheshim në mënyrë figurative, do të thoshim, se gurin e kufirit ndërmjet dy periudhave të letërsisë sonë të realizmit socialist e vuçi botimi i romaneve të para, që ishte me të vërtetë një hap i ri drejt zhvillimit të mëtejshëm të letërsisë së realizmit socialist në vëndin tonë.

Pra, periudha e parë është periudha e grumbullimit, përgatitjes dhe aktivizimit të forcave tona letrare, periudha e përqafimit të metodës krijonjëse të realizmit socialist dhe e krijimit të

veprave të para sipas kësaj metode. Vlen të shënojmë se deri më 1952, Dhimitër Shuteriqi kish botuar dy poemat «O Ptoleme», «Enverit» dhe vëllimin me vjersha «Mbi krahn e praruar të pagues», Zihni Sakua vëllimin me tregime «Nga jeta në luftë», vëllimin për fëmijë «Foleja e dallëndyshes», tregimin e gjatë «Bereqeti» etj., Fatmir Gjata vëllimet «Gruri nuk u dogj», «Pika gjaku», dhe, pak më vonë, tregimin e gjatë «Ujët fle, hasmi s'fle», Shefqet Musaraj poemat «Epopeja e Ballit Kombëtar» dhe «Do bëhen zgjedhjet», Aleks Çaqi poemat «Ashtu Myzeqe», «Mety Stalin» dhe pjesën më të mirë të vjershavë të vëllimit «Këngët e dheut», Llazar Siliqi poemat «Prishtina», «A ka kala që s'marin komunistat!» dhe vëllimin «Rruga e lumbunisë», Luan Qafëzi vëllimin «Vjersha», Kolë Jakova është njohur me dramën «Halili dhe Hajrija» Mark Gurakuqi ka botuar vëllimin «Kangë për jetën», Vehbi Balla vëllimin «Shtigje Drite», Kin Dushi tregimin e gjatë «Në gojën e ujkut», Aleksandër Banushi përbledhjen «Ylberi». Nuk do duhej të zgjatet teshim edhe më tepër se kaq për të shënuar listën e plotë të veprave të botuara gjatë asaj periudhe. Në këtë kohë nisin të çfaqen edhe talentet e para të lindura në kushtet e shoqërisë sociale. Rradhët e shkrimtarëve shtohen dhe zënë të nijien emrat e debutantëve të rinj si Jakov Xoxa, Vehbi Skënderi dhe pas tyre, Ismail Kadare, Naum Prifti, Sotir Andoni, Dritëro Agolli e të tjera. Veç kësaj, disa shkrimtarë të vjetër, që deri në këtë kohë nuk kishin botuar gjë, dalin me vëllimet e tyre të para si shkrimtarë të realizmit socialist, duke kapérxyer kështu të kaluarën e tyre letrare. Të

tillë janë Nönda Bulka, Sterjo Spasse, Vedat Kokona, Nexhat Hakiu.

Grumbullimi i eksperiencës, pasurimi i letërsisë, shtimi i radhëve të shkrimtarëve, krahas sukseseve të mëdha ekonomike, shoqërore dhe kulturore të vëndit, e ngrejnjë letërsinë tonë si tërësi, në një nivel më të lartë ideo-estetik, në krahasim me periudhën e mëparëshme.

## 2.

Lind pyetja: Pse shtyhet kufiri i fillimeve të letërsisë të realizmit socialist deri në vitet njëzetë-tridhjetë? A nuk është më e arësyeshme të meret si fillim periudha e luftës Nacional-Çlirimtare?

Historia e letërsisë sonë gjatë tridhjetë vjetëve të fundit vërteton, se metoda e realizmit socialist në Shqipëri nuk u importua nga jashtë dhe nuk u imponua nga lart, siç mundohen të thonë revizionistët për realizmin socialist në përgjithësi, po u arrit si një sukses krijonjës i shkrimtarëve tanë më të përparuar, që e kishin lidhur jetën dhe krijimtarinë e tyre me jetën dhe luftën e popullit, me ideologjinë socialiste dhe me veprimtarinë revolucionare të masave punonjëse, të udhëhequra nga komunistët.

Letërsia e viteve tridhjetë, ose, siç thuhet ndryshe, krijimtaria e shkrimtarëve të brezit të tridhjetepesës dhe disa fenomene në letërsinë e mëparëshme provojnë, se aso kohe, po bëhej një përpjekje e pandërgjegjëshme dhe e ndërgjegjëshme përfshi kërkuar rrugë të reja krijonjëse, brendi të re ideologjike, spjegim të ri të jetës. As metodat e vjetra krijonjëse tradicionale të

letërsisë së atëherëshme, as format e njohura nuk kënaqnin më letrarët më të përparuar, të cilët, si produkt i kohës dhe i raporteve shoqërore që ishin krijuar, kishin diçka të re për të thënë dhe këtë diçka të re e shihnin se nuk mund ta thoshnin në mënyrat e vjetëra. Pra, vetë jeta i shtynte letrarët drejt një metode të re krijonjëse.

Në këtë mes përhapja e ideve të socializmit dhe ndikimi i fitores së revolucionit të Totorit, shërbyen si një katalizator i fuqishëm, si në gjallërimin e lëvizjes demokratike, ashtu edhe në përparimin ideologjik të kulturës sonë. *Ndikimi politik* i fitores së socializmit në Bashkimin Sovietik (botimi i dokumentave të traktatit të Londrës, ideja që toka u përket atyre që e punojnë etj.) i çei udhën edhe *ndikimit ideologjik* të socializmit në Shqipëri, sidomos pas formimit të grupeve komuniste, me të cilat u bashkuan edhe intelektualët më të përparuar të kohës. Qënia e Bashkimit Sovietik, si shtet i parë i punëtorëve dhe i fshatarëve, ishte gjithashtu një element i rëndësishëm për revolucionimin e mentalitetit të njerëzve Ndkoi gjithashtu edhe letërsia sovjetike, sidomos botimi i romanit «*Nëna*» të Maksim Gorkit.

Deziluzioni është elementi i parë i revoltës shoqërore në letërsinë tonë pas shpalljes së independence-s. Deri këtu arritën shkrimitarët përparrimtarë të Rilindjes: Çajupi, Mjeda, Asdreni, të cilët vrejtën me dhimbje fundin e idealeve të larta për të cilat u luftua dhe daljen në sipërfaqe të kontradiktave të thella klasore, që lufta për çlirimin kombëtar i kish hedhur në plan të dytë. Njerëzit që luftuan me gjithë shpirt për Shqipë-

rinë, bijt e thjeshtë të popullit, u lanë në mëshirën e fatit dhe iu nënështruan shtypjes së egër të cifligarëve, të matrapazëve e të fajdexhinjve. Asdreni arrin deri atje, sa t'i paralajmërojë klasat sundonjëse që fati i tyre është në duart e masave që po të zëmërohen më keq, mund edhe t'i përbysin:

Mjaftë, mjaftë! Se u mbush kupa e hidhërimit!  
Gjarpnj, pushoni! Helmin tej e çporrni.

*Mos dalim tej kufirit të durimit:*

*Që më në fund se ç'mbuallt, ju të korrni!»*

(Krerëve tradhëtarë)

Ose:

«Prej gazit t' marrët duart po fërkojnë:  
Me zemër të kënaqur shohin varret...

*Po s' dinë se edhe fati i tyre mvaret  
Në dorë të atyre që sot shqelmojnë.*

(Shpërblimi).

Fan Noli e thelloi edhe më tepër karakterin demokratik të letërsisë me vjershat e tija të fuqishme politike, të cilat përshkohen fund e krye nga urrejtja e pakufi ndaj shtypësve të popullit. Lidhur me çështjen që trajtojmë, në krijimtarinë poetike të Nolit, të tërheqin vëmëndjen në mënyrë të veçantë dy aspekte: demaskimi i sundonjësve dhe satrapëve, si përfaqësonjës të klasës sundonjëse dhe qëndrimi autokritik ndaj gabimeve të bëra gjatë revolucionit të vitit 1924, gabime që sollën rrëzimin e qeverisë demokratike të asaj kohe. «*Krishti d'he Kanzhiku*», është një vjershë revolucionare që bën thirrje të përdoret dhuna

revolucionare, Dhe, më së fundi, vjershat «*Rend or marathonomak*» dhe «*Anës lumenjve*» nuk ka asnjë arësyte të shkëputen prej traditave të poezi-së sonë revolucionare. të realizmit socialist.

Një element tjetër i rëndësishëm që para-rend letërsinë tonë të realizmit socialist dhe që i përgatit terrenin kësaj letërsie është kërkesa e parashtruar prej letrarëve tanë më të përparuar të asaj kohe për një letërsi *realiste demokratike*, për një letërsi të lidhur me popullin, për një letërsi militante.

Në këtë kohë, (vjetet 1930-1940) zhvillohet procesi i ndarjes gjithënë e më të theksuar të letërsisë sonë në dy drejtime të kundërtë, në drejtimin *reaksionar* të *përfaqësuar* prej shkrimtarëve të *regjimit* dhe prej *konservatorëve, patriarkalistëve, fetarëve* e *dekadentëve* dhe në *drejtimin përparimtar*, të *përfaqësuar*, në *radhë* të *parë* prej letrarëve të *brezit* të *tridhjetepesës*. Nuk ka periudhë tjetër në historinë e letërsisë shqipe, në të cilën këto dy drejtime të kundërtë të janë çfaqur kaqë haptaz e të janë vënë kaq vendos-mërisht njeri kundrejt tjetrit. Kjo ka ndodhur për shkak, se pas shpalljes së indipendencës dhe përfundimit të turbullirave që pasuan atë, u çfaqën më tepër kontradiktat e klasave dhe sho-qëria shqiptare, si shoqëri antagoniste, ishte e ndarë më dysh: shtypës e të shtypur, shfrytëzo-njës e të shfrytëzuar. Njerëzit e kulturës dhe të artit, s'mund të qëndronin mbi këtë ndarje. Në mënyrë të detyrueshme, pavarësisht nga nuancat që mund të ketë, ata morën ose njerën anë, ose tjetrën. Jeta jonë letrare po polarizohej.

Prej krahut më të përparuar të letërsisë sonë të atyre vjetëve dallohej Migjeni, Gaspër Pali,

Veli Stafa, Qemal Stafa, Kristaq Tutulani, Norda Bulka, Aleks Çagi, Petro Marko, Shefqet Musarai, Dhimitër Shuteriqi, Andrea Varfi, Kristaq Cepa e ndonjë tjetër. Shkëndiat e letërsisë socialiste shtohen: Nuk janë aq të pakta shkrimet e këtyre letrarëve që mund të meren si çfaqje të para të realizmit socialist. Pa përmëndur shkrimet, që nuk u botuan mund të kujtojmë këtu, krahas mjaft prej krijimeve të Migjenit, edhe poezinë e Qemal Stafës «*Hijes së tim vëllai*», disa prej vjershave të Petro Markos e të Kapës e të tjera. Po kështu mund të përmendim edhe rolin e revistës «*Bota e re*», revistën «*Vullnetari i Lirisë*», gazeten «*Sazani*», që kontribuan në këtë drejtim dhe organe të tjera të shtypit të kohës, në të cilat u botuan herë pas here shkrime me përbajtje revolucionare.

Po nuk janë vetëm këto shkrime të pakta, që na shtyjnë të themi, se periudha tridhjetë-dyzetë është koha që krijojen premisat e letërsisë së realizmit socialist. Në radhë të parë na shtyn të mendojmë kështu përbajtja e kësaj letërsije, në të cilën ndiheshin të fuqishme e të gërshetuarë njëra me tjetrën notat e dëshpërimit, të zëmërimit, të revoltës e të thirrjes për përbysjen e rendit egzistonjës. Edhe vetëm Migjeni sikur të kishte dalë në këtë kohë, si poet i protestës dhe i revoltës, do mjaftonte të thoshim se *në atë kohë u ndie nevoja, po krijojeshin mundësítë dhe po çeleshin shtigjet për një letërsi të re që do të ndryshonte shumë prej letërsisë së mëparëshme dhe që s'mund të ishte veçse letërsi e realizmit socialist.*

Kur u krijuar Partia Komuniste dhe nisi revolucioni populor, nën udhëheqjen e kësaj partie,

qielli u qartësua dhe shkrimtarët, ashtu si gjithë njerëzit, përcaktuan më mirë qëndrimin e tyre. Koha shtroi alternativën e rreptë: ose me popullin në luftë për çlirimin kombëtar e shoqëror, ose me fashizmin kundër popullit. Nuk është aspak e rastit që gjithë letrarët më të përparuar tē asaj kohe u bashkuan me Partinë Komuniste. Tani ishte e qartë për 'ta udha që duhej ndjekur, motivet që duheshin trajtuar, mënyra si duhej parë e pasqyruar bota.

*Pra, letërsia e luftës Nacional-Çlirimtare nuk është një shkëputje, por një vazhdim i natyrshëm dhe i drejtëpërdrejtë i letërsisë përparimtare me tendenca revolucionare të viteve 1930-1940.*

Veç kësaj, një element tjetër që e lidh letërsinë e asaj kohe me letërsinë e sotme tē realizmit socialist është edhe fakti se pionierët e letërsisë së re ishin përgjithësisht letrarët më të përparuar të brezit të tridhjetepesës, Shevqet Musaraj, Petro Marko, Andrea Varfi, Aleks Çaci, Dhimitor Shuteriqi, të cilët nuk bënë ndonjë *kthesë* në krijimtarinë e tyre, po vazhduan natyrshëm rrugën e nisur që më parë sigurisht duke the luar gjithënjë e më tepër anët më karakteristike për një letërsi të realizmit socialist. Krahas këtyre në luftë u çfaqën edhe talente tē reja si Gjikë Kuqali, Fatmir Gjata, Kolë Javoka dhe Llazar Siliqi, të cilët nuk ishin njohur më parë, edhe nëqoftëse kishin shkruar.

A nuk është e arësyeshme pra, që tē themi, se fillin e gjenezës së letërsisë sonë tē realizmit socialist duhet ta kërkojmë dhe ta gjejmë në periudhën e dhjetëvjeçarit tē tretë, pa përjashtuar edhe ndonjë çfaqje tē mëparëshme? A nuk është e drejtë tē themi se ajo ishte fazë e krijimit tē

premisave letrare dhe e shkëndijave të para të letërsisë së realizmit socialist ndër ne?

Vjetët e luftës Nacional-Çlirimtare janë një fazë e re në krijimin e letërsisë së realizmit socialist. Gjatë katër-pesë vjetëve letërsia jonë e në mënyrë të veçantë, poezia morën një ton të ri, duke çfaqur haptaz idealet revolucionare prej të cilave fryshtoheshin. Kjo për dy arësy: së pari, politika e partisë kishte celur para masave punonjëse dhe përfaqësonjësve të tyre intelektualë perspektiva të qarta dhe, së dyti, lufta revolucionare tashti nuk ishte me një qëllim që duhej arritur, po ishte një realitet historik i përcaktuar mirë, që duhej pasqyruar. Ndërsa më parë letrarët me prirje revolucionare e ëndërronin dhe e dëshëronin revolucionin, pa qënë të sigurtë për format që do të merte ai në Shqipëri, tani ata e shihnin këtë revolucion të mishëruar në forcën e luftës Nacional-Çlirimtare të udhëhequr nga Partia Komuniste me perspektivën e shndrrimit në revolucionin socialist. Këto dy elemente historike të kohës përcaktuan fizionominë e letërsisë sonë të periudhës së luftës, kurse heqja dorë prej botimit në shtypin zyrtar, krijimi i shtypit të Partisë dhe synimi që të shkrueheshin këngë për repartet partizane, këngë që do të këndoheshin ndër luftime e ndër zonat e lira e bënë poezinë tonë të kthjellët. Tani nuk ndihej më nevoja për aluzione, për alegori e për simbole. «Gjuhës së Ezopit» i kishte ikur koha. Letërsia duhej të militonte haptaz për qëllimet e luftës, duhej të ndihmonte në mobilizimin e popullit në luftë.

Para se të kalojmë në shqyrtimin e prodhit të letrar të kësaj faze është mirë të shtrojmë

çështjen, pse është e nevojëshme që në letërsinë e luftës të përfshihen edhe veprat e botuara gjatë vitit 1945 dhe disa që janë botuar një vit më vonë.

Na duket e arësyeshme që faza e letërsisë së luftës Nacional-Çlirimtare, të përfshijë periudhën 1941-1945 inkluzivisht, mbasi, së pari, mjaft prej veprave që hyjnë në letërsinë e luftës, u botuan pas çlirimtimit edhe nëqoftëse u shkruan më parë (përmëndim poemën e Dhimitër Shuteriqit «O Ptoleme» reportazhin letrar «Shtek më shtek me partizanët» të Shevqet Musarajt, «Kujtime nga jeta e Brigadës së parë» të Mehmet Shehut, «Tregime nga lufta» të Zihni Sakos, poemat «Prishtina» dhe «A ka kala që s'marrin komunistat» të Llazar Siliqit, vëllimin «Pika Gjaku» të Fatmir Gjatës) dhe së dyti, me përjashtim të poemës «Prishtina», që merr spunto prej periudhës pas çlirimtimit, të gjitha të tjerat, siç është e natyrëshme, ndjekin valën e letërsisë së vjetëve të luftës dhe pasqyrojnë atmosferën e betejave çlirimtare të frymëzuara drejtpërdrejt prej këtyre betejave. Prandaj, si për temat, ashtu edhe për trajtën e tyre, këto vepra me të drejtë nuk janë shkëputur dhe nuk mund të shkëputen prej fazës së luftës.

Letërsia e luftës Nacional-Çlirimtare nisi si një letërsi antifashiste patriotike. Lufta për çlirimin kombëtar, hymnizimi i heroizmave të popullit, sidomos hymnizimi i heronjvet dhe thirrjet për hakmarrje janë motivet kryesore të kësaj letërsie. Dhe, ashtu siç ndodhi me vetë luftën, ndodhi edhe me letërsinë: antifashizmi i çeli rrugë depërtimit gjithënjë e më të thellë të ideve komuniste, të cilat siç thamë, kishin një terren pak a shumë të shtruar qysh më parë. Sigurisht, brë-

nda një kohe aq të shkurtër do të ishte absurdë  
të kërkonim apo të vinim kufij ndërmjet antifa-  
shizmit dhe çfaqjes së ideve socialiste në letërsi.  
Këto shpesh janë të së njëjtës kohë në autorë të  
ndryshëm, ose edhe në shkrime të ndryshme, të  
të njëjtit autor. Kështu, për shëmbull, këngët e  
adaptuara prej Petro Markos më 1942, kanë një  
frymë socialiste më të theksuar, se mjaftë këngë  
të tjera partizane, që u shkruan më vonë e traj-  
tonin tema konkrete të luftës partizane.

Këtu është rasti të japim një spjegim. Gjatë  
okupacionit gjerman u bë e modës, si të thuash,  
tema e shtatë prillit dhe çfaqia e urrejtjes kundër  
fashizmit italian. Disa shkrimtarë, që aso kohe  
nuk kishin gjë të përbashkët me Revolucionin  
Popullor, shkruan dhe botuan legalisht veprat e  
tyre «antifashiste». Ato janë sulme kundër të  
vdekurit, në një kohë që duhej luftuar kundër të  
gjallit.

Çfarë elementesh të reja solli lufta Nacional-  
Çlirimtare?

Para së gjithash të bije në sv *fryma e re* që  
*përshkon gjithë krijimtarinë e letrarëve tanë* të  
*asaj kohe*, gjë që lidhet me vetë kushtet e reja  
në të cilat u zhvillua kjo letërsi e për të cilat  
folëm më lart. Fryma heroike, optimizmi, besimi  
dhe perspektiva e qartë u çfaqën kësaj radhe me  
një forcë më të madhe se çdo herë tjetër. Patriotizmi  
pasurohet me elemente të reja dhe gërshtoheret  
me qëndrimin klasist ndaj Atdheut, kështu  
që letrarët tanë nuk përsëritën në formë të thje-  
shtë frymën patriotike të letërsisë së Rilindjes, po  
e vazhduan atë, duke e pasuruar me idetë e pa-  
triotizmit socialist. Letërsia e luftës Nacional-  
Çlirimtare është lidhur shumë ngushtë me politi-

kën e Partisë Komuniste dhe është shprehje besnik e kësaj politike. Parullat e partisë ishin burimi i parë i frysëzimit për letrarët tanë, ashtu siç ishte edhe vetë lufta heroike e komunistëve dhe e gjithë popullit tonë.

Veo kësaj, *letërsija jonë gjatë luftës Nacional-Çlirimtare u pasurua me elemente dhe me temë të reja*, të cilat nuk kishin hyrë dhe nuk mund të hynin më parë në letërsinë tonë, mbasi mungonte materiali jetësor, prej të cilët lindin temat dhe subjektet. Ndër temat më karakteristike të kësaj kohe janë: demaskimi i fashizmit dhe i organizatave tradhëtare, masakrat e push-tonjësve, trimëria në luftë, qëndrimi burrëror pas torturave, dashuria për shokun, hakmarrja, etj., Siç shihet kemi të bëjmë me një letërsi me karakter të theksuar politik. Temat shoqërore janë më të pakta dhe janë trajtuar nëpër skeçe, vjersha humoristike e skica letrare, prej të cilave pak gjë ka mbetur. Kjo shpjegohet me vetë karakterin e luftës dhe me faktin se motivet shoqërore nuk zunë dot vendin që do t'u përkiste në rrethana të tjera. Përpjekje për trajtimin shoqëror të temave të luftës ka bërë Gjikë Kuqali, sidomos në novelën e pambaruar «*Lumpen proletariat*».

Së treti, gjatë kohës së luftës mori zhvillim të vrullshëm kënga. Nuk ka periudhë tjetër në historinë e letërsisë sonë, ku, brënda një kohe aq të shkurtër të janë shkruar e të janë përhapur aq shumë këngë, sa gjatë luftës Nacional-Çirimtare, Dhe, mbështetës, këngët janë gjëja më karakteristike dhe më popullore e kësaj letërsie. Ndër autorët e këngëve partizane, një pjesë e të cilëve kanë mbetur anonimë, përmë-

dim Petro Markon, Fatmir Gjatën, Andrea Varfin, Shevqet Musarajn, Kolë Jakovën, Qamil Buixhelin. Prej këtyre autorëve, dy të parëve u përkasin pjesa më e madhe e këngëve të luftës.

*Edhe folklori nuk mbeti prapa.* Ai u zhvillua në pajtim me kohën dhe u pasurua me elemente të reja ideologjike, duke mbetur, para së gjithash, poezi popullore patriotike. Kontribut të veçantë në zhvillimin e poezisë të kësaj kohe dhanë edhe Memo Metua e Shevqet Peçi, të cilët krijuan tekste për shumë këngë labe dhe vjersha popullore me tema të ndryshme të luftës.

*Zhvillim të mirë pati edhe publicistika, sidomos panfleti politik.* Gazetaria revolucionare, që ishte zhvilluar edhe më parë, tani hyri në rrugën e formimit të saj të plotë, nëpërmjet organeve të shtypit ilegal, sidomos nëpërmjet «Zërit të Popullit», «Kushtrimi i lirisë» dhe, më vonë, të gazetës «Bashkimi».

*Koha e re solli edhe heronj të rinj në letërsi.* Njerëzit e popullit, punëtorët dhe fshatarët, ishin në qendër të vëmëndjes. U përshkruan përgjithësisht mirë, ndonëse në formë stereotipe, transformimi i ndërgjegjës së masave dhe kalimi i njerëzisë në anën e luftës Nacional-Çlirimtare. Partizanët dhe komunistët, ashtu siç ishin qëndra e luftës popullore, ishin edhe në qendër të shkrimeve letrare. Kjo vihet re, sidomos, në ato vepra që u botuan pas mbarimit të luftës, që u shkruan në rrethana të qeta dhe me piksynime artistike më të mëdha.

Prej letërsisë sonë të luftës Nacional-Çlirimtare ne trashëgojmë vepra me vlerë, të cilat, pëtë kemi parasysh rrethanat, janë të mjafta. Dhe jo vetëm me kaq. Disa prej tyre mbeten edhe sot

e kësaj dite në radhën e veprave më të mira të letërsisë sonë. Të tilla janë poema «*Epopeja e Ballit Kombëtar*» e Shevqet Musarajt, «*Nga jeta e brigadës së parë*» e Mehmet Shehut, poema «*Prishtina*» e Lazar Silliqit, këngët partizane të Fatmir Gjatës etj.

Njeri prej rezultateve më të rëndësishme të letërsisë së luftës Nacional-Çlirimtare është debutimi i disa autorëve të rinj, që sot janë ndër shkrimtarët tanë kryesorë, si Fatmir Gjata, Lazar Siliqi, Kolë Jakova e të tjerë, të cilët edhe nëqoftëse kishin shkruar më parë nuk kishin arriut të botonin, ose kishin botuar gjëra pa rëndësi.

Ndërsa para lufte u krijuan premisat historike e letrare për lindjen e realizmit socialist dhe u dukën shkëndijat e para të kësaj letërsie, gjatë luftës Nacional-Çlirimtare u hodh hapi i parë i rëndësishëm për krijimin e një letërsie të tërë revolucionare, në kushtet e revolucionit popullor dhe të udhëheqjes së Partisë Komuniste. Është fakt historik që gjat atyre vjetëve, me ndonjë përjashtim shumë-shumë të rrallë dhe jo aq të rëndësishëm, asnjë prej shkrimtarëve, që s'u bashkuan me luftën Nacional-Çlirimtare, nuk krijoj diçka që t'u përgjigjej kërkesave të kohës. Letërsia e luftës sado e vogël si vëllim, është bërrë kriter vlerësimi i gjithë krijmtarisë së shkrimtarëve të tjerë, kriter shqyrtimi dhe përcaktimi të afërsisë së këtyre shkrimtarëve me revolucionin dhe me popullin, mbasi ajo ishte mishëronjëse e ideve më të përparuara revolucionare dhe pasqyronjëse besnike e realitetit të luftës heroike të popullit, nën udhëheqien e partisë. Asnjë vlerësim kritik i krijmtarisë së këtij apo atij shkrimtarë gjatë vjetëve të luftës, nuk mund të jetë i

drejtë, nëqofëse nuk mer parasysh ekzistencën e letërsisë sonë të luftës.

Megjithékëtë, a mund të thuhet se gjatë luftës Nacional-Çlirimtare përfundoi procesi i krijuar mit të letërsisë së realizmit socialist? Është e qartë se jo.

Letërsia e luftës, sidomos ajo letërsi që u krijuar gjatë kohës së luftës, nuk mund të themi, se është një letërsi plotësisht e zhvilluar dhe shkakqet pse nuk arijti të zhvillohej plotësisht janë të kuptueshme, po të kemi parasysh kohën e shkurtër dhe rrethanat e vështira të luftës. Duke qënë një letërsi e përfaqësuar prej gjinive të vogëla (e vetmja vepër e madhe ishte «*Epopeja e Ballit Kombëtar*»), nuk mund të pretendohet që ajo mund t'u përgjigjej të gjitha kërkesave të një letërsie të zhvilluar të realizmit socialist. Edhe në dy vjetët e fundit para çlirimit veprat që u krijuan, megjithë vlerën e tyre artistike, duke qënë kryesisht vepra poetike ose tregime të shkurtëra, nuk mund të përfaqësonin gjithë veçoritë e letërsisë së realizmit socialist, siç përfaqësohen ato në letërsinë tonë të sotme, që me plot gojën mund të themi se është një letërsi plotësisht e zhvilluar.

Në vitet 1945-1952, në kushtet e realizmit të revo'ucionit demokratik dhe të trasformimit të tij në revolucionin socialist gati në të njëjtën kohë, nisi të zhvillohej revolucioni edhe në fushën e kulturës me reformën arsimore të vitit 1946 dhe të një sërë masave të rëndësishme për çdukjen e analfabetizmit, shtrirjen e rrjetit të shkollave, të shtëpive e vatrave të kulturës, të theatrove diletante, të kinemave, të shtimit të shtypit, të formimit të Lidhjes së Shkrimtarëve (1945), etj. Përpjekjet për krijimin e letërsisë së realizmit socialist

u bënë më të *theksuara e shumë më të vetëdij-me*. Realiteti socialist, ashtu si edhe lufta revolucionare, kërkonin pa tjetër një letërsi të realizmit socialist, mbasi vetëm një letërsi e tillë, e frymëzuar nga idetë e mëdha të socializmit, e lidhur ngushtë me popullin dhe që e shihet jetën nën prizmin e botkuptimit materialist dialektik, dhe të interesave jetësore të punonjësve mund të ishte në gjëndje të pasqyronte me vërtetësi transformimet e mëdha që po kryeheshin në vëndin tonë.

Letërsija sovjetike, e cila nisi të përkëthehej gjérësisht, u bë shëmbull për zhvillimin e letërsisë sonë të re, ashtu siç mësonte shoku Enver Hoxha.

Tema e kthesës së madhe revolucionare në jetën e popullit dhe puna pér rindërtimin e ndërtimin e vëndit zënë vendin kryesor në letërsi, krahas temës së luftës Nacional-Çlirimtare.

Prej autorëve kryesorë, që trajtuan temat e reja në poezi ishte Aleks Çaći, i cili në një prej vjershave të asaj kohe, shkruante:

*Unë dola nga mjerimi sot në botë,  
Me kokën lart e zëmërën të ngrohtë  
Dhe shoh se atdheu i lirë lulëzon,  
Fosnja në gji të nënës po gëzon.*

*Atje përtej, në vëndin q'u zhurit,  
Fabrikën shoh të bukur që u ngrit  
Dhe në një fshat një grua që mban fjalë...*

Kjo është fryma entusiaste e të gjithë poezisë sonë të asaj kohe, në të cilën reflektohet, para së gjithash, hovi revolucionar i punë ndërtimtare, gëzimi i fitores, mbresat e thella të përmbytjes së madhe që po kryhej në vëndin tonë. Kjo vihet re në shumë vjersha të Aleks Çacit, të përbledhura më vonë prej tij në vëllimin «*Këngët e dheut*», në poemat e të njëjtit autor «*Ashtu Myzeqe!*» dhe «*Me ty Stalin*», në vjersha të Lazar Silliqit, sidomos te «*Miku*», në krijime poetike të Andrea Varfit, Luan Qafëzezit, Mark Gurakuqit, Kolë Jakovës, në poemën «*Enverit*» të Dhimitër Shuteriqit dhe në mjaft vjersha të tij, në disa vjersha të Zisa Cikulit, etj.

Krahas kësaj, poezia jonë e asaj kohe, pasurohet edhe me tema të reja, prej të cilave tërheqin vëmëndjen tema e luftës për paqë dhe tema e miqërisë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Ende poezia vazhdonte të mbetej kryesisht poezi luftarake-politike. Të rralla janë akoma temat shoqërore dhe motivet intime. Po, në një kthesë të madhe revolucionare, nuk mund të ndodhëndryshe. Vala e luftës politike, vetëdija e fitores, e detyrave të mëdha dhe e perspektivave të shkëlqyera që i hapeshin Shqipërisë tërroqën të gjitha forcat më të shëndosha të letërsisë sonë. Përpara fitores së madhe dhe të ardhmes së ndritur, ashtu si i gjithë populli, edhe shkrimitarët s'kish si të mereshin me vogëlsira, bi'e, as që parashikonin vështirësitë e punës ndërtimtare, të bindur me të drejtë, se tani që kishin në krye Partinë dhe pushtetin e punëtorëve e të fshatarëve, gjithçka do të zgjidhej më së miri. Puna ishte të mobilizoheshin masat në punë për rindërtimin dhe ndërtimin e Shqipërisë së re, të

ngrihej rinia në këmbë për të kryer aksionet e rëndësishme të ndërtimit. Letërsija e asaj kohe e kreu mirë detyrën e vet. Ajo u bë ndihmëse e partisë.

Proza hedh hapat e para me tregimet e shkurtëra mbi luftën Nacional-Çlirimtare, prej të cilave dallohen ato të Dhimitër Shuteriqit dhe, dalëngadalë, nis të trajtohen edhe temat e reja të kohës. Interesantë janë, për shëmbull, tregimet e shkurtëra humoristike të Shevqet Musarajt, mbledhur më vonë në vëllimin «*Të shkuara të paharruara*», tregimi i Dhimitër Shuteriqit «*Edhe floriri hahet me lugë*», ndonjë tregim prej vëllimit «*Novela*» të Jakov Xoxës, tregimi «*Medalja e trimërisë*» i Zihni Sakos e të tjera.

Pas vitit 1950, temat e reja të kohës trajtohen edhe në veprat e gjata të prozës, sidomos në «*Beregeti*» të Zihni Sakos dhe në «*Ujët fle, hasmi s'fle*» të Fatmir Gjatës, në të cilat bëhet përpjekja e parë për të trajtuar pak a shumë gjërësisht temat e jetës së re dhe të preket problemi i transformimit shpirtëror të njerëzve. Për herë të parë debuton në prozë Jakov Xoxa dhe ndonjë tjetër.

Dramaturgjia shkundet prej prapambetjes dhe kalon prej skicave dramatike në vepra me shumë akte si «*Dom Gjoni*» dhe «*Halili e Hajrija*» të Kolë Jakovës, «*Prefekti*» e Besim Lëvonjës, «*Trashëgimtarët tanë*» e Haki Stërmillit, por ende nuk mund të flitet për dramaturgji, me që veprat janë shumë të pakta.

Hov të dukshëm mer në këtë fazë letërsija për fëmijë, në të cilën dallohen shkrimitarët Zihni Sako; Drago Siliqi, Spiro Çomora dhe Luan Qafëzezi.

Në satirë dalin librat e para të shkruara prej Shévqet Musarajt, Spiro Çomorës dhe Nonda Bulkës.

Pra, në krahasim me periudhën e luftës, numëri i veprave dhe i autorëve rritet shumë. Letërsia përfshin gati të gjitha gjinitë e krijimit me përjashtim të romanit, i cili e nis shtegëtimin më 1952 për të kurorëzuar të gjitha sukseset e periudhës së parë, të periudhës së fillimeve të letërsisë së realizmit socialist dhe për të filluar periudhën e re të zhvillimit të plotë të letërsisë sonë të re, periudhën e lulëzimit e të pjekurisë së saj.

Sic shihet, në këtë fazë letërsija jonë e re del prej shpërngjenje dhe hedh hapat e para në jetë, si letërsi e zhvilluar. Rezultatet kryesorë të fazës 1945-1952 janë: *trajtimi i temave të reja, zhvillimi i gjinive të ndryshme letrare, përpjekja për të dhënë tabllo të gjëra të jetës, për të krijuar tipa, për të hyrë në botën e brëndëshme të njerëzve dhe për të zbuluar ndryshimet në ndërgjegjën e tyre, debutimi i disa autorëve të rinj dhe krijimi i disa veprave me vlerë në poezi, në prozë e në dramë, trajtimi teorik i çështjeve të realizmit socialist.*

Në konferencën e tretë kombëtare të shkrimitarëve iu bë një analizë e përgjithëshme krimtarisë së deri atëherëshme dhe u përcaktuanc mërisë tri çështje me rëndësi: a) lidhja e letërsisë sonë të re me traditat e përparuara të së kaluarës dhe qëndrimi i diferencuar ndaj shkrimitarëve të vjetër (përvetësimi kritik i traditës); b) letërsia jonë e re si letërsi e realizmit socialist; c) vlerësimi kritik i krimtarisë së deri atëherëshme të shkrimitarëve tanë pas qëllimit.

Sigurisht, këto çështje, nuk u shtruan për

herë të parë në konferencë, po atje, si të thuash, u trajtuan gjërësisht dhe u diskutuan me hollësi. Rëndësi ka që në këtë konferencë u dënuan njëzëri pikëpamjet oportuniste të Sejfulla Malëshovës.

Rezultatet e punës krijonjëse të shkrimtarëve tanë gjatë dhjetë vjetëve të fundit dëshmojnë qartë për zhvillimin përherë më të madh të forcave tona letrare, për ngritjen e mjeshtërisë artistike, për lidhjen e ngushtë të shkrimtarëve me Partinë e me popullin, për pastërtinë ideologjike të krijimtarisë letrare, për shtimin e radhëve me shkrimtarë të rinj të ta'entuar dhe për rritjen gjithënjë e më të madhe të numurit të veprave të mira, sidomos të prozës e të poezisë. Vlerësimi i lartë që i bëri Partia punës krijonjëse të shkrimtarëve dhe të artistëve në Kongresin e saj të IV-të, vendimi i Komitetit Qëndror të Partisë «Për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve», fjalët e përzemërtë miqësore të shokut Enver Hoxha në mbledhjen e shkrimtarëve e të artistëve më 14 Korrik 1961 dhe kujdesi i vazhdueshëm për krijimin e kushteve të punës për njerëzit e artit, janë një burim i ri frymëzimi për suksese të reja dhe një garanci e sigurtë për lulëzimin gjithënjë e më të bukur të artit e të letërsisë sonë të realizmit socia'ist.

(Botuar në gazeten «Drita» 3 dhe 10 dhjetor 1961)

## **NE UDHEN E LULEZIMIT TE METEJSHEM**

*(Disa probleme të prozës sonë  
të sotme).*

Shkrimtarët tanë, të udhëhequr në krijimtarinë e tyre prej botkuptimit dhe mësimeve të partisë, të pajisur me shije të shëndosha estetike dhe duke mos e quajtur artin një stoli të vdekur, po një armë të efektëshme për realizimin e idealeve të ndritura të socializmit e të komunizmit, nëpërmjet edukimit estetik dhe ideologjik të masave, *kanë përqafuar metodën krijonjëse* të realizmit socialist dhe kanë arritur rezultate mjart të mira në punën e tyre krijonjëse.

Letërsia jonë e re, po të shprehemi në mënyrë të figurëshme, i ngjan një mozaiku plot larmi dhe me karakter unik, në të cilin ngjyrat e figurat janë të ndryshme, po edhe në harmoni me njëra tjetrën. Mund të dallojmë lehtë njërin shkrimtar prej tjetrit, po njëkohësisht, në të gjitha krijimet tona më të mira, gjejmë edhe

diçka të përbashkët shumë të rëndësishme. *Kjo diçka e përbashkët është platforma e njëjtë estetike dhe ideologjike e letërsisë sonë të re, është botkuptimi ynë i përbashkët, është metoda jonë e përbashkët krijonjëse, metoda e realizmit socialist.*

Ekspriencia jonë e deritanishme si dhe eksperienca e gjithë shkrimtarëve të vëndeve socialiste, vërteton se socializmi krijon kushtet më të mira për zhvillimin e gjithanëshëm të krimtarisë artistike, kurse realizmi socialist, jo vetëm që nuk pengon, por përkundrazi, presupozon stilin dhe profilet e ndryshme artistike, mbasi artistët e realizmit socialist, duke kryer një punë krijonjëse të *vetëdijeshme* dhe duke mos lakuuar «të habitin» botën me akrobaci fantazije dhe me ekstravaganca forme, janë të *detyruar objektivisht*, prej vetë natyrës së metodës së tyre krijonjëse, që të kërkojnë, të eksperimentojnë, të zbulojnë dhe të gjejnë mënyra dhe mjete shprehës artistike të reja dhe të bucura, të krijojnë personalitetin e tyre artistik, Bile, ne, shpesh, kemi four për kërkimet e pamjafta të shkrimtarëve dhe të artistëve tanë.

Letërsia jonë e re, pra edhe proza jonë, është vazhdim i natyrshëm dhe i drejtpërdrejtë i letërsisë sonë të mëparëshme patriotike dhe demokratike. Ajo është rezultat i vetvetishëm i procesit historik të zhvillimit të letërsisë sonë kombëtare në kushtet e luftës revolucionare kundër klasave sundonjëse dhe, sidomos, kundër diktaturës dhe pushtimit fashist.

Kurdoherë letërsia jonë përparimtare ka qënnë e lidhur ngushtë me fatet e atdheut e të popu-

llit dhe ka pasqyruar me vërtetësi jetën, mundimet, luftën, aspiratat dhe shpirtin e popullit. Shkrimtarët tanë më të mirë dhe më të përparuar kanë qënë të shumtën e herës edhe luftëtarë nga më të mirët për çështjen e popullit. Pothuajse gjatë tërë historisë, letërsia jonë ka qënë, si rrallë gjetiu, një mision luftarak dhe revolucionar.

Po si një letërsi artistike relativisht e re, letërsia jonë e së kaluarës, edhe nga vetë kushtet historike në të cilat u desh të formohej e të zhvillohej, nuk mundi të ecë hap pas hapi e krah për krah me letërsitë e tjera të zhvilluara, ashtu siç nuk mundi të ecë edhe vëndi ynë krah për krah me vëndet e zhvilluara. Për këtë arësy realizmi, që nuk mund të kuptohet i çkëputur prej zhvillimit të përgjithshëm shoqëror e kultural, në letërsinë tonë është një çfaqje e vonë, fillimet e së cilës i gjejmë vetëm këtu e pesëdhjetë a gjashtëdhjetë vjet më parë, krahas me hyrjen më të gjërë të motiveve shoqërore në letërsi. Që atëhere proza jonë është prirë drejt realizmit, duke kapercyer dalngadalë edhe vështirësitë e formimit të vet artistik, po një prozë të formuar realiste në të kaluarën nuk kemi patur.

Etapa e zhvillimit të përgjithshëm të realizmit në prozën tonë përkon me lindjen dhe me lulëzimin e letërsisë së realizmit socialist. Pa e tepëruar mund të themi se pikërisht në këtë fazë të historisë së letërsisë sonë kombëtare *realizmi del prej fazës së kfaqjeve të veçuara* dhe *kthehet në ideal estetik për gjithë letërsinë*.

Ky moment i rëndësishëm në historinë e prozës dhe të letërsisë në tërsi, është, mbasë,

një nga temat më interesante, si për studimin e karakterit dhe të fizionomisë së letërsisë sonë të sotme, ashtu edhe për vlerësimin teorik të kapercimit të kësaj letërsie prej stadir të mëparshëm të saj, si letërsi realiste akoma e paformuar plotësisht, në stadin e tanishëm, si letërsi e realizmit socialist. Këtu kemi të bëjmë me një prej veçorive historike të letërsisë sonë të re, e cila mundi të bëhet një letërsi e realizmit socialist, pa qënë më parë një letërsi realiste e zhvilluar.

Me letërsinë tonë ndodhi e njëjta gjë që ndodhi edhe me vëndin tonë, i cili kaloi në fazën e zhvi limit socialist, pa qenë më parë një vend kapitalist i zhvilluar. Këtu nuk kemi të bëjmë thjeshtësish me një krahasim, po edhe me rrethanat objektive shoqërore të zhvillimit të letërsisë sonë të re, përpara së cilës egzistonin dy rrugë të mundëshme: ose të ekte me ritmin e mëparshëm të zhvillimit dhe të mbetej prapa zhvillimit të përgjithshëm të vendit dhe të binte në kundërshtim me 'të, ose të përparonte, e shtyrë prej hovit që mori gjatë luftës Nacional-Çlirimtare dhe të ekte krah për krah me përparimin socialist të vendit, duke u shkundur gjatë udhës prej gjithë bagazhit të vjetër ideo-estetik. Letërsia jonë ndoqi, siç e shohim, udhën e dytë dhe kjo nuk ndodhi rastësish, po për shkak se, prej luftës revolucionare dhe prej transformimit socialist të shoqërisë sonë, që u kryen dhe po kryhen nën udhëheqjen e Partisë sonë të Punës, si një proces i vetëdijshëm, u krijua një bazë e atillë e fortë ideologjike, që depërttoi si forcë jetësore në të gjitha rrëmbat e ven-

dit tonë, sa që do të kish qenë anakronike, në mos qesharake, — edhe sikur të kish qenë e mundur — që letërsia të merte një udhë tjetër, të ndryshme prej rrugës që ka marë.

Ideologjia jonë marksiste-leniniste presupozon rea izmin në art dhe e orienton gjithë kri-jimtarinë artistike drejt realizmit. Në letërsinë e sotme botërore ka shëmbulla, që tregojnë se si poetë të njojur janë afruar me realizmin pikërisht pasi kanë përqafuar idetë komuniste. Po kështu, nuk është aspak e rastit dhe e diktuar prej rrethanash thjesht politike që revizionistët e sotëm në lëmin e estetikës e të artit janë kundërshtarë të realizmit dhe përkrahës së rymave dekadente dhe formaliste.

Ideollogjia marksiste-leniniste, si e vetmja ideologji deri në fund shkencore dhe objektive e zhvillimit shoqëror, është një orientonjëse e sigurtë dhe e pagabueshme për shkrirtarët e realizmit socialist. Ajo e çliron letërsinë prej çfaqjeve të shumta, që dëmtojnë vërtetësinë dhe rëndësinë edukative të veprave. Fatalizmi, pesimizmi dhe nihilizmi, përulja e turpëshme para përendisë dhe ideollogjisë fetare, kufizimi tematik dhe shmangia prej problemeve më themelore të shoqërisë njerëzore, mungesa e perspektivës dhe përhapja e ideve të huaja edhe për vetë realizmin, pacifizmi dhe mungesa e idealeve pozitive janë disa nga sëmundjet prej të cilave e çliron ideollogjia jonë realizmin. Arti i udhëhequr prej këtij botkuptimi është arti më popullor dhe më njerëzor.

Proza jonë, si gjithë letërsia, është frysme-zuar ngajeta e populit nga ka marë temat, subjektit dhe frysmit optimiste dhe luftarake që e

përshkon. Pothuajse të gjitha veprat e prozatorëve tanë, me ndonjë përjashtim shumë të rrallë, pavarësisht nga vlera dhe konsideratat artistike që mund të kemi për secilën nga 'to, janë frut i lidhjeve të drejtpërdrejta të shkrimtarëve me jetën e gjallë, me hallet, me vështirësitë, me luttën dhe me punën e popullit, me problemet që shtron historia dhe e tashmia e vëndit tonë, me shpirtin dhe me mendimet e njerëzve tanë. Kjo është një shënjë shumë e mirë që tregon se puna krijonjëse tek ne është një proces veprimtarie të vetëdijshme dhe me përgjegjësi, që nuk afron fantazinë e pambështetur në jetë dhe çkëputjen prej interesimeve dhe aspiratave ideo-estetike të popullit. Kjo është gjithashtu një prej kushteve themelore për të patur letërsi realiste.

Sigurisht, nuk mund të themi se gjithçka ka shkuar mirë në lidhjet e prozës sonë me jetën. Jeta është shumë e gjërë dhe letërsia, sado e zhvilluar dhe e pasur që të jetë, zakonisht është debitore, aq më tepër proza jonë, që është e re.

*Krahas frysëzimit* prej jetës, një prej suseve të rëndësishme të prozës sonë është edhe pasqyrimi *me vërtetësi* i jetës dhe i njerëzve. Veprat tona më të mira kanë brendi konkrete-historike dhe paraqesin *objektivisht* luftën, punën dhe jetën e njerëzve tanë. Kjo ka ndodhur se pozita prej së cilës janë nisur shkimtarët tanë ka qenë kurdoherë një pozitë e drejtë, që nuk pajtohet me shtrëmbërimin e realitetit, gjë që tek ne, jo vetëm kritika, po as lexonjësit e thjeshtë nuk e pranojnë. Parimi i analizës shoqërore-historike të jetës ka qenë dhe mbetet një prej parimeve kryesore të realizmit. Ky, si të thuash, është aspekti objektiv ideologjik, që përcaktohet prej

**botkuptimit** të shkrimtarit. Po ky problem, si të gjitha problemet e rëndësishme të artit, ka edhe aspektin estetik, që çfaqet nëpërmjet krijimit të *figurave artistike bindëse* dhe që ka të bëjë, si me traditën, ashtu edhe me mjeshterinë e shkrimtarit. Në këtë kuptim nuk mund të thuhash se të gjitha veprat tona janë të një niveli, ose që proza jonë ka arritur të jetë bindëse. Gjen ende mjaft vepra, të cilat, megjithse janë të vërteta, nuk të bindin nga që nuk të emocionojnë ose nga që autorët nuk kanë treguar kujdesin e duhur për të zbuluar në jetë atë që është me te vërtetë e rëndësishme dhe nuk i kanë dhënë dot vepres forcën dhe gjallërinë e jetës vetë.

Si pasojë e drejtpërdrejtë e lidhjes së shkrimtarit me jetën, e njoħjes prej tij të veçorive të zhvillimit tonë kombëtar dhe e ngritjes së nivelist artistik të prozës sonë, janë krijuar ambjente dhe tipa interesantë, që të térheqin vëmëndjen, si për vërtetësinë dhe për karakterin e tyre kombëtar, ashtu edhe për realizimin artistik, për forcën përgjithësonjëse, për natyrën emocionale dhe për vlerën morale edukative. Është për t'u shënuar, se proza jonë, duke u mbështetur edhe në trashëgimin letrar të së kaluarës dhe në eksperiencën e prozës botërore, ka mundur të zbulojë dhe të pasqyrojë me vërtetësi edhe tipat e ambjentet e reja të krijuara në kohën tonë prej transformimit socialist të vëndit. Po, nëqoftëse ka diçka për të cilin ná térheqin vëmëndjen me të drejtë, është pikërisht puna e pamjaftë që kemi bërë në këtë drejtim, ndonse ky do të jetë kontributi ynë më i rëndësishëm në historinë e letërsisë sonë, mbasi janë temat e reja, heronjt e rinj dhe ambjentet e re-

ja ato që përcaktojnë fizionominë e letërsisë në një periudhë të caktuar të zhvillimit të saj.

Edhe kjo është një çështje që ka preokupuar shumë kritikë dhe shkrimtarë të vëndeve sociale dhe prej diskutimeve kanë lindur shumë justifikime, ndër të cilat më i rëndësishmi është arsyetimi, se jeta në socializëm ecën me ritme të shpejta dhe njeriu ndryshon shumë më shpejt nga ç'ndryshonte më parë. Ai nuk qëndron «*ta fotografosh*». Ky arsyetim ka një anë të vërtetë, po nuk është punë të gjejmë justifikime. Duhet të mendojmë më shumë si ta kapërcejmë këtë vështirësi, si t'u bëjmë ballë detyrave tona për njojjen dhe pasqyrimin me kohë të dinamikës së jetës, *se nuk mund t'i nënshtrohet jeta natyrës dhe ritmeve të punës së shkrimtarëve, po është letërsia ajo që duhet t'u përgjigjet edhe me formën e vet ritmeve të përparimit e të transformimit të jetës e të njerëzve;* Baza objektive e kapercimit të kësaj kontradikte janë vetë shkrimtarët e lidhur me popullin, të cilët janë njerëz, që si gjithë të tjerët, ndryshojnë e përparojnë nën ndikimin e ndërtimit socialist. I vetmi shteg që ata të mos arrijnë të pasqyrojnë me kohë këto transformime, po te lemë mënjanë arsyet thjesht subjektive, mund të jetë vetëm një: *shkëputja prej jetës së gjallë, vjetërimi i opinioneve të tyre për botën e për njërezit dhe kontradikta që mund të lindë mbi këtë bazë ndërmjet formës së veprave të tyre dhe kërkesave të kohës.* Është interesant të shënojmë se këto katër-pesë vjetët e fundit, në shumë vënde, janë çelur diskutime për gjëndjen e romanit dhe përfundimi i parë që mund të nxirret prej tyre është ky: *romani i kohës sonë duhet të jetë më*

*dinamik, më i koncentruar, më i shkathët dhe më i thjeshtë, i çliruar prej përshkrimeve manieriste dhe prej zhbirimeve pafund në situatat psikologjike.* Mendoj se ky përfundim është i drejtë dhe vlen të meret parasysh edhe prej prozatorëve tanë.

Së fundi, një prej sukseseve të prozës sonë në rrugën e konsolidimit të realizmit janë përpjekjet e deritanishme për krijimin e stileve r ealiste, për shkëputjen gjithnjë më të dukëshme të shkrimtarëve tanë prej elementeve romantike të vjetëruara dhe, sidomos, sentimentale, që kemi trashëguar nga e kaluara dhe që s'mund të themi se i kemi kapërcyer plotësisht.

Sic shihet, proza jonë, në themel e veta, në çfaqjet e veta më të rëndësishme dhe në prirjet e veta është një prozë realiste, një prozë që ka hyrë në udhën e realizmit socialist. Proçesi i kosolidimit të realizmit në prozën tonë, nuk është një fenomen i ri, që u çfaq këto katër-pesë vjetët e fundit, po një fenomen, fillimet e të cilit i gjejmë, jo vetëm që në vjetët e parë të letërsisë sonë të realizmit socialist, po edhe më parë, në krijimet dhe në anë të veçanta të veprave të shkrimtarëve tanë të mëparshëm. Realistë janë tregimet e Migjenit: «*Historia e njenës nga ato*», «*Bukën tonë të përditshme falna sot*», «*A don qymyr, zotni*», dhe «*Studenti në shtëpi*». Elemente dhe vlera të veçanta realiste gjejmë edhe në veprat e Ndoc Nikajt, të Mihal Gramenos, të Foqion Postolit, të Haki Stërmillit dhe në dy romanet e mëparëshme të Sterjo Spasses. Këtë trashëgim, si dhe gjithë traditat e prozës e të letërsisë sonë kombëtare, duke nisur që nga

më të vjetrit, ne duhet ta njohim mirë dhe të mësojmë prej tij.

Veç këtyre, trashëgimi në lëmin e artit nuk duhet parë ngushtësish vetëm në aspektin e tij kombëtar, pasi çdo letërsi nuk mund të kuptohej e çkëputur prej zhvillimit të përgjithshëm artistik të njerëzimit. Dhe letërsia jonë është mbësh-tetur dhe do të mbështetet kurdoherë në traditat më të mira të letërsisë botërore,, sidomos në traditat më të mira të realizmit prej nga kemi për të mësuar shumë. Mbase sot, prej vetë gjëndjes dhe problemeve që shtron letërsia jonë, si letërsi e përparuar; më tepër se kurrë, është ko-ha të kuptojmë më thellë eksperiencën e grumbulluar gjatë shekujve dhe të përfitojmë më mirë prej saj. Në mënyrë të veçantë theksojmë ndikimin e letërsisë sovjetike, e cila ka qënë me të vërtetë fanar ndriçonjës për letërsinë tonë të re të realizmit socialist. Veprat e Gorkit, të Majakovskit, të Fadajevit, të Ostrovskit, të Shol'ohovit dhe të shkrimtarëve të tjera sovjetikë kanë qënë modelet e gjalla para të cilave shkrimtarët tanë panë të ardhmen e letërsisë sonë. Studimet e estetëve dhe kritikëve sovjetikë, materialet e kongresit të parë të shkrimtarëve sovietikë dhe dokumentat e tjera që flasin për zhvillimin e artit të realizmit socialist në Bashkimin Sovjetik kanë ndihmuar shumë për njojen teorike të rea'izmit socialist ndër ne.

## II

Në prozën tonë të deritanishme janë trajtuar shumë tema të rëndësishme. Tema e dashuri-së dhe e luftës për liri dhe drejtësi, tema e sa-

krifikimit në emër të idealeve të mëdha revolucionare socialiste, e triumfit të së resë mbi të vjetrën në jetën tonë të sotme, tema e lindjes dhe konsolidimit të botkuptimit dhe të mëmori komunist dhe të transformimit të ndërgjegjes së njerëzve, si dhe disa tema të tjera, kanë qenë objekti kryesor i vëmëndjes dhe i punës krijojnëse të prozatorëve tanë. Si terren i trajtimit të këtyre temave kanë shërbyer për prozatorët tanë manifestimet më të rëndësishme të jetës sonë kombëtare dhe shoqërore, siç janë luftat e të parëve tanë për liri e drejtësi («Për mëmëdhënë», i Thoma Kacorit, «Të munduarit» i Hasan Petrelës, «Hasta la vista» i Petro Markos, «Ata nuk ishin vetëm» i Sterjo Spasses, tregimet «Fyelli i Tanës» dhe «Ditët e spasme të Gjorgj Golemit» të Dhimitër Shuteriqit dhe mjaft tregime të autorëve të tjerë); lufta partizane prej së cilës janë fyrmezuar vepra si «Përmbyrsja» dhe mjaft tregime të Fatmir Gjatës, «Vjeshtë me stuhin» dhe disa tregime të Ali Abdihoxhës, «Çlirimtarët» i Dhimitër Shuteriqit, libri «Në gojën e ujkut» i Kin Dushit, «Kali i mbretit dhe kalorës të rinj» i Qamil Buxhelit, «Endra dhe plagë» e Nasho Jorgaqit dhe shumë tregime e novela të autorëve të ndryshëm si Jakov Xoxa, Zihni Sako, Sotir Andoni e të tjerë; jeta jonë e sotme dhe transformimi socialist i vëndit, në të cilat mbështeten vepra si romani «Kënetë» dhe noveala «Tana» të Fatmir Gjatës, «Udha e Velanit» e Kin Dushit «Pelikanët ndrojnë fole» e Reshat Nepravishtës, «Bereqetë» dhe «Ditë të gëzuara» të Zihni Sakos, dhe vëllimet me tregime të Dhimitër Shuteriqit, Naum Priftit, Dhimitër Xhuvanit, Dalan Shaplos, Gazmend Kongolit etj.

Pra, përfundimi i parë që mund të nxjerrim për këtë çështje është, se proza, në përpjekjet e veta për të zgjeruar gjithnjë e më shumë kufijt tematikë, është mbështetur kurdoherë në jetën e popullit, në realitetin tonë. Prozatorët tanë i ka tërhequr kurdoherë procesi i zhvillimit progresiv të shoqërisë sonë dhe kanë zbuluar në përgjithësi me sukses filizat e reja në jetë.

Partia shpesh herë ka theksuar domosdonë e afrit sa më të madh të shkrimtarëve me jetën e popullit. Kjo porosi e Partisë u theksua në mënyrë të posaçme edhe në vendimin e K.Q. të P.P.SH. për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve dhe në Kongresin e IV të Partisë. Njohja e thellë dhe e gjithanëshme e jetës për shkrimtarët e talentuar është nevojë, se vetëm duke ndjekur këmba-këmbës jetën dhe ndryshimin e njerëzve tanë, duke jetuar me problemet e kohës dhe me hovin e punës ndërtimtare, ne mund të zbulojmë dhe të pasqyrojmë në veprat tonë ato elemente të reja, me të cilat pasurohet e zbulurohet vazhdimisht jeta e popullit.

Disa herë ne kemi një parafytyrim të vjetëruar, të ngushtë dhe të gabuar për jetën dhe për njerëzit tanë. Ka ndodhur që edhe nënër mbledhje e në shkrime të jepen përcaktime të tipit të shqiptarit apo të bëhen konstatime për natyrën e tij. Dhe thuhet: «*shqiptari të vret, për çështje nderi*», «*shqiptari nuk i nënshtrohet gruas*», «*shqiptari nuk pi çaj*», «*shqiptari nuk bën këtë*», «*shqiptari bën atë*». Po për cilin shqiptar thuhen të gjitha këto? Për shqiptarin e fillimit të shekullit, apo për shqiptarin e ditëve tonë? Për atë fshatarin e dikurshëm të prapambetur, apo për kooperativistin e sotëm, që të mos përmendim puntorin dhe intelektualin?

Ekstremi tjetër do të ishte skllavërimi prej fakteve të vëguara, që nuk shprehin një gjëndje reale dhe një tendencë në çfaqjet objektive të jetës, sundimi i këtyre fakteve në vepër dhe përdorimi i tyre i keq për të nxjerrë përfundime të gabuara. e për të bërë përgjithësimë të padreita. Kam përshtypjen se proza jonë nuk ka vuajtur gjer tanë prej një të mete të tillë, bile, mund të themi, se akoma janë të pakta dhe të pamjafta përpjekjet që të sillet në letërsi material i freskët nga jeta. Ky proces i filluar duhet nxitur dhe përkrahur me të gjitha forcat, duke patur parasysh ngahera domosdonë e seleksionimit dhe trajtimit kritik të materialit jetësor, jo sipas disa formulave skolastike, po sipas kritereve të shëndosha revolucionare të botkuptimit, të moralit dhe të idealeve tona estetike.

Shumë gjëra kanë ndruar rrënjosisht në jetën tonë dhe këto ndryshime kanë sjellë dhe po sjeillin me vete edhe ndrimin e mënyrës së jetesës, të zakoneve, të mendimeve dhe të shpirtit të njerëzve. Ne nuk duhet të mbajmë anën e patriarkalitetit dhe të zakoneve mikroborgjeze, po siç ka ndodhur në të shumtën e rasteve deri tanë, duhet të ecim krah për krah me jetën, me njerëzit tanë, me transformimin socialist të vendit.

Eshtë për të ardhur keq që në prozën tonë të derisotme nuk ka hyrë figura e punëtorit dhe jetë e fabrikave, e kombinateve, e minierave dhe e kantiereve të ndërtimit. Po mund ta marim si shënjë të mirë që kanë hyrë inxhinjerët dhe po hyjnë, dalngadalë, edhe teknikët, Siç duket, prozatorët u ngjajnë gjahtarëve të mirë: zënë pritë dhe nuk shpejtojnë të heqin këmbëzën e armës, pa qenë të sigurtë se do qëllojnë në shenjë.

Shakaja nuk e thotë ngaherë të vërtetëtën plotësisht. Këtu ka mjaft arsyе objektive dhe subjektive. Përgjithësisht, gjer tanë ne kemi qëndruar larg klasës punëtore dhe nuk e kemi ndjekur sa duhet procesin e formimit, të rritjes dhe të përparimit të saj. Vetëm në disa vepra, duke u nisur nga kritere jo aq artistike, janë futur punëtorët për të ilustruar tezën, se lufta dhe ndërtimi i socializmit bëhet nën udhëheqjen e klasës punëtore. Dhimitër Shuteriqi, në romanin «Çlirimtarët», është munduar mjaft ta nxjerrë Gani Gurin puntor dhe ta sjellë prej Kuçove n'Elbasan. Këtë gjë kanë bërë edhe Sterjo Spasse e Fatmir Gjata në romanet «Ata nuk ishin vetëm» dhe «Përmbyjsja».

Në jetën tonë, në shoqërinë tonë, në famijet tona, në rrëthim e miqve dhe të farefisit tonë ka shumë punëtorë. Ne i njohim dhe i duam ata. Ne njohim dhe admirojmë punën e vështirë të ndërtonjësve dhe të prodhonjësve tanë, rrojmë në shtëpitë e ngritura prej tyre dhe përdorim nga ditë prodhimet e dala nga duart e tyre. Ne jemi nën ndikimin e forcës dhe vullnetit të tyre, kemi përqafuar ideologjinë e tyre, udhëhiqemi prej Partisë sonë të Punës, që është parti e punëtorëve dhe e masave punonjëse. Dhe, duhet thënë, gjithë veprat e mira të prozës sonë, në kuptimin e gjërë të fjalës, pëershkohen nga fryma dhe idealet e klasës punëtore, që janë bërë idealet dhe piksynimet e gjithë popullit tonë.

Të gjitha këto na bëjnë të besojmë se kardhë koha që në veprat e prozatorëve tanë të hyjnë me guxim punëtorët, siç kanë hyrë edhe në jetën tonë. Poezia e kohëve të fundit e dha shëmbullin. Ky do të jetë një sukses shumë me

rëndësi për letërsinë tonë, jo aq se do të flitet për punëtorë dhe për fabrika, megjithse edhe kjo ka rëndësi, po sepse, duke hyrë punëtori në letërsi do të sjellë me vete diçka të re, si për brendinë ashtu edhe për vlerën artistike të prozës sonë. Në jetën e klasës punëtore shkrimtarët tanë do të gjejnë po aq tema dhe subjekte interesante, sa edhe në çdo aspekt tjetër të jetës së popullit.

Me njohjen e jetës, me hetimin, kërkimin dhe zbulimin e momenteve poetike të jetës, me gjetjen e elementeve të reja të zhvillimit, që shprehin pulsin dhe prirjen e ecjes përparrë të vëndit tonë nis edhe procesi i krijimit të figurave artistike. *Ka vepra të mira të frysmezuara drejt-përdrejt nga jeta, që sjellin diçka të re, interesante dhe emociononjëse, ndonse mund të kenë edhe të meta, po nuk ka vepra të mira të pa frysmezuara nga jeta, sado me «mjeshtëri» të jenë shkruar ato. Emocioni i zbulimit të diçkaje të re është, jashtë çdo diskutimi, një prej vlerave më të mëdha estetike të veprave letrare.* Në jetën tonë të sotme kanë ndodhur shumë transformime të mëdha në marrëdhëni ndërmjet njerëzve, në botkuptimin dhe psikologjinë e tyre, në qëndrimin e shoqërisë ndaj individit dhe në qëndrimin e individit ndaj shoqërisë. E vjetra po shëmbet përfundimisht edhe në shpirtin, edhe në mendjen e njerëzve. Hetimet e mëtejshme të shkrimtarëve në këtë drejtim do t'i sjellin prozës sonë shumë materiale me vlerë, do ta gjallëronin më tepër, do ta freskonin më shumë dhe, si pasojë, do të rriten akoma interesimi i lexonjësve për veprat tonë.

Po, interesimi për individët dhe për krijimin e figurave artistike nuk duhet të na shpjere në

mohimin e sfondit shoqëror-historik të veprave, se ashtu siç humbet një shtatore e vogël mbi një pjedestal gjigand, ashtu nuk mund të qëndrojë edhe një shtatore gjigjande mbi një pjedestal prej balte. Ky nuk është ndonjë rrezik për prozën tonë të sotme, po ka edhe ndonjë vepër, si romani «*Buzë liqenit*» i Sterjo Spasses, në të cilat figura artistike nuk mbështetet si duhet në terrenin historik të kohës sonë. Autori i romanit «*Buzë liqenit*» ja ka besuar më tepër fantazisë krijimin e figurës kryesore të romanit, i cili, në mos për natyrën dhe ambicjet e veta, të paktën për proporcionet që i janë dhënë, nuk i përgjigjet realitetit të kohës, Autori, duke mos u marë gjerësisht dhe thellësisht me kushtet që e pollën Spiro Gurmadihin, duke iu shmangur detyrimeve ndaj të vërtetës së jetës, ka krijuar vetveti një personazh jo aq real në qënien, në lakmitë dhe nënë veprimet e veta. Në një vend të romanit autorit tregon si u pasurua Spiro Gurmadihi, — që paskish qënë fshatar i varfër e i këputur, — *duke çe'ur toka të reja, duke vjedhur nga toka e të tjerëve, me kërcënime dhe me lloj-llojë mënyra të tjera. Si përfundim, nga 90 dynim tokë, që i dha reforma agrare, ai arrin të ketë 145 dynim më 1950. Ai ka krijuar edhe një kope të madhe me bagëti, po me atë mënyrë.*

Sikur autorit t'i kishte paraqitur me realizëm marëdhëniet e reja, që ishin krijuar në fshatin tonë gjat dhjetë vjetëve të para pas çlirimt, sikur ai t'i kishte dhënë më tepër vënd bazës shoqërore mbi të cilën ka ngritur konfliktin dhe figurën e Spiro Gurmadihit, atëhere, vetë të dhënët e jetës, do ta kishin latuar figurën dhe do ta kishin bërë më të besueshme, më artistike, bile, edhe më njerëzore.

Edhe në novelën «*Sinfoni e pambaruar*» Sterjo Spasse, duke iu shhangur bazës shoqërore-historike dhe duke kaluar përciptas disa momente me rëndësi në jetën e heronjve, ka krijuar personazhe që nuk janë të vërtetë. Nuk mund ta kuptojmë ne një vajzë, që ka marë pjesë në demonstratat e para, që ka folur nëpër mbledhjet ilegale për detyrat e grave në luftë, të vijë fundit dhe të katandiset për t'u martuar me një të vdekur. Edhe qëndrimin e Lekë Korabit ndaj saj, kur i bën thirrje të afektuara për t'u martuar dhe për të lindur fëmijë, nuk e kuptojmë dot, po të kemi parasysh ato që përmëndëm. Kjo na duket se është më tepër një kllapi, se sa një pasqyrë reale e njerëzve dhe e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Prandaj, e meta themelore prej së cilës vinë të gjitha të këqiat ideologjike dhe artistike të novelës, është *baza e saj e pavërtetësia, pavërtetësia e tipave, pavërtetësia e kushteve shoqërore-historike* në të cilat ata rrjnjë.

T'u qëndrojmë besnik të vërtetave të jetës — kjo është një nga kërkesat themelore të realizmit socialist. Fantazia ka vëndin e vet në letërsi, po ajo nuk mund të mënjanojë realitetin, nuk duhet kursesi ta largojë shkrimtarin prej realitetit.

Në prozën tonë shpesh u lihet më tepër vënd se në jetë veprimeve të vullnetëshme të personazheve dhe të krijuhet përshtypja se gjithçka varret vetëm prej mendimeve, vullnetit dhe fjalëve të tyre. S'do mënd që proza jonë do të meret, para së gjithash, me karakteret e forta, me njerëzit e ndërgjegjëshëm dhe të vullnetshëm të kohës sonë, po është e nevojshme të kemi parasysh më tepër edhe kushtet objektive, edhe rethanat historike

që ndikojnë në jetën e njerëzve që, në fund të fundit, përcaktojnë edhe mendimet, edhe vullnetin e tyre. Prozatorët tanë deri më sot janë marë kryesisht me veprimtarinë e vu'l netëshme të njerëzve për transformimin e jetës, po janë marë pak me ndikimin e madh të jetës për transformimin e njerëzve. Të arrijmë këtu, do të thotë të dalim në fushën e gjërë të veprimtarisë njerëzore, të çlirohemi prej ngushtësisë dhe prej ndërtimit gati-gati dramatik të veprave të prozës. Jo në tregime, po edhe në ndonjë prej romaneve tonë, subjektet ndërtohen mbi bazën e një konflikti dramatik, ku vihen njëri kundër tjetrit protagonisti dhe antagonist i ose, në rastin më të mirë, krijohet një thurje dramatike, në rrjetin e së cilës përpëliten disa njerëz.

Kapërcimi i kësaj të mete është një sukses tjetër i prozës sonë të realizmit socialist. Largimi prej subjekteve të ndërtuara në formën e intrigës dramatike dhe përpjekjet për ta përqafuar jetën me krahë të hapur, ka sjellë me vete tri të mira kryesore: mbështetjen e subjekteve dhe të tramës së veprave, jo në intriga të menduara e të përcaktuara vetëm prej pasionit të personazheve, po në kushtet shoqërore-historike dhe në jetën e popullit; ka krijuar realisht mundësinë e pasqyrimit të veprimtarisë historike të masave dhe ka çliruar heronjtë e veprave prej kthetrave të skematzimit dhe prej skemave të paramenduara, u ka që'ur atyre horizonte të gjëra veprimi. Ky sukses është shoqëruar disa herë edhe me mungesa kompozicionale, po kjo është e keqja më e vogël në këtë rast, një e keqë që mund të kapërcehet dhe do të kapërcehet shumë më lehtë se skematzimi dhe ngushtësia e pasqyrimit të jetës. Le të

kujtojmë romanin «*Këneta*» të Fatmir Gjatës dhe «*Hasta la vista*» të Petro Markos. Në të parin, shkrimtari, krahas linjave dhe aspekteve të tjera, ka përshkruar edhe dashurinë e *Stavri Larës* me *Rinën*. Kjo linjë shumë lehtë mund të merte formën e një intrige të vogël e të menduar, që do të binte në kundërshtim me natyrën e konceptimit të përgjithshëm artistik të subjekut. Bile, në fillim, të lihet përshtypja që këtë udhë do marë, po shpejt e kuption që nuk do të jenë pasionet dhe mendimet, po jeta që do t'i afrojë përsëri këta heronj. Merita e shkrimtarit është që dëshirat e heronjve të veprës i ka pajtuar me tendencën e zhvillimit historik, ndaj nuk ka patur nevojë të krijojë skena dramatike e melodramatike.

Edhe Petro Markua nga të njejtat pozitë artistike është nisur kur ka shkruar romanin «*Hasta la vista*» në themel e të cilit ka vënë jetën në kohën e luftës së Spanjës dhe jo intrigën e vogël. Ai, bile, edhe linjën e dashurisë së *Gori Gjinlekës* me *Anita Gonzales Seton* e ka çliruar prej skenave të paramenduara. Sikur të kishte vepruar ndryshe, sikur çdo lëvizje të personazhevë ta kishte skemuar sipas kërkesave skematike, ai nuk do të kishte patur mundësi të pasqyronte objektivisht e me gjërësi atë mori aspektesh nga lufta dhe nga jeta në luftë.

Proza jonë, sidomos gjatë dhjetë vjetëve të fundit, ka luftuar vendosmërisht kundër skematizimit që ishte një prej sëmundjeve foshnjore të saj dhe, mund të themi, se sot nuk është më një plagë çqetësonjëse, megjithse masat e karantinës nuk duhen hequr asnjëherë. Edhe ky është një sukses i rëndësishëm krijonjës i prozatorëve tanë, që e ka burimin në afrimin e tyre me jetën dhe

në zotërimin e mjeshtërisë. Sot është vështirë të gjesh, ndërmjet krijimeve të prozatorëve tanë më të mirë, vepra skematike. Vec. krahas kësaj, do thënë që *elemente të skematizmit*, haje të tij mund të gjesh akoma në krijimet tonë, pa qenë nevoja të përdorësh aparate me reze Rontgen.

Kritika janë ka folur shpesh për skematizmin dñe ka folur në dy mënyra: *ose janë kritikuar vepra vërtet skematike, ose është bërë thirrje për skematizëm.*

Në vitet e para pas çlirimt pati mjaft vepra skematike. Dhe nuk është për t'u çuditur. Së pari, prozatorët n'atë kohë pa dyshim jo të gjithë — viheshin përballë një realiteti të ri dhe kishin përparrë pretendime të reja ideo-estetike. Si duhej pasqyruar ky realitet i ri? C'femene duhej të tërhoiqnin vëmëndjen e shkrimitarëve? Cilat qenë ato tipare të reja morale të heronjve të rinj që duheshin theksuar? Cilat duhej të qenë piksynimet estetike të prozës së re? Po të kemi parasysh përvojën e paktë letrare të shkrimitarëve të rinj të asaj kohe, mund ta kuptojmë lehtë sa punë e vështirë ishte të gjenin zgjidhje të gjitha këto probleme krijonjëse theme'ore.

Sot punët kanë ndryshuar tepër dhe, para së gjithash, prozatorët tanë, në krahasim me periu-dhën e tyre rimore, janë bërë njohës të mirë të jetës e të mjeshtërisë letrare, janë pasuruar ideologjikisht dhe, jo vetëm nga ana teorike, po edhe nga ana praktike, kanë bërë të tyret pari-mët krijonjëse të realizmit socialist. Po edhe sot gjen aty këtu kërkesa për të ringjallur skematizmin. Ndodh që lavdërohen vepra të dobëta vetëm se janë «në rregull» dhe kritikohen vepra

të mira, ose edhe shumë të mira nga që thyejnë «disiplinën», ndonse mund që kanë edhe ndonjë të metë.

Eshtë kërkësë kategorike e metodës krijuar njëse të realizmit socialist që t'u qëndrojmë sa më larg skemave, kanoneve skolastike dhe përpjekjes për të futur në kallëpe të parapërgatitura jetën e gjallë, njerëzit dhe krijimtarinë letrare. Kjo eshtë e vetmja rrugë për të shpëtuar prej skematizmit dhe tanë në këtë udhë eshtë vënë proza jonë.

### III.

Disa herë gjer tanë na u desh të meremi, krahas me çështjet që trajtuam, edhe me heronjtë e veprave që zumë në gojë. Këtë pjesë të referatit do t'ja kushtojmë krejtësisht problemeve të tipit shoqëror, të karakterit psikologjik në prozën tonë dhe, bashkë me 'to, edhe çështjes së krijimit me realizëm të ambjenteve në të cilat veprojnë këta tipa.

Këto janë çështje themelore të artit realist, mbasi pa tipa dhe ambjente të krijuara me realizëm, nuk mund të bëhet fjalë as për vepra e për letërsi të realizmit socialist.

Frutet e punës së deritanishme krijonjëse të prozatorëve tanë dëshmojnë, se edhe në këtë drejtim, proza jonë eshtë në rrugë të mbarë dhe ka patur disa suksese të rëndësishme. Heronjtë e romaneve, tregimeve dhe novelave tonë kanë qënë njerëzit e popullit, bashkëkohësit tanë, luftëtarët e ndërgjegjshëm të çlirimt shoqëror dhe të ndërtimit të socializmit, njerëzit e përparruar të kohës, përfaqësonjësit e të sotmes dhe

të ardhmes së atdheut tonë. Kjo është dëshmia më e mirë për brendinë e shëndoshë të prozës sonë dhe për karakterin e saj të thellë demokratik popullor, për fryshtën e saj revolucionare. Nga arra artistike po ta shqyrtojmë këtë çështje, me gjithë dobësitë që mund të na bien në sy, do të vrejmë, se edhe në krijimin e tipave prozatorët tanë qëndrojnë në pozita përgjithësisht realiste, duke mos përjashtuar edhe disa nota të fortë romantike, që vrehen aty këtu.

Para së gjithash vlen të shënojmë se metoda realiste e krijimit të tipave, vec zbulimit të karaktereve tipike në jetë, presupozon edhe formimin e tyre si tërësi unike shoqërore — psikologjike. Çdo tip i vërtetë dhe i realizuar me mjeshtëri është, siç dihet, edhe një përgjithësim artistik, edhe një individ i veçantë, është, si të thuash, *e përgjithëshmja që cfaqet nëpërmjet të veçantës, e veçanta që mishëron të përgjithëshmen*. Le të marim, për shëmbull, *xha Koroveshin* e Sterjo Spasses. Nëqoftëse ky personazh na bën përshtypje dhe, bile, del edhe pënpa para heroit kryesor të veprës, kjo ndodh se ne e shohim, e njohim dhe bindemi që i atillë ka qenë vërtet, siç kanë qenë dhjetra e dhjetra xha Koroveshër që kemi njohur ose për të cilët kemi dëgjuar të flitet. Kurse *Gjikë Shpati* nuk na bën këtë përshtypje, megjithëse, edhe te ky duket dora skalitëse e shkrimtarit. Nuk na bën përshtypjen e xha Koroveshit, pasi shkrimtari ka përshkruar më tepër idealin e tij, të mishëruar tek një njeri, se sa një njeri të gjallë, tipin e fshatarit real, që lufton kundër shtypjes ekonomike dhe shoqërore. Në këtë rast, po të

përdorim një shprehje të Engelsit, shkrimtari «për hatër të Shilerit ka sakrifikuar Shekspirin».

Ndër tipat më të realizuar të prozës sonë mund të përmendim edhe *Hatijen*, *Nadiren*, *Muzafër Aliun*, *Maksutin* («Clirimtarët» e Dh. Shuteriqit), *xha Nelon e Rrako Ferrën* («Afërdita përsëri në fshat» dhe «Ata nuk ishin vetëm» të Sterjo Spasses). *Gurkën*, *Mehmet Mullixhiun*, *Stavri Larën*, *inxhinier Mborjen* («Përbmbysja» dhe «Kënetë» të F. Gjatës), *Puçellin*, *Gori Gjin-lekën*, *Anitën* («Hasta la vista» e P. Markos), *Lumtën* dhe *Petritin* («Një vjeshtë me stuhi» e A. Abdihoxhës) e të tjerë. Në këto raste dhe në raste të tjera si këto, shkrimtarët kanë mundur të pasqyrojnë me realizëm shpirtin e njerëzve, të analizojnë dhe të përcaktojnë me mjeshtëri personalitetin e këtyre tipave, duke na i dhënë edhe si përgjithësime shoqërore, edhe si individualitet të caktuara.

Heronjtë e veprave të prozës sonë janë njerëz realë, të marë nga jetë, ashtu siç janë reale edhe fenomenet shoqërore dhe problemet që trajtohen prej prozatorëve tanë. Vetëm në raste të rra'la na dalin përpëra personazhe të shpifura, që nuk i përgjigjen së vërtetës dhe që nuk kanë mish e kockë. Po, në përgjithësi, — dhe një gjë e tillë mbështetet edhe prej eksperiencës së paktë jetësore, edhe prej shkallës së zotërimit të temave, edhe prej përvjohjes artistike, — sidomos në heronjtë pozitivë ne njejmë një dozë të theksuar elementësh idealizimi, një largim të tepëruar prej njerëzve konkretë, të vërtetë. Pothuajse shumica e heronjve kryesorë të romaneve tonë, duke përfshirë këtu edhe më të realizuarit, megjithëse shprehin mendimet dhe aspi-

ratat tonë, megjithëse janë njerëzit tanë, luftëtarët e çështjes sonë, mbeten larg nesh, nuk na pushtojnë me forcën e mendimeve dhe me zjarrin e zëmrave të tyre. Kjo ndodh, kur nuk shohim sa duhet *njeriun*, po detyrën që kryen ai, nuk shohim njeriun që kryen detyrën e komisarit e të komandantit partizan, të sekretarit të partisë a të luftëtarit të pararojës, po krijojmë një skelet, të cilin e veshim me brumin që duam ne, i japim trajta t'atilla, që e bëjnë atë ireal. Ky është një prej problemeve më të rëndësishme të tipizmit në gjëndjen e sotme të prozës sonë, mbasi heronjtë tanë janë flamurtarët e idealeve tonë dhe, po të mos jenë ata plotësisht të vërtetë dhe bindës, atëherë edhe veprat tonë vetveti do të humbasin shumë prej vlerës së tyre si vepra realiste. Në këtë mes ushtrojnë ndikim negativ kërkesat skematike të kritikës dhe, duhet ta pranojmë, edhe piksynimet skematike të shkrimtarëve, të cilët, prej dëshirës që të krijojnë heroin e vërtetë të kohës, e rëndojnë aq shumë atë me elemente ideale, sa harrojnë, që edhe ai është njeri si gjithë njerëzit e tjerë, që vuan e që gjëzon, që ëndëron dhe që mendon, që mund të ketë fatkeqësi në jetë dhe që mund të tërhiqet apo edhe të dështojë ndonjëherë, që gjykon në mënyrë autokritike veprimet e veta dhe që mund të stepet para një situate të papritur. Ai është njeri që s'mund të kuptohet i çkëputur prej marëdhënieve shoqërore që e kanë lindur dhe që ndikojnë në karakterin dhe në personalitetin e tij. Ai vepron si shprehës i vullnetit të masave dhe, prandaj, veprimet e tij i nënshtrohen ngaherë gjykimit të masave. Me një fjalë, ai, si gjithë të tjerët, është njeri i gjallë.

Në romanet tona, shumë heronj të dorës së dytë janë më të skalitur se heronjtë kryesorë. Gurka është më i vërtetë dhe *Luftar Bregu* («Përmbyssja» e F. Gjatës). *Puçelli* nga *Gori Gjinleka*, («Hasta la vista!» e P. Markos), *Llambi Linua* nga *Til Stefani* dhe *Loni Sotiri* («Udha e Velanit» e K. Dushit).

Zakonisht duhej të ndodhte e kundërta, se vëmëndja kryesore e shkrimtarëve përqëndrohet në heronjtë më të rëndësishëm të veprave, po mbasë prej kujdesit të tepëruar, mbasë prej dëshirës që heronjtë kryesorë të shprehin gjithë idealet tona, mbasë prej paracaktimit të veprimeve dhe të mendimeve të tyre, ata dalin më të zbetë dhe nuk kanë rëndësinë që duhej të kishin. Një e metë e tillë mund që të përligjet në ato periudha historike, kur realiteti nuk na jep heronj që t'iu përgjigjen idealeve tona, po sot, kur idealet tona janëjeta dhe lufta jonë, kur njerëzit tanë janë heronjtë e idealeve tona, nuk ka arsy që të shpikim heronj të pabesueshëm, kur mund të *marim ngajeta heronjtë realë dhet'i përshkruajmë realisht*. Nëqoftëse themeli do të jetë i qëndrueshëm, atëhere pa frikë mund të shprehim edhe atë që është ende ideale, nëpërmjet asaj që egziston.

Një arsy që heronjtë tanë kryesorë marin shpesh trajta të pasakta e të pavërteta është edhe nënvizimi i tepëruar i tipit shoqëror dhe lënia mbas dore ose harrimi i karakterit psikologjik. Shkrimtarët tanë kanë patur si burim të veprave të tyre jetën e masave punonjëse dhe si heronj njerëzit e dalë prej këtyre masave, sidomos fshatarësinë e varfër dhe, më pak, shtresat e varfëra të qytetit dhe klasën punëto-

re. Me të drejtë, gjithashtu, janë nxjerrë në plan të parë motivet shoqërore dhe ekonomike të luftës dhe të përcaktimit të heronjve. Po, dihet nga të gjithë, që njerëzit nuk janë një pasqyrë pasive në të cilën reflektohen njësoj kushtet dhe rrethanat e jetës. Secili ka temperamentin dhe karakterin e vet dhe temperamenti e karakteri janë forca aktive në jetë që, nganjëherë, marin rëndësi vendimtare në përcaktimin e rrugës së njeriut. Heronjtë tanë kryesorë, shpesh, janë karaktere psikologjike të papërcaktuara, ose, mendonjë përjashtim të rrallë, të gjithë janë sanguinë, kurse personazhet e lëkundshëm janë zakinist flegmatikë. Edhe kjo është një prej arsyeve që krijon uniformitet dhe monotonji.

Pak kujdes tregojmë në edhe për pasqyrimin e «dialektikës së shpirtit» të njerëzve. Heronjtë e veprave tona shumë herë janë njerëz të formuar plotësisht dhe që ndjekin një vijë horizontale zhvillimi. Ndryshojnë kushtet, ndrojnë rrethanat, ndron pozita e tyre në jetë, po atëmbeten siç i kemi njohur në fillim, ose, në rastin më të mirë, pësojnë ndryshime krejt të parëndësishme. Kjo shkakton disa herë që edhe personazhe të skalitur me mjeshtëri, siç është, bie fjala, Puçeli i Petro Markos, vjen një moment në vepër dhe humbasin interesin, se shkimitari, pasi ka zbuluar para lexonjësve anët e ndryshme të karakterit e të personalitetit të tyre, vihet e krijon situata të reja, në të cilat nuk zbulohet diçka e re, po përsëriten ato gjëra që janë thënë edhe më parë për personazhin.

Ndodh edhe diçka tjeter në rastet kur shkimitari ka treguar pak kujdes për zhvillimin shpirtëror të personazhit ose nuk ka mun-

dur ta japë këtë zhvillim në udhë të natyrëshme. Atëherë gjëndet ose krijohet një ngjarje e fortë ose e jashtëzakontë që shërben për të kryer një përbysje të plotë në shpirtin e personazhit. Kështu ka vepruar, për shëmbull, Kin Dushi me *Llambi Linon* në romanin «Udha e Velanit». *Llambi Linua* është fshatar i mesëm, ka qenë ngahera *pronar* dhe *bujk*, ndaj është e natyrëshme të ketë një natyrë të dyfishtë, që e afrojn me socializmin dhe e largon prej tij. Element tjetër që e afrojn me socializmin *Llambi Linon* është edhe revolucioni popullor, sidomos gjaku i vëllait të vrarë gjatë luftës. Pra, veç momentit ekonomik, ka edhe një moment politik që e afrojn këtë njeri me socializmin, ose, të paktën, me pushtetin popullor. Pra, kemi të bëjmë me një rast *tipik* ngajeta e fshatarësisë sonë. Ky njeri, kur vjen puna për kolektivizimin e bujqësisë, kallon në pozita të kundërtta. Edhe kjo është e natyrëshme, ka arsyen ekonomike dhe sentimentale, siç na i ka dhënë autori. Domethënë këtu kemi të bëjmë me një *zhvillim* të mendimit dhe të shpirtit të këtij njeriu: pronari fiton përfundimisht mbi bujkun, e vjetra mbi të renë; *Llambi Linua* bashkohet me armiqjtë. Deri këtu ai ka një zhvillim të natyrshëm, ndonse shkrimitari nuk na ka dhënë gjithë kopleksitetin e ndjenjave dhe të mendimeve të personazhit, po gati e ka fshirë njerën anë të natyrës së këtij fshatari dhe ka nënvizuar tjetrën. Në fund (s'është nevoja të tregojmë episodet, se romani njihet prej të gjithëve), kur ngjarjet marin forma e ngjyra tepër dramatike, *Llambi Linua* ndesh rastësish në lapidar e të vëllait dhe, aty për aty, bën një kthesë rrënjosore, ndodh në mëndjen dhe në

shpirtin e tij një përmbyssje e plotë. Para "nies së tanë del Llambi Linua që do të dëshironim: *fshatari i mesëm, që bashkohet me socializmin.*

Dy momente me rëndësi e kanë shtyrë autorin, me sa duket, të zgjedhë këtë mënyrë kapërcimi të menjëhershëm, efektuoz dhe të lehtë. Së pari, siç thamë, ai i ka dhënë shumë pak vënd në roman paraqitjes së kontradiktave në psikologjinë, në mendimet dhe në piksynimet e Llambi Linos. Duke qënë i sigurt se çështja do të zgjidhej më së miri me lapidarin në momentin vendimtar, shkrimtari nuk është preokupuar shumë me atë që ndodhte në shpirtin e Llambi Linos.

Së dyti, siç ndodh shpesh në veprat tona, autori i ka dhënë rëndësi vetëm agjitasjonit e fjalëve dhe nuk ka zbuluar para lexonjësve ndikimin e vetë jetës, të kushteve të reja, të lufftës, të reformës agrare, të hollësive ngajeta e fshatit pas çlirimit në ndërgjegjen dhe në mëndjen e Llambi Linos, qoftë për të mirë, qoftë edhe për të keq. Grindjet në fshat dhe thash e themet mund ta çkëputnin Llambi Linon prej kooperativës, po nuk mund ta bashkonin me armiqtë e pushtetit. Për të arritur deri këtu duhet të ketë shkaqe më të thella, arësyte më të forta.

Ka raste në veprat tona kur shkrimtarët nuk meren me studimin dhe zhvillimin e personazheve e të heronjve të veprës, po jepen *tëreirisht* ose *kryesisht* pas përshkrimit me hollësi të peripetive të këtij apo atij personazhi. Kjo ndodh sidomos në ato tregime e novela, në të cilat sundon naracioni dhe mungojnë analizat shqërore dhe psikologjike të heronjve. Në të tilla raste vepra i ngjan një rröte që vërtitet dhe që

na tregon gjithënë vetveten. Vinë episodet njëri pas tjetrit, ngjarjet i zënë vëndin njëra tjetrës, po kuptimi i tyre është i njejtë ose i ngjashëm, gjersa, disa herë, përshkrimi i ngjarjeve kthehet në qëllim në vetvete. Do të mar përsëri si shëmbull dy vepra me vlerë.

Në romanin «Këneta» të Fatmir Gjatës dihet që personazhet formojnë dy grupe antagonistë: nga një anë inxhinierët dhe teknikët sabotatorë dhe, nga ana tjetër, Stavri Lara me shokë. Prej gjithë grupit të armiqve dallojnë *inxhinjer Mbora*, i cili ka luftë motivesh të kundërtë në shpirtin e vet dhe *Zyra*, që është karakterizuar si një grua tepër sensuale dhe provokonjëse. Të tjerët nuk të lenë ndonjë mbresë. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh se shkrimtari, duke mbajtur që në fillim «qëndrim armiqësor» ndaj këtyre personazheve, duke e patur të qartë ç'do të bëjnë dhe si do të përfundojnë, duke *dashur më tepër t'i demaskoja*, *se sa t'i përshkruajë me realizëm*, i ka vënë të veprojnë në situata të ndryshme, po nëpërmjet këtyre situatave nuk na ka zbuluar edhe anë të ndryshme të karakterit dhe mendimeve të tyre.

Ose marim romanin «Hasta la vista» të Petro Markos me heroin e tij *Gori Gjinleka*. Ky, përmua, është njëri prej tipave më interesantë të prozës sonë, po ne atë e njohim shumë shpejt dhe mbështetur do të mjaftonin gjysma e perimetive nëpër të cilat e ka vënë të veprojë shkrimtari, për të na dhënë portretin e plotë të tij. Në këtë mënvëre vepra do të kish qenë më solide, më e ngjeshur, e shkarkuar prej gjërate të tepërtë. Petro Markua, është, mbështetur, prozatori më spontan i letërsisë sonë, po është, mbështetur, edhe një prej atyre që e përdor me shumë kursim limën, që tregon pak kujdes për

harrjen e lëndës dhe për koncizitetin e dhënies së momenteve, të analizave dhe të episodeve.

Në krijimin e karaktereve ndikon për keq edhe të kuptuarit e ngushtë të konfliktit në letërsi. Konflikti nganjëherë përfytyrohet, ose të lihet përshtypja se përfytyrohet, si grindje ndërmjet dy ose më shumë njerëzish, të cilët ndahen për shkak të arsyeve ekonomike, politike e sentimentale që mund të kenë ndërmjet tyre. Në themelin e veprave të tilla zakonisht vihet jo jeta, në tërë gjërësinë e vet, po ndërtimi dramatik i subjektit, lidhja e personazheve ndërmjet tyre me fijet e një intrige, e cila mund të jetë e menduar edhe me shumë kujdes e me mjeshtëri. Dhe ndodh që, duke u nisur prej kësaj intrige të thurrur, autori të dëmtojë vetveten, të kufizohet në mundësitë e përshkrimit të gjërë të jetës dhe t'i përdorë personazhet në funksjon të intrigës e jo intrigën në fuksion të ekspozimit të personazheve.

Kapitujt e fundit të romanit «*Të munduarit*» të Hasan Petrelës janë një shëmbull i qartë, që tregon sa mund të humbasë vepra nëqoftëse autori heq dorë prej përshkrimit të jetës dhe merret thjeshtësisht me grindjet ndërmjet personazheve, grindje, që në fund të fundit, mund të i-ihen edhe për t'u nënkuptuar prej lexonjësit. Sidomos pas kthimit të *Rrem Heshtjes* nga ushtria romani, që në pjesën e parë ka qënë interesant dhe i shtruar, bie përnjëherë, ngjarjet shpejtohen dhe sundon një dramacitet i jashtëm, që duket si montim për të shpejtuar fundin. Prejkëtij precipitimi figura e Rremës humbet shumë. Ai nuk rritet para syve të lexonjësit, po bije poshtë dhe ngjan tepër me një njeri ordiner, që

s'meriton vëmëndje. Autori i kishte të gjitha mundësitë që t'i shmangej këtij fundi dhe të qëndronte deri në mbarim të veprës në ato pozita artistike prej të cilave është nisur.

Një të mete të tillë, më ngjan, se nuk i ka shpëtar edhe romani «*Një vjeshtë me stuhi*» i Ali Abdihoxhës. Në themelin e romanit janë vënë vërtet konfliktet e mëdha shoqërore-politike të kohës së luftës, po kujdesi i tepërt i autorit për të thurur një intrigë të vogë', që zë tepër vënd, ndërmjet Petritit, Lumtës dhe Qamilit ka ngushtuar paksa diapazonin e veprës dhe ka dëmtuar të tre personazhet e përmendur, sidomos Qamilin, i cili, megjithëse ka një fillim të mirë dhe deri diku origjinal, bije pastaj viktimë e fijeve të intrigës nëpër të cilën është ngatëruar. Besoj se edhe *Lumta*, që është ndër tipat më të realizuar, edhe Petriti, që nuk mbetet shumë pas saj, do të kishin përfituar, sikur autori të mos i kishte dhënë aq vënd në roman intrigës së dashurisë, po të kishte ndjekur më gjérësisht jetën e heronjve, të cilët, edhe pa një intrigë të tillë, do të ndesheshin patjetër me njëri-tjetrin.

Një mjet efikas për karakterizimin e heronjve është edhe përshkrimi me realizëm i ambjenteve dhe i rrethanave tipike. Krijimi i ambjenteve të vërteta dhe bindëse, veç rëndësisë që ka për karakterizimin e përcaktimin e personazhevë, ruan vlera njohëse dhe emocionale edhe në vetvete, se pikërisht nëpërmjet ambjentit, shkrimitari tregon shkallën e zhvillimit shoqëror, mënyrën e jetesës, zakonet dhe psikologjinë e kohës, qëdrimin e shoqërisë ndaj individit dhe qëndrimin e individit ndaj shoqërisë. Në këtë kuptim mund të

gjesh edhe vepra të dobëta, të cilat të kenë vlera të veçanta ideo-artistike realiste përsa i takon paraqitjes së ambjenteve.

Suksesi kryesor i prozës sonë në krijimin e ambienteve është kalimi prej ambjenteve *konvencionale* e të *papërcakuara* në pasqyrimin e ambjenteve të vërteta, të *trajtuar me realizëm*. Kjo nuk ka ndodhur në afate të caktuara kalendarikë, se asnje fenomen letrar nuk mund të ndodhë kështu. Ka vepra të herëshme të prozës sonë të re, në të cilat ambjentet janë dhënë me realizëm, ka edhe vepra të vona, që nuk të kënaqin në këtë pikpamje. Po, si fenomen i përgjithshëm, mund të themi që edhe ambientet kanë ardhë duke u pasqyruar gjithnjë e më me vërtetësi, gjithnjë e më me mjeshtëri. *Jakov Xoxa*, bie fjala, që në vëllimin e dytë me tregime është treguar njohës i mirë i ambjenteve myzeqare, të cilat i përshkruan me zotësi artistike. Ndërsa në vëllimin e parë të novelave ai merej kryesisht me ambjente të papërcaktuara e konvencionale, në vëllimin e dytë e, sidomos, në romanin «*Lumi i vdekur*» ai është treguar mjeshtër i krijimit të ambienteve dhe i harmonizimit të tyre me psikologjinë dhe jetën e heronjve. Është e vështirë, për shëmbull, të çkëputësh një tip si *Vita* prej ambjentit myzeqar. Ajo me çdo gjë të veten të kujton Myzeqenë, është një pjesëz e Myzeqesë.

I njojur për krijim me realizëm të ambjentit të fshatrave të Korçës, sidomos të ambienteve patriarkale, është Sterjo Spassia. Që në dy romanet e veta të para ai na ka dhënë ambiente fshatarake tipike, prej të cilave është vështirë të ndash tipat, që veprojnë në vepra. Dhe janë pikërisht

këta tipa të vendosur në ambjente të krijuara me realizëm që ngjallin më shumë interes, si në dy romanet e para, ashtu edhe në romanet «*Ata nuk ishin vetëm*» dhe «*Afërdita përsëri në fshat*». *Rrako Ferra, xha Nelua e xha Koroveshi* janë lidhur organikisht me ambjentet në të ci at rrojnë.

Ambjent interesant dhe me kolorit lokal ka sajuar edhe Zihni Sakua në tregimin e gjatë «*Bereqeti*», në të cilin na ka dhënë me vërtetësi fytyrën e një fshati gjirokastrit dhe, brënda këtij ambjenti, ka krijuar një tip po aq të veçantë e karakteristik, siç është *Basho Gori*. Ambiente gjirokastrite me vlerë na ka dhënë ai edhe në tregimet e vëllimit «*Njerëz e ngjarje*».

Suksese të tilla kanë arritur edhe prozatorë të tjera. Në romanin «*Pelikanët ndrojnë folë*» Reshat Nepravishta, na ka dhënë aspekte karakteristike të ambjenteve myzeqare. Dalan Shapllua ka përshkruar me realizëm ambientet e vjetruara të Gjirokastrës, kurse Gazmend Kongoli është përpjekur me sukses të pasqyrojë ambientet e reja të qyteteve tona.

Vihet re që prozatorët kanë më tepër sukses në pasqyrimin e ambienteve të vjetra, ashtu siç kanë patur më tepër sukses edhe në krijimin e tipave të vjetër. Një gjë e tillë spjegohet, jo vetëm me anë të traditës letrare, po edhe me faktin se ambientet e vjetra janë plotësisht të formuara, kurse ambientet e reja, ose sapo janë formuar, ose janë në formim e sipër. Kjo është një arësye objektive, që u shtohet të metave subjektive të punës sonë të paktë për njohjen dhe pasqyrimin e ambienteve të reja.

#### IV.

Në kushtet e sotme të zhvillimit të prozës sonë, një prej të këqijave kryesore, kundër së cilës duhet të luftojmë me vendosmëri dhe pa kurfarë, ngurimi është sentimentalizmi, në të gjitha format që është çfaqur ose mund të çfaqet në letërsinë tonë, pasi ai, si në pikpamje ideo-logjike, edhe në pikpamje artistike, nuk mund të pajtohet kurrsesi me realizmin, e, aq më tepër, me realizmin socialist.

Kohët e fundit është folur për sentimentalizmin, për format e çfaqjes dhe për natyrën e tij në prozën e ditëve tona, janë kritikuar disa vepra të dobëta, dhe, në përgjithësi, janë thënë fjalë me vënd. Në këto artikuj janë dhënë edhe mendime për shkaqet e sentimentalizmit. Trim Gjata, për shëmbull, nxjerr dy shkaqe të rëndësishme: influencën e sentimentalizmit të letërsisë së huaj dhe letërsisë sonë «*në fund të Rilindjes dhe gjatë pavarsisë*» dhe, së dyti, paaftësinë e autorëve të veprave sentimentaliste, të cilët «*ndonse janë përpjekur, nuk kanë ditur* (nënvizuar prej meje R.B.) *të ngrihen deri në lartësinë e kërkesave të reja të kohës, nuk i kanë kuptuar si duhet këto kërkesa dhe i kanë ndriçuar në mënyrë jo të drejtë problemet e rëndësishme që nxjerr para nesh shoqëria...*» («Drita», datë 9 shtator 1962).

Në analizën e veprave konkrete edhe Ali Abdihoxha pothuajse të njëjtat shkaqe gjen: pa aftësinë e shkrimtarit dhe mosnjohjen e jetes prej tij. Në këtë artikull bëhen edhe disa karakterizime të përgjithshme të gjendjes së prozës sonë. Aty thuhet:

«Kohë më parë, në krijimet e disa shkrimtarëve, sidomos në krijimet e letrarëve të rinj, qe bërë modë tregimi me heronj të dobët, të pavullnetëshëm, të cekët, të cilët duke u zbrapsur para çdo pengese, ofshanin e derdhnin lotë përfatim» e tyre «të pandryshuar». Megjithëse sot mund të themi se kjo tendencë, në se mund ta quajmë sentimentaliste, është kapërcyer ose po kapërcehet dita ditës me sukses, prapseprap meriton një vemëndje e një kujdes të madh, mbasi mbeturinat e saj nxjerrin krye herë pas here» («Nëndori», Nr. 8, 1962, f. 116-117).

Më poshtë gjejmi edhe këtë karakterizim: «...Trajtimi i njëanshëm i heronjve, mbivlerësimi i botës së tyre intime, absolutizmi i kësaj botë, shkëputja e temës apo e heronjve në mënyrë artificiale dhe mekanike nga tërësia e problemeve esencjale të kohës sonë, kanë të bëjnë me ato tendenca sentimentale që kanë lulëzuar deri në një farë shkalle në letërsinë tonë të vjeteve të fundit (në prozë, kryesisht në tregime, në dramaturgji, në poezi)». Pra, me përjashtim të romanit, në të gjithë letërsinë.

Le të marim tregimet. Autorë tregimesh ndër ne janë Dhimitër S: Shuteriqi, Fatmir Gjata, Zihni Sako, Naum Prifti, Sotir Andoni, Dallan Shapllo, Dhimitër Xhwani, Jakov Xoxa, Moisi Zaloshnja, Gazmend Kongoli etj. Besoj se nuk është nevoja të përmendim këtu titujt e përbledhjeve dhe të tregimeve të veçanta përfundit as «kohë më parë» dhe as «kohët e fundit» nuk ka patur ndonjë «lu'ëzim» (sado «deri në një farë shkalle») të senimentalizmit. Tregimet e autorëve që përmendëm nuk janë të gjithë pa

mëkate, po vështirë është të quash ndonjë prej këtyre autorëve si shkrimitar sentimentalist, apo të marësh si vepër sentimentaliste ndonjë prej përbledhjeve të tyre. Nëqoftëse në disa gazeta e revista botohen prej fillestarësh tregime psherëtimash, kjo nuk do të thotë se në prozën tonë ka «lulëzuar» sadopak sentimentalizmi.

Përgjithësime të tilla prej përshtypjeve të rastit ka nxjerë edhe Kin Dushi në artikullin e botuar në gazeten «*Drita*», ku shpreh mendime të drejta, po që nuk na duket se i përgjigjen gjëndjes së sotme të tregimit tonë.

Me që është një prej temave kryesore të diskutimeve tona letrare dhe me që vërtet kanë dalë dy a tri vepra sentimentaliste edhe në prozë (nuk po merem me veprat poetike e dramatike) më duket me vënd të ndalemi pakëz në natyrën, në shkaqet dhe në çfaqjet e sentimentalizmit në letërsinë tonë.

Dihet që sentimentalizmi në letërsi lindi prej rrëthanash historike dhe artistike të caktuarra dhe që, në filimet e veta, pati fryshtë përparrimtare demokratike dhe ishte një hap përpara edhe në kuptimin estetik. Nga pikpamja shoqërore sentimentalizmi shprehu prirjet demokratike dhe dobësinë e borgjezisë së porsalindur, e cila nuk ishte në gjëndje ende të shëmbte muret hijerënda të kështjellave feodale, ndaj edhe protesta e saj çfaqej në formë lutjesh, në formë kërkesash për mëshirë dhe thirrjesh patetike për dhëmbshuri e drejtësi. Fundi tragjik i *Eloizës* së Riçardsonit dhe i *Lizës së mjerë* të Karamzinit në letërsinë angleze e ruse, si dhe i *Mrikës* së Risto Siliqit dhe *Dijes* së Haki Stërmilit në letërsinë tonë, shprehin pikërisht protestën ndaj pa-

drejtësive shoqërore, duke u bërë thirrje, jo forçave revolucionare, po ndjenjave të mira njerëzore. Dhe ky ishte kufizimi ideologjik i sentimentalizmit, kufizim që u përcaktua, jo prej «paaftësisë» së shkrimtarëve sentimentalë, po prej shkallës së zhvillimit të atëhershëm shoqëror, prej botkuptimit të këtyre shkrimtarëve si dhe prej metodës së tyre krijonjëse. Kjo ngushëtësi ideologjike u kapërcye prej letërsisë realiste, e cila nisi të zbulojë shkaqet shoqërore të fatkeqësive dhe të pasqyrojë kontradiktat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Nga pikpamja estetike, sentimentalizmi ishte një reaksion i pashmangshëm ndaj racionalizmit klasicit. Ai tërroqi vëmëndjen e artistëve në botën e ndjenjave, duke marë kështu një qëndrim krejt të kundërt me klasizmin. Po edhe nga pikpamja artistike sentimentalizmi mbeti mbrënda kufijve të ngushtë të botës së ndjenjave, me anën e të cilave mundohej të spjegonte dhe t'u jepte udhë problemeve shoqërore, sidomos konfliktit ndërmjet njerëzve të thjeshtë të shtresës së tretë dhe klasës sundonjëse feodale. Edhe në këtë aspekt ai u kapërcye plotësish prej realizmit i cili, në analizat e veta, niset njëkohësisht prej arsyes dhe prej ndjenjave dhe, veg këtyre, edhe prej kushteve shoqërore-historike. Pra, shënojmë posaçërisht, që për letërsinë realiste nuk është aspak e huaj bota e ndjenjave, sentimentet njerëzore. Përkundrazi ato zënë një vënd të rëndësishëm në të gjitha veprat realiste, gjersa janë një prej çfaqjeve kryesore të qënies njerëzore.

Prej këtej del se sot *nuk ka asnje bazë shoqërore për ekzistencën* dhe aq më pak për lulëzimin e sentimentalizmit në formën e tij klasike,

derisa forcat përparimtare të shoqërisë sonë i kanë fatet në duart e veta dhe kanë të çelur para tyre perspektivën historike, si në kuptimin politik, ashtu edhe në kuptimin shoqëror. Po atëherë, për çfarë sentimentalizmi bëhet fjalë në letërsinë tonë? Mua më duket, se kemi të bëjmë kryesish me këto çfaqje kryesore të sentimentalizmit:

Së pari, me një farë sentimentalizmi në qëndrimin ndaj vdekjes së botës së vjetër, dhe në ndonjë rast flagrant, edhe në idealizimin e kësaj bote. Sigurisht nuk e kemi fjalën për kuptimin politik të termës «*botë e vjetër*», mbasi çfaqje të huaja politike në letërsinë tonë nuk kemi, po për kuptimin shoqëror, sidomos për mentalitetin, moralin dhe zakonet, gjë që e gjejmë, jo vetëm në ndonjë vepër letrare, po edhe në disa artikuj mbi poezinë.

Në mënyrë pak a shumë më të plotë kjo çfaqje sentimentalizmi vrehet në novelën «*Sinfoni e pambaruar*» të Sterjo Spasses, në të cilën autori, disa herë, ka folur edhe shprehimisht për një gjë të tillë. Në këtë nove ë, për shëmbull, lexojmë:

«Vëllamëria në fshat nuk është një gjë e jashtëzakonshme. Të gjithë të rinjtë edhe pleqtë kanë nga një motër ose nga një vëlla të kindur në të tillë kondita. Por për borgjezinë tonë të qyteteve është një akt që shkel ligjet e «moralit» sado ideale, sado e singertë qoftë miqësia e dy vetave të seksit të ndryshëm... Ne nuk do të mund të dalim ballëhapur rrugëvet, ose të jemi të lirë të takohemi disa herë në javë për të kur-vënduar me tërë dëri në zëmrës si dy vëllamër të vërtetë, ashtu siç kemi kuvënduar që kur-jemi njohur!»

*Sa zili i kam moralit tē fshatit dhe sa e urrej  
moralin borgjez tē qytetit, që është vetëm maskë,  
maskë e asgjë tjetër e që na detyron edhe ne tē  
deskreditohemi me këtë maskë («Nëndori» 1,  
1962 f. 35).*

Kjo, pak a shumë, është një pozitë e qartë. Autori përballë moralit tē qytetit (tē borgjezisë, po deshe) vë moralin patriarkal tē fshatit, hipokrizinë patriarkale. Është e nevojshme tē shënojmë që heroi i novelës, tē cilin autorri nuk ka dashur aspak ta nxjerrë tē keq, i thotë këto fjalë aty nga viti 1946, pasi qindra vajza kishin luftuar krah pér krah me djemtë dhe qindra e qindra tē tjera, krah pér krah me shokët e tyre, mernipjesë në aksionet e shumta tē rindërtimit dhe bënин pjesë në organizatat e Rinisë Komuniste e tē Rinisë Popullore. Pra, ishte koha kur po flakej me përcëmim e në mënyrë revolucionare si morali patriarkal, ashtu edhe morali borgjes. Personaliteti i njeriut tonë, sidomos i gruas, po çlirohej prej barrës së rëndë tē mentaliteteve tē mykura, që i kishin marë fryshtëshekuj me radhë. Tani lind pyetja: Edhe nëqoftëse morali borgjez ishte ende shumë i fortë në qytetet tonë, a do tē thotë kjo që tē kthehej fytyra nga diçka që perëndonnte, kur po lindëte një moral i ri, një qëndrim i ri? Është e qartë se kemi tē bëjmë këtu me një pozitë sentimentaliste, me një keqardhje pér shëmbjen e moralit patriarkal. Edhe kohës së mëparshme sikur t'i takonte kjo vepër, pra, edhe sikur tē bëhej fjalë vetëm pér moralin patriarkal dhe pér moralin borgjez, prap pozita e shkrimitarit do tē ishte e gabuar, pasi do t'ishte në kundërshtim me prirjen e zhvillimit historik.

Një çfaqje tjetër e sentimentalizmit në prozën

tonë është edhe kulti i jetës intime dhe shkëputja e kësaj jetë të ngushtë prej atmosferës së kohës. Kjo çfaqje sentimentalizmi është karakteristikë sidomos për tregimet e fillestarëve, të cilët i shtyn edhe mësha, preokupacionet dhe eksperiencia e paktë në jetë të meren me tema ngushtësisht intime dhe, si të thuash, me anën e letërsisë të qajnë hallet e djalërisë. Për këta letrarë mendoj se nuk duhet të shqetësohem i tattered. Edhe nëqoftëse botojnë ndonjë tregim të tillë, s'prish punë. Ata vetë, po të jenë të talentuar, do ta kuptojnë shpejt ngushtësinë e shkrimave të tyre të para dhe do të çirohen prej saj. Në këtë mes mund të bëjnë një punë të mirë redaksitë e gazetave e të revistave, sidomos «Zëri i Rinisë», «Shqiptarja e Re», «Drita» dhe «Nëndori», të cilat, edhe kur botojnë shkrimë të tilla, është mirë tua venë në dukje këtë të metë autorëve.

Një vepër e kësaj natyre në prozën tonë është novela «Dashuria e Mimozës» e Nasho Jorgaqit, për të cilën është folur shumë kohët e fundit dhe është kritikuar me të drejtë dhe patë drejtë. Unë nuk jam i mëndjes që rea'iteti ynë i sotëm nuk i jep autorit të drejtën të ndërtojë një personazh si Mimoza. Me sa di unë vajza të tilla ka mjaft edhe prej atyre që kanë lindur dhe janë rritur në kryeqytetin tonë prandaj heroinë është realë. Edhe problemi që ngre autori është real dhe aktual.

E meta e kësaj vepre duhet kërkuar pikërisht në *veçimin* e heronjve prej jetës së madhe në absolutizmin e jetës së tyre intime. Shkrimtari, duke dashur, me sa duket, të tregojë sa bregë mund të ketë një vajzë që i nënshtronet mo-

ralit mikroborgjes të familjes, e ka bërë Mimozën një qënie për të ardhur keq, një personalitet të pafuqishëm dhe pasiv, që nuk ka rrugëdalje, që as dashuria nuk e shtyu të shpërthejë rrrethin e mbyllur, në të cilin e ka futur autori. Dhe, pikërisht te ky rrreth i mbyllur është e keqia. Veç dashurisë a nuk ka forca shoqërore që ta nxjerrin Mimozën prej kthetrave të absolutizmit patriarkal e mikroborgjez? Vetë autori ka folur përinstitutin, për shokët e shoqet, po nuk ka gjetur në 'ta forcën reale të shoqërisë sonë që shëmb të vjetrën dhe krijon të renë. Ai, duke folur për ta, duket sikur thotë: «*Sa keq! Ja, Mimoza, me të hequr dorë nga dashuria, hoq dorë nga të gjitha*» dha, pa të drejtë, sulmon Mimozën, në vënd që të godasë *kryesish* dhe sa më ashpër ambjentin patriarkal mikroborgjez.

Mimoza mund të përfundonte ashtu siç përfundoi, po në novelë duhej të triumfonte e reja, jeta jonë, morali ynë, botkuptimi ynë, të triumfonin realisht, ashtu siç triumfojnë edhe në jetë. Më duket i nxituar mendimi i shokut Aili Abdi-hoxha, i cili thotë se «*vepra të këtilla, që trajtojnë problemin duke marë shëmbullin negativ, janë të rralla në praktikën letrare, bile realizmi socialist, ose s'i ka njohur, ose i njeh fare pak, sidomos në gjininë dramaturgjike*». Prej praktikës letrare, edhe të realizmit socialist, mund të përmënden shumë shëmbulla që e hedhin poshtë këtë mendim.

Në novelën «*Dashuria e Mimozës*» realiteti ynë nuk është konceptuar në mënyrë të gjithanëshme, realiste dhe, si të thuash, janë nën-vlefteşuar forcat e shoqërisë sonë, janë treguar ato të dobëta dhe të paafta që t'i japid dërmën të vjet-

rës. Një gjë e tillë ka të ngjarë të jetë bërë që vepra të ketë «efekt», të shkaktojë pshertima dhe lotë, të ketë «sukses», si vepër e ditës.

Ka edhe një çfaqje sentimentalizmi, që në vështrim të parë duket pozitive, po që dëmton brendinë ideologjike dhe vlerën realiste të veprave tona. Kjo çfarë duket në zbutjen e kontradiktave dhe në lehtësimin e rrugës së heronjve pozitivë. Ky farë sentimentalizmi ka si burim dëshirën për të pasqyruar fitoren e së resë mbi të vjetrën nëpërmjet parafytyrimesh melodramatike dhe për të ngjallur tek lexonjësit ndiesi dehje prej likeri, siç ndodh, bije fjala në tregimin e Gazmend Kongolit, «*Pa tjetër do të kthehet*», në të cilin autor, duke u munduar të pasqyrojë pjesëmarjen e shoqërisë në fatkeqësinë e individit, ka krijuar një atmosferë të vakët e ca artificiale, së pari, duke mos na dhënë një tip real, po një heroinë të afektuar, dhe së dyti, duke mos iu shmangur dot zgjidhjes sentimentale. Po te ky autor gjen elemente të tjera sentimentalizmi të kësaj natyre edhe në ndonjë tregim që ka vlera të veçanta,, si pasqyrim i kohës sonë dhe i jetës së rinisë.

Cilat janë shkaqet e sentimentalizmit në letërsinë tonë?

Aty për aty është e vështirë të përcaktosh shkaqet e vërteta të një fenomeni aktual, po sidoqoftë, mund të konstatojmë ata më kryesorët.

Thamë më lart, se letërsia jonë hyri në fazën e realizmit socialist, pa qenë një letërsi e formuar realiste. Në prozën tonë të paraçlirimt kishte elemente të theksuara sentimentaliste. Do të ishte e pamundur që të shkëputeshin një herë e

mirë prej këtij trashëgimi. Ndonjë prej shkrimtarëve tanë, si për shëmbull Sterjo Spasse, ndoshta e ka patur edhe më të vështirë. Ndërsa ne të rinxjtë nuk u shkëputëm dot aq lehtë prej të tjerëve, ai e ka më të vështirë që të shkëputet prej vetvetes. «*Sinfonia e pambaruar*» është, si të themi, një përtëritje e fillimeve letrare të tij.

Po ky nuk është shkaku kryesor. Atë ne duhet ta kërkojmë dhe ta gjejmë jashtë letërsisë, në jetën shoqërore. Ne jetojmë sot në një moment revolucionar. Para syve tona po transformohet, jo vetëm sipërfaqja e atdheut, por edhe shpirti i bashkatdhetarëve tanë. Si një vënd me popullsi kryesisht fshatare dhe me qytete të vogla, që para çlirimt nuk kishin kurfarrë zhvillimi, është e natyrshme që të sundonin tek ne zakonet, morali dhe mentaliteti patriarkal e mikroborgjez, që fshehin bashkë me gjithë të këqiat e tjera, edhe nxitjen për sentimenta'zëm në jetë dhe në art.

Lufta Nacional-çlirimtare dhe ndërtimi socialist, çdukja e pronës private, përhapja e arësimit dhe e kulturës, kolektivizimi i bujqësisë dhe hovi i madh i industrisë, zhvillimi i jetës shoqërore dhe ngritja e brezit të ri, të gjitha këto kanë tronditur nga themelet moralin dhe mentalitetin patriarkal dhe mikroborgjez, që janë në kundërshtim të hapur me socializmin. Po, e vjetra nuk dorëzohet lehtë, sidomos kur llogoret e saj janë në ndërgjegjen e njerëzve, Ajo reziston dhe do t'i bëjë ballë me kryeneçsi sulmit të përgjithshëm të moralit dhe të botkuptimit socialist. Në këtë luftë, fitorja e së cilës i takon të resë, ka heronj, ka edhe viktima.

Heronjtë janë më dhjetra mijë. Viktima ka shumë më pak dhe janë, ose përfaqësonjës të së vjetrës, që nuk duan të dorëzohen dhe pengojnë ecjen përpara të forcave të reja, ose janë njerëz që humbasin ekuilibrium, duke dalë prej ambjenteve të mbyllura e duke u futur në jetën e madhe. Të mbash anën e viktimave dhe të vajtosh për fatin e keq të tyre, pa u interesuar për vrullin e përgjithshëm të jetës dhe duke harruar ata dhjetra mijë luftëtarë, që përfaqësojnë të sotmen dhe të ardhmen e vendit, do të thotë të mos jesh realist, të biesh në sentimentalizëm.

Zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës popullore kanë sjellë me vete rritjen e mirëqënieve materialë të masave punonjëse dhe kanë shtuar interesimin e shoqërisë për njerinë, për individin, për hallet dhe për preokupaconet e tij. Nga ana tjetër, njerëzit, pasi kanë siguruar kushtet e domosdoshme të jetës, pasi kanë zgjidhur njëherë e përgjithnjë çështjen e qënies, vetveti janë dhënë më tepër pas kërkesave shpirtërore, i jatin më tepër vend botës së ndjenjave dhe përpjekjeve për plotësimin e dëshirave të tyre. Jetesa e njerëzve tanë të thjeshtë nuk është më një proces spontan, po një ueprimitari gjithnjë më e vetëdijshme. Letërsia, si pjesë e ueprimitarisë shpirtërore të shoqërisë, s'ka si të mos e pasqyrojë këtë ndryshim të rëndësishëm të realitetit tonë.

Është folur disa herë për këtë farë sentimentalizmi dhe është paraqitur si reaksion ndaj një farë «asketizmi» që ka patur vend në prozën tonë fill pas çlirimit. Kjo lidhje e dy fenomeneve është dhe s'është e vërtetë. Është e vërtetë se prirjet sentimentaliste janë dukur pas atij «as-

*ketizmit*» të dikurshëm; po kjo është vetëm një lindhje kohe dhe s'na duket të jetë shkak kryesor. Pastaj s'na duket me vënd t'i biem shumë në qafë veprave të para të letërsisë sonë të re, të cilat s'kish si të mos pasqyronin kohën dhe psikologjinë e kohës. Në ato vjete, kur po kryhej një përbmbysje e madhe dhe e gjithanëshme revolucionare në jetën tonë, kur ende ndihet era e barutit dhe njerëzit tanë punonin me rrÿpin e shtrënguar, duke kapërcyer vështirësi shumë të mëdha, s'është *aspak e çuditëshme* që në letërsi *nuk zunë vënd këngët për dashurinë dhe tregimet për jetën intime të njerëzve*. E çuditshme do të kish qenë sikur të kishte *ndodhur e kundërta*. Proza jonë e asaj kohe, sado e paktë, me tregimet e para të Dhimitër Shuteriqit e të Fatmir Gjatës, me skicat e Zihni Sakos dhe më parat tregime të gjata në letërsinë tonë të re, pasqyroj problemet dhe psikologjinë e kohës dhe kjo është një prej meritave kryesore të saj. Pra, brëndia e saj përcaktohej prej kushteve në të cilat u zhvillua, Edhe forma e saj, që tanë, në disa raste, na duket e pakëndëshme, është përcaktuar prej eksperiencës së pakët krijonjëse të shkrimtarëve dhe prej faktit që, siç konstatonte dikur Engelsi «*në fillim kurdoherë për shkak të brendisë nuk i kushtojnë vëmëndje formës*» (Marksi dhe Engelsi për kulturën dhe artin f. 87).

Eshtë e natyrëshme që, ashtu siç kalohej dikur në ekstrem, duke *mohuar* fare ndjenjat intime të njerëzve, të kalohet edhe sot në ekstremin tjetër, domethënë, në *absolutizmin* e këtyre *ndjenjave intime*. Të dyja këto ekstreme janë të dëmëshme, cënojnë realizmin dhe vlerën artistike të veprave. Ashtu siç nuk ka njeri pa

ndjenja intime, ashtu nuk ka edhe njerëz, qenia e të cilëve të mos përcaktohet prej shoqërisë dhe prej ambjentit në të cilin jeton.

Veç këtyre duhet të pranojmë se masa e gjërë e lexonjësve tanë, me gjithë ndryshimet kolosale që kanë ndodhur në gjëndjen arsimore dhe kulturale të popullit, ushtron ndër ne një presjon, që nga një herë, na imponohet, kur nuk arrijmë të gjejmë një farë ekuilibri ndërmjet nivelit të masës së lexonjësve dhe kërkesave të larta artistike realiste. Si çdo lexonjës i ri edhe lexonjësi ynë pranon dhe rrëmbehet më tepër prej efekteve e prej shpërthimeve sentimentale. Këtij presioni nuk mund t'i shpëtojmë lehtë. Për këtë duhet kohë, bile, një kohë relativisht e gjatë. Po, nga ana tjetër, nuk duhet ta lëmë punën në dorën e kohës. Përpjekjet tonë, punajonë e vtdijëshme duhet të synojë, jo që të biem në nivelin e masës së lexonjësve, po që të ngrejmë letërsinë dhe lexonjësin në nivelin e kërkesave ideo-estetike të kohës.

Si përfundim, sentimentalizmi nuk ka asgjë të përbashkët me botkuptimin, me metodën kri-jonjëse dhe me jetën tonë socialiste. Mëshira, ngashërimet dekadente, klithmat tragjikomike dhe parafytyrimi melodramatik i jetës dhe i njerëzve janë të huaja për letërsinë e realizmit socialist. Ato e kanë burimin në presionin e shtresave mikroborgjeze, në moskuptimin e drejtë të procesit objektiv të zhvillimit historik, në njojhen e pakët dhe në pasqyrimin e një-anshëm e të ngushtë të jetës, në konceptimin dhe pasqyrimin e gabuar sentimentalist të temave, të subjekteve e të heronjve, Kritika jonë, edhe në të ardhmen, duhet të godasë rreptë dhe nga

pozita të shëndosha qdo vepër sentimentaliste e, kritikas kësaj, të kritikojë qdo element të tillë, që dëmton vlerën realiste të veprave tona.

## V.

Një dobësi tjetër që prek natyrën realiste të prozës sonë dhe që dëmton brendinë ideologjike të saj, është edhe trajtimi historikisht i pašakt dhe, nga ndonjëherë, edhe i shtrembër i fenomeneve shoqërore. *Me trajtim historik* të fenomeneve shoqërore kuptojmë, jo vetëm autenticitetin e subjektit të veprës letrare dhe të ngjarjes që ka shërbyer për krijimin e tij, po qëndrimin, objektiv dhe shkencor, do të thoshnim, të shkrimitarit në trajtimin e problemeve shoqërore, marjen paraçysh prej tij të ligjeve objektive të zhvillimit të shoqërisë.

Ngritja e prozës sonë në nivelin e analizës historike të fenomeneve është një prej sukseseve kryesore të saj në rrugën e realizmit. Kur doherë prej prozatorëve tanë, sidomos prej autorëve të romaneve tona, në të cilat jeta pasqyrohet në mënyrë më të gjithanëshme, jeta, vëprimtaria praktike, mendimet, bota e brëndëshme dhe idealet e individëve, janë spjeguar, jo si çfaqje të thjeshta të vullnetit të tyre të mirë apo të keq, si shprehje të mirësisë apo të ligësisë së tyre si individë, po, në radhë të parë, si tipare shoqërore të tyre, si karakteristika të qënies së tyre shoqërore. Teoritë fiziclogjike, patologjike dhe psikanaliza kanë qënë kurdoherë të huaja për prozën shqipe, kanë mbetur dhe do të mbeten të tilla, si teori idea'iste, Nga ana tjetër, parimi realist i trajtimit historik të fenome-

neve shoqërore nuk mohon, po pranon dhe e quan të domosdoshme analizën psikologjike, sigrisht edhe këtë nën prizmin e vlerësimit shoqëror të fenomeneve.

Le të marim, për shëmbull, veprat që i kushtohen luftës Nacional-Çlirimtare. Si karakteristikë e përgjithëshme e këtyre veprave është pasqyrimi objektiv i shkaqeve shoqërore dhe politike, i forcave lëvizëse dhe qëllimeve të kësaj lufte, nënvizimi i njëkohshëm i motiveve patriotike dhe ekonomike-shoqërore të revolucionit tonë. Ky, më ngjan, është një prej rasteve më të qarta që tregon se botkuptimi dhe pjekuria ideo-logjike e politike e shkrimitarëve tanë, krahas ngritjes së nivelit të mjeshtërisë së tyre, këndihmuar dhe është bër shkak për trajtimin realist të këtij aspekti shumë të rëndësishëm. Po kështu mund të përmëndim edhe vepra të tjera, që u kushtohen problemeve të ndryshme të jetës sonë, siç janë veprat kushtuar kolektivizimit, veprat kushtuar ditëve tonë etj. Vetëm në raste të rralla dhe në shkrime amatorësh *absolutizohen* dëshirat dhe vu'lleti i individëve, pikërisht se nuk zbulohen rrënjet shoqërore të fenomeneve të jetës.

Po ka edhe rastë kur qëndrimi i shkrimitarëve ndaj fenomeneve që përshkruajnë është i pasaktë dhe i padrejtë historikisht dhe, kështu, është dëmtuar brendiq ideologjike e disa veprave, që mund të kishin patur një vlerë më të madhe edhe nga pikpamja thjesht artistike, pofshi marim.

Le të kujtojmë romanin interesant «*Të munduarit*» të Hasán Petrelës. Është një vepër e shkruar me frysëzim, një vepër me vlera

realiste. Po ky roman ka dhe një të metë themelore në pasqyrimin e ndjenjave liridashëse të popullit tonë dhe për vëndin që zë në vepër depërtimi në shpirtin e njerëzve tanë i psikologjisë dhe mentalitetit të pushtonjësve turq.

Autori, dashur pa dashur, na ka paraqitur në roman krahas tabllove shumë interesante dhe me vlerë për jetën shoqërore të asaj kohe edhe një «*rrem Stambollis*» në Shqipëri, një vënd, banorët e të cilit krenohen me *fidaixhanët* e Turqisë dhe me trimëritë e bashkëpunëtorëve të pushtonjësit, gjëra që autori i romanit na i pëshkruan me objektivizëm. Zona të tilla të vogla edhe ka patur në vëndin tonë, siç ka qënë Petrela e autorit, po detyra e shkrimitarit, që vendos të meret me një gjë të tillë është të zbulojë shkaqet historike të kësaj shhangjeje prej gjëndjes së përgjithshme të vëndit, dhe, qoftë nëpërmjet qëndrimit të tij, qoftë dhe nëpërmjet krijimit të figurave të ngjashme, që përgjithësojnë, të nxjerë në pah edhe tendencën e zhvillimit historik. Arësyet e kësaj dobësie të veprës së Hasan Petre'ës më ngjan se janë kryesish dy: E para, autori i ka dhënë shumë rëndësi pasqyrimit të shtypjes ekonomike e shoqërore dhe, megjithse kjo është një nga vlerat kryesore të romanit, ka harruar shtypjen kombëtare dhe luftën kundër kësaj shtypjeje, të cilat edhe duke mos dalë në plan të parë, do ta kishin inkuadruar më mirë historikisht subjektin. E dyta, duke patur në qëndër të vëmëndjes një vënd të njojur dhe të përcaktuar, ai është ngushtuar duke dashur, siç duket, t'i qëndrojë plotësisht besnik të vërtetës historike, në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Një të metë të tillë themelore ka edhe romani «*Me valët e jetës*» i Vedat Kokonës.

Autori i kësaj vepre objektivisht na ka dhënë një tip mikroborgjez, siç është Ismail Kamberi dhe, ndonse në sipërfaqe, na ka përshkruar ambjente dhe situata reale të kohës, në të cilën zhvillohen ngjarjet. Në këtë mes nuk ka asgjë të keqe. Përkundrazi, prozës sonë i duhen edhe tipa si Ismail Kamberi. E keqia nuk është që autor i s'ka vënë në qendër të romanit një komunist, po një mikroborgjez, po se, duke dashur që këtë mikroborgjez të na e paraqesë sa më simpatik, ai ka dëmtuar vlerën realiste të veprës dhe ka cenuar, dashur pa dashur, edhe natyrën artistike të krijimit letrar. Në roman mendimin e vët për heroin kryesor shkrimitari e ka shprehur, ose duke e përkëdhelur vetë duke u egzaltuar para veprimeve të tij, ose duke u përpjekur domosdo ta lidhë atë me rrymat më të përparuara politike të kohës. Në rastin e parë kemil të bëjmë me mungesë të qëndrimit kritik ndaj një fenomeni shoqëror negativ, gjë që vrehet, deri diku, edhe në përshkrimin e ambjenteve, kurse, në rastin e dytë, nga që heroin nuk ka shkruar dot atje ku ka dashur shkrimitari dhe shkrimitari nuk ka dashur ta dënojë megjithatë, vepra ka rënë artistikisht. Pra, askush nuk kërkon që në vënd të mikroborgjezit të vihet komunisti, se kjo është e pamundur, por nuk mund të mos kërkohet që ky mikroborgjez të përshkruhet me realizëm dhe të vështrohet nga pozita e botkuptimit dhe të moralit komunist, mbrojtës të të cilave janë shkrimitarët në veprat e tyre.

Këtu dalim edhe të çështja e frysës së ko-

hës në letërsi, Ç'e shtyu shkrimtarin ta shkruajë këtë vepër? Cili është mendimi i kohës që shprehet në të? Sigurisht nuk mund të jetë as egzaltimi ndaj patriarkalitetit dhe ambjenteve mikroborgjeze, as dëshira për të llastuar një tip së Ismail Kamberi... Dhe, më duket, që fatkeqësia e romanit është se tingëlon pikërisht kështu. *Ismail Kamberi dhe ambjentet që përshkruhen në roman përligjen historikisht, domethënë janë të vërtetë, po nuk përligjet dot qëndrimi i autorit ndaj tyre.*

Që të kuptohemi, le të marim një shëmbull të kundërt. Në nuk pajtohami me psikologjinë prej skllavi të Mehmet Mullixhiut në romanin «Përbysja» të Fatmir Gjatës, po e përligjim historikisht qenien e tij dhe pajtohami p'otësish me qëndrimin e shkrimtarit ndaj tij si fenomen shoqëror. Kjo ndodh se Fatmir Gjata ka zbuluar shkaqet e vërteta të ekzistencës së kësaj qenie dhe, duke nënvíuar shkatërimin e personalitetit të këtij njeriu prej shtypjes shoqërore, nuk është pajtuar kursesi me 'të. Po kështu mund të përmëndim *Uanin* e tregimit «Zot e rob» të Dhimitër Shuteriqit. Tjetër është të përshkruash diçka dhe tjetër të mbash qëndrim ndaj saj.

Shëmbulla të tillë ka sa të duash në prozën tonë të re. Tipike janë tregimet e Dalan Shapilos. Me përashtim të ndonjerit, tregimet e para të këtij autori i kushtohen pasqyrimit të tipave mikroborgjezë dhe elementeve që dalin nga skena e historisë. Po qëndrimi i shkrimtarit ndaj këtij fenomeni shoqëror është përgjithësisht i drejtë dhe realist, me gjith një farë keqardhje për ta, që rrjedh nga se shkrimtari, krahës tyre, nuk na ka dhënë me të njëjtën

forcë filizat e së resë, që sot mbijnë edhe mbi gërmadhat.

Përsa i takon frysëmës së kohës në prozën tonë, sidomos kur flitet për trajtimin e aspekteve të së kaluarës, vlen të theksojmë që prözatorët tanë, nganjëherë, tërhiqen vetëm pas ngjarjeve interesante, pa nxjerrë atë që duhet prej tyne. Për shëmbull, Ali Abdiroxha në tregimin «*Arti për t'u bërë gjeneral*» na flet për rreshter Dau-tin, i cili gjeti «*mënyrën*» si të tërhiqte vëmëtidjen e eprorëve që ta gradonin. Sikur ky tregim të ishte shkruar në kohën e Zogut, do të kishte qenë një goditje e fortë kundër mëndjetëtrashësisë dhe aparatit ushtarak-bürokratik të kohës. Po lexonjësit të sotëmi ç'i jep ky trëgim, përveç subjektit me natyrë anekdotike?

Ka raste, pastaj, që ndonjë tregim të tingëlllojë i gabuar nga që autor mund të mos ketë menduar mirë për atë që ka dashur të thotë. I tillë më gjan tregimi «*Babai*» i Petro Markos në të cilin autorri rrëfen si u kthyesh i biri në shtëpinë e vet pas shumë vjetësh që ishte ndarë më të atin për arsy politike. Babai kish qënë ballist i bindur, kurse i biri komunist. Ky është një fenomen i njojur ndër ne gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare. Tani lind pyetja: kur i ati ka qënë bë list dhe i biri partizan, për atrimin e tyre, ndryshimin e kujt duhet të ndjekim: të babait apo të djalit? Sigurisht të babait, sepse realiteti ynë bind ata që kanë qënë në udhë të gabuar (ky, gjithashtu, është një fenomen shumë i njojur i ditëve tona) dhe nuk shtyn ata që kanë qënë në udhë të drejt të rishqyrtojnë pozitat e tyre. Mirëpo tregimi i Petro Markos është marë më shqetësimet dhe përviljen e të birit dhë nuk

është marë pothuajse fare me ndryshimin e qëndrimit dhe të pikpamjeve të plakut.

Sic dihet, parimi i analizës konkrete historike dhe i pasqyrimit të jetës në zhvillimin e vet revolucionar, ashtu si dhe gjithë parimet e tjera themelore të realizmit socialist, ka *anët e veta estetike* dhe *ideologjike*, dhe është një kërkesë e *demosdoshme* për *stabilizimin e mëtejshëm* të realizmit në prozën tonë dhe bazë kryesore e ngritjes së nivelit ideologjik të saj. Po kështu nuk duhet harruar për asnjë çast që objektivizmi në trajtimin e çështjeve shoqërore nuk ka gjë të përbashkët me realizmin e, aq më pak, me realizmin socialist dhe me fryshtën e përgjithëshme revolucionare të letërsisë sonë.

## VI

Prozatorët tanë kanë patur suksese të mira edhe në punë të stilit, i cili, si komponent i kri-jimtarisë artistike, nuk mund të kuptohet i shkëputur prej metodës krijonjëse dhe, bile, edhe prej botkuptimit të shkrimit e prej shijeve të tij estetike. Stilet e prozatorëve tanë kanë nisur e dallohen mirë prej njëri tjetrit.. Shkrimitarët tanë më të mirë kanë formuar personalitetin e tyre krijonjës, duke qëndruar të gjithë në pozitat e realizmit socialist.

Dhimitër S. Shuteriqi, sidomos në tregimet e veta («*Xha Demi*», «*Ditët e sprasme të Gjorg Golemit*», «*Fyelli i Tanës*», «*7 vjet pas*» etj.) si dhe në vëllimin e dytë të romanit «*Çlirimtarët*» dallohet për karakterin monumental e, deri

diku, romantik të ndërtimit të tregimeve dhe të krijimit të figurave. Atë e tërheqin karakteret e forta dhe ngjarjet me kuptim të thellë, e, gati, simbolik, që mund të qëndrojnë në këmbë si grupe skulpturale, me trajta të përcaktuara mirë. Ky stil i ka shërbyer autorit të zbulojë dhe të pasqyrojë karakterin burrëror, të ashpër dhe të qëndrueshëm të njerëzve tanë, të zbulojë dhe të pasqyrojë, si të gdhëndura në gur, tipat karakteristike të vëndit tonë. Ne themi stili i ka dhënë dorë të zbulojë e të pasqyrojë, po duhet të themi, se merita kryesore e tij është që ka *gjetur* stilin e përshtatshëm, që i përgjigjet më së miri kërkesave për pasqyrimin e madhështisë së ko-hës sonë, të madhështisë së historisë sonë.

Lexon njeriu tregime si «*Fyelli i Tanës*» dhe «*Ditët e sprasme të Gjorg Golemit*», kënaqet me bukuritë e stilit dhe me forcën emocionnjëse të figurave, ka dëshirë të mendojë për jetën, të thellohet më tepër në ato që ka lexuar, të kërkojë diçka që autori e ka lënë të nënkuqtohet. Prej penës së të njëjtit shkrimtar janë shkruar edhe tregime si «*Lufta e bekuar*», «*Deti qesh*» etj., që nuk lenë mbresa kaq të forta dhe nuk të shtyjnë të mendosh.

Fatmir Gjata ka formuar një stil tjetër: të shtruar, të qetë, përshkronjës, të depërtuar prej notash të lehta lirike. Në konceptimin e subjekteve dhe në krijimin e personazheve ai niset po-thuajse ngaherë prej parashtrimit të natyrshëm të ngjarjeve, pa degresione e spjegime të tepërtë, pa shbirime të tepëruara në ndërgjegjen e njerëzve, pa kërkime të jashtëme për formën. Në rastet më të mira, ai di të përdorë me mjeshtëri

hollesitë artistike për karakterizimin e situatave dhe të personazheve. Veç kam përshtypjen, se stili i tij është pakëz i sipërfaqëshëm dhe i lehtë. Kjo vihet re sidomos në disa prej krijimeve të tija të kohëve të fundit. I tillë është, ta zëmë, tregimi i gjatë «*Kapedani i mirë në furtunë njihet*» në të cilin autor i ka mbytur mendimin e madh dhe forcën emociononjëse të figurës me një shtrirje deskriptive të tepëruar të subjektit dhe me hollësi të panevojëshme, pa nerv jete, që mbajnë erë montazhi. Petro Marko, ndryshe prej të tjera, ka stilin e vet *lirik-publicistik*, të figurshëm, të shkathët, të rrëmbyer, me hypje e zbritje të shpeshta, si natyra e ngjarjeve që pëshkruan. Po stili i Petro Markos ka edhe dy të meta themelore: së pari, ai ka shumë elemente të huaja për natyrën realiste të veprave, si egzaltime, apostrofat e tepërtë, kapërcimet e lehta prej një situate në tjetrën vetëm me një «oh», me një apostrofim apo me një pyetje retorike dhe, së dyti, ndihet në veprat e tij edhe një kujdes i pakët për gjuhën, për ndërtimin e frazës, për selitjen e figurave dhe për pastrimin e veprës nga teprimet që mund të ketë sjellë me vete vrulli i krijimit.

I njobur për bukuri fraze, për pasuri gjuhe, për émbëlsi dhe rjedhshmëri stili është Jakov Xoxa. Në romanin «*Lumi i vdekur*» të bën për vete gjérësia e pasqyrimit të jetës, pëershkrimet e bukura të natyrës myqezare, figurat e krijuara me de ikatesë, tingulli gati muzikor i fjalës. Po, krahas kësaj bukurie, në roman, më tepër se edhe në tregimet tij, është çfaqur e meta themelore e stilit të stolisur të Jakov Xoxes. Aty-aty zotërimi i gjuhës së popullit, njobja e fazollo-

gjisë popullore dhe mjeshteria në përdorimin e të folurit të figurshëm e të tërthortë, duket se kthehen në mani, që dëmton veprën, që krijon monotoninë dhe që të lodh. Shkrimtari, duke ruajtur plotësisht veçoritë e tij si stilist, është e nevojshme të mendojë më tepër për thjeshtësinë dhe për përdorimin e kursyer të frazeologjisë e të të folurit të figurshëm.

E theksuar është kjo manierë të shkruari edhe në tregimet e Sotir Andonit, i cili është, pa dyshim, një prej prozatorëve tanë të talentuar, që e ndjen bukurinë dhe muzikalitetin e të folurit popullor dhe që e zotëron mirë mjeshterinë e të treguarit me frymë popullore, gjer diku, duke ndjekur Mitrush Kutelin, e, gjer diku, duke ecur në udhën e vet, si shkrimtar romantik i bukurisë dhe i poezisë së jetës fshatarake. Më duket se do të gabonim nëqoftëse do ta hidhnik poshtë në mënyrë kategorike këtë mënyrë të shkruari dhe, konkretisht, profilin e Sotir Andonit si shkrimtar. Pavarësisht nga shijet tonë individuale artistike dhe prej preferencave stilistike, tregimet e Sotir Andonit kanë vlera ideo-artistike të pakundërshtueshme. Sidoqoftë, tani që ai ka nxjerrë dy libra me tregime dhe ka botuar mjaft tregime të tjera, ndodhet para një problemi krijonjës me rëndësi, pasi ka nisur të përsërëtë vvetven dhe të bëhet monoton. Veç kësaj, stili i tij sikur e heq pas vetes edhe në zgjedhjen e temave e të subjekteve. Nga ana tjetër a nuk tregohet ai pak realist edhe në gjuhë? Jeta ndron dhe mënyrën e të menduarit e të folurit të njerëzve dhe shkrimtari duhet t'i ketë parasysh këto ndryshime.

Për konceptimin dhe pasqyrimin realist të

subjekteve dhe për ndërtimin harmonik të veprave, rëndësi të dorës së parë ka formimi i mirë kompozicional i veprave. Kompozicioni mund të ndihmojë, ose mund të pengojë drejt-përdrejt pasqyrimin me thellësi e gjërësi të jetës dhe mund të cënojë vlerën e përgjithëshme artistike të veprave. Rastet më tipike në prozën tonë janë formimi kompozitional i pamenduar mirë dhe thyerja e unitetit arkitektonik të veprave për të pasqyruar domosdo aspekte të futura me vështirësi në romanet dhe në tregimet e gjata. Janë aq të përhapura këto dy dobësi kompozicionale, saqë do të ishte pâk e vështirë të gjëndeshin vepra në zhanret e gjata të prozës që të mos vuanin prej tyre. Ndonjë proj diskutonjësve mund të meret hollësish me këtë prob'em të rëndësishëm, i cili do të na detyronte të zgjateshim tepër po ta analizonim në këtë referat.

Një prej çfaqjeve më të rënda të amatorizmit në prozën tonë, që dëmton vlerën stilistike të veprave është raporti i padrejtë dhe mosëshkrirja organike, në një të vetme, i sfondit historik shoqëroj dhe i figurave artistike që krijohen dhe ngrihen mbi këtë sfond ose, diçka tjetër: përshkrimi descriptiv i fenomeneve shoqërore dhe i ngjarjeve, duke i marë këto si qëllim në vetvete. Kjo nuk është një e metë që çfaqet vetëm në prozën tonë dhe nuk ka të bëjë vëtëm me mjeshtërinë e shkrimitarëve. Kjo është një sëmundje e foshnjërisë, një dobësi e fillimeve të çdo letërsie të re.

Dihet prej të gjithëve që objekti i letërsisë nuk është bota në përgjithësi, apo jeta në përgjithësi, po është njeriu në botë, njeriu në jetë.

Eshtë detyrë e historisë, e gazetarisë dhe e formave të tjera të kësaj natyre, që të përshkruajnë fenomenet historike dhe shoqërore në veteve e të lidhura me njëra tjetrën. Etnografi ta zëmë, interesohet dhe ka për detyrë të përshkruajë me hollësi dhe objektivisht zakonet e vëndit, ceremonitë populllore. Ai edhe nëqoftëse mer një rast konkret dasme zbulon në' të karakteristikat e një krahine, duke përshkruar me hollësi procesin e dasmës. Shkrimtari duhet t'i njohe këto zakone e ceremoni, raportin pozitiv apo negativ ndërmjet zakoneve dhe njeriut, por duhet të përshkruajë *njeriun* në këto ceremoni e në lidhje me këto zakone. Në romanin «*Me valët e jetës*» të Vedat Kokonës ka një përshkrim të hollësishëm dhe, nga ana etnografike të mirë, të zakoneve dhe të ceremonisë populllore të dasmës; po në roman kjo tingëllon si një notë e zgjatur dhe, bile, e tepërt, se autori, duke u marë me një përshkrim deskriptiv të dasmës, ka haruar personazhet e veprës, gjëndjen e tyre shpirtërore, mendimet e tyre, ndikimin që ushtron dasma në gjëndjen e tyre psikologjike.

Ose të kujtojmë skenat e punës për tharjen e kënetës në romanin e Fatmir Gjatës. Ndërsa në historinë e dashurisë së Stavri Larës me Rinnën, në përshkrimin e gjëndjes shpirtërore të disa personazheve e, deri diku, edhe në analizën e motiveve të punës armiqësore të inxhinjerëve sabotatorë, ndihet pu'si i emocioneve të shkrimit tarit dhe e vërteta e jetës eshtë mishëruar në profilin dhe veprimet e heronjve, përshkrimi i punës, me ndonjë përjashtim të rrallë, eshtë dhënë në formë deskriptive dhe eshtë kthyer në qëllim në veteve, ndaj lexonjësi mbetet i ftohët karshi saj.

Edhe në vëllimin e parë të romanit «*Çlirimtarët*», sidomos në fillimet e kapitujve dhe në digresionet, ka shumë njojuri të dhëna në formë pak emocionale, ndaj, me gjithse nxitin kureshqerjen e lexonjësit të kulturuar për probleme shoqërore e historike, ato nuk arrijnë ta tërheqin atë në kuptimin estetik të fjalës.

Shëmbulla të tilla ka mjaft në veprat e prozatorëve tanë, po duhet të shënojmë, se janë të rralla, veprat të cilat përshkohen fund e krye prej një natyre të tillë deskrptive. Mund të përmëndim ndër 'to tregimin e gjatë të Shevqet Musarajt «*L'az Qestorati*» tregimet e gjata «*Ujrat e verdha*» dhe «*Prova e madhe*» të Fatmir Gjatës, novelën «*Ditë të gëzuara*» të Zihni Sakos, tregimin e gjatë «*Shpërthimi*» të Miço Kallamatës etj. Prej një të mete të tillë vuan në një masë të ndijshme edhe romani «*Për mëmëdhënë*» i Thoma Kacorit. Në këto vepra dhe në të tjerat si këto, shkrimtarët kanë treguar pak kujdes për krijimin e figurave artistike dhe janë marë me parashtrimin e materialit bruto që u ka dhënëjeta, prandaj, edhe kur kanë patur të bëjnë me momente mjaft interesante, nuk të emocionojnë, të lënë të ftohtë, të duken të rënduar së tepërtimi.

E shohim të nevojshme të ndalemi edhe tek çështja e mendimit të madh që duhet të vihet në themele të çdo vepre dhe çdo figure artistike. Këto 10 vjetët e fundit proza jonë, duke dalë prej fazës fillestare të zhvi limit të vet, ka filluar të ketë piksynime ideo-estetike më pretendonjëse, të mos kufizohet vetëm me përshkrimin e ngjarjeve, po të kërkojë edhe kuptimin e tyre, të ketë parasysh edhe qëllimin ideo-estetik të

zgjedhjes së temave dhe të trajtimit të tyre.

Të kësaj kohe janë edhe veprat në të cilat subjekti nuk luan domosdo rolin kryesor, në të cilat nëpërmjet një subjekti «të vogël» krijojen figurat artistike të forta, me kuptim të thellë ideo-artistik. Kjo është një nga shënjet e pjekurisë, pa qenë e vëtmia rrugë që duhet ndjekur.

Prej tregimtarëve të socëm, që kanë bërë përpjekje të frutëshme në këtë drejtim, që i kanë dhënë rëndësi jo vetëm asaj që përshkruajnë, po edhe mendimit që do të mishërojnë me 'të, do të përmëndja Naum Priftin (vëllimi «Çezma e florrit»), Dhimitër Xhuvanin (vëllimi «Këmbana e fundit»), Dalan Shapllon (vëllimi «Përtëritje»), Gazmend Kongolin (vëllimin «Vajza me vathë të kuq»). Këta prozatorë të rinj, që tani kanë hyrë në radhët e tregimtarëve të mirë, i ka interesuar shumë dhe me të drejtë kuptimi i fakteve që përshkruajnë dhe kujdesi për të qënë konçizë, të thellë dhe për të shkruar me kulturë, duke iu shmangur manierave gjuhësore, duke iu afruar shumë gjuhës së folur, ndonse Dhimitër Xhuvani mund të qértohet për pakujdesi të theksuar në punë të gjuhës.

Detyra kryesore e prozatorëve tanë në këtë periudhë, për sa u takon çështjeve të stilit, mendoj se është ngritja e mëtejshme e *kulturës së të shkruarit*, duke u mbështetur në eksperiencën e mirë kolektive, që është sajuar prej të gjithëve. Veprat tona duhet të jenë jo vetëm të mira, me përbajtje të shëndoshë, po edhe të bucura, të shkruara me pasion e me mjeshtëri.

U mundova të shtroj disa prej problemeve të prozës sonë dhe të prek disa çështje, që kanë të bëjnë me konsolidimin e mëtejshëm të realizmit Në fund dëshiroj të shpreh bindjen e theilë, se me këto forca letrare që kemi, me këto suksese që kemi arritur gjer tani dhe me perspektivat e mëdha që i ka çelur Partia lulëzimit të mëtejshëm të kulturës socialiste në vëndin tonë, proza jonë në dhjetvjeçarin e ardhshëm, ashtu siç ka parashikuar Komiteti Qëndror i Partisë për gjithë letërsinë dhe artet tona, do të bëhet një prozë plotësish e zhvilluar e realizmit socialist dhe do të pasurohet shumë e më shumë me vepra të reja, gjithnjë e më të mira. Kujdesi i Partisë dhe dashuria e respekti që kanë për punën tonë masat e gjëra të popullit, do të jenë edhe në të ardhmen burim forcash dhe nxitje e madhe për ne. *Faza e kapërcimit prej gjëndjes së dikurshme të prapambetur tani, mund të themi, se ka përfunduar plotësish dhe me sukses në prozë. Po nis një fazë e re e pjekurisë dhe e përparimit të mëtejshëm, faza e lulëzimit të plotë të saj.* E ardhmja do të tregojë që edhe këtij piksynimi të vështirë do t'ja arritmë. S'mund të ndodhë ndryshe në një vënd si yni, që udhëhiqet prej Partisë sonë të mrekullueshme, në një vënd që lufton me frymzim të lartë për arritjen e qëllimeve fisnike për transformimin e vet socialist, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe për triumfin e lirisë, të socializmit dhe të paqës në të gjithë botën.

*(Botuar në revistën «Nëndori»  
Nr. 1, 1963)*

## **LENINI — KULTURA DHE ARTI**

*(Duke çfletuar librin: «Lenini për kulturën  
dhe artin»)*

Botkuptimi më i përparuar dhe deri në fund revolucionar i kohës sonë, — marksizëm-leninizmi, — është i lidhur ngushtë me emrin, jetën dhe veprën e pavdekshme të Vladimir Iliç Leninit. Në veprat e tija komunistët dhe punonjësit e gjithë botës gjejnë përgjigjen e saktë shkencore për çështjet më të rëndësishme të filozofisë, të ekonomisë politike, të socializmit shkencor. Veprat e Leninit, të cilat sot janë bërë më aktuale se kurrë, ndriçojnë në mënyrë revolucionare mëndjen e njerëzve të punës, duke analizuar shkencërisht të kaluarën e njerëzimit, të sotmen dhe të ardhmen e tij. Prandaj njojja e the'lë e mendimeve leniniste nuk është vetëm një burim dituri-shë, po edhe një mjet nga më të rëndësishmit, pa të cilin nuk mund të zgjidhen drejt as problemet e vështira të analizave e përcaktive historike, as çështjet themelore të kohës sonë dhe as nuk mund të ndriçohen drejt perspektivat dhe de-

tyrat për të ardhmen. Kështu qëndron puna si në filozofi dhe në ekonominë politike, në politikë dhe në shkencat shoqërore. Kështu qëndron puna edhe në lëmin e kulturës e të artit.

Që të flitet për mendimet e Leninit mbi kulturën e artin është e domosdoshme, para së gjithash, të nisemi nga parimet themelore fi'o-zofike të botkuptimit marksist-leninist, prej të cilave rrjedhin edhe tezat kryesore të marksistëve në lëmin e artit, të kulturës e të shkencës. Është e nevojshme të theksohet, që asnjë fjalë e Leninit për kulturën nuk mund të merret e shkëputur prej botkuptimit materialist-dialektik, të cilin ai e mbrojti prej armiqve të marksizmit dhe e zhvilloi më tej, në pajtim me gjëndjen e re të krijuar pas vdekjes së Marksit e të Engelsit, në pajtim më zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë e të shkencës.

Revisionistët dhe oportunistët e sotëm janë orvatur dhe po orvaten akoma ta çveshin personalitetin e madhërishëm të Leninit prej frymës revolucionare, duke parafytyruar një Lenin, sipas dëshirave të tyre, «paqësor» që për hir të paqës në shoqëri e në botë, qënkish gati të sakrifikonte çdo gjë, deri edhe parimet. Por, këto orvatje djallëzore janë të gjykuara të dështojnë, mbasi parimet jetdhënëse leniniste nuk janë fjalë librash, po pasqyrim i ligjeve objektive të vëjetrënës dhe jeta, ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen, do t'i vërtetojë e do t'i mbrojë ato. Lenin ka luftuar pamëshirë kundër të gjithë armiqve të marksizmit, kundër të gjithë deviatorëve dhe oportunistëve. Ai ka folur kurdoherë me përbuzje e neveri për ata që hiqen si marksistë dhe janë armiq të marksizmit.

Duke çfletuar botimin shqip: «*Lenini për kulturën dhe artin*», ne vrejmë, para së gjithash, se të gjitha tezat e parashtruara prej Leninit mbi teorinë e njohjes, mbi fryshten e partisë në art, mbi lidhjen e ngushtë të krijimtarisë artistike me botkuptimin e artistit e me po'itikën, mbi egzistencën në çdo kulturë kombëtare të dy kulturave kombëtare, mbi revolucionin kulturor, mbi traditat e novatorizmin dhe mbi një varg çështjesh të tjera të estetikës dhe të krijimtarisë artistike, janë dhe do të mbeten përgjithnjë themel i patundur i mendimit estetik marksist-leninist dhe i veprimitarisë krijonjëse të artistëve e shkrimitarëve të realizmit socialist.

Marksi dhe Engelsi në kohën e tyre shënuan se arti ka patur dhe do të ketë kurdoherë karakter të partishëm. Në artikullin «*Organizata e partisë dhe letërsija e partisë*» Lenini na jep në formë të plotë e harmonike teorinë e fryshtës së partisë në art. Ai thekson se gjithë krijimtaria artistike, në të gjitha kohërat, ka patur karakter partijsk dhe kjo nuk është një kërkesë e diktuar nga jashtë, po është një karakteristikë e natyrëshme e artit, që diktohet prej jetës vet. Ndryshimi qëndron vetëm këtu: ndërsa borgjezët, vërtet demagogji, e mohojnë karakterin e partishëm të artit të tyre, proletariati e proklamon haptaz, mbasi fryshtë e partisë komuniste në art është e vetmia fryshtë, që pajtohet me interesat e miljona e miljona punonjësve, që luftojnë kundër zgjedhës kapitaliste, apo që punojnë për transformimin revolucionar të shoqërisë, për ndërtimin e socializmit. Arti, që përshkohet nga fryshtë e partisë komuniste, siç thoshte Lenini, u drejtohet miljona e dhjetra miljona punonjësve, të

cilët përbëjnë lulen e vëndit, të ardhmen e tij. Kjo fryshtë revolucionare partije pajtohet plotësisht me kërkuesat për një art thëllësisht realist dhe humanist. Prandaj, elementët oportunistë e revizjonistë, i kanë drejtuar shigjetat, para së gjithash, kundër këtij parimi revolucionar të estetikës marksiste-leniniste. Nga një anë ata mohojnë fryshtën e partisë në art dhe kështu përkrahin me të gjitha format dhe mjetet e mundëshme interesat e borgjezisë dhe, nga ana tjetër, luftojnë kundër realizmit, veçanërisht kundër realizmit socialist, duke e ditur se artisti realist pasqyron me vërtetësi jetën, ligjet objektive të zhvillimit të saj, tendencën përparimtare të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, fundin e borgjezisë dhe domosdoshmërinë e socializmit. Pra, kur flasin kundër fryshtës së partisë, ata në të vërtetë flasin vetëm kundër fryshtës së partisë komuniste dhe i japin teren ideo'logjisë borgjeze reaksionare në art.

Artikulli i Leninit hedh dritë edhe në çesh-tjen e të kuptuarit të lirisë së krijimit. Pasi demaskon hipokrizinë borgjeze, — të cilën sot e ngrejnjë aq lartë estetët borgjezë e revizjonistë, — se gjoja në kushtet e kapitalizmit ka një liri të plotë krijimi, Lenini proklamon lirinë e vërtetë, e cila mund të arrihet vetëm në socializëm. Ai thotë:

«*Ne duam të krijojmë dhe do të krijojmë një shtyp të lirë, jo vetëm në kuptimin policor, po edhe të lirë nga kapitali e nga karierizmi; — dhe, jo vetëm kaq: të lirë edhe nga individualizmi anarqik borgjez».*

Kjo është e vetmja bazë e vërtetë, prandaj edhe e drejtë, mbi të cilën mund dhe duhet të mbështetet koncepti i lirisë së krijimit, mbasi në

këtë përcaktim të Leninit theksohet edhe çirimi ekonomik-shoqëror i artistit nga skllavërija kapitaliste, edhe çirimi i personalitetit të artistit prej karierizmit dhe individualizmit anarqik borgjez, pra, ngritja e tij në nivelin e lartë të përfaqësonjësit të denjë të shtresave më të gjëra dhe më përparimtare të shoqërisë njerëzore. Pa çirimin ekonomik e shoqëror të artistit, pa çirimin e tij prej ideologjive reaksionare borgjeze, nuk mund të bëhet fjalë për liri krijimi.

Disa estetë revizjonistë, ndër 'ta edhe Josip Vidmari, kryetar i Lidhjes së shkrimitarëve jugosllav, janë përpjekur, duke përdorur një formë skolastike e sofistike gjykimesh, të provojnë se Le-nini, sidomos në artikujt për To'stoin, është kundër lidhjes së krijimtarisë artistike me botkuptimin e shkrimitarit dhe kundër lidhjes së artit me politikën. Përpjekje sa absurde, aq edhe të rezikëshme e djallëzore prej shërbëtori të borgjezisë, që janë krejtësisht në kundërshtim të hapët me mendimet e Leninit!

«Të jetosh në një shoqëri dhe të jesh i lirë prej kësaj shoqërije — thotë Lenini — është e pamundur». Kurse, për kontradiktat në botkuptimin e Tolstoit, ai shkruan:

«Kontradiktat në pikpamjet e Tolstoit... janë një pasqyrë reale e atyre kushteve kontradiktore, në të cilat u vu veprimitarija historike e fshatarësisë në revolucionin tonë».

Pra, krijimtarija e Tolstoit shihet prej Leninit e lidhur ngushtë me shtresa të caktuara shoqërore, që përfaqësonte shkrimitari, — me fshatarësinë, — dhe kontradiktat në pikpamjet e tij trajtohen si pasqyrë e vet kushteve kontradiktore historike. Përsa i takon vlerësimit të

Vidmarit dhe misjonit politik të artit, mund ë përmëndim edhe një pasazh tjetër nga Lenini, në të cilin ai thotë:

«Ata (liberalët borgjezë, Red.) nuk mund t'i vlerësojnë haptazi dhe qartë pikpamjet e Tolstoit mbi shtetin, mbi kishën, mbi pronën private të tokës, mbi kapitalizmin... sepse çdo tezë në kritikën e Tolstoit është një dackë për liberalizmin borgjez».

A nuk janë një dackë e fortë kundër estetëve të sotëm revizionistë, që proklamojnë shkëputjen e artit nga ideologjia e nga politika, këto fjalë të Leninit?

Kundër praktikës që ndiqet sot në Jugosllavi dhe kundër tezave të revizjonistëve, që shpien në çdukjen e kufijve ndërmjet klasëve dhe pikpamjeve klasiste, është edhe teza leniniste e egzistencës së dy kulturave në çdo kulturë kombëtare: të kulturës popullore, demokratike, socialistike, nga një anë dhe të kulturës borgjeze, reaksionare, nga ana tjetër. Partija jonë e Punës, në pajtim të plotë me këtë parim leninist, na ka mësuar ne, që jo vetëm në të kaluarën, po edhe në të sotmen e artit e të kulturës së vëndeve kapitaliste, t'i dallojmë mirë këto dy kultura; të njohim, të përhapim e të përkrahim kulturën dhe artin pérparimtar, duke përfituar prej anëve më të mira të tij dhe të luftojmë vendosmërisht, ashtu siç bënte Lenini, kundër të gjitha çfaqieve dekadente, formaliste e reaksionare të kulturës e të artit borgjez, që me aq zell e dëshirë e përkrahin dhe e përhapin revizjonistët, si mjet përtë luftuar kundër socializmit dhe klasës punëtore,

Me qëllim revizjonistët dhe oportunistët mbajnë në lëmin e artit e të estetikës një qën-

drim objektivist, që është në dobi të rymave e tendencave më reaksionare të artit të sotëm. Duke pohuar gjithçka që egziston, duke nxitur haptaz dekadentizmin në letërsi e në art, ata luftojnë kundër artit përparimtar realist të ditëve tonë, kundër artit, që përkrah me të gjitha forcat klasën, punëtore, masat punonjëse dhe socializmin.

Rëndësi të posaçme, si përmendimin estetik, ashtu edhe përm krijimtarinë artistike të ditëve tonë, kanë tezat leniniste mbi piknisjen materialiste në studimin e fakteve, analizën e situatave, që na jep jeta dhe mbi domosdonë e dallimit, në kushtet e ndërtimit socialist, të lindjes e lulëzimit të së resë nga dekompozimi dhe vdekja e së vjetrës. Ai shkruan:

*«Objektivisti, kur provon domosdonë e një vargu të dhënë faktesh, rrëzikohet gjithnjë të bjerë në pozitat e mbrojtësit të këtyre fakteve; materialisti zbulon kontradiktat e klasëve dhe, në këtë mënyrë, përcakton pikpamjen e tij.»*

Kurse në artikullin «Inisjativa e madhe» thotë:

*«Kur e reja apo ka lindur, e vjetëra gjithmonë vazhdon të jetë, përm një farë kohe, më e fortë se ajo; kjo ndodh gjithmonë, si në natyrë dhe në jetën e shoqërisë. Të tallesh me dobësinë e filizave të së resë, të tregosh në çdo hap skeptiqizmin prej intelektuali etj. — kjo do të thotë, në thelb, të përqafoshë metodat e luftës së klasës që bën borgjezija kundër proletariatit, do të thotë të mbrosh kapitalizmin kundër socializmit.»*

Shkrimtarët dhe artistët tanë, të udhëhequr me urtësi prej Partisë së Punës, që gjat luftës Nacional-Çlirimtare kanë përkrahur dhe përkrahin me krijimet e tyre filizat e së resë dhe kanë luftuar dhe luftojnë me vendosmëri kundër

të gjitha çfaqjeve të botkuptimit, psikologjisë; mënta itetit dhe zakoneve të së vjetrës e cila; megjithëse është përbysur, ka lënë gjurmë gjat shkujve në ndërgjegjen e njerëzve dhe nxitet prej rrethimit kapitalist, në kushtet e të cilit popullit tonë i duhet të ndërtojë socializmin.

Lenini i kushton te vëmëndje të veçantë tipizmit të karaktereve dhe të fenomeneve shoqërore, si në lëtërsi e në art, ashtu edhe në politikë. Ai kurdoherë ka nënvizuar nevojën e domosdoshme të zbulimit të rrënjjëve historike shoqërore të cdo fenomeni dhe kapërcimin e kufijve të ngushtë të të dhënave të sipërfaqëshme për një individ apo për një fenomen të caktuar shoqëror. Siç shihet, edhe kjo kërkesë leniniste buron prej parimeve themë ore të filozofisë marksiste-leniniste dhe është në harmoni të plotë më tezat e tjera të estetikës sonë. Në veprat e veta Lenini na ka dhënë shumë shëmbulla interesante dhe bindësse tipizimi, prej të cilave do mjaftonte të përmëndnim artikujt e tij: «*Kujtimit të kontit Hejden*» dhe «*Në konakët e shërbëtorëve*», ku del para nesh, jo individi me tiparët e tij të sipërfaqshëme e të parëndësishme, po tipi shoqëror, mendimet, psikologjija, idealet dhe sjell jet e të cilit përcaktohen prej esencës së tij shoqërore si tip. Ja q'thotë Lenini, kur merret me karakterizimin e tipit të shërbëtorit:

«...Puna qëndron pikërisht te tipi shoqëror dhe jo te vetitë e njerëzve të veçantë. Shërbëtori mund të jetë njeri shumë i ndershëm, pjestar shëmbullor i familjes së tij, qytetar shumë i mirë, po ai, pa tjetër, është i dënuar të sillet me hipokrizi, sepse tipari kryesor i profesionit të tij është bashkimi i interesave të zotërisë, të cilit

*ai «i është zotuar» t'i shërbejë me «besa-besë», me interesat e rrerhit, nga i cili rekrutohen shërbëtorët».*

Kjo analizë leniniste shtron para artistëve dhe shkrimtarëve realistë detyrën e rëndësishme të trajtimit historik konkret të fenomeneve shqërore, të thellimit në proceset jetësore, që do pasqyrohen në vepra arti, të njojjes së gjithë-anëshme të shoqërisë, të së kaluarës, të së tashmes dhe të së ardhmes së sajë, mbasi vetëm në këtë mënyrë mund të bëhen përgjithësime të vërteta artistike dhe të krijojen «*karaktere tipike* në *rrethana tipike*», siç thoshte Engelsi.

Në përmbledhjen: «*Lenini për kulturën dhe artin*» një vënd të dukshëm zënë edhe ato shkrimi, në të cilat udhëheqësi i madh i proletariatit trajton çështjen e traditave dhe të novatorizmit në art. Nëpërmjet vlerësimit që ai u ka bërë përfaqësonjësve më të shquar të mendimit dhe të letërsisë klasike ruse, njeriu mëson se si dhe "bazë të ç'kritereve shkencore duhet të niset kur analizon, çmon apo kritikon krijimtarinë e artistëve të së kaluarës. Dihet prej të gjithëve lufta e vendosur e Leninit kundër teoricjenëve të «*kulturës proletare*», të cilët donin ta shkëputnin kulturën socialiste prej terrenit të sajë të shëndoshë, të krijuar gjatë qindra e qindra vjetëve prej njerëzimit dhe pretendonin të «*krijonin*» një kulturë të re nga hiçi i mendimeve të tyre çapraze. Kundër tyre Lenini parashtroi tezën marksiste, sipas së cilës: «*kultura socialiste nuk është diçka që s'dihet nga ka dalë; nuk është një shpikje e njerëzve që e heqin veten specialistë të kulturës proletare. Të gjitha këto janë gjëpura fund e krye. Kultura proletare duhet të jetë zhvillim i natyrshëm i të gjitha atyre diturive, që ka për-*

*punuuar njerézimi nën zgjedhën e shoqërisë kapitaliste, çifligare e burokrate».*

Teoritë e dështuara shtatanike të «kulturës proletare» të kujtojnë sot teoritë e kutëbuara borgjeze e revizioniste mbi «artin e së ardhmes», apo mbi «artin proletar». Në këto raste demagogjija dhe hipokrizija duket sheshit: ata u vënë emra të tillë «simpatikë» përcudnimeve të muzikës dodekafonike, konkrete e elektronike, pikturnave abstrakte dhe rrymave dekadente 'etrarë vetëm që të térheqin në anën e tyre proletariatin dhe ta shkëpusin atë prej artit të vërtetë realist të ditëve tonë, në të cilin shprehen mendime përparimare, ideale të larta dhe ndjenja të thella njerëzore, në të cilin demaskohet natyra e egër dhe e paturpëshme e çfrytëzimit kapitalist kundër të cilët lufton proletariati.

Lenini, duke vlerësuar traditat përparimtare të së kaluarës dhe duke ndjekur me vëmëndje të posaçme lulëzimin e filizave të reja të artit e të kulturës socialiste në Bashkimin Sovjetik, fiste me neveri për «modën artistike, që sundon në Perëndim». Ai, ndryshe nga ç'duan ta paraqesin revizjonistët, ishte armik i vendosur i të gjitha ekstravagancave të dekadentëve e formalistëve dhe kërkonte që arti socialist të ishte një art thellësisht realist, i mbrujtur me ideale të larta, i afërt me popullin dhe i kuptueshëm prej tij.

«Pse duhet të përulemi përpara së resë, si përpara zotit dhe t'i nënshtrohem i asaj vetëm e vetëm se është «e re»? — i thoshte Lenini Klara Cetkinit. — Absurditet, absurditet kokë e këmbë! Këtu ka shumë hipokrizi dhe respekt të pandërgjegjshëm për modën artistike që sundon në Perëndim... Unë nuk jam në gjëndje që t'i

*quaj çfaqie të mëdha të gjenisë artistike veprat e ekspresionizmit, të futurizmit, të kubizmit dhe të «izmave» të tjera. Unë nuk i kuptoj ato. Unë nuk ndiej asnje gjëzim prej tyre».*

Arti socialist, sipas Leninit, është novator, pikërisht se është zhvillim i natyrshëm i triditave përparimtare të së kaluarës. Çdo kuptim tjetër i novatorizmit është i gabuar dhe i dëmshëm, mbasi shpije në shkëputjen e artit prej thesarit të kulturës përparimtare dhe e fut atë në qorsokaqet e formalizmit, ekstravagancat e shëmtuara të cilit nuk kanë asnje lidhje me aratin e vërtetë. Përballë këtyre përcudnimeve Lenini ka vënë artin populor demokratik dhe ka theksuar:

*«Arti duhet t'i shtrije rrënjet e tij të thella në shtresat e dëndura të masave të gjera të punonjësve. Ai duhet të kuptohet e të pëlqehet nga këto masa. Ai duhet të bashkojë ndjenjat, mendimet dhe vullnetin e këtyre masave dhe t'i ngrejë ato».*

Pikërisht për një art të tillë u ka bërë thirrje vazhdimi i partija shkrimitarëve, piktorëve, skulptorëve dhe kompozitorëve tanë dhe pikërisht një art i tillë po lulëzon në vëndin tonë, nën udhëheqien e Partisë së Punës, e cila, si në gjithë sektorët e tjerë të jetës sonë sociale, edhe në lëmin e kulturës e të artit është mbështetur fuqimisht në mësimet jetdhënëse të Marksit, Engelsit e Leninit, duke siguruar në fushën e artit, ashtu siç thoshte Lenini, *«një liri më të madhe inisiativës personale, prirjeve individuale»*, duke u lënë fushë të lirë *«mendimit dhe fantazisë, formës dhe përmbytjes»*.

*(Botuar në gazeten  
«Drita» 22 prill 1961)*

## NJE E VERTETE QE DO THENE

Kam parasysh mjaft artikuj teorikë dhe kritikë mbi gjëndjen e artit të sotëm jugosllav, mbi tendencat e theksuara dekadente të tij dhe mbi «teoritë» reaksionare, që kultivojnë në Jugosllavi estetët dhe teoricienët revisionistë. Artikujt janë të pasur me shëmbulla të shumta dhe prej tyre njeriu mund të krijojë një tabllo të saktë të anarshisë dhe dekadentizmit, që sundojnë sot në jetën kulturore, letrare dhe artistike t'atij vëndi.

Por, megjithkëtë, pasi i këndon këto shkrimet, mbetesh i pakënaqur. Në 'ta mungon *diçka* dhe ajo *diçka*, që mungon, është shumë e rëndësishme, themelore, që mund të shpjegonte rrënjet e vërteta të degjenerimit të artit jugosllav, që mund të zbulonte shkaqet e vërteta të përhapjes së teorive më reaksionare estetike në Jugosllavi.

Autorët e artikujve, zakonisht padisin shkrirtarët, piktorët, skulptorët, kritikët dhe estetët për «veprat» e për «teoritë» e tyre, tregojnë

lidhjet e tyre me artin e sotëm dekadent borgjez dhe me estetikën reaksionare, po nuk flasin për raportet e artit e të mendimit estetik me jetën e vëndit, me politikën e Beogradit, me ideologjinë e oportunizmit revisionist.

Kurse pikërisht nga një piknisje e tillë duhej të zinte fill analiza e veprave dhe e problemeve, mbasi vetëm në këtë mënyrë çështjet do trajtoheshin njëkohësisht në aspektin e tyre *logjik* dhe *historik*, siç e kërkon metodologjia marksiste. Të studjosh botkuptimin e një vëndi apo të një kohe pa patur parasysh jetën e atij vëndi e të asaj kohe, pa vënë në dukje rendin e marrëdhënieve shoqërore ndërmjet njerëzve, do të thotë të mos u hysh thellë problemeve, të jesh i përciptë. Të studjosh artin dhe pikpamjet e teoritë estetike t'atij vëndi jashtë lidhjeve të tyre me jetën, jashtë kushteve historike, në të cilat ato zhvillohen, jashtë orientimit ideo-logjik zyrtar dhe politikës zyrtare, do të thotë të mos nisesh andej nga duhet nisur dhe të mos arrish dot atje ku duhet arritur. Arti — dhe këtë të vërtetë e dinë të gjithë, — në të gjitha format e çfaqjes së tij, as që mund të egzistojë jashtë jetës, i çkëputur nga politika dhe nga ideologjia, që ushtrojnë mbi 'të një ndikim të vazhdueshëm, që shkrihen në 'të, që çfaqen në-përmjet tij, bashkë me qëndrimin e artistit apo të estetit.

Kritikohen, për shëmbull, disa shkrimitarë dhe poetë jugosllavë, të cilët në veprat e tyre, trajtojnë çështjen e kotësisë së sakrificave dhe gjakderdhjes gjatë luftës antifashiste. Ata, — disa, bile, sinqerisht të dëshpëruar, — tregojnë se gjithçka shkoi kot, gjithçka humbi, gjithçka

që ndodhi: edhe heroizmi, edhe lufta, edhe viktimat, edhe shkatërrimet e luftës, — gjithçka ishte pa kuptim. Këto vepra, që nuk janë të pakta, përshkohen nga një pesimizëm i thellë, i cili kalon disa herë edhe në nihilizëm.

Artikuujshkronjësit, gati të gjithë, i kritikojnë shkrimtarët për pesimizëm, për nihilizëm. Kritika është e drejtë. Po lind pyetja: si duhet t'i trajtonin këto tema autorët e veprave të kritikuara? Mos vallë duhej të dëshmonin të kundërtën?

Nëqoftëse kritikët do kishin parasysh realitetin jugosllav, tradhëtinë e udhëheqësve revisionistë, tragjedinë e mijëra komunistëve, dëshpërimin e mijëra luftëtarëve, nëqoftëse ata do t'i analizonin veprat lidhur ngushtë me jetën që i lindi, pra, nëqoftëse e trajtonin çështjen edhe në aspektin historik, atëhere nuk do të kërkonin prej shkrimtarëve që të mos flisnin për «kotësinë e revolucionit», po do kërkonin diçka tjetër. Do kërkonin pasqyrimin realist të luftës së popullit jugosllav dhe të tradhëtisë që i bënë kërret parullave, idealeve dhe fitoreve të revolucionit. Do kërkonin që shkrimtarët të paraqisin në veprat e tyre perspektivën e populit jugosllav, po aq me realizëm, sa edhe luftën, trimëritë dhe sakrificat e tij, të cilat u tradhëtuan. Se sa mund të arrihet diçka e tillë në Jugosllavi, ku mbretëron spiunazhi dhe terrori, kjo është një çështje tjetër.

Pra, edhe pse nuk na pëlqen pesimizmi e nihilizmi i veprave të till'a, zjarri i kritikës do drejtuar në radhë të parë kundër burimit të këtij pesimizmi, kundër jetës që e ngjall dhe e nxit edhe në kundërshtim me dëshirën e kre-

rëve revizionistë, pa pyetur në se u pëlqen apo nuk u pëlqen një gjë e tillë shkrimtarëve. Ndryshe biem në subjektivizëm.

Njerëzit, parullat dhe idealet e luftës antifashiste të populit jugosllav kritikohen edhe nga piknisje haptas reaksionare prej disa shkrimtarëve dhe artistëve thellësisht dekadentë. Në veprat e këtyre zakonisht lufta e popullit për liri paraqitet si një çfaqje egërsie barbare, kurse heronjt e luftës, që dhanë jetën për lumturinë e popullit, vizatohen me ngivrat më të pështira. Ata paraqiten si njerëz karieristë, hipokritë, pa moral, pa ideale njerëzore. Ky su'm i neveritshëm, cinik dhe çnjerëzor, ky mohim i çdo gjëje të lartë e sublime, kjo tallje mefistofeliane kundër traditave më të çmuara të popullit, është një çfaqje e hapët e sulmit të «reakzionit të bardhë» kundër ideve dhe idealeve revolucionare. Që këta shkrimtarë janë të poshtër dhe që veprat e tyre janë të neveritëshme, si çdo vepër reaksionare borgjeze, është e qartë për të gjithë,

Po, veprat e artit e lozin rolin e tyre, jo kur ndodhen mbi tryezën apo në studion e artistit, po kur i serviren publikut, kur ato kthehen në objekt ndikimi mbi lexonjësit, spektatorët dhe dëgjonjësit. Gjersa është kështu vetveti u lind pyetja: kush i boton dhe i përhap këto kulturëma? Kësaj pyetjeje nuk duhet t'i shmanget asnjë studionjës i artit, nëqoftëse ai dëshëron ta trajtojë çështjen shkencërisht. Këto vepra nuk mund të kuptohen të shkëputura nga përhapja gjithënjë e më e madhe e ideologjisë borgjeze në Jugosllavi, nga largimi gjithënjë e më i hapur i revizionistëve prej ideologjisë revolucionare, nga dëshira e tyre për të shuar në

kujtesën e njerëzve edhe kujtimin e parullave për të cilat ata luftuan e dhanë jetën, nga liria që u kanë dhënë ata gjithë njerëzve të liq, të cilët janë në gjëndje t'i ndihmojnë që të shushatin e të turbullojnë masat, që të mbjellin konfuzion dhe mjegullimë në jetën shoqërore të vëndit. Ndryshe s'ka si spjegohet botimi i vepgrave të tilla dhe ekspozimi i pikturave që përshkohen nga ide të tilla. De', pra, që në Jugosllavi egzistojnë kushtet objektive, prandaj çfaqen fenomene të tilla në art.

Estetët dhe revizionistët e sotëm reklamojnë, duke marë poza prej mburravecësh, «gjeninë» e piktorëve dhe të skulptorëve abstraksionistë, duke thënë, bile, që Jugoslavia po bën çudira në lëmin e artit. Mund të ketë edhe njerëz që i pranojnë këto «çudira», ashtu siç pati njerëz në përrallën e vëllezërve Grimm, që lëvduan veshjen e bukur të mbretit... lakuriq. Gjithë studionjësit dhe kritikët përparimtarë janë të një mëndjeje, se këtu nuk kemi të bëjmë me art, po me ekstravaganca të modës perëndimore, me degjenerim të artit. Po, që një fenomen i tillë vrehet vetëm në artin reaksionar broqjez, në Jugosllavi dhe pjesërisht edhe në ndonjë vënd tjetër dhe nuk ndodh as me shkrimtarët e artistët e njojur përparimtarë, as në vëndet socialistë, nuk është një gjë e rastit dhe as që ndodh vetëm përfaj të disa sharlatanëve, marrëzitë e të cilëve nuk vleinë të analizohen seriozisht si «vepra arti». Kjo ndodh, para së gjithash, sé vetë jeta në Jugosllavi orientohet nga Perëndimi, se udhëheqësit revizionistë i kanë kthyer krahët agimit. Ata duan njëmijë herë më tepër një «art» të tillë, se sa një vepër të vërtetë

të artistike që do të zgjonte ndërgjegjen e mësive punonjëse, duke pasqyruar me vërtetësi hallet e vendit. Të vërtetës ata i largohen sr. shejtani temjanit.

Një aspekt tjeter i jetës së sotme artistike në Jugosllavi është konfuzioni në lëmin e mendimit teorik. Ashtu siç lindin «*drejtimet artistike*», si kërpudhat pas shiut, ashtu lindin edhe pikpamjet e teoritë estetike. Si «*rrymat artistike*» ashtu edhe teoritë atje krijojen fët e fët, nga që autorët e tyre nuk kanë pse të vrashn mëndjen shumë, mjafton të paraqesin si të redicka që panairi i ekstravagancave të Perëndimit e ka reklamuar disa vjet më parë. (Lexonjësi të mos çuditet. Viti për modën artistike që sundon në Perëndim, është shekull!). Vetëm realizmin dhe estetikën marksiste nuk ua ka qejfi atyre. Realizmi thonë që është vjetëruar, kurse estetikën marksiste bëjnë sikur nuk e njo hin, prandaj i janë vënë punës... që ta «*krijojnë*», ashu siç po «*krijojnë*» edhe shefat e tyre «*socializmin specifik*».

Të konstatosh këtë anarshi borgjezë në mendimin «*estetik*» të Jugosllavisë së sotme, është gjysma e punës. Gjysma tjetër e punës është të spjegosh pse ka lindur dhe ka marë hov kjo anarshi. A nuk është kjo një pasqyrim i realitetit të sotëm jugosllav? A nuk ëshë kjo anarshi frut i politikës prej shërbëtori të imperializmit, që ndjekin udhëheqësit e sotëm revizionistë t'atij vëndi? A nuk është kjo, më në fund, në pajtim të plotë me profkat ideologjike të përpunuara nga «*kokat*» e «*socializmit specifik?*» Të trajtosh çështjen e drejtimit reaksionar të mendimit «*estetik*» jugosllav dhe të anarshisë që zotëron.

në këtë fushë dhe të mos e lidhësh me realitetin objektiv, me kushtet konkrete historike, me jetën e vëndit, me ideologjinë sundonjëse dhe me politikën, do të thotë t'u bijesh më qafë çirakëve e të harrosh ustanë — faktorin kryesor.

Ky karakter i mangët i mjafëtë studimeve kritike mbi artin e sotëm jugosllav dhe mbi pik-pamjet reaksionare në estetikë duket se e ka burimin në propagandën revizioniste se gjoja në Jugosllavi po u ndërtuaka socializmi. Duke u nisur nga një pozitë e tillë e gjenjeshtër, mjafëtë artikujshkronjës, që kanë prekur me mprehtësi shumë probleme të rëndësishme dhe që janë frymëzuar në punën e tyre prej urrejtjes kundër revizionizmit, prej dashurisë ndaj artit e përparimit, kanë heshtur kur ka ardhur puna të flasin për shkaqet e vërteta të fenomeneve që kanë analizuar. Mirëpo, pa thënë haptas dhe me plot gojën të vërtetë mbi gjëndjen reale të Jugosllavisë, nuk mund të pretendohet për një analizë me të vërtetë shkencore marksiste-leniste të problemeve të artit e të mendimit estetik n'atë vënd.

Më së fundi, do thënë haptas se ka art përparimtar dhe art reaksionar, ka estetikë materialiste përparimtare dhe estetikë idealiste-reaksionare. Revizionizmi nuk ka krijuar dhe as mund të krijojë «art» dhe «estetikë». Ai «*krijon*» vetëm frazeologji demagogjike për të mbuluar karakterin borgjez-reaksionar të «artit» e të «estetikës» që propagandon, ashtu siç «*krijon*» frazeologji për të fshehur edhe fytyrën e vërtetë prej shërbëtori të borgjezisë në të gjitha fushat e veprimtarisë. Për të mbushur boshllëkun revizionistët përvehtësojnë çdo «modë» dhe çdo «teori», mjaf-

ton që kjo të mos jetë marksiste-leniniste,  
shkencore e revolucionare.

E, pra, a nuk do thënë kjo e vërtetë? A  
nuk duhet të nisemi nga pozitat e materializmit  
historik kur trajtojmë probleme të artit e të es-  
tetikës së sotme?

*(Botuar në gazetën  
«Drita» 30 prill 1961)*

## **LOGJIKE E ÇUDITESHME**

Në numurin 4 të vitit 1963, revista «*Probleme të paqes dhe të socializmit*», që, siç dihet, ka rënë kryekëput në llumin e revizionizmit hrushovjan, në një prej korespondencave për problemet aktuale të letërsisë angleze, të hartuar prej Xhudit Todd, shkruante:

«Në çdo rast të veçantë është e vështirë të përcaktohet, në se shkrimtari i ndryshon parimet e veta artistike me vetëdijë apo bije në kompromis me to, duke u përligjur para vetes, se po të mos marë përsipër një punë të caktuar (është fjala për kërkesa e porosi nga ente botonjëse, kinostudjo e firma televizioni borgjez R.B.) këtë punë do ta bëjë ndonjë tjetër, ose justifikohet duke menduar, se shpërblimi për një punë të padenjë do t'i japë mundësinë të shkruajë diçka të mirë në të ardhmen.

Ne mund të gjykojmë për shkallën e këtyre zbrapsjeve vetëm në bazë të kushteve objektive. Ne do të parashtronim kërkesa negative, po të deklaronim, se nuk duhet të jepen tabullo të

*shtrëmbëruara, nuk duhet të përkrahet «kufta e ftohët», siç bëhet në veprat, si romanit «Nuk është koha për të puthura.» (Ky roman drejtohet kundër Bashkimit Sovjetik, kundër çarmatimit atomik dhe ekranizmi i tij në televizion shkaktoi protesta të shumta nga ana e Bashkimit të skenaristëve të televizionit). Ne nuk mund të kërkojmë që në veprat e shkrimittarëve ne dhe miqtë tanë të idealizohen e të paraqiten me pamjen e kalorësve bujarë «të paprekshëm e të paqërtueshëm», mbasi ky do të ishte një shtrëmbërim i realitetit, vetëm në formë tjetër. Ne mund t'i lutemi e t'i kërkojmë shkrimittarit që ta përdorë aftësinë e tij profesionale për një akt të drejtpërdrejtë politik ose që të afrchet me ne në kërkesat politike për mbrojtjen e lirisë së Kubës, ose në protestat kundër apartejdit. Po ne nuk kemi të drejtë të kërkojmë që krijimtaria e tij t'i shërbejë skemës që ilustron idetë e luftës për socializëm. Ne mund t'i lutemi atij vetëm që të përpiqet të kuptoje shoqërinë që e rrëthon, pastaj të përpiqet ta pasqyrojë atë me vërtetësi, mbasi atëhere, me forcën e mjeshtërisë së tij prej shkrimitari, do të shprehë të vërtetën dhe e vërteta është aleati ynë më i mirë. Duke iu lutur për një gjë të tillë, ne praktikisht i lutemi atij të ndjekë porositë e ndërgjegjes së vet prej shkrimitari». (faqe 88).*

Citat i gjatë, po deshëm të mos i lemë jash-të asnjë fjalë këtij parashtrimi të qëndrimit revisionist ndaj letrarëve, letërsisë dhe politikës në fushën e krijimtarisë artistike, aq më tepër se ky parashtrim nuk shpreh vetëm pozitën ideologjike e politike të autorit po edhe qëndimin e organit, në të cilin është botuar, pra, «ori-

entimin' zyrtar» të revizionistëve të sotëm. Vëç kësaj, platformën e parashtruar në korespondencën e cituar, e kanë vënë në jetë dhe mundohen ta përhapin të siithë revizionistët e sotëm me anë të përpjekjeve për të gjetur një të ashtu-quajtur «*gjuhë të përbashkët*» me shkrimtarët e borgjezisë e të korenteve dekadente e formaliste, pa asnje bazë të vërtetë e të qëndrueshme ideologjike, politike apo estetike, paasnje qëllim të rëndësishëm, real, qoftë edhe të përkohshëm, duke fshehur, në mos duke mohuar, pozitat ideo-estetike të marksizmit e të artit socialist, duke çelur shtegun e largimit gradual prej tyre.

Revizionistët flasin shpesh për «singjeritet» dhe «guxim», megjithëse rrallëkush prej tyre është vërtet i singertë dhe i guximshëm. Në këta të rrallë mund të përfshihet, mbështetësi, edhe autori i korespondencës që po shqyrtojmë, i cili, pa u larguar prej rregulave të mirësjelljes e prej fjalëve delikate, ka parashtruar haptaz disa nga pozitat dhe piksynimet e të gjithë revizionistëve.

Nën pretekstin e shqyrtimit të diferencuar dhe të gjykimit në bazë të kushteve objektive të çdo rasti më vete, autori i korespondencës shtron dhe zgjidh në mënyrë objektiviste, antidialektike, jo revolucionare, probleme themelore të politikës në lëmin e artit e të letërsisë. Faktet nga niset ai janë deri diku të vërteta dlie bëjnë pjesë në tablonë e jetës në vendet kapitaliste, ku çdo gjë borgjezia e kthen në mall përtregëti, siç e kanë provuar këtë një shekull e ca më parë Marksit dhe Engelsit në «*Manifestin e Partisë Komuniste*». Ata kanë thënë:

«Borgjezia ua hoqi aureolën e shënjtë të

*gjitha llojeve të veprimtarisë që deri në atë kohë gjëzonin nder dhe respekt të thellë. Mjekun, juristin, priftin, poetin dhe shkencëtarin ajo i ktheu në punëtorë të saj me mëditje»; (Vepratë zgjedhura, vëllimi i I, f. 23, botim shqip).*

Kjo është një e vërtetë historike, që prej kohës, jo vetëm që nuk ka ndryshuar, po është bërë më e hapët dhe më intensive. Këtë gjë e provon edhe korespondenti i revistës «Probleme të paqes e të socializmit» kur bën fjalë për kërkosat e paturpëshme dhe kategorike të botonjësve e të punëdhënësve borgjezë të Anglisë. Po është një gjë të pranosh e të njoftohesh faktin, «kushtet objektive» dhe është diçka tjetër ta kuptosh drejtë këtë fakt e të nxjerrësh prej tij përfundime vërtet revolucionare. Duke njoftur normat morale dhe fisionominë ekonomike, politike dhe ideologjike të klasëve sundonjëse dhe kriteret jetësore të tyre, në shoqërinë me k'asa antagoniste, është e pafalëshme për një që e heq veten marksist, të mohojë egzistencën e të kundërtës dailektike në këtë shoqëri dhe perspektivën e zhvillimit, e cila kërkon prej komunistëve e shkrimtarëve të partisë veprimtar aktive për t'i vënë minat botës së vjetër, për të irritur e kalitur radhët e luftëtarëve të botës së ardhëshme socialist, si kudo, edhe në fushën e kulturës e të artit.

Duke u munduar të përligjë përuljen ideologjike ndaj borgjezisë dhe kapitullimin e disa shkrimtarëve dhe artistëve para kërkosave të sai politike e shijeve të prishura estetike, autori i korespondencës dhe bashkë me 'të edhe redaktorët e revistës e lënë mënjanë perspektivën dhe heqin dorë prej piksynimeve luftarake revolu-

cionare në lëmin e kulturës e të artit, duke shëmbëllyer me ata «heronj» të lëvizjes punëtore, të cilët ishin gati të sakrifikonin parimet e marksizmit dhe qëllimet revolucionare të proletariatit nën pretekstin se prej tyre mund të trëmbej borgjezia e të largohej nga revolucioni. Dihet që Lenini i ka hedhur poshtë me përbuzje këto pretekste të ngritura në teori.

Duke folur për «kushtet objektive» dhe përvlerësim të diferencuar të çdo rasti të veçantë, korespondenti, në të vërtetë, përligj haptaz e me paturpësi «kompromisin me parimet» dhe, në emër të «shpérblimit», të cilin mund ta marrë «dikush tjetër», kërkon të hiqet dorë prej qëndrimit kritik ndaj veprave me brendi ideoologjike e politike të keqe, bile, edhe antisocialiste. Që të shprehemi haptaz, ky është një variant i psikologjisë prej Sanço Pançe, ose siç mund të thuhet ndryshe, mohim i idealeve dhe i parimeve, në interes të borgjezisë që shkrimtari të mos humbasë «kafshatën e gojës». A ka gjë më të turpëshme për një revistë, që e heq veten si organ i lëvizjes komuniste? Apo edhe ky qëndrim shërbëtori të uritur përligjet me frazat boshe për «humanizmin» e reklamuar prej revisionistëve?

Është e natyrëshme që në shoqërinë kapitaliste të mos jenë të gjithë shkrimtarët të një platforme ideologjike e artistike e aq më pak, mund të pretendohet që të jenë të gjithë revolucionarë, po nëqoftëse ka shkrimtarë e artistë revolucionarë, ata, jo vetëm ndaj vetes së tyre, po edhe kundrejt të tjerëve do të jenë parimore dhe do ta vlerësojnë veprimtarinë e cilitdo, jo sipas nevojës që ka njëri e tjetri për «shpérbl-

me», po sipas dobisë apo dëmit që i sjell kjo veprimtari popullit dhe vëcanërisht lëvizjes revolucionare të proletariatit. Servilizmi ideologjik kundrejt borgjezisë, cilatdo qofshin motivet që e shkaktojnë, është sa i dëmshëm, aq edhe i neveritshëm, mbasi, në fund të fundit, është vepra artistike ajo që ndikon në masat e popullit dhe kur kjo vepër është e keqe dhe e dëmëshme, kundër saj duhet luftuar, pavarësisht nga ato «kushte objektive» që e shtynë shkrimitarit të bëjë kompromis me parimet e të përulet përpara kërkesave të borgjezisë. Ndryshe, ashtu si autori i korespondencës, njeriu largohet prej marksizmit, prej dialektikës, prej parimeve të moralit komunist dhe bije në meskinitet të paprincip.

Pas përligjies «teorike» të servilizmit ideologjik dhe të pushimit të luftës ideologjike në fushën e kulturës e të artit, autori i korespondencës, duke menduar se ka hedhur themelin e domosdoshëm, kalon me guxim në trajtimin e një problemi tjetër të rëndësishëm, lidhur me qëndrimin që u dashka mbajtur ndaj veprave që shprehin ideale reaksionare dhe shtrëmbërojnë realitetin dhe arrin në përfundimin çuditërisht absurd, sipas të cilit, nga një anë, nuk u dashka luftuar kundër shtrëmbërimit të realitetit dhe, nga ana tjetër, nuk u dashka kërkuar që «*krijimtaria e tij t'i shërbëjë skemës që ilustron idetë e luftës për socializëm*». Pra, pas braktisjes së kritereve dialektike marksiste të vlerësimit të kombinuar të motiveve e të rezultateve të krijimtarisë dhe të parimeve më elementare të moralit komunist, kërkohet prej revizionistëve të hiqet dorë edhe prej kërkesave ideologjike dhe

politike të partisë në vlerësimin e veprimtarisë së shkrimtarëve dhe prej përpjekjeve për afri- min e tyre me idetë e «luftës për socializëm». Po ç'mund të jetë kjo, vegse një pozitë tjetër e ngjajshëme në mos identike me pozitat e kritikës letrare borgjeze, e cila, gjithashtu, përpinqet t'i trëmbë shkrimtarët, duke u thënë, se komunis-tët duan që «krijimtaria e tyre t'i shërbuje ske-mës që ilustron idetë e luftës për socializëm? Vetkuptohet se në këtë rast nuk bëhet fjalë (edhe as që mund të flitet) për shkrimtarët reaksiona-rë (megjithëse një pozitë e tillë është edhe në dobi të tyre), po flitet, me sa duket për shkrimtarë, të cilët kanë predispozita, që të ka ojnë në anën e klasës punëtore e të luftës së saj revolu-cionare. Revista, nëpërmjet shkrimit me të ci-lin po meremi, rekomandon si të vetmin qëndrim të drejtë, heqjen dorë prej kritikës dhe prej luftës në emër të krijimit të një «fronti unik», gjë që do të thotë të dobësohet, në mos të shuhet, ndeshja e pashmangëshme ndërmjet kulturës borgjeze dhe kulturës proletare socialiste, të pushohet çdo kritikë kundrejt veprave edhe kur ato shtrëmbërojnë realitetin dhe përkrahin «luf-tën e ftohët» ose mbajnë qëndrim kritik apo ne-gativ ndaj socializmit. Kjo, siç kuptohet vetve-tiu, shpije domosdo në herien dorë edhe prej luftës e përpjekieve për konsolidimin e pozitave të kulturës socialiste, për zhvillimin e saj të më-tejshëm, për afrimin e shkrimtarëve përparim-tarë me idetë soċia iste revolucionare.

«Ne, — shkruan korespondenti, — *nuk mund* të kërkojmë që në *veprat e shkrimtarëve* ne dhe miqtë tanë të *idealizohen e të paraqiten*

*me pamjen e kalorësve bujarë «të pafrikshëm e të paqërtueshëm», mbasi ky do të ishte një shtrëmbërim i realitetit, vetëm në formë tjetër.»*

Gjer më sot dihej se të gjithë komunistët kishin për ideal socializmin dhe ishin të bindur që pozitat revolucionare të tyre janë të drejta me që mishërojnë objektivitetin e zhvillimit historik, prandaj si socializmi, ashtu edhe lufta përrealizmin e tij, janë ideali më i ndritur i gjithë njerëzimit dhe realiteti socialist, në krahasim me realitetin borgjez është parajsë, në tërë kuptimin e fjalës. Po ja që paska edhe «komunistë», që kanë hequr dorë prej këtyre idealeve dhe mundohen si e si t'i diskretitojnë ato, duke njojur e aprovuar me lehtësi kritikat shpifëse kundrejt tyre nga ana e borgjezisë dhe e shkrimtarëve të borgjezisë. Vetë shprehjet e përdorura në korespondencë: «skemë që ilustron idetë e luftës për socializëm» dhe «kalorës bujarë të pafrikshëm e të paqërtueshëm», shprehin më së miri pozitën ideologjike dhe emocionale të autorit kundrejt ideve të mëdha revolucionare, kundrejt komunistëve dhe vëndeve socialiste. Autori nuk e ka për gjë ta konsiderojë «kërkesë negative» kritikën kundër veprave që shtrëmbërojnë realitetin dhe, nga ana tjetër, të quaj «shtrëmbërim të realitetit», pasqyrimin e luftës për socializëm si një ideal të ndritur. Lind pyetja: pra, cili është ideali shoqëror i këtij njeriu? Cili është ideali estetik i tij? Ideali shoqëror, mesa duket, përfshihet në përligjien që i bën ai përuljes prej skillavi ndaj kërkesave të borgjezisë, kurse idea'i estetik i tij, duke mos patur asgjë të përbashkët me idealin e artit socialist. Është mishërim i shijeve dhe pikpamjeve eklektik.

tike t'atyre intelektualëve të perëndimit (tani edhe të disa vëndeve të lindjes), që përulen para çdo «mrekullie» të modës artistike borgjeze. Të paktën ai nuk shpreh asnje rezervë, nuk ve asnje kufi, bile, realisht, as realizmin nuk e përfil, megjithëse në pikpamje politike flet, si të gjithë revizionistët, për «qëndrim realist» ndaj fenomeneve.

Po, cili është qëllimi i këtij largimi të parturpshëm e të hapur prej pozitave marksiste-le-niniste? Autori i korespondencës mendon se ky largim justifikohet prej dëshirës për të krijuar një «front të përbashkët» të njerëzve të kulturës, që të mos shkaktohen disarmoni dhe grindeje, që të njihet e të pranohet e drejta e borgjezisë dhe e shkrimitarëve të saj për të sharë komunistët dhe socializmin, që të mos i jepet rëndësi dëmit që sjellin veprat e këqia, kur autorët e tyre janë «të detyruar» të lëpijnë sahanët e borgjezisë, etj. Kuptohet lehtë se ç'front i përbashkët mund të jetë ky dhe ç'mundësi praktike ka për t'u realizuar, pa mos rënë kokë c'këmbë në pozitat e borgjezisë! Po për të shpëtuar prej kësaj pozite aspak të hijëshme, që shëmbëllen si tepër me pozitat e liberalëve borgjezë e që s'ka të bëjë aspak me qëndrimin revolucionar marksist, autorii i korespondencës mer «guximin» e thotë:

«Ne mund t'i lutemi e t'i kërkojmë shkrimitarit që ta përdorë aftësinë e tij profesionale për një akt të drejtpërdrejtë politik ose që të afrohet me ne në kërkësat politike për mbrojtjen e lirisë së Kubës, ose në protestat kundër apartejdit.» Me një fjalë: le të jetë ci ido në veprat artistike, ne nuk e prekim se njohim të drejtën e

«shënjtë» të krijimtarisë veç do t'i luteshim të bënte ndonjë deklaratë në dobi të aksioneve tonë politike. Vetëm kaq e asgjë më tepër nuk duhet të kërkojmë e s'mund të kërkojmë!

Ky qëndrim të kujton fjalët e thëna nga një sociolog borgjez për ata intelektualë të një vëndi, të cilët kanë tesërën e Partisë Komuniste, e ndihmojnë atë materialisht, i sigurojnë disa vota në zgjedhjet, kurse me veprat e tyre i drejtojnë njerëzit ndaj borgjezis. Edhe në rastin tonë, për hatër të një deklarate politike, që në vetvete është një akt pozitiv dhe s'ka pse të mo-hohet v'era e tij, hiqet dorë prej kritikës ndaj veprave të dëmëshme, të cilat rrënjosin në ma-sën e lexonjësve e të spektatorëve botkuptimin reaksionar borgjez. Le pastaj që nuk kërkohen as deklarata të tilla për të hequr dorë prej kritikës! Por, revizionistët e sotëm, jo vetëm në letërsi e në art, po edhe në politikën e madhe, nisen prej kriteresh të tilla dhe, për hir të një konçesjoni të vogël apo të një deklarate në dobi të tyre, bëjnë tregëti me parimet e me idealet revolucionare të popujve, kështu që kemi të bëjmë edhe këtu me një princip të paprincipitë të gjithë revizionistëve, e jo me një predikim të rastit.

Më poshtë, në korespondencë, shprehet edhe një mendim tjetër, që u vë kapakun të gjithave.

«Ne, — thuhet në korespondencë, — mund t'i lutemi atij vetëm që të përpigjet të kuptojë shoqërinë që e rrëthon, pastaj të përpigjet ta pas-qyrojë atë me vërtetësi, mbasi atëhere me forcën e mjeshtërisë së tij prej shkrimitari do të shprehë të vërtetën dhe e vërteta është aleati

*ynë më i mirë. Duke u lutur për një gjë të tillë, ne, praktikisht, i lutemi atij të ndjekë porositë e ndërgjegjes së vet prej shkrimtari»*

C'është ndërgjegjja prej shkrimtari? Ndërgjegjja profesionale apo klasore e tij? Nëqoftëse bëhet fjalë për ndërgjegjen profesionale, atëhere ne mund t'i kujtojmë artikullshkronjësit, se ai ka një parafytyrim tepër të çuditshëm për «shkrimtarët» dhe, me sa duket, është pasojës i atyre që f'asin për «shënjtërinë» e krijimtarisë letarre dhe nuk niset prej realitetit, i cili na provon katërcipërisht, që nuk egziston ndonjë «ndërgjegje prej shkrimtari» që t'i u atribuohej të gjithë shkrimtarëve njësoj, mbasi edhe ndërgjegjja profesionale përcaktohet prej bazës nga niset dhe piksynimeve që ka secili. Dhe, nëqoftëse flitet për ndërgjegjen klasore, që përcakton edhe ndërgjegjen profesionale, atëherë vlen të theksojmë, se jo çdo ndërgjegje të shpije në zbulimin dhe afirmimin e së vërtetës, prandaj lutja që shkrimtari të ndjekë porositë e ndërgjegjes së vet prej shkrimtari, s'është gjë tjetër vecse një frazë sa e bukur aq edhe boshe, që më kot mundohet të fshehë mungesën e ndërgjegjes klasore të autorit të saj dhe që, përkundrazi, hedh poshtë edhe ato ideçka për «të vërtetën» aleaten tonë më të mirë.

Pastaj, për ç'të vërtetë bëhet fjalë? Autori presupozon (dhe jo vetëm presupozon), që secili shkrimtar, duke dëgjuar «lutjen» e tij «të kuptojë shoqërinë që e rrethon» pastaj «me forcën e mjeshtërisë së tij prej shkrimtari do të shprehë të vërtetën.» Se ç'mund të jetë kjo e vërtetë, një zot e di, mbasi ka të vërtetë e të vërtetë, siç ka shkrimtarë dhe shkrimtarë, siç ka ideolo-

gji dhe ideologji. S'na duket gjë e rastit që në këtë mes nuk flitet as për ideologjinë e shkrimtarit, as për idealet e tij, as për domosdonë e udhëheqjes ideologjike të krijintarisë letrare nga partia, as për interesat e popullit e të lëvizjes së tij revolucionare, po flitet për një shkrimtar në përgjithësi, jashtë klasëve dhe luftës së klasëve, për një të vërtetë në përgjithësi, për një «ndërgjegje prej shkrimtari» në përgjithsi.

Dhe thonë, pastaj, se përpjekjet për gjetjen e një «*gjuhe të përbashkët*», siç e kuptojnë revizionistët, nuk janë «bashkegzistencë ideologjike» dhe nuk shpien në lëshime politike. Në këto predikime mund të ketë dhe ka diçka të vërtetë, mbasi, koha ka provuar se me gjithë mënd nuk mund të ketë bashkëegzistencë ideologjike», po ka vetëm *nënështrim ideologjik të revizionisteve para borgjezisë*.

(Botuar në gazeten «Drita»  
12 prill 1964)

## A KA SHKRIMTARE TË GJINISE ASNJANESE?

Në një intervistë dhënë korespondentit të gazetës «Avji», Juli Putramenti shkruan:

«Shkrimitari marksist niset nga një ngjarje që takon në jetë. Mund ta interpretojë këtë ngjarje kështu ose në një mënyrë tjetër. Pra, nuk mund t'a injorojë. Përkundrazi, shkrimitari dogmatik niset nga dogma. Çdo ngjarje që është në kundërshtim me dogmën e hedh poshtë...»

Pak më poshtë, i njëjtë autor, në të njëjtin shkrim, thotë:

«Besoj se Kongresi XXII (e ka fjalën për Kongresin XXII të P.K. të B.S., megjithëse vëtë nuk është sovjetik), ndonse jo shpejt, po, sidqoftë, në një të ardhëme të largët, do t'i japë fund asaj që ndodh sot: që u kërkojmë shkrimitarëve t'u shërbejnë çështjeve aktuale. Sigurisht mundim dhe duhet të mendojmë poetë, shkrimitarë, etj., që shkruajnë në shtyp artikuj mbi tema aktuale. Po të shtyhet gjithë arti që t'u shërbejë disa parrullave politike të çastit, është harxhim i artit...»

Lexonjësit do të na falin që në këtë shënim nuk do t'i japim rëndësi faktit që ky «antidogmatik» e mbështet besimin e vet në vendimet e kongresit të partisë së një vëndi tjetër, jo se ky fakt nuk ka rëndësi, po, sepse në shtypin marksist-leninist është folur shpesh për majmunërinë e revizionistëve. Ne do të meremi vetëm me anën letrare të çështjes.

Me fjalët e cituara më lart, autori pretendon se:

a) *Shkrimtari marksist nuk mund t'i injorojë ngjarjet, po mund t'i interpretojë kështu ose në një mënyrë tjetër.»*

b) *Në t'ardhmen, si pasojë e ndikimit të Kongresit XXII, nuk do t'u kërkohet shkrimtarëve që t'u shërbejnë çështjeve aktuale.*

c) *Nëqoftëse arti u shërben «disa parullave politike të çastit», një gjë e tillë është «harxhim i artit.»*

Tek ne kushdo e kupton se këtu kemi të bëjmë me disa teza revizioniste në letërsi e në art, që nuk ndryshojnë prej pretendimeve të përgjithëshme revizioniste, po, me gjithatë, autori i kësaj deklarate, ndonëse ende mban si pazmore realizmin socialist, ka folur më haptaz se disa të tjerë dhe pikpamjet «e veta» i ka shprehur shkurt e qartë, prandaj nuk është nevoja të zgjatemi tepër.

Po fillojnmë me çështjen e parë, që shtrohet në fjalët e cituara. Autori i deklaratës, duke injoruar pozitën shoqërore të artistit, kërkon ta bëjë atë skllav të fakteve dhe nuk i jep asnje rëndësi interpretimit të këtyre fakteve. Duke folur kështu ai dhe revizionistët e tjerë, (se të gjithë revizionistët, nga më i «madhi», deri tek më

i «vogli». hiqen si «respeketonjës të fakteve») mund të kujtojnë se thonë diçka të re, po, në të vërtetë, ata nuk bëjnë gjë tjetër, veçse ecin në gjurmët e oportunistëve të vjetër, që janë demas-kuar me kohë prej Leninit, i cili ka theksuar, se disa njerëz, duke u hequr si njohës të fakteve, bëhen sklllevër të çfaqieve të veçanta të jetës dhe harrojnë rrymën e madhe të zhvillimit historik.

Faktet kanë rëndësi për këdo dhe jo vetëm për shkrimtarin dhe artistin. Po në jetë ka shumë farë faktesh, nga më banalët deri tek më seriozët dhe më sublimët, fakte që dëshmojnë degjenerimin e botës së vjetër dhe lindjen e botës së re, fakte kryesore dhe të dorës së fundit, faktë që meritojnë vëmëndje dhe që s'meritojnë vëmëndje. Pra, edhe fakti, në të vërtetë, nuk është asnjanës, gjersa ai dëshmon për një proces të caktuar shoqëror, nëqoftëse flasim për jetën shoqërorë. Ta marësh faktin në vvetvete, të çkëputur nga faktet e tjera me të cilët ka lidhje dhe të pavarur prej rrethanave historike në të cilat çfaqet, nuk është punë e një njeriu të mënçur, mbasi kushdo e di që çdo fenomen i jetës shoqërore nuk mund të lindë pa një shkak shoqëror dhe nuk mund të egzistojë iasht lidhjeve me çfaqiet e tjera të jetës shoqërore. Kështu, për shëmbull, do t'ishte e çuditëshme që dhjetë vjetë më parë një shkrimtar, e aq më tepër, një anëtar i udhëheqies së një Partie Komuniste, të bënte deklarata si ajo që cituam më lartë. Kurse sot nië gjë e tillë nuk na çudit aspak, mbasi është pasojë e drejtperdrejt e kursit të përgjithshëm ideologjik e politik të revizionizmit të sotëm, dhe shkrimtari, që ushqehet prej atij stani, do t'ishte

çudi të fliste ndryshe. Prandaj, të ngresh kultin e «faktit» të pavarur, do të thotë të jeshë, para së gjithash, dogmatik dritëshkurtër, njeri që s'mer erë nga dialektika, megjithëse mund të bëshë dhjetra dek arata pompoze kundër dogmatizmit. Kjo e vërtetë mbi lidhjet dhe determinimin reciprok të fenomeneve shoqërore ka rëndësi për këdo që pretendon të meret me problemet e shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe shkrimitarët e artistët. Nuk do t'ishte pa vënd që të përmëndnim këtu një letër që i pat dërguar Stalini shkrimitarit sovjetik Mihail Shollohov. Siç na thotë Hrushovi, më 16 prill të vitit 1933, Shollohovi i dërgoi një letër Stalinit, në të ci ën fliste për ekstremizmin e disa kuadrove të partisë kundrejt kozakëve të stanicës Veshenskaja. Dhe Stalini, ndër të tjera, i përgjigjet:

«Unë ju falenderoj për letrat, mbasi ato zbulojnë anët e dobëta të punës sënë të partisë e të sovjetëve, zbulojnë që, disa herë, aktivistët tanë, duke dashur të frenojnë armikun, godasin pa dashur miqtë dhe kalojnë deri në sadizëm. Po kjo nuk do të thotë se unë jam në një mëndje me ju për gjithçka. Ju shihni vetëm një anë dhe nuk shihni keq. Po kjo është vetëm njëra anë e çështjes. Që të mos gabohesh në politikë (letrat Tuaja nuk janë letërsi artistike, po politikë fund e krye), duhet të hetoshë, duhet të shohësh edhe anën tjeter. Dhe ana tjeter është, se prodhonjësit e nderuar të bukës të rajonit tuaj (dhe jo vetëm të rajonit tuaj) kishin shpallur «italjankën» (sabotazhin!) dhe për pak do t'i linin punëtorët dhe Ushtrinë e Kuqe pa bukë...»

Hrushovi, si admironjës i zellshëm dhe si sklav i «fakteve» e publikoi këtë letër, — që

Stalini nuk e pat botuar, siç duket, prej respektit që kish pér shkrimtarin, — duke dashur të nxjerré ndonjë divident prej saj, po, nё tё vërtetë, ai tregoi edhe një herë ç'spekullime politike eshtë gati të bëjë, duke përdorur disa t'ash<sup>tin</sup>-quajtura «fakte», pa hyrë nё thelbin e çështjes. A mund tё provojë Hrushovi, qoftë edhe teori-kisht, tё kundërtën e asaj që thotë Stalini nё letër? A do ta kishte ai, nga një anë, guximin e Stalinit, që ta shihte tё vërtetën nё sy, kur flitet pér tё metat dhe, nga ana tjetër, ta studjonte fenomenin, faktin, jo nё mënyrë dogmatike-vulgarë, po nё mënyrë dialektike? Shol'ohovi, me sа duket, përfitoi si shkrimtar prej përgjigjes së Stalinit dhe prej artikujve tё tij mbi politikën e partisë nё fshat dhe, nё vëllimin e parë tё romanit «Tokat e çara» i pa tё dy anët e fenomenit e kështu krijoj një prej veprave më tё shquara tё letërsisë së realizmit socialist.

Veç kësaj nuk eshtë pa rëndësi edhe çështja se ç'fakte e térheqin këtë apo atë shkrimtar. E shòhim që pér së largu se kritiku revizionist po bëhet gati tё shënojë nё anë tё kësaj fraze fjallëni dogmatizëm. Po, le ta shënojë po deshi, mba-si, pavarësisht nga deklaratat e tij, edhe sikur tё nisemi thjesht prej punës profesionale tё shkrimtarit, do tё vërejmë se ky nuk i mer faktet me indiferentizëm, po, duke njobur mijra prej tyre, bën seleksionimin dhe zgjedh ato që i duhen pér veprën që shkruan. Sigurisht, ka artistë e shkrimtarë që shkruajnë me tezë, që janë dogmatikë dhe një gjë e tillë nuk eshtë e re. Në Mesjetë, bije fjala, tё gjithë shkrimtarët dhe artistët kish-tarë ishin dogmatikë, kurse sot, nё letërsinë e nё artin e vëndeve kapitaliste, sidomos tё Sh.B.A.,

ka shumë «shkrimtarë» e «artistë», që ilustrojnë teza të botkuptimit borgjez. Edhe në vëndet socialiste ka patur dhe ka shkrimtarë me aftësi të kufizuara e që nuk e njohin jetën e popullit, që, pavarësisht nga dëshira e mirë e tyre, shkruajnë vepra anemike, që politikisht janë të mira, po artistikisht, ose janë të dobëta ose nuk vlejnë fare. Po ky është një fenomen i të gjitha kohëve dhe vepra të tilla do t'egzistojnë gjersa të egzistojnë letërsia dhe arti. Të pretendosh se mund t'i jepet fund kësaj me një kongres e, aq më tepër, me një deklaratë, është demagogji.

Po e kishim fjalën tek zgjedhia e faktave. Sot ka shkrimtarë e artistë edhe në vëndet socialist, që pikërisht, duke pretenduar se nisen nga «faktet» diskretitojnë realitetin socialist, tërhiqen prej «parrullave të çastit» të krerëve revolucionarë dhe harrojnë prirjen e zhvillimit historik, tallen me gjérat më sublime, bijen në objektivizëm dhe kështu, pavarësisht nga deklaratat që bëjnë, vihen në shërbim të borgjezisë, ndihmojnë aparatin e saj propagandistik në fushatën helmonjëse kundër socializmit. Admironjës të tillë të «fakteve», që nuk dinë ose nuk duan të dallojnë atë që është kryesore nga ajo që është e dorës së fundit, që i çkëputin faktet arbitrarisht nga lidhjet e tyre reciproke dhe nga rrëthanat historike objektive, jo vetëm nuk vlejnë asnjë dysh për popujt e vëndeve socialistë, po janë edhe të dëmshëm për çështjen e tyre të madhe revolucionare.

Në deklaratën e cituar thuhet, se shkrimtarë e artisti i realizmit socialist është i lirë t'i interpretojë faktet «kështu ose në një mënyrë tjetër», mjafton që ato të jenë «fakte.» Po, i nde-

ruar zotëri, a nuk e kupton që kjo nuk është vetëm demagogji, po edhe absurditet? Cili është ai shkrimtar apo artist gjatë gjithë historisë së artit e të letërsisë, që i ka interpretuar fenomenet shoqërore pavarësisht nga pozita e tij ideo-logjike klasore? Cili është ai shkrimtar apo artist që ka kujtar se është «krejt i pavarur» nga shoqëria dhe nuk është gënjer e nuk ka gënjer? Shkrimtarë të tillë nuk ka patur kurrë dhe nuk ka. Prandaj, të pretendosh se shkrimtari dhe artisti mund t'i interpretojnë «faktet» sipas qejfit, ky është një subjektivizëm absurd. Dhe jo vetëm kaq.

Shkrimtarët dhe artistët e realizmit socialist, për të cilët flitet në deklaratë, presupozohet që pasqyrojnë me realizëm tendencën objektive të zhvillimit shoqëror revolucionar dhe janë artistë me botkuptim socialist, pra, presupozohet që se cili prej tyre e sheh, e pasqyron dhe e interpretton jetën në mënyrë materialiste-dialektike, i bindur se socializmi dhe komunizmi janë e ardhmia e pashmangëshme e të gjithë njerëzimit. Po ç'do të thotë, atëhere, t'i interpretoshë faktet «kështu ose në mënyrë tjetër?» Kushdo e kupton që interpretimi i fakteve ka të bëjë drejtpërdrejt me pozitën ideologjike dhe politike të shkrimtarit e të artistit, mbasi, sipas pozitës politike (ose sipas «interpretimit», që është e njëjta gjë) i njëjtë fakt mund të shërbejë, jo vetëm si subjekt i veprave të ndryshme, po edhe i veprave të kundërta. Le të kujtojmë si e panë dhe si e pasqyruan shëmbjen e feudalizmit dhe indjen e kapitalizmit shkrimtarët përnarimtarë dhe romantikët reaksionarë të asaj kohe. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për socializmin dhe për lë-

vizjen revolucionare në përgjithësi, të cilat paraqiten prej kalemxhinje të borgjezisë si «dnunë», si «arbitralitet», si «gjakderdhje», etj, etj. A mund të pajtohen shkrimtari dhe artisti socialist me një pozitë të tillë politike, me një «interpretim» të tilë të fakteve? Apo shkrimtarët dhe artistët socialist mund të janë edhe ata që i «interpretojnë» faktet nga pozita borgjeze, edhe ata që i «interpretojnë» nga pozita revizjoniste? Logjike kërkon që as njëra, as tjetra nuk duhet të ndodhin në vëndet socialiste, me shkrimtarët dhe artistët socialistë. Kushdo që pretendon se është shkrimtar i vërtetë socialist, nuk mund të naitohet kursesi me pretendime të tillë të ideologjisë borgjeze, po duhet të deklarojë me zë të lartë, se qëndron në pozitat e marksizëm-leninizmit, i shërben politikës së proletariatit revolucionar dhe të punojë gjer në fund, duke qëndruar në këto pozita. Përndryshe, le të ketë burrërin ta heqë maskën dhe të tregojë fytyrën e vërtetë! Të hiqesh si admironijsë i «fakteve» dhe të mbash qëndrim asnjanës ndaj «interpretimit» të fakteve, do të thotë të mos jeshë marksist, po objektivist.

Vazhdojmë më poshtë: «*Në t'ardhmen, si pasojë e ndikimit të Kongresit XXII, nuk do t'u kërkohet shkrimtarëve e artistëve t'u shërbejnë çështjeve aktuale.*

Për ta sqaruar këtë çështje është rasti të kujtojmë, se arti i të gjitha kohëve, duke qenë i lidhur me aktualitetin, i ka shërbyer aktualitetit dhe, prandaj, të gjithë ata shkrimtarë dhe artistë të që janë orvatur të bëjnë të kundërtën, kanë dështuar dhe nuk kanë krijuar veçse vepra anemike. Po, aktualiteti nuk do marë kallëp, mbasi

edhe ai është parë dhe shihet nga pozita politike e artistit: artisti me botkuptim borgjez dhe që niset nga pozitat e borgjezisë, me veprat e veta i shërben aktualitetit borgjez, kurse artisti me bokuptim marksist, që niset nga pozitat e proletariatit e të socializmit, i shërben aktualitetit socialist. Nga ana tjetër, shkëputja nga aktualiteti është një iluzion i keq që mund t'i sjellë dëme të mëdha artit e artistëve, mbasi ata, duke pандehur se u «çliruan» nga barra e aktualitetit, ose do të përfundojnë në një hapësirë të zbrazur, ku s'do kenë ç'të bëjnë tjetër veçse të meren me veten e tyre, ose do të «çlirohen» prej aktualitetit socialist dhe do bijen në zgjedhën e aktualitetit borgjez, dhe në këtë mënyrë, do të çelin brazda në dobi të borgjezisë.

Ndërtimi i shoqërisë sociale, nëpërmjet transformimeve revolucionare, lindja dhe formimi i njeriut ndërtonjës të socialistit, me botkuptim, me psikologji e profil moral të ri, marëdhëni e reja të njerëzve ndërmjet tyre dhe raportet krejtësisht të reja të individit me shoqërinë e të shoqërisë me individin, — ja cilat janë disa nga «çështjet aktuale», që dalin prej ndërtimit socialist dhe që nuk mund të mos e preokupojnë artin dhe artistin e vëndeve socialiste. Të kërkosh e, aq më tepër, të predikosh që artistët të mos u shërbejnë këtyre «çështjeve aktuale», do të thotë të çkëputesh prej popullit, prej interesave dhe idealeve të tij e ta ktheshë artin e letërsinë në një qëllim në vetvete, jashtë kohës dhe jashtë aktualitetit gjë që, në fund të fundit, as që mund të bëhet, gjersa artistët rrojnë në tokë e jo në stratosferë. Eshtë e pamundur të jeshë shkrimitar i realizmit socialist dhe të mos

ngrihesh kundër këtij predikimi për çkëputjen e artit nga aktualiteti, kundër këtij udhëzimi për «harxhimin» e kot të artit.

Ç'është e vërteta, autori i deklaratës, pranon që mund të ketë edhe shkrimtarë që mund të shkruajnë *artikuj* në shtyp për problemet aktuale, po më tepër se artikuj jo, mbasi, sipas tij, «*po të shtyhet arti që t'u shërbejë disa parrullave politike të çastit, është harxhim i artit.*» Siç shihet edhe në këtë pikë deklaronjësi nuk flet si marksist, po si një liberal borgjez, që nuk di, ose bën sikur nuk di që «*parrullat politike të çastit*» mund të jenë të ndryshme e të kundërtë, borgjeze dhe socialistë, revolucionare dhe reformiste. Dhe t'u shërbesh apo të mos u shërbesh parrullave politike kjo ëhtë një gjë, kurse të tregosh cilave u shërben e kundër cilave lufton kjo është një gjë tjetër. Në trajtimin e kësaj çështjeje ne nisemi prej faktit që arti kurdoherë ka qënë i lidhur me politikën, i ka shërbyer asaj, e ka ndihmuar atë dhe që pretendimi se mund të ketë artistë të çkëputur nga politika është hipokrizi.

Duke ndier dobësinë e pozitës së vet, autori i deklaratës, e redukton çështjen e lidhjeve të artit me politikën, duke folur vetëm për «*parrullat politike të çastit*» dhe, në këtë mënyrë, nga një anë, tregon se e kupton çështjen e lidhjeve të artit me politikën në mënyrë vulgare dhe, nga ana tjetër, redukton vetë artin. Mbasi, të flasësh për lidhjet e artit me politikën do të thotë, në radhë të parë, (kur është fjala për artin socialist) të flasësh për lidhjet organike ndërmjet politikës revolucionare socialistë të proletariatit dhe artit revolucionar socialist, që u shërben masave pu-

nonjëse. Prandaj, duke theksuar vetëm lidhjet e artit me «parrullat e çastit» (nënkuptohet: vendimet, rezolutat, plenumet, kongreset) do të thotë ta reduktosh, ta denigrosh dhe ta vulgarizosh problemin. Dhe, nga ana tjetër, duke pohuar që lidhjet e artit me politikën duhen kuptuar gjërë, është prap se prap e gabuar të mohosh ose të përqëmosh lidhjet e tij me «parrullat e çastit», mbasi, në këtë mënyrë, injorohen disa forma të artit, që i përgjigjen aty për aty aktualitetit dhe «parrullave politike të çastit», siç janë skicat lettrare e fejtonet, vjershat politike e satirike, vizatimet e karikaturat, pllakatet, etj.

Si përfundim, nga çdo anë që ta marësh, deklarata që cituam në krye të këtij shënimini, biie erë revizjonizëm dhe si e tillë, i shërbën borgjezisë e jo socializmit, është në dëm të artit e të letërsisë së vërtetë të realizmit socialist dhe predikon depërtimin e ideologjisë borgjeze në vëndet socialiste, mbasi shkrimtarë e artistë të gjinisë asnjanëse as ka patur, as nuk ka.

(Botuar në revistën «Ylli»  
Nr. 5, 1964)

# AUTORË DHE VEPRA

## **«KENGE» — POEZI TË DH. S. SHUTERIQIT**

Në njerën prej vjershave të veta, Dhimitër S. Shuteriqi, duke zbuluar një prej vlerave të poezisë, shkruan:

*Gëzim i madh kur çel librin e ri,  
gëzim i madh kur gjen dhe një poet,  
që zemrës edhe mëndjes më s'i flet  
po me ato fjal' e po me ato fjali.*

Kur lexon vëllimin «Këngë», në të cilin autor i vargjeve të cituara ka përbledhur kriimet e veta më të mira poetike, në të vërtetë nuk zbulon ndonjë poet të ri, se vjershën e Dhimitër S. Shuturiqit e ke njojur me kohë, po, sidqoftë, radhët e përmëndura të kujtohen dhe bëhen, si të thuash, edhe kriter vlerësimi për ato, që ke kënduar në libër. Nga kjo pikëpamje në vëllimin «Këngë» shohim, në përmjet krijimeve më të zgjedhura, pikënisjen,

interesimet, zhvillimin dhe rezultatet e arritura prej poetit gjatë tërë veprimtarisë së tij letrare, që është shtjelluar në etapa të ndryshme të zhvillimit shoqëror të vëndit tonë, në afro tridhjetë vjet. Megjithëse prej kësaj përmbledhje nuk mund të arrijë lexonjësi në përfundime fare të sakta *për fazën e parë* të krijimtarisë poetike të Shuteriqit, e cila ka patur edhe lëkundje që nuk pasqyrohen në vëllim, prapserap, një ide e përgjithëshme mund të formohet dhe nuk është vështirë të arrihet në përfundimin. që Dhimitër S. Shuteriqi si poet, duke të *kujtuar sérish se ku qe*, është prirur ngaherë e më tepër ndaj jetës dhe problemeve të kohës dhe, në mënyrë të natyrëshme ka kaluar prej ndikimeve të poezisë simboliste, që vreheshin në disa prej krijimeve të para, në pozitat e *qarta* dhe luftarake-revolucionare të realizmit socialist. Poezia e tij është një shëmbull i gjallë, që dëshmon edhe një herë, se pozitat e realizmit socialist nuk arrihen as në mënyrë mekanike, as në formë hopi, as duke u diktuar prej të tjerëve, po arrihen gradualisht dhe në mënyrë të natyrtë, së bashku me ndërgjegjen revolucionare, prej atyre artistëve, që e ndjejnë veten të lidhur me popullin dhe kuptojnë perspektivën e zhvillimit historik, prej atyre që duan të shkruajnë për popullin e që t'i këndojet populli.

Elemente revolucionare të kthjellëta, pak a shumë, i hasim te Dhimitër S. Shuteriqi aty nga viti 1937-1938, në disa poezi të cilat nuk mundën të botohen asokohe, po që janë dëshmi e proçesit të vazhdueshëm të ndryshimeve

në krijimtarinë e shkrimtarit. Që atëhere e deri më sot, këto elemente revo ucionare vinë duke u shtuar e duke u theksuar, gjersa püşojnë së qëni elemente dhe bëhen themeli i brendisë së vjershavë të Shuteriqit. Në këtë evolucion për së mbari, ne gjejmë një prej tipareve më të shëndosha të krijimtarisë poetike të shkrimtarit.

Poetin e kanë tërhequr ngaherë temat shoqërore dhe trajtimi në plan shoqëror i motiveve intime, politike e patriotike, në të cilat ai ka shkrirë mendimin e përparuar të kohës dhe ndjenjat e njeriut të prirë drejt një të ardhmje më të mirë. I gjejmë këto tema dhe këtë frymë demokratike që në mjaft prej poezive të para me prirje realiste të Shuteriqit dhe kur, në ndonjerën prej tyre, (pëershëmbell «*Vdekja e peshkatarit*») ndihen nota pesimiste ose fataliste. Interesante në këtë drejtim janë prej krijuarve të herëshme të tij, vjershat: «*Lumtëni*», në të cilën ndihet bukuria dhe gazi i punës dhe i mundit; «*Duert*», ku shtjellohet në plan të gjerë shoqëror një temë e vjetër për letërsinë: krimi dhe shkaqet e vërteta të tij në botën kapitaliste; «*Gjak*», në të cilën poeti shpreh revoltën dhe besimin që gjaku i derdhur «*shtrin përdhe, si qen të ngordhët edhe mat'fortin prej xhelatëve*». Në krijimtarinë e më-pastajme të Shuteriqit, këto elemente shoqërore demokratike shtohen, zgjeroohen e thollohen, krahas afrimit gjithënjë më të madh të tij me realizmin.

Në poezinë e Dhimitër S. Shuteriqit të tërheq vëmëndjen kujdesi i paprerë i shkrimtarit për formën, për vargun, për mjetet e shpre-

hjes artistike, sidomos për saktësinë e fjalës, për rithmin e vargjeve, për efektet akustike dhe për rimat, të cilat janë kurdoherë të gjatura mirë. Këto elemente të mjeshtërisë artistike përbëjnë një prej anëve më të mira të poezisë së Shuteriqit, e cila dallohet prej poezisë së gjithë poetëve tanë të sotëm dhe ruhet prej ngjasimit edhe me mjaftë poetë të së kaluarës, ndonse me disa prej këtyre të fundit ka edhe pikë takimi, që mbas vijnë nga ndikimi i letërsisë së kohës në poetin e ri.

Vargu i Dhimitër S. Shuteriqit është i matur, i peshuar mirë dhe, megjithëqë poeti nuk është kurdoherë spontan, shpesh, është i shkathët, dinamik dhe arrin të na japë, nëpërmjet rithmit dhe muzikalitetit të brëndëshëm, lëvizjet në natyrë, në jetë dhe në shpirtin e poetit, siç ndodh, për shëmbull, në vjershat «*Vdekja e peshkatarit*», «*Mëngjes votimesh*», «*Lavdi për ty, Parti!*», «*Tingëllima romantike*», «*Era*», në poemën «*Lufta*», etj. Për çështje të formës e të kujdesit prej mjeshtëri të ndërgjegjëshëm, poezia e Shuteriqit është shëmbull i rrallë i letërsisë sonë të sotme dhe mund të merret si model egzigjence dhe përpjekje për të arritur përsosmérinë e shprehjes. Si e tillë vjersha e tij mund të krahasohet pa frikë me vjershën e mjeshtërve tanë më të mirë të var-gut.

Shqetësimet e veta për formën Shuteriqi i ka shprehur edhe në mjaftë prej krijimeve kushtuar poetëve dhe poezisë, prej të cilave njeriu mund të kuptojë shijet e pikësynimet e poetit në art dhe, duke i krahasuar pikëpamjet e këtyre vjershave me pjesën tjetër të krim-

tarisë së tij, mund të arrijë në përfundimin, se ato janë fjalë të menduara e të peshuara dhe shprehin, — aq sa mund të shprehin, — individualitetin dhe natyrën e tij si poet.

«*Nuk i due vargjet të lehta si pendë*» — thotë poeti në vjershën «Partisë». Dhe, vërtet, është zor të gjesh vargje të lehta në krijimtarinë e tij. Ai ka luftuar ngaherë, i shtyrë edhe prej natyrës së vet si poet, që në çdo varg të ketë mendim, që çdo vjershë, — edhe kur nuk shpreh një emocion të çastit, gjë që rrallë e takojmë te Shuteriqi, — të shprehi, jo aq dhëmbjen a gjëzimin e poetit, sa gjykimin e tij për jetën, për njerëzit dhe për objektin konkret të perceptimit poetik. Në këtë veçori të vjershës së Shuteriqit ne zbulojmë një vlerë tjetër të tij si poet: zotësinë për të gjetur vetyven në art, zotësi, që, për fat të keq, nganjëherë nuk e kanë disa poetë të tjerë me talent, se nuk është punë e lehtë të gjesh vëndin tënd në orkestrën e madhe të poezisë, në të cilën «*kush asht i holli fyell dhe kush daullja e randë, kush violina e kjartë, kush kontrabasi që çap-çap shkon pass*». Te lexonjësi i poezisë nganjëherë lind e formohet, — në një masë ose në një tjetër, — po ajo gjëndje shpirtërore në të cilën është ndodhur poeti kur ka shkruar. Kur 'exon vjershat e Shuteriqit të mbetet peng diçka, të duket se, bashkë me poetin, nëpërmjet të poezisë nuk ke arritur atje ku do dëshiroje. Hera-herës të krijuhet një gjëndje shpirtërore gjëzimi a trishtimi të lehtë, kurse, ndonjëherë, mbetesh i ftohtë ndaj vjershave që të kujtojnë statujat klasike në mermer. Kjo vjen, sipas meje, prej karakterit të poezisë së

Shuteriqit dhe prej njëfarë pasqyrimi jo aq të drejtpërdrejtë të jetës së gjallë.

Në vjershat e vëllimit që po shqyrtojmë, të bie në sy edhe një veçori tjetër e pcezisë së Shuteriqit, si poezi ndjenjash të lehta e të holla malli e trishtimi dhe mendojmë që, më tepër se kudo, Shuteriqi shkëlqen si poet pikërisht në krijimet e kësaj kategorie. Ç'vezullim e ç'drithma shpirti janë shkrirë në «*Tingëllimat romantike*» që të kujtojnë tregimin «*Flutarakja*», për frymën dhe predispozitën shpirtërore të poetit! Me gjithëcka: me fjalët, mendimet, me figurat stilistike dhe me muzikalitetin e vargut është dhënë harmonishëm dhëmbja dhe dashuria, mallëngjimi dhe malli, drita dhe dliresia e moshës së rinisë. Një drithmë poetike ka krijuar vjershën «*Një trandafil picërrak*» malli i singertë për vëndlindjen është burimi i poemës «*Mall i Elbasanit*», ashtu si poemën «*Kujtime*» e kanë sajuar mbresat nga lufta dhe dhëmbja për ata që s'janë më. Edhe poema për Vangjush Mion e këtij karakteri është. Të bucura e të përshkruara prej ndjenjash të holla, që shkrihen me mendime të larta, janë edhe vjershat «*Syt e tu*» dhe «*Drejt dashurisë*».

Dhimitër S. Shuteriqi çquhet nga një herë, në këtë vëllim, edhe si poeti i ditës. Është vërtet interesante të mendosh, si ka arritur ai të shkruajë një vjershë aq të bukur, që të rrëmben në rithmin e vargut e të mendimit për një ngjarje gati të zakontë për ne, — përzgjedhjet në gjykatat popullore. «*Mëngjes votimesh*» është një prej poezive të rralla të këtij lloji në letërsinë tonë të sotme, që vërtet të

emocionon dhe që nuk harrohet bashkë me numurin e gazetës, ku është botuar, ashtu siç mund të mos mbeten në mënd edhe vjershat e Shuteriqit si: «*Orkestër e dashur bje te dera*», «*Përrallë*», «*Nëna kolkoziane*», etj. Si poet politik e qytetar, Shuteriqi shquan në mjaft prej krijimeve të veta, ndër të cilat mund të përmëndim vjershën energjike «*Lavdi për ty, Parti!*», «*Një poeti neutral*», «*Për ditën e re*», poemat «*Lufta*» dhe «*Enverit*». Në krijime si këto, vargu zakonisht i qetë dhe pakëz i ngurtë i Shuteriqit gjallërohet, bëhet më dinamik dhe sikur të shtyn t'i dalësh përpara. Edhe horizonti i mendimit sikur zgjerohet dhe përqafon një botë më të gjerë, se bota e zakonëshme, që ka interesuar poetin në raste të tjera. Ndër poemat më e parealizuara është «*O Ptoleme!*». Kjo vepër që me sa duket, duhej të kish qënë një *klithmë poetike*, është tepër e rëndë, e ngatëruar, më tepër e menduar se e ndjerë, sa që zor ta marësh si të bukur. Ajo sikur e prish rrjedhën e natyrtë të krijimtarisë së Shuteriqit drejt një poeziqe të kuptueshme të realizmit socialist, mbasi, po të flasim për vlerën dhe për natyrën estetike të kësaj poeme, do ta kemi vështirë ta përfshijmë atë, krahas krijimeve më të mira, — edhe të mëparëshme, të këtij autori. Poema «*Enverit*», është përgjithësisht e fryshtuar dhe e arrië, megjithë ndonjë pasazh të pasaktë, në të cilin autori duhej të kishte vënë dorë në këtë botim të ri të veprës.

Ndër krijimet e gjata, që zumë në gojë, më interesantja është poema «*Lufta*», e cila, si lufta, është e gjerë, plot mbresa të forta, men-

dime të ashpra, ndjenja të tronditura. Kjo është një vepër në të cilën lufta shihet në aspektet më të ndryshme, po kurdoherë prej një pozite të shëndoshë humanitare e revolucionare. Është me rëndësi të shënojmë këtu, që në letërsinë tonë përparimtare, megjithëse është letërsi e një populli të vogël, që ka vuajtur shumë prej luftave e pushtimeve, nuk ka patur asnjëherë nota pacifiste dhe asnjë prej shkrimittarëve tanë të njohur nuk e ka çfrytëzuar temën e luftës e të paqës për t'u kallur datën lexonjësve dhe për të mbjellur panik. Përkundrazi, lufta, ashtu si në poemën e Shuteriqit, është parë si një e keqe, kundër së cilës duhet luftuar me vendosmëri, duke i drejtuar goditjet, jo vetëm kundër fenomenit në vetvete, po dhe kundër burimit të tij: imperializmit.

Në një pjesë të krijimeve të fundit, sidomos në poemat «*Vangjush Mios*» dhe «*Kujtime*», Dhimitër S. Shuteriqi duket se është orvatur të gjejë kufirin ekstrem ndërmjet poeziës dhe prozës. Dhe, në tërësi, po të mos përmëndim ndonjë pasazh prozaik të vjershës «*Kujtime*», duke na kujtar shumë gjëra prozën, ai ka qëndruar vendosmërisht në terrenin e poeziës. Nuk e di në shpreh një pikëpamje plotësisht të drejtë, po mendoj, se një provë e tillë, — në letërsinë tonë të sotme e gjejmë edhe te ndonjë tjetër, — duhet patur parasysh në zhvilimin e mëtejshëm të poeziës, mbasi ajo përmban në vetvete disa mundësi më tepër për pasqyrimin e gjerë të jetës dhe për të dhënë, nëpërmjet vargjeve, skena masive dhe episode, që deri më sot kanë qënë monopol i prozës. Në fund të fundit, limiti më ekstrem i poeziës

është proza dhe, me sa duket, shumë poetë të sotëm janë përpjekur ta çfrutojnë në dobi të poezisë hapësirën deri më sot të zbrazët, që egsistonte ndërmjet kuptimit klasik mbi poezinë dhe prozës. E pse të mos provojmë me guxim?

Një vlerë tjetër e poezisë së Shuteriqit është *fjalori poetik*. Me këtë nuk kemi para-sysh aq gjuhën e pasur, të punuar e korrekte, sa fjalorin në funksion të idesë emociononjëse të vjershave. Dhimitër S. Shuteriqi është mjeshtër në përdorimin dhe në *çfrytëzimin* e gjuhës, jo vetëm në poezi, po edhe në prozë. Fjala në poezitë e vëllimit «*Këngë*» është në vëndin e vet, e perdorur me veçantësi dhe me kulturnë. Në mjaft prej vjershave, — edhe në ato, që mund të kenë pjesë të tepërtë si «*Malli i E'basanit*», — është vështirë të gjesh fjalë të përdorura pa vënd dhe po aq e zorëshme është të gjesh edhe fjalë të tepërtë. Bile, nganjëherë, — veçanërisht në krijimet e shkurtëra, — Shuteriqi duket se i qëndron pranë parimit të De Radës për të mos thënë gjithëçka, po vetëna atë që është krejtësisht e domosdoshme. Mundësitet e mëdha të gjuhës, poeti i ka çfrytëzuar me mjeshtëri edhe për *pasurimin e vjershave* me elementë të shumta vjershërimi si ritmi, rimat e zgjedhura, ritmet dhe rimat e brëndëshme, krijimi i efekteve akustike, etj. E vet-mja vrejtje që mund të bëjmë për punë të gjuhës është se ajo, si edhe natyra e vetë poezisë së këtij autori, është ca e ftohet dhe larg gjuhës së zakontë të njerëzve të thjeshtë, larg zhvillimit të pandërprerë të gjuhës. Pa dashur të kërkojmë të pamundurën, (që poeti të heqi

dorë prej profilit të vet), ne do të dëshëronim që ai; krahas pasurimit të poezisë me hollësi të mara drejtpërdrejt nga jeta, duke mos hequr dorë prej qëmtimit të fjalëve, të luftojë vazhdimisht për ta gja'lëruar më shumë poezinë dhe për ta afruar më tepër atë me masën e gjerë të lexonjësve.

Kështu mendojmë se poeti do t'i përgjigjet më së miri idealit të shprehur në vjershën «Për ditën e re», në të cilën shkruan, duke iu drejtuar njerëzve të artit:

*Gumo në dallgët njerëzore,  
sulmo n'aradhet punëtore,  
lulzo në kopështet rinoare, —  
me ngjyr' agimi shkruaj.*

*Dhe të gëzosh apo të vuash,  
dhe të urresh apo të duash,  
ti gjoksin shkëmb ta ruash, —  
me ngjyr' agimi shkruaj.*

(Botuar në gazeten «Drita»  
1 prill 1962)

## NJE VEPËR PIETIKE ME RËNDESI

(*Shënim kritik për vëllimin «Shekulli im»*  
të I. Kadaresë)

Dhjetë vjet më parë njerëzve u tërroqi vëmiendjen një vë'lim i vogël dhe i thjeshtë me titullin «*Frymëzime djaloshare*». Pothuajse të gjithë e pranuan që po lindëte një poet i ri i talentuar me mendime të freskëta, me ndjenja të pastra, me ideale të bukura e fisnike. Më vonë emërin e këtij djaloshi e pamë shpesh në organet e ndryshme të shtypit dhe në kapakët e vëllimit «*Endërimë*» dhe të poemës «*Princesha Argjiro*». Ai po çfaqej gjithënë e më tepër si poet, po imponohej gjithënë e më shumë si talent. Dhe nuk është as e rastit, as e tepërt që ai, në moshë ende të re, zuri një vënd të rëndësishëm dhe krejt të vetin në poezinë tonë të re, në historinë e letërsisë sonë të realizmit socialist.

Ky poet është Ismail Kadarea, që kohët e

fundit na gëzoi edhe me një përbledhje të re e të rëndësishme poetike, me vëllimin «*Shekulli im*». Në poezitë e këtij vëllimi nuk gjemë më djaloshin e talentuar, po pakëz naiv të «Fry i mëzimeve djaloshare» dhe as të riun kryesisht romantik e ca të myllur në vetvete të «Endërimeve», po takojmë një poet pothuajse të ri, me një horizont shumë më të gjerë ndjenjash e mendimesh, me një fizionomi individuale më të përcaktuar, me një «peshë specifike» më † madhe. Temat e tij tani nuk janë më, as konstatimet e thjeshta nga jeta shkollore, si në vëllimin e parë, as meditimet dhe filozofimet romantike të vëllimit të dytë. Ai ka dalë jashtë kufive të vetvetes, është përzier me botën e madhe dhe, deri në një farë mase e kuptimi, është shkrirë me 'të, me ato «një milionë diej», që shkëlqejnë në tokën tonë amtare, me miliona e miljona njerëz të kohës sonë. Ai është bërë më universal, si në kuptimin e temave të trajtuara prej tij, ashtu edhe në kuptimin e vlerës që ka poezia e tij.

Ne e vrejmë me kënaqësi këtë përparim të poetit, jo vetëm se gëzohemi për sukseset e tij krijonjëse, po edhe se këto suksese të tij janë frut i sukseseve të mëdha të vëndit tonë në rrugën e ndërtimit socialist, frut i revolucionit kultural, që po zhvillohet tek ne, frut i vetë sukseseve që kanë arritur letërsia dhe artet tona të realizmit socialist. Pa luftën për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, pa kujdesin e madh të Partisë sonë të mrekullueshme për krijimin dhe edukimin e kuadrove të reja, pa përvojën kolektive të dhjetra shkrimitarëve e artistëve të realizmit socialist, poezia e Ismail

Kadaresë dhe sukseset e tij të padiskutueshme krijonjëse, nuk mund të kuptohen.

Po, Ismail Kadarea, me gjithëkëto, vlen të përmëndet e të nderohet si poet jo se veshi uniformën e të tjerëve, po se solli diçka të vetën, diçka *krejt të vetën* dhe, bile, shumë të rëndësishme në poezinë tonë të realizmit socialist, e pasuroi dhe e zhvilloi atë. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe. Ai lindi si poet, jo në kushtet e shtypjes e të varfërisë, as në rrëthanat e luftës së armatosur kundër push-tonjësve të huaj e klasëve sundonjëse të vëndit, po në valën e punës për ndërtimin e socialist, në ambientin e shkollës sonë popullore e të aksioneve të rinisë, në bankat e universitetit tonë të posaçelur. Prandaj poezia e tij s'kish si të mos kishte diçka të re, në krahasim me krijimtarinë e poetëve tanë të vjetër dhe të poetëve të parë të realizmit socialist, përderisa ai është një talent i lindur. Ai e sheh botën me syrin e rinisë sonë të gëzuar, që nuk ka njëphur shtypjen dhe urinë, po është rritur me pekule nga Atdheu ynë socialist, që nuk është shtypur shpirtërisht prej bestytnive, dogmave fetare, paragjykimeve patriarkale e mikroborgjeze, që nuk ka shijuar çorbën e filozofive reaksionare idealiste, po që ka dëgjuar t'i flitet që në shkollën fillore për Marksin e për Leninin, për socializmin dhe për politikën e Partisë sonë. Dhe nuk është vetëm Ismail Kadarea i tillë. Sot 'ne mund të përmëndim me kënaqësi emërat e disa poetëve e prozatorëve të rinj të talentuar, që po sjellin, — dhe s'ka si të mos sjellin, — diçka të tyren, të rëndësishme e të re në letërsinë tonë të realizmit socialist. Në

radhën e këtyre të rinjve Ismail Kadarea është më i talentuar. Ai është, si të thuash, krenaria e brezit të ri të poetëve e të prozatorëve tanë, dhe me shokë të rrallë në tërë letërsinë tonë. Ne flasim për kushtet e reja, flasim për njerëzit e rinj, që lindin prej këtyre kushteve, prandaj është plotësisht e natyrëshme të flasim edhe për poetë e artistë të rinj, jo vetëm në moshë, po edhe në prirjet e tyre. Si në çdo sektor të jetës edhe në art kushtet e reja sjellin kurdoherë diçka të re.

C'gjë të re ka sjellë Ismail Kadarea në poezinë tonë? Ku qëndron individualiteti i tij poetik?

Në vëllimin «Shekul'i im» të tërheq vëmëndjen një gjëreshi e habitëshme temash, motivesh dhe interesimesh të poetit, një gjëreshi, që nuk e teprojmë po të themi, se nuk e gjejmë tek asnje prej poetëve tanë të sotëm. Lavdia kombëtare e pasqyruar nëpërmjet figurës së Skënderbeut, të mbretit Genc e të mjaftë pasazheve të fryshtuara në vjersha e poema, hovë revolucionar i ndërtimit socialist, dashuria e gjiltër për Partinë, gatishmëria për të dhënë edhe jetën për mbrojtjen e Atdheut. fizionomia e brezit tonë të ri, romantizmi i së ardhmes, lufta për paqën, solidariteti ndërkombëtar, luftha për lirinë e popujve të shtypur, besimi në triumfin e idealeve të mëdha të njerëzimit. urejta për armiqjtë, neveria për tradhëtarët, dashuria për vajzën — dhe të gjitha këto të konceptuara e të transmetuara në mënyrë poetike, të paraqitura me mjeshtëri e me fryshtëzin. megjithëse ka aty-këtu dhe pasaktësi, figura të paqarta, ndonjë mendim me të cilin nuk mund

të pajtohemë dhe ndonjë ekstravagancë në formë paradoksi.

Në poezinë tonë të re, sidomos në poezinë lirike, Ismail Kadarea ka sjellë si diçka të vetën dhe të brezit të tij frymën e luftës së rreptë e të papajtueshme kundër zakoneve, psikologjisë, mentalitetit dhe paragjykimeve patriarkale e mikroborgjeze. Ky është një kontribut i çmuar dhe tepër me rëndësi për rrethanat e sotme të zhvillimit të revolucionit socialist në Shqipëri.

A ju kujtohet në poemën «*Endër industriale*» figura impresiononjëse e plakut, që zurret prej malësie për të vënë në vend «nderin e shtëpisë» me armë? Ai i urrente oxhaqet e uzinës gjigante, që i rrëmbeu vajzën, po uzina triumfoi mbi 'të, mbi mentalitetin e tij të ndryshkur. Sa e fuqishme është figura, aq i drejtë është dhe mendimi i shprehur me anë të saj.

E përdorëm këtë shëmbull për të treguar ku e ka bazën hovi i tij luftarak kundër shpirtit e psikologjisë meskine mikroborgjeze e patriarkale. Kundër këtij mentaliteti e kësaj psikologjie, ai lufton me efekt në shumë prej lirikave që përfshihen në vëllimin «Shekulli im», si në lirikat me tema shoqërore, në disa prej atyre me tema letrare, por veçanërisht në lirikat e dashurisë. Të gjitha këto poezi përbëjnë një unitet të plotë ideje. Poeti është i vendsur dhe konsekuent në pikëpamjet e tij. Mendimet e tij për jetën, për dashurinë, për problemet e kohës, pajtohen plotësisht me mendimet e tij për poezinë.

Në «*Poezia e deklasuar*», ai krahas të tjerave shkruan, duke iu drejtuar poetëve meskinë e të demoduar:

*Ju shoh tek trëmbeni si laraska prej sirenave  
Se si tmeroheni prej formave që vijnë,  
Luleshqerakë të mjerë!*

*Poet është ai që me dorën e fortë,  
Ashtu siç këput një trëndafil në lëndinë,  
Mund të zbërthejë pranë trandafilit  
Edhe një minë!*

S'ka nevojë për koment! Një koncept i tillë për poezinë është plotësisht luftarak dhe revolucionar, është, në mund të themi, koncept majakovskjan.

Në vjershat për dashurinë, ai ngrihet kundër gjithë meskiniteteve dhe paragjykimeve, që kemi trashëguar nga e kaluara: kundër pabarazisë së plotë dhe efektive të vajzës me djalin, kundër premtimeve dhe lotëve hipokrite, kundër psherëtimave sentimentale, kundër idealit të një jete të vogël mikroborgjeze familjare. Pikënisja e tij është e drejtë, e shëndoshë dhe në pajtim të plotë me moralin komunist. Po kjo nuk mjaf-ton.

C'i vë përbalë poeti meskinitit mikroborgjez në raportet dashurore e familjare? Në poezinë e Ismail Kadaresë, për fat të keq, këtu kanë depërtuar idetë e dashurisë së lirë. Të flakim tej çdo normë, të mos pranojmë «skllavërimin» familjar, të dashurojmë, gjithënjë të dashurojmë — kështu tingëllojnë disa vjersha të Ismail Kadaresë kushtuar dashurisë. Po, a mund të jetë e tillë dashuria? Dashuria nuk mund të jetë e tillë! Ajo është diçka tjetër,

krejt e ndryshme me atë që u ka servirur poeti lexonjësve të vet me emërin «dashuri».

Duke u ndodhur ngushtë, përballë meskinititet mikroborgjez, me që nuk ka dhënë zgjidhje të drejtë, Ismail Kadarea ve këtë vizion të pakapshëm romantik të dashurisë:

*«Dashurive të mëdha u merr era flokët  
ndanë binarëve,  
ngulçimet e tyre u ngjajnë sirenave,  
sirenave të hapësirta (?) të ndarjeve.*

Këto janë vetëm fjalë dhe asgjë më tepër. Nuk janë në gjëndje këto për të përballuar meskinitetin mikroborgjez, as ato ndikime të ndonjë poeti të huaj të modës, që e kanë shtyrë disa herë Ismail Kadarenë edhe në qëndrime cinike, në egocentrizëm në një pjesë të vjershavë të pjesës «*Pizhamet dhe aeroportet*» e në ndonjë pjesë të poemës «*Rrugëve të Moskës*». Ne na vjen keq që Ismail Kadarea ta përdorë talentin e vet për «frymëzime» të tilla dhe çuditemi si ka pranuar Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve t'u japë lexonjësve, krahas krijimeve shumë të bukura e të shëndosha të Ismail Kadaresë, edhe vjersha të tillë që, në fund të fundit, edhe pse luftojnë kundër meskinitët, nuk dalin jashtë kufive të tij.

Një tjetër temë e preferuar e Ismail Kadarësë është edhe «portretizimi» i shekullit të njëzetë. Në vjersha të ndryshme, po sidomos në poemën «*Shekulli XX*» dhe pjesërisht në

«*Shënime për brezin tim*», ai është orvatur të na japë, dhe disa herë na ka dhënë, mendime interesante dhe karakterizime poetike të buku-rë për shekullin tonë. Në përgjithësi aty ndihet fryma luftarake e Partisë sonë, besimi në forcat e socializmit e të paqës. Idea kryesore është shprehur në mënyrë të plotë në vargun: «*Era e Lindjes sundon mbi erën e Perëndimit*». Me të drejtë kur flitet për shekullin tonë, vargu, përgjithësisht i qetë i Ismail Kadaresë, bëhet nervoz, po ky nervozitet nuk është gjithënjë i përligjur. Në mjaftë raste, ai mbështetet në një konceptim jo të drejtë të gjëndjes së sotme të botës, kur kjo paraqitet si një kaos me «*grindje shtetesh*», e mbuluar me «*antena televizorësh*, e pushtuar prej *ankthit* e rrëmu-jës. Po kështu, poeti, i mahnitur prej antenave të televizorëve, harron kontrastet e thella të shekullit tonë, në të cilin ka njerëz që rrojnë akoma në fise primitive, skllevër që vuajnë për bukën e gojës, fëmijë që vdesin nga malarja, gra që shesin veten për të jetuar, familje që jetojnë nëpër shpella e karakatina... Pra, ajo që na pëlqen më tepër, jeta moderne, është kulmi i arritur prej kohës sonë, po nuk është karakteristikë e përgjithëshme e saj. Edhe në vënde ku televizioni është bërë i modës gjen miliona e miliona njerëz që vuajnë nga uria e që nuk gjejnë punë, pikërisht se jeta është e modernizuar. Mund të shihet shekulli i njëzetë nga lart si një «*peizash gjeneral*», po nuk duhen parë vetëm majat e tij.

Nervozizmi për të cilin folëm më lart cfa-qed sidomos në poemën «*Paqën do ta imponoj-më*». Vetë ideja për të krijuar një vepër në ba-

za kllapie të papërligjur, nuk është një ide e shëndoshë, për të mos thënë që shpreh një gjëndje të sëmurë. Në poemë ka fragmente, sidomos kur flitet për Shaipérinë, që janë të mrekullueshme, po ato mbeten copa të bukuratë një vepre jo aq për tu lëvduar.

Në vëllimin «*Shekulli im*» janë të bukuratë pothuajse të gjitha krijimet poetike me tema shqiptare: «*Malli i Shqipërisë*», «*Varrimi i Skënderbeut*», «*Statuja pa krahë*», po mbi të gjitha shkëlqen si diçka e rrallë për poezinë tonë poema «*Endër industriale*», në të cilën përshkruhet me realizëm një vizion i bukur i të ardhmes sonë: qyteti i ri industrial, ku do të ngrihen në qzell oxhaqe të mëdhenj, prej nga nuk do të bjerë kurrë flamuri ynë fitimtar. Atje do të ketë edhe ndonjë gagarel, edhe ndonjë grua me «buzëqeshje kaproni», edhe ndonjë lavirë, po këta krimba do mybyten, siç thottë poeti «prej moralit proletar» të qytetit të ardhëshëm. Në «*Shënime për brezin tim*», (me gjithëse nocioni «*brezi im*», ashtu si nocioni «*shekulli im*» nuk është shumë i qartë e i përcaktuar, mbasi herë kemi parasysh brezin e ri të vëndit tonë e herë brezin e ri në përgjithësi), ka gjithashtu pjesë të mrekullueshme kushtuar Atdheut dhe punës sonë ndërtimitare.

Karakteristikat poetike të krijimtarisë së Ismail Kadaresë nuk janë më pak interesante dhe të rëndësishme, se temat e trajtuarë prej tij. Edhe këtu ai sjell diçka të re.

Para së gjithash poezia e Ismail Kadaresë është realiste, kryesisht realiste. Ky realizëm, kaq i vështirë përtu arritur, sidomos në poezinë lirike, e ka bazën në vetë konceptimin realist të botës prej

poetit. Ai i sheh gjërat ashtu siç janë, pa i veshur me vello sentimentale e romantike, pa përdorur truke e makiazh të stërholluar në paraqitjen e tyre. Ai i gjen frymëzimet drejtpërdrejt në jetë dhe nuk spekullon, as me fantazi, as me përdorim ndërmjetësish midis tij dhe jetës. Ai e ka çveshur poezinë e tij prej gjithë stolive të kota dhe e ka çliruar prej shumë konvencioneve të vjetëruara. Të gjitha këto, krahas përdorimit të figurave e të hollësive artistike të vërteta, e vënë poezinë e Ismail Kadaresë në krye të përpjekjeve të sotme për një poezi *realiste*.

Veç kësaj, poezia e Ismail Kadaresë është krejt e natyrëshme, e qartë, e kthjellët dhe e pastër. Ajo i ngjan shumë një bisedimi të përzémërt të poetit me lexonjësit dhe të lë përshtypjen se poeti nuk është përpjekur kurrrë të krijojë figura, — megjithëse ajo është plot figura të bukura. Kjo vjen nga që Ismail Kadarea nuk i gëzohet figurës së gjetur, siç i gëzohet ndonjë poet tjetër, i cili duket sikur do t'u tregojë lexonjësve sa i zoti është.

Më së fundi, — e ndoshta kjo duhej thënë në fillim, — ajo është poezi e frymëzuar. Në çdo poezi të vëllimit «*Shekulli im*», ne ndjejëmë të rrahuat e zëmrës së një djaloshi, që e sheh botën me sytë e vet, të një poeti të talentuar, të *etur* pér përparim. Duke çfletuar veprën e tij ne zëmërohemi, kur ai flet me zëmërim, prekemi, kur ai flet me dhëmshuri, gëzohemi dhe rrëmbehemë prej entuziazmit, hovit dhe optimizmit të tij djaloshar. Ka raste që edhe s'jemi në një mëndje me poetin (pér rastet që përmëndëm, pér ndonjë figurë ekstrava-

gante, etj.), po, shumë rrallë rrudhim buzët siç i rrudhim shpesh, duke lexuar vjersha që i kanë të gjitha, por u mungon frymëzimi.

Mund të zgjateshim akoma dhe kishim përsë të flisnim, por ato që shënuam janë më kryesoret.

## **SHAP I HEDHUR ME SIGURI**

*(Shënim kritik për vëllimin «Hapat e mijë në asfalt» të Dritero Agollit)*

Dritero Agolli i vëllimit «*Hapat e mijë në asfalt*» është një poet me frymëzim. Pothuajse në të gjitha vjershat e tij ndihet pulsi i kohës dhe rreh zemra e Atdheut tonë socialist, i cili po hedh një hap shumë të madh përpara, prej prapambetjes dhe varférise së trashëguar, drejt përparimit dhe begatisë, për të cilat luftoi me heroizëm dhe punon me vetmohim populli ynë. Realiteti ynë socialist, ashtu si për gjithë letërsinë tonë të sotme, është burimi kryesor i krijimtarisë poetike të Dritero Agollit. Po, sikur në vëllimin e poetit të mos zbulonim diçka të vëçantë, origjinale, që e dallon atë prej poetëve të tjerë, nuk do t'ia viente as të bënim analiza kritike.

Zakonisht, kur flitet për origjinalitet të poetëve përmenden temat dhe subjektet e reja

që kanë trajtuar ata dhe manifestimet e jashtme të krijimtarisë poetike, mbasi këto janë gjëra që të bien në sy më parë se vlerat e tjera që mund të ketë poeti dhe që, nganjëherë, janë më të rëndësishme, se vlerat që duken aty për aty.

A ka tema të reja në vëllimin «*Hapat e mi-ja në asfalt*»? Po, ka një temë të re shumë të rëndësishme, që në një formë tjetër është trajtuar edhe prej Ismail Kadaresë në shumë prej krijimeve të përfshira në vëllimin «*Shekulli im*». Kjo temë është lufta kundër mentalitetit psiko'logjisë dhe zakoneve mikroborgjeze dhe proklamimi i botëkuptimit, shpirtit dhe normave morale të njeriut të ri, ndërtonjësit vepronjës të shoqërisë socialiste. Kjo temë është një prej elementeve të rëndësishme që dallon Ismail Kadarenë me Dritero Agollin prej poetëve të tjerë, që i shquan ata edhe ndërmjet tyre, mbasi, ndërsa Ismail Kadareja proklamon, Dritëro Agolli vërteton nëpërmjet subjektesh konkrete luftën e së resë me të vjetrën në kushtet e ndërtimit socialist të vëndit. Pra, Dritëro Agolli trajton në krijimet e veta poetike një temë të re për poezinë tonë të sotme dhe e trajton atë në mënyrë të re, ndryshe prej të tjerëve.

Kjo nuk është një temë e trilluar, po e marrë nga jeta, ashtu siç është marë nga jeta edhe fryma që përshkon poezinë e vëllimit dhe zgjidhja që parashtron poeti në krijimet e veta me këtë temë. Ky është një sukses i vërtetë krijonjës për dy arësy: së pari, gjithçka (dhe, kur themi gjithçka, kemi parasysh temat, subjektet, frysë optimiste dhe hollësítë artistike), është marë drejtpërdrejt nga jeta, *nuk është*

*interpretim i jetës, as arësyetim për jetën, po  
është pasqyrimi i realitetit, në kuptimin e sak-  
të dhe më të mirë të kësaj fjalë. Një qëndrim i  
tillë, — pa qënë ky i vetmi qëndrim i drejtë dhe  
i mundshëm, — ndihmon në thellimin e karakterit  
realist të poezisë dhe e aftron atë më shumë  
me procesin e gjallë jetësor të kohës sonë.  
Së dyti, në krijimet e Dritero Agollit, zërthimi  
i momenteve poetike kontradiktore, nuk bëhet  
as nëpërmjet psherëtimave sentimentale, siç ka  
ndodhur, për shëmbull, në disa drama me tema  
shoqërore, as nëpërmjet rrugëdaljeve të trillua-  
ra prej fantazisë, po ashtu siç ndodh në jetë,  
nëpërmjet ndikimit gjithënjë e më të fuqishëm  
të realitetit socialist mbi mentalitetin, psikollo-  
gjinë dhe zakonet prapanike e filistine.*

Le të kujtojmë vjershat «*Kurbatka*», «*Kar-  
meni*», «*Balladë optimiste*» dhe nga «*Fletorka  
e shënameve*». Në këto katër vjersha, si edhe në  
disa të tjera, autori, në emër të jetës së madhe,  
të përparimit e të perspektivës niset kundër  
shpirtvogëlsisë, meskinititet dhe mëndjengush-  
tësisë mikroborgjeze. Jeta jonë është një 'um i  
vrullshëm për poetin, një lum që flak kalbësi-  
rat dhe njerëzit i pastron prej mykut, i çliron  
prej myshqeve, që mund t'u ngjiten pas trupit,  
ose që mund t'u ngatërrohen nëpër këmbë. Es-  
trada i rrëmbejn kurbatkës djalin' i cili nis një  
jetë të re si muzikant; vajza e vogël, që prindë-  
rit e pengonin, do të luajë Karmenin në teatrin  
e Operas; djali, që 'idhte fijet e tensionit të lar-  
të, shpëtoi edhe vajzën që familja e mbante të mby-  
llur si plaçkë të vyer, kurse vëtmohimi i ndërt-  
jonësve të hidrocentralit e shtyn poetin ta shohë  
jetën e vogël nga lart, ashtu siç sheh djalo-

shi grindjet e plakave nga majë e shtyllës së tensionit të lartë.

Ka diçka prekëse kur ndahet fëmija prej prindërve, po ka diçka të papajtueshme me jetën tonë kur prindërit, nuk duan të përqafojnë idealet e mëdha të bijve të tyre, kur nuk i kuptojnë kërkjesat e tyre të reja për një jetë të madhe, për t'u çliruar, prej prangave të interesave të ngushta e prej egoizmit të rrënjosur gjatë shekujve të luftës për egzistencë, sidomos kur prindërit përpiken të ndalojnë hovin e të rinxve. Kurbatkës i vjen keq të heqë dorë prej breshjeve «*me shtëpi në krahë*» dhe nuk i vjen mirë që estrada i mori të birin, kurse prindërit e «Karmenit» dhe të vajzës në «Balladën optimiste» nuk mundën e nuk duan t'i kuptojnë të rinxjtë, përparimin. Një shkrimitari sentimental, lotët që pleqve do t'i bënin përshtypje më të madhe se shkëputja e të rinxve prej jetesës së vogël dhe futja e tyre në valën e jetës socialiste, kurse një shkrimitar realist, ashtu si Dritero Agolli, do t'i bënte përshtypje e kundërtë. Ndërsa i pari vihet në pozita të kundërtë me prirjet e zhvillimit të jetës, i dyti nuk idealizon të vjetërën, po i këndon të sotmes dhe të nesërmes së Atdheut, i bindur se zakonet patriarkale dhe shpirtvogëlsia mikroborgjeze nuk mund të pajtohen me socia izmin. Ne gjëzohemi për djemtë e vajzat, që ngrihen në lartësitë morale të njeriut të ri dhe na vjen keq për ata, që duke mos kuptuar kërkjesat e bukura dhe idealet e mëdha të rinisë, mbeten të vetmuar, të mbyllur në guaskën e konservatorizmit. Jeta ecën drejt së ardhmes së ndritur. Ja pse trajtimi i kësaj teme është sukses krijonjës.

Një temë tjetër e dashur për poetin e ri, është edhe perspektiva e ndritur e njeriut në kushtet e ndërtimit të socializmit, perspektivë kjo që të mbush me gjëzim dhe entuziazëm. Atmosera entuziazzte dhe e gjëzuar e ecjes së vëndit tonë përpara pasqyrohet në fatin e njerëzve tanë, në sigurinë e tyre në jetë, në guximin e tyre për të ëndëruar e për të shpresuar, se në Atdheun tonë do të gjejnë gjithçka që dëshirojnë, gjithka të mirë, që krijuhet me punë e me përpjekje. Të rintjtë që vihen në udhën e jetës, dhe që vështrojnë përpara në horizontin pakufi që çelet para tyre ëndërrat, dëshirat dhe guximi i tyre janë një prej burimeve kryesore të poezisë së Dritero Agollit. Kjo, mbas, nuk është krejt e re, se për rininë dhe për ëndërat e idealet e saj është shkruar edhe prej poetëve të tjerë, po, megjithëkëtë, në vjershat e këtij poeti vërejmë diçka të veçantë, interesante dhe të freskët në trajtimin e kësaj teme. Para së gjithash, në vjershat e Dritero Agollit, nuk gjejmë një rini *në përgjithësi*, një rini, që mund të parafytrorsh në shumë fazë të zhvillimit tonë shoqëror, po rininë e ditëve tona, brezin e ri të Shqipërisë, që apo ka dalë nga hallet e vështirësitë e mëdha të hapave të para të ndërtimit të bazave të socializmit. Krijimi i portretit moral dhe njerëzor të brezit që rritet në ditët tona është një meritë tjetër krijonjëse e poetit, i cili, duke na dhënë këtë portret, rrëfen se është i lidhur ngushtë me procesin e zhvillimit të jetës dhe ka ditur të marë prej saj një moment të caktuar historik dhe ta reflektojë këtë në krijime poetike me vlerë. Le të përmendim vjershën «*Endëra*», heroinë e së cilës është një malësore e re.

që është hedhur në krahët e jetës së madhe, duke zbritur nga fshati në qytet. Brezi i ri i ditëve tonë është fatlum. Ai po gjëzon frutet e djersës e të mundit të prindërve, po vjel pemët e rritura me gjakun e dëshmoriëve.

Po a është rinia e sotme vetëm vjelëse e fitoreve dhe sukseseve të arritura prej të tjerëve? Do t'ishte gabim të mendohej kështu, ndonse mund të gjesh edhe gagarelë, që kërcejnë fokstrot në pistën e shtruar me serën, që nxjerrin etrit e tyre. Po, për fat të mirë, këta janë të pakët dhe përbëjnë vetëm një fshikëz boshe në trupin e shëndoshë të rinisë sonë, në jetën e së cilës edhe sot ka shumë vënd për heroizëm. Në poemën «*Dhjetë sy*» poeti u këndon pesë kufitarëve të përjetshëm, që ngrinë në borë, ponuk hoqën dorë prej kryerjes së detyrës luftarakë, që u ishte besuar. A nuk është heroizëm ky? A nuk janë të rinxjtë tanë të sotëm heronjtë e poemës?

Tjetër temë e rëndësishme është edhe dashuria për njerëzit e punës, sidomos për punëtorët, një dashuri revolucionare kjo, që s'ka as gjë të përbashkët me frymën filistine të simpatisë mikroborgjeze. Ndërsa më parë dashuria për njerëzit e punës çfaqej shpesh si simpati që zbriste prej «*lartësive*», sot, si në vjershët e Dritero Agollit, njerëzit e punës hymnizohen si një shëmbull i lartë dhe si heronj të vërtetë të kohës sonë, që vështrojnë nga lart tymin e kafeneve, ku lëvrijnë kokat e të ngathhtëve e të njerëzve, që janë të tepërtë në këtë botë. Në vjersha si «*Nga fletorka e shënimave*», «*Vargu*», «*Malësori*», dhe «*Këmishët*» jepet qartë ideali i poetit dhe shprehet bukur poezia heroike e pu-

nës, e përpjekjes dhe e mundit për lumturinë e të gjithë popullit.

Lirika intime, vjershat e dashurisë dhe pësazhet zënë, gjithashtu, një vënd të mirë në vëllim dhe ka ndërmjet tyre vjersha të bukura si «Vjeshta», «Ne të dy me Shkumbinin», «U rrit fqinja ime», «Kjo grua» «Malli», dhe poema «Mendime në vjeshtë», ndërsa prej lirikës politike, mund të përmëndim vjershën «Kongo, Kongo» e ndonjë tjetër. Interesante dhe trajtuar bukur, ndonëse e zgjatur dhe fluide, është edhe poema «Hapat e mijë në asfalt», që të térheq vëmëndjen për shpirtin revolucionar dhe përfrymën optimiste që e përshkon.

Në trajtimin e këtyre temave të térheqin vëmëndjen disa veçori karakteristike poetike të Dritero Agollit dhe disa vlera të poezisë së tij.

Kur lexon vëllimin «Hapat e mijë në asfalt» ke përshtypjen se poeti nuk e vret mëndjen, për të gjetur figura stilistike dhe për të përdorur fja është zgjedhura. Kjo nuk është vetëm një përshtypje, që i krijohet në mënyrë të pavetë-dijshme lexonjësit, po është një veçori e stilit të autorit, i cili, ashtu siç ka afruar poezinë me rrjedhën e jetës, ashtu e ka afruar atë edhe me gjuhën e thjeshtë të përditëshme, sa që vjershat e tij shpesh ngjajnë, (ose janë), me një bisedim ndërmjet poetit e lexonjësit, apo poetit dhe heroit të poezisë. Kjo prirje është shumë e mirë dhe pajtohet plotësisht me mendimet që poeti ka shprehur për poezinë në disa prej vjershave të vëllimit. Veç duhet thënë që kjo prirje e shëndoshë realiste nuk i përligj pasaktësítë gjuhë-sore dhe varfërinë, që vërejmë disa herë në

vjershat e Dritero Agollit, pasaktësi dhe varfëri, që të lënë mbresa të pakëndëshme gjatë leximit.

Dritero Agolli, frysëzimet e mara nga jetëna i transmeton, jo nëpërmjet formash të përgjithësuara, po me anë trajtash tepër konkrete, sa që, nganjëherë, të duket sikur poeti, nuk del jashtë kufijve të rrethanës, së cilës i kushtohet poezia. Merita e poetit, në këtë rast, është se ai ka mundur të zbulojë në jetë e transplantojë në poezi elemente dhe momente të atilla të realitetit, të cilat kanë në vetvete forcë përgjithësonjëse dhe emociononjëse. Kështu, për shëmbull, për shumë nga vjershat që kemi përmëndur, poeti është frysëzuar nga raste krejt konkrete dhe nuk është munduar t'u vijë rrotulli këtyre rasteve me spjegime të tepërtë, me komente e as është përpjekur të nxjerrë prej tyre përfundime të përgjithëshme, prandaj vjershat e tij kanë nënëtekst të pasur. Ato i thonë lexonjësit aq sa duhet thënë për momentin poetik që trajtohet në vjershë. Të tjerat, lexonjësi i kupton vetë dhe, pikërisht pse ka diçka për t'u marrë me mënd, pikërisht pse ka diçka për t'u lexicuar ndërmjet vargjeve të pëlqen poezia. Nënëteksti është një nga shprehjet e forcës së poezisë.

Kjo mënyrë trajtimi të temave, është një veçori tjetër krijonjëse e Dritero Agollit, që e bën atë të dallohet prej poetëve të tjerë, ndonjëse në disa raste, si në vjershat «*Burrave të ardhshëm të shteteve*» dhe «*Ariani*», ai mbetet brënda kufijve të konstatimit, prandaj lexonjësi orvatet kot të zbulojë diçka dhe, duke mos zbuluar asgjë, mbetet me përshtypjen se këto

vjersha janë frut i një frymëzimi të paarrirë dhe i tërheqies së poetit ndaj konstatimit apo ndaj figurës, po jo ndaj idesë dhe brendisë poetike të vjershës.

Në vëllimin e Dritero Agollit, të tërheqin vëmëndjen edhe merita të tjera ideoestetike, si qartësia dhe siguria në shprehjen e mendimeve, krijimi i atmosferës shqiptare të ditëve tona, vështrimi i botës nga prizmi i klasës punëtore, zotësia për të zbuluar momentet poetike të realitetit tonë të sotëm, etj. Në krahasim me përmbledhjen «Në rrugë dola», vë limi «Hapat e mijë në asfalt» është sukses i dukshëm i poetit dhe një prej vëllimeve të mira të poezisë sonë të re. Ky vëllim e vë Dritëro Agollin në radhën e poetëve tanë më të fryshtuar e më interesant, i cili, sikur të kish qenë më i kujdesëshëm për vargun e për gjuhën, do ta kishte rritur edhe më tepër vlerën e përmbytjes poetike që analizuam.

(Botuar në gazetën  
«Zëri i Rinisë», 1962)

## KATER VELLIME POETIKE

(«Dhe thonë se paqë ka në botë» —  
«Shtigje poetike» — «Lirikat e majit» —  
«Çështje personale»).

### 1.

Shumë lexonjës do të jenë ndodhur para një surprise, kur kanë parë mbi kapakun e librit «...dhe thonë se paqë ka në botë» emrin e Agim Gjakovës, të cilin më parë mund që edhe të mos e kishin vënë re në faqet e revistës «NËNDORI», ku poeti i ri ka botuar vetëm një tregim. Përshtypja e parë bëhet më e theksuar pasi ke kënduar vëllimin dhe arrin në përfundimin se nuk ke të bësh me një fillestar, po me një poet thuajse të formuar mirë, me pretendime ideo-artistike, me frymëzim e me një brendigati të panjhur e me motive pothuajse të patrajtura më parë prej poezisë sonë të re. Dhe një përshtypje e tillë ka arësyet e veta. Autori i

vëllimit është një i ri kosovar, i cili duke ardhur në Shqipëri, ka sjellë me vete mbresat, përshtypjet dhe mendimet për jetën e atjeshme të shprehura në vargjet e vjershave të veta.

Në vëllimin «...dhe thonë se paqë ka në botë» autori ka përbledhur krijimet e veta më të mira, gjithësej njëzetegjashtë vjersha, duke përfshirë në këtë numër edhe poemat «Përshtendetje Gjakovës», «...dhe thonë se paqë ka në botë» dhe vjershën e gjatë satirike «Kangë e derrit». Prej këtyre krijimeve poetike vetëm ndonjëri meret me aspekte të shkëputura prej jetës së sotme në Kosovë dhe prej problemeve që shtron atje realiteti i sotëm, i karakterizuar prej shtypjes kombëtare e shoqërore. Prandaj nuk është gjë e rastit që brendia e vjershave të Agim Gjakovës na tërheq vëmëndjen menjëherë, si brendi e re për poezinë tonë. Po, nga ana tjetër, në poezitë e vëllimit, krahas pasqyrimit të një realiteti të ri, ne shohim edhe aftësinë e autorit që të zbulojë në këtë realitet anët e tij më esenciale, të prekë pikërisht ato momente të çfaqjeve të gjalla të këtij realiteti që ngjallin emocione dhe që karakterizojnë jetën nëpërmjet manifestimeve të saj të drejpërdrejta. Dhe, së fundi, ky realitet i ri dhe kjo brendi emocionale kanë gjetur, në të shumtën e herës, edhe shprehjen e duhur artistike, që e bind dhe e siguron lexonjësin, se ka të bëjë me një poet, që e zotëron mirë mjeshterinë e vjershëtorit.

Elementet kryesore emocionale të vjershave të Agim Gjakovës, i gjejmë në pasqyrimin e tragjedisë e të vuajtjeve të popullsisë shqiptare të Kosovës, në dhëmbjen e thellë njerëzore të

poetit, kur përshkruan këto vuajtje, në ndjenjën e zemërimit e të revoltës, që përshkon të gjithë librin dhe në urrejtjen e thellë, që u transmetohet lexonjësve prej çdo vjershe ndaj shkaktarëve të këtyre vuajtjeve e dhëmbjeve. Është për t'u nënvizuar se poeti i ri, megjithëse pasqyron një realitet shumë të hidhur, nuk ka manifestuar asnje rast dëshpërimi e pesimizmi dhe, ndonse e përbajtur, poezia e tij përshkohet fund e krye prej frysës së thellë luftarake revolucionare. Nga ana tjetër, vjershat e Agim Gjakovës, duke qenë thelësisht politike, i janë shmanjur çdo «britme» të jashtme dhe çdo ngushtësie, duke qenë në të njëjtën kohë edhe vjersha me brendi të thellë shoqërore. Në këtë drejtim poezia e tij ka qëndruar larg edhe çdo çfaqjeje të shovinizmit, i cili është shpesh shoqëronjës i ndjenjave patriotike dhe i idealeve shoqërore të pakicave të shtypura kombëtare.

Vjershat e Agim Gjakovës janë dinamike, me figura poetike të forta dhe, shpesh krijojnë tabllo të vizatuara në mënyrë të theksuar me laps karboni. Qoftë figurat poetike, që formohen prej tërësisë së vjershave, qoftë edhe figurat stilistike kanë karakter unik dhe të lënë përshtypjen se ke të bësh me një poet i cili, në mos e ka gjetur plotësisht, e ka zgjedhur rrugën e vet. Profili i tij poetik është i afërt dhe i ngjashëm me profilin poetik të Ismail Kadare-së dhe të Fatos Arapit në poezinë tonë të re. Tek Agim Gjakova nuk është vështirë, gjithështu, të zbulosh edhe ndikimin e poezisë së Migrjenit, i cili, siç duket, është një prej poetëve më të dashur të tij.

Vëllimi «...dhe thonë se paqë ka në botë»

të bën të shpresosh që Agim Gjakova, duke iu shmangur edhe ndonjë të mete, si zgjatjet dhe deskripzioni, që vrehen rrallë-tek dhe ndonjë ndikimi të lehtë të simbolizmit, mund të ecë me siguri në rrugën e nisur dhe të vihet në radhën e poetëve tanë të mirë.

## 2

Edhe Fatos Arapi del për herë të parë me një libër vjershash. Vëlimi «*Shtigje poetike*», që sapo është vënë në shitje, pasqyron frutin e punës së tij krijonjëse gjatë pesë-gjashtë vjetëve të fundit dhe rrëfen se ai që tani mund të renditet në radhën e poetëve tanë më interesantë.

Fatos Arapi nuk është i panjohur për lexonjësit tanë, mbasi një pjesë e mirë e poezive të përfshihra në vëllimin «*Shtigje poetike*» është botuar më parë në gazetat e në revistat tonë. Po, sidoqoftë, kur i lexon të gjitha vjershat së bashku, njeriu mund të përcaktojë më mirë përshtypjet që i kanë lënë ato, kur i ka kënduar veç e veç.

Në disa prej vjershave të veta, Fatos Arapi ka folur për poezinë, për poetët dhe ka shprehur, si të thuash, kredon e vetë poetike. Sipas tij, poezia, duhet të jetë e guximshme, e gjallë, militante dhe, para së gjithash, ajo nuk duhet të pajtohet më pshërëtimat sentimentale dhe me falsitetin. Mua më duket, se poeti, në krijimet e veta më të mira, i ka qëndruar besnik kësaj kredoje.

Një nga meritat kryesore të poezisë së Fa-

tos Arapit, që është edhe një nga veçoritë e saj kryesore, është se ajo, *duke qënë një poezi moderne, ka karakter të theksuar kombëtar*. E theksojmë këtë veçori, mbasi ka njerëz që mendojnë se *kombëtare* mund të jetë vetëm poezia *tradicionale* dhe disa të tjera, përkundrazi, kujtojnë se poezia e sotme mund edhe të mos ketë karakter kombëtar, po duhet të jetë një poezi pan-njerëzore. Shëmbulli i vëllimit «*Shtigje poetike*» më ngjan se është një prej rasteve që i hedh poshtë të dyja këto pretendime *ex catedra*. Poezia e sotme nuk mund të mos ketë karakter kombëtar, nëqoftëse është vërtet manifestimi i shpirtit të një populli të caktuar dhe, për të patur karakter kombëtar, nuk do të thotë të mbetesh prapa apo që të gjykojen fenomenet letrare nga pozita të prapambetura.

Në vjershat e Fatos Arapit gjithçka që është njerëzore është shqiptare. Në Shqipëri ai ka zbuluar edhe mendimet e ndritura, edhe ndjenjat e pastërta, edhe heroizmin, edhe luftën e ashpër e të vështirë, edhe prirjen e përjetëshme të njerëzimit drejt përparimit e përsosmërisë. Asnjë element i brendisë emocionale të vjershave të tij nuk është ireal dhe asnjë prej frysëzimeve të vëllimit, nuk mund të thuash se e ka burimin, jo në jetën tonë; po diku gjektë. Nga ana tjetër, temperamenti i poetit, natyra e tabllove poetike të tij, ngjyra dhe dritat që përshkojnë vjershat, shpirti që zbulohet para nesh, bile, edhe vetë toni i fjalëve dhe i frazave poetike të vjershave, janë të gjitha shqiptare, duke mos përgjasuar aspak me poezinë tonë tradicionale apo me shkollën e sotme tradicionale të vjershërimit, e cila gjithashtu ka karakter kombëtar dhe mund të jetë

po aq moderne, sa edhe forma e lirë e vjershë-rimit.

Vëllimi «Shtigje poetike» është, gjithashtu, një vëllim aktual, me tema aktuale, me mendime të kohës, me reflekse realiste të atij revolucionar të madh që është kryer e po kryhet në jetën, në psikologjinë dhe në botëkuptimin tonë. Të shpesh-ta janë rastet, kur poeti i ri e sheh të sotmen si një hal kë në procesin e përjetshëm të zhvillimit, si një hap të madh përpara dhe poezinë e këtij realiteti e zbulon në ndryshimin e madh që ka kjo e sotme në krahasim me të kaluarën, pa haruar që e ardhmia do të jetë akoma më e bukur më e pasur e më poetike. Në vjershat e vëllimit kujtimet e hidhura e të dhimbëshme, parafytyrimet heroike dhe poezia e kapërcimit të vështirësive gërshtetohet shpesh me imazhet e ndritura të së ardhmes ftyrëqeshur e të gëzuar, të cilat poeti i sheh edhe sot në ftyrat e rinisë. Në pasqyrimin dhe afirmimin e realitetit të sotëm, poezia e Fatos Arapit të bën përshtypje edhe për gjallërinë e mendimit dhe për gjerësinë e krijimit të figurave poetike. Në vjershat e tij ndihet një zëmër që treh dhe një mëndje që punon. Dhe, mbas, në këtë gjerësi pasqyrimi dhe në këtë gjallëri mendimi, që janë dy elemente të rëndësishme të guximit krijonjës, fshihet edhe realizmi i poezisë së Fatos Arapit, i shkrirë për bukuri me notat dhe përfytyrimet e dukëshme romantike.

Duke qënë një poezi, që afiron jetën tonë dhe vrullin e saj revolucionar, ajo është poezi thellësisht militante e mbrijtur me frymë revolucionare, me dashuri për jetën e për njerëzit, me optimizëm dhe me besim për të ardhmen e ndritur të njerëzimit e të popullit tonë.

Poezia e Fatos Arapit, pra, edhe vëllimi i tij «Shtigje poetike» mund që nuk kuptohet e nuk pranohet prej të gjithëve. Disa mund që nuk e pranojnë krejt e disa gjejnë në 'të gjëra të diskutueshme, po besoj se të gjithë e pranojnë se kemi të bëjmë me një poet të vërtetë, i cili po thotë fjalën e vet në poezinë tonë të sotme dhe që mund të eci i sigurt në rrugën e vet, duke luftuar gjithënë të flasë, siç thotë vetë, «shkurt dhe qartë», duke iu shmangur hermetizmit në krijimin e ndonjë figure stilistike, duke u kujdesur më tepër për ndërtimin harmonik të veprave, duke mos përsëritur motive të njëjta dhe duke i vënë veshin akoma më shumë tingu'lit muzikor të vargjeve.

### 3.

E pastër, e thjeshtë dhe intime është poezië e Koçi Petritit, i cili sapo botoi vëllimin e tij të parë me vjersha — «Lirikat e majit». Autori i këtij libri i përket brezit më të ri të poetëve tanë, atyre që s'kanë më tepër se katër-pesë vjet, që kanë nisur të botojnë krijimet e tyre të para. Dhe mosha e tij e re, më ngjan se shprehet në mënyrë prekëse në të gjitha vjershat e vëllimit, të cilat janë të singerta, si shprehje të drejtpërdrejta të shpirtit, të mendimeve e të ndjenjave të kthjellta. Në poezinë e Koçi Petritit nuk gjen pothuajse asgjë të panatyrëshme, që të mos pajtohej me moshën e poetit. Për atë janë të huaja pozat, spekulimet filozofike dhe orvajtjet për të shkruar ndryshe nga ç'mund të shkruajë një i ri.

Prandaj edhe vjershat e tij i shëmböllejnë fyttyrës së pastër, të kthjeillët e të qeshur të rinisë, që e vështron botën me optimizëm, me gazin e zbulimit të bukurive e të vlerave të saj pozitive.

Vjershat e Koçi Petritit janë lirike. Ato, para së gjithash, zbulojnë e pasqyrojnë ndjenjat që i zgjohen poetit prej elementeve sublime të jetës dhe, kryesisht, përfshijnë një rrëth të caktuar aspektesh të preferuara edhe për të rintjtë tanë të tjerë: dashuria e parë dhe poezia e dashurissë, shokëria e miqësia, kujtimet e fëmijërisë, — temë shumë e trajtuar prej mjaft poetëve të rinj, — bukuria e natyrës e ndonjë tjetër çfaqje poetike e jetës. Pra, brendia emocionale e poeziës së Koçi Petritit nuk ka ndonjë pretendim të madh shoqëror. Ajo është larg temave të mëdha dhe përpjekjeve për të zbuluar e për të përgjithësuar anët e çfaqjet kryesore të jetës sonë, po kjo nuk do të thotë se një poezi e tillë nuk ka të drejtë të egzistojë dhe nuk ruan në vëtvete vlera ideo-artistike. Dhe, nga kjo pikpamje, vlera e vjershave të vël'imit «*Lirikat e majit*» është, se ato priren të zbulojnë ose, në rastet më të mira, zbulojnë bukurinë e aspekteve më të zakonta të jetës së përditëshme njerëzore, të nxjerrin në pah poezinë e çasteve që mbushin jetën tonë, sidomos jetën e rinisë. Dhe është për t'u shënuar që poezia në vjershat e Koçi Petritit, nuk sillet nga jashtë me anë të shpërthimeve apo dënesjeve romantike, me anë të psherëtimave sentimentale ose edhe me anë të spekullimeve gjoja filozofike, po përmbahet në vetë argumentin e krijimeve të tij, sa që të ngjan se poeti i ri nuk bën gjë tjetër veçse rikrijon me indiferencë një çast të jetës së vet. Këtu e ka burimin thjeshtësia dhe pastërtia e

krijimeve të Koçi Petritit dhe, disa herë, këtu fshihet edhe lehtësia e vjershave të tij.

Një element artistik që harmonizohet bukur me thjeshtësinë dhe lehtësinë e vjershave të poetit të ri është edhe humor, një humor, gjithashtu i lehtë, i natyrshëm dhe i pastër, që herë përmbahet në figurat sti istike e herë përshkon, gati i padukshëm, gjithë vjershën. Dhe është përt'u shënuar, që një humor të tillë rrallë e tek mund ta gjesh në vjershat lirike të poetëve që sapo kanë nisur të shkruajnë.

Për këto arësyё vëllimi «*Lirikat e majit*» mendoj se është tufa e parë me lule që ka mbledhur fushave e fshatrave Koçi Petriti dhe na i ka sjellë që të kënaqemi me 'to. Ai ka ditur të mbledhë, ka ditur të zgjedhë, prandaj tufa e tij me lule fushe nuk ngjan me buqetat e tjera që na ka takuar të shikojmë. Po, sidoqoftë, ky është vetëm fillimi. Poeti i ri që «*ka parë pak në jetë*» dhe që «*mustaqes brisk i vuri tashti shpejt*», pasi ka çelur shtegun e komunikimit me njerëzit nëpërmjet poeziës, do të dijë e do të mundet, besojmë, të shkojë më tej, duke u pasuruar gjithënjë e më tepër pa hequr dorë prej freskisë e natyrësisë së vjershave të tij të para.

#### 4.

Vëllimi «*Çështje personale*» me vjershat satirike të Dionis Bubanit është një tjetër përbledhje e këtij autori, i cili tani njihet si një prej humoristëve tanë më të përmëndur. Dhe,

ndonse në dukje më modest, ky vëllim përmban diçka të re dhe interesante në krahasim me kriji-  
met e para t' autorit e të humorit tonë, në përgjithësi. Temat dhe subjektet e një pjese të mirë  
të vjershavë të vëllimit janë të fryshtuara drejt-  
përdrejt nga jeta, ndaj edhe janë të freskëta, të  
natyrëshme dhe nuk të kujtojnë më atë rrëthim e  
mbylur të çështjeve që trajtohen dikur në  
shkrimet humoristike e satirike. Ne kemi nevojë  
për një humor të gjallë, të freskët, që të mos  
mbështetet vetëm në efektet komike të fjalëve e  
të kombinimit të tyre, po që të zbulojë elementet  
komikë të jetës dhe t' i reflektojë ato nëpërmjet  
pasqyrimit të atyre mijëra e mijëra çfaqjeve të  
përditëshme e të ndryshme. Dhe vëllimet e fundit  
me shkrime humoristike e satirike, duke përfshirë  
edhe krijet më të mira të Dionis Bubanit, na bëjnë të mendojmë, se humoristët tanë,  
pasi kapercyen fazën fillestare të veprimitarë së  
tyre, tani po hyjnë në jetë, përzihen me elemen-  
tet komike të saj, duke zbuluar anë dhe aspekte  
të reja që të bëjnë të zëmërohesh e të qeshësh.  
Kulaku, drejtori burokrat, servili dhe gagareli  
nuk janë gjithçka mund të tallet dhe as mund të  
tallen sipas skemave e shablloneve të krijuara.  
Pra, fryshtimi i drejtpërdrejtë nga jeta, rastet  
e freskëta dhe trajtimi i disa problemeve morale  
e shoqërore të kohës më duket se janë një prej  
anëve pozitive kryesore të vjershavë të reja të  
Bubanit, megjithëse në vëllim ende ndihet jehona  
edhe e mënyrës së dikurshme të të shkruarit,  
sidomos në disa vjersha me tema e fryshtë  
intelektuale. Autori më ngjan se ka patur sukses si-  
domos në trajtimin e temave morale dhe të edu-

katës. Konkretësia e subjektit, që nuk është nga-hera e domosdoshme, në rastin tonë ka shërbyer e shërben si një mjet i mirë për të patur humor me gjallëri e me efekt. Kjo ka sjellë me vete shmangien prej shablloneve, prej përsëritjeve dhe prej monotonisë dhe, veç këtyre, humorit i ka dhënë më tepër karakter shoqëror, si humor kundër zakoneve, psiko'ogjisë dhe mentaliteteve të mykura, si humor që afirmon të renë dhe të mi-rën, duke fshikur të vjetrën e të keqen. Në vjer-shat më të mira të vëllimit ndihet atmosfera e kohës sonë, jo vetëm në mendimet e përgjithësh-me, po edhe në aspektet e në hollësitë konkrete që jepen nëpër vjersha. Të keqen që goditet ne e ndjejmë që çfaqet sot, tek ne dhe jo diku e dikur, në një kohë e në një vënd të pacaktuar. Ky element pozitiv i humorit tonë, që kërkon hetime të vëmëndëshme ndaj proceseve të jetës dhe gu-xim krijonjës, është ende në embrion, po tanë, më ngjan, se vlen më tepër nga rutina dhe shab-lonet, prandaj edhe do nxitur e përkrahur.

Duke qënë më të përcaktuara humori dhe satira e Dionis Bubanit, në rastet më të mira, ka-në edhe më shumë gjallëri dhe forcë. Kur lexon disa prej vjershave të vëllimit e ndjen që poeti e urren sinqerisht fenomenin apo tipin që fshi-kullon dhe lexonjësi, disa herë, këto fenomene e këta tipa, edhe i konkretizon sipas eksperiencës dhe vrojtimeve të veta.

Pra, karakteri konkret, frymëzimi nga jetë dhe dinamizmi mendoj se janë disa nga anët më pozitive të një pjese të mirë të vjershave që për-shihen në vëllimin «*Çështje personale*» të Dionis Bubanit dhe, nga ana tjetër, mungesa e tyre dhe trajtimi intelektual e pa gjallëri jetësore i disa

problemeve, sidomos artistike e politike, të kujtojnë edhe në këtë vëllim të mirë jehonën e humorit pa humor, të humorit që konsiderohet i tillë vetëm se botohet në rubrika e organe satirike.

*(Botuar në revistën  
«Nëndori» Nr. 4, 1963)*

**“ME VALET E JETES” —  
ROMAN I VEDAT KOKONES**

Vedat Kokona është njëri prej shkrimtarëve tanë të vjetër, që është përpjekur me sukses të kapërcejë të kaluarën e vet letrare e të përqafojë metodën krijonjëse të realizmit socialist. Me dramën «*Hijet e natës*» dhe, kohët e fundit, me librin e parë të romanit «*Me valët e jetës*», mund të themi me plot gojën, se shkrimtari ka arritur sukseze të dukëshme krijonjëse në kuadrin e veprimtarisë së vet letrare, sa që asnjë krahasim nuk mund të bëjë njeriu midis veprave të tij të paraçlirimit dhe krijimeve të përmëndura më lart. Kjo tregon se Vedat Kokona e sheh botën tani me një sy tjetër dhe, prandaj, kërkon edhe mjete e mënyra të reja shprehje të afta që të pasqyrojnë realisht dhe me thellësi proceset jetësore dhe shpirtin njerëzor. Vec kësaj, në këtë kapërcim të së kaluarës letrare jo realiste, ne vrejmë edhe forcën tërheqëse të letërsisë sonë të realizmit socialist, të cilën e përqafon çdo shkrimtar, që do të ecë me ritmin e kohës dhe që e ve talentin në shërbim të popullit e të socializmit.

Ngjarjet që shtjellohen në librin e parë të romanit përfshijnë një periudhë kohe pak a shumë të gjatë, që nis aty nga viti 1920 dhe mbaron më 1939. Vëndi ku zhvillohen këto ngjarje është ambienti shqiptar i kohës së Zogut në qytetet e Gjirokastrës, të Tiranës e të Korçës. Nëpërmjet përshkrimit të atmosferës së jetës në këto qytete, autorë i romanit është përpjekur dhe, deri diku ia ka arritur, të na japë një tabllo të gjërë të Shqipërisë së atëherëshme, si vënd i prapambetur, me jetë të amulluar dhe me kontraste të çuditëshme prej një qyteti në tjetrin. Ai ka mundur të na japë një panoramë të përgjithëshme të Gjirokastrës, të Korçës e të Tiranës, duke zbuluar ato anë karakteristike për secilin prej këtyre qyteteve dhe, prandaj, romani ka tërhequr vëmëndjen e shumë lexonjësve, të cilëve, nëpërmjet fletëve të veprës, u përtërihen kujtimet e jetës së dikurëshme dhe u vinë ndërmënd qytetet e tyre, ashtu siç ishin para tridhjet-dyzet vjetësh. Gjirokastra me zakonet patriarkale, Tirana e zhytur në atmosferë prapanike orientale dhe Korça e qeshur si borë, që përpinqet të imitojë çdo gjë të huaj për t'u hequr e qytetëruar. Në këtë drejtim romani i Vedat Kokonës, pavarësisht prej qëndrimit të autorit ndaj ambienteve që përshkruan, ka vlerën njohëse dhe pasuron parafytyrimin e lexonjësve me elemente të reja për atë kohë, megjithëse mund të prisnim prej tij që, krahas *riprodhimit* besnik të hollësirave e të fenomeneve të sipërfaqëshme, të depertonte më tepër në thellësi të jetës dhe të zbulonte rrymat e padukëshme të zhvillimit të saj, ato rryma, që kishin nisur të çfaqeshin e që më vonë u bënë prirja kryesore më e përparuar e

shoqërisë sonë. Gjithashtu edhe qëndrimi i shkrimtarit ndaj fenomeneve shoqërore që përshkruan mund të kishte qënë më i përcaktuar dhe më luftarak. Janë të bucura përshkrimet e zakoneve patriarchale të Gjirokastërës, po a ja vlen në kohën tonë të kujtohen ato me nostal-gji? Edhe vetë Ismail Kamberi një qëndrim tjetër do të kish mbajtur, po t'i qëndrohej besnik tipit të tij dhe kërkesave për një jetë shoqërore më të qytetëruar. Kurse në roman, përveç Tiranes, e cila në pjesën e parë është përshkruar si një vrimë e keqe Anadolli dhe në pjesën e dytë si një grumbull kafenesh, parazitësh e njerëzish të tepërt, lexonjësi nuk gjen asgjë të vjetër e të keqe n'ambientët e përshkruara prej shkrimtarit. Ose, më mirë të themi, shkrimtari nuk i ka dhënë lexonjësit asgjë të til'ë nëpërmjet përshkrimeve panoramike të përgjithëshme. Amulla është dhënë disa herë në formën e harmonisë e të paqës klasike, për shkak të pasovrimit të saj të jashtëm, të cekët e të njëanshëm.

Disa herë Vedat Kokona e ka kapërcyer këtë të metë themelore të veprës me anë të përshkrimit të rasteve konkrete ngajeta, me gjithëse edhe këto nuk lidhen drejtpërdrejt me subjektin e romanit dhe me heroin kryesor të tij. Në të tilla raste ai ka arritur të krijojë disa figura episodike interesante dhe të paraqesë aspekte karakterizonjëse për përfaqësonjësit e rendit zyrtar dhe të klasave sundonjëse, sigjanë kapiteni i gjindarmërisë *Kapllan Ademi*, *Nuri beu*, *Elma* dhe episodet që lidhen me 'ta. Sikur gjithë jetën e asaj kohe ta kishte parë prej pozitash të tilla kritike, pa hequr dorë prej temës dhe prej natyrës së heroit kryesor, shkrimtari

do na kishte dhënë një tabllo më të gjerë, më të thellë dhe do të kish mbajtur vetvetiun nië qëndrim më të përcaktuar kritik ndaj ambienteve të përshkruara. Demaskimi i klasave sundonjëse nëpërmjet figurave dhe mjeteve artistike të letërsisë do të qe më i plotë dhe rastet e përshkruara nuk do mereshin vetëm si episode të çkëputura, po si fryshtë e përgjithëshme e veprës.

Për të kapërcyer ngushtësinë e temës e të subjektit shkrimtari ka përdorur edhe një mënyrë tjetër: pasqyrimin e lëvizjes komuniste dhe antifashiste. Kjo nuk është gjë pa rëndësi, se përcakton në pjesën e dytë të veprës pozitat politike dhe ideologjike të autorit, po, përfat tă keq, nuk mund të pajtohem me mënyrën e pasqyrimit të kësaj lëvizje në roman, meqënëse këtu autorit i mungon thellësia dhe gjithanëshmëria në paraqitjen e jetës. Ndërsa kur flasim përf pjesën e parë të romanit, na duket si dobësi kryesore karakteri i papërcaktuar mirë i qëndrimit të autorit, kur vjen puna përf pjesën e dytë, vrejtjen kryesore e kemi përf vlerën artistike, përf mungesën e brendisë emocionale të përshkrimeve dhe përf karakterin e çkëputur të ngjarjeve prej temës dhe subjektit të veprës. Sigurisht, ndonjë prej këtyre dobësive mund të ndregeti në vëllimin e dytë të romanit. (fjala vjen, moslidhja e episodeve të luftës revolucionare me subjektin e romanit), po dobësitet e tjera, (karakteri kronikal-publicistik dhe mungesa e brendisë emocionale). do të mbeten.

Pra, është e qartë se kur flasim përf pasqyrimin e gjerë e të thellë të jetës, nuk nisemi nga kërkesat e përgjithëshme ndaj letërsisë, po prej

pretendimeve që ka vëllimi i parë i romanit dhe prej vetë përpjekjeve jo ngaherë me sukses të autorit për një pasqyrim të tillë të rea'itetit të asaj kohe. Gjithashtu nuk harrojmë as temën e romanit, as karakterin e heroit kryesor, i cili është njeri i veçuar dhe i shkëputur prej rrjetdhës së madhe të jetës, ndonëse disa anotacione të autorit, (takimi i tij me profesor Larinasin, miqësia me Reshat Delvinën, etj.), mekanikisht e afrojnë Ismail Kamberin me rrymat përparimtare të asaj kohe, bile, edhe me lëvizjen komuniste, po prej këtij afrimi e prej këtyre marrëdhënieve asnje mbresë nuk mbetet në shpirtin e heroit,asnje ndryshim nuk ndodh në karakterin e tij. Ai nuk lëviz, as përpara, as prapa dhe kjo ndodh se autori lidhjet e Ismailit me heronjtë e jetës sonë të atëherëshme i ka dhënë si episode pa rëndësi dhe pa lidhje organike me tërësinë e romanit. Siq shihet, nuk është fjala këtu për të na krijuar një Ismail Kamber tjetër, as për të hequr dorë prej piksynimeve tematike të shkrimitarit, po për t'u thelluar në ato që ai vetë na ka dhënë. Këtu, mbështetës, do qe me vënd të shënonim që edhe sikur më pak vënd të zinte përshkrimi i lëvizjes komuniste në Korçë, nuk do të humbiste gjë romani, nëqoftëse shkrimitari do të kish mundur të zbulonte në jetës lidhjet e vërteta të Ismail Kamberit me ambientet e ndryshme të kohës, duke i qëndruar besnik karakterit të tij dhe duke qenë vetë më i përcaktuar ndaj heroit kryesor.

Këto dobësi kanë shkaktuar që lexonjësi të mos kuptojë dot cila është tema e veprës. Ndërsa në pjesën e parë autori meret kryesisht me prejardhjen e me jetëshkrimin e Ismail Kambe-

rit, në pjesën e dytë, pasi e braktis një herë këtë qëllim, duke ënë jashtë veprës periudhën e studimeve të larta të heroit, ai heq dorë përfundimisht prej jetëshkrimit të heroit dhe jepet më tepër pas paraqitjes kronikale-politike të lëvizjes komuniste në Korçë, (ndërsa heroi kryesor është në Tiranë), dhe përshkrimit të gjëndjes së vëndit në pragun e pushtimit fashist.

Në roman kemi një hero: Ismail Kamberin. Heroi tjetër është, deri diku, *koha*, që siç thamë, nuk na jepet me thellësinë e me gjerësinë e nevojshme realiste. Gjithë të tjerët, kush më shumë e kush më pak, janë personazhe episodike me dy funksione: të térheqin Ismail Kamberin në jetë, (Selimi, Frosina, Teli, Sofia), ose të vennë në pah më mirë portretin e tij, (Esmaja, Elma, Nuri beu, etj.) dhe prej këtyre personazhevë episodikë ka disa të realizuar me të vërtetë mirë, si Ollga, Frosina, Esmaja dhe disa të tjerrë të përcaktuar bukur nëpërmjet ndonjë rrethane: Elma, Nuriu, Teli.

Është meritë e autorit, që, në kundërshtim me dëshirën e tij, na ka dhënë me protagonistin Ismail Kamberi një *intelektual tipik mikrobor-gjez*, te i cili, më tepër se çdo gjë, ka rëndësi të kënaqurit e vetvetes dhe konsiderata për vetvete. Kur ishte në liceun e Korçës, atij i pëlqente të shihej në pasqyrë e të kënaqej me vetvete, me një ndjenjë të pafshehur narcisiste. Pasi mbaron liceun, pa lëkundje, fejohet me Esmanë, që të ketë mundësi të vejë për studime në Pariz. Në Pariz dashuron K otildën. Pasi kthehet nga Parizi martohet me Esmanë dhe sillet gjithë ditën nga një kafenë te tjetra, duke vëgjetuar. Në këtë kohë dashuron Sofikën. Kur

Shqipëria është me litar në grykë ai, duke i shtrënguar dorën së shoqes, derdh lotë për dashurinë. Këto janë momentet kryesore të jetës së tij.

T'i shqyrtojmë një nga një:

Kur fejohet me Esmanë, ai vepron si egoist. Për hir të studimeve ai pranon të fejohet me një të panjohur, me të cilën nuk do të lidhet kurrë shpirtërisht. Si kthehet nga Parizi, ai vendos të martohet, megjithëse e di që nuk do ta dojë kurrë nusen. Pse u fejua? Ta zëmë se ai është viktimit regjimit, që nuk i dha bursë dhe, nga etja e madhe për dituri, u shtrëngua të shitej me para, ndonse edhe këtu ka një dozë të theksuar egoizmi. Pse u martua atëhere? A nuk do të kish qënë më mirë ta prishte krush-qinë dhe, në këtë mënyrë, të çlironte veten, të ngrihej kundër zakoneve patriarkale dhe të shpëtonte Esmanë? Kaq gjë duhej ta bënte një njeri me kulturë. Po Ismail Kamberi vepron ndryshe, jo vetëm si njeri pa vullnet, po edhe shumë individualist.

Në Pariz ai kishte K'otildën për grua. A e donte? Nëqoftëse e donte, atëhere është më egoist nga ç'duket dhe më i pavullnet nga ç'kuqojtmë, mbasi ai edhe atë e ka mashtruar dhe e ka braktisur, ashtu siç mashtron dhe braktis Esmanë, kur dashuron Sofikën e bukur e të re.

I tillë na paraqitet Ismail Kamberi në jetën personale. Në jetën shoqërore dhe politike, ai është me të vërtetë një *i dehur me afion*, që s'di nga vjen e s'mer vesh ku po shkon, jo se nuk mundet ta dijë, po se nuk e vret mëndjen për një gjë të tillë. Në pjesën e dytë të romanit, ai rrëshqet sipër valëve të jetës pa u lagur

fare. Në këtë mes, autori nuk ka arritur të na e japë plotësisht njeriun e shkëputur nga jeta dhe, në vënd të tij, na ka dhënë një tip, që nuk çan kokën për asgjë të rëndësishme. Siç shihet, ky është një tip gati i ri për etërsinë tonë. Merita e autorit është se e ka marë atë prej jetës dhe, pavarësisht nga të metat, e ka realizuar në përgjithësi mirë.

Po a mjafton që tipi të jetë real? Krahas kësaj, prej një shkrimtari të realizmit socialist, kërkohet që ky tip real të vlerësohet, duke u nisur nga pozitat ideo-politike dhe morale të masave punonjëse dhe të pararojës së tyre revolucionare. Ndryshe, nuk mund të flitet me plot gojën për veprën të realizmit socialist.

Vedat Kokona nuk mban një qëndrim të prerë kritik ndaj heroit të veprës, shumë vepri-me të të cilët, siç e pamë, nuk pajtohen me pik-pamjet tonë për jetën dhe me normat e moralit tonë. Duke kaluar lehtë disa çaste përcaktonejse, siç është fejesa dhe martesa e Ismail Kamberit, duke mos nënvizuar as karakterin negativ, as tragjedinë e shkëputjes prej masave, duke miratuar llastimet e tij, duke e përkëdhe-luq disa herë dhe duke mos i shkuar deri në fund analizës së Ismail Kamberit si *tip shoqëror*; autori i romanit nuk na jep qartë qëndrimin e vet ndaj këtij intelektua i mikroborgjez dhe ndaj ambientit që e rrëthon atë. Në pjesën e dytë të veprës, shkrimtari nuk ka mundur të krijojë asnje lidhje organike ndërmjet ngjarjeve historike që përshkruan dhe heroit, që ka zgjedhur.

Dy fjalë për kompozicionin dhe për stilin e veprës.

Prej hyrjes së romanit mbetesh me përshtypjen se, pas një degresioni qoftë edhe të gjatë, do kthehet rishtas te fillimi, për të vazhduar më tej. Po nuk ndodh kështu. Menjëherë vepra mer karakter kronikal biografik dhe, ndërsa heroi u afrohet brigjeve të Shqipërisë, ne njihemi me parardhësit e me prindërit e tij dhe ndjekim fëmijërinë e Ismail Kamberit, nëpërmjet një përshkrimi të shpejtë e gati të nxituar të episodeve. Ky nxitim i autorit gjatë leximit na duket i arësyeshëm dhe ne nxitojmë bashkë me 'të që të dalim prej degresionit dhe të ndjekim fatin e mëtejshëm të Ismail Kamberit. Mirëpo autori nuk heq dorë prej jetëshkrimit të heroit. Atëhere lexonjësi bindet se përshtypja e parë ka qënë e gabuar dhe vihet të ndjekë fëmijërinë dhe adoleshencën e heroit. Shkon derri në një vënd dhe ngel. Në vepër krijohet një hon që, ndoshta, do qe zënë nga një prej pjesëve të romanit. Shkrimtari ka lënë jashtë veprës periudhën e studimeve të larta të Ismail Kamberit, që për formimin e botkuptimit dhe karakterit të tij do të kishte rëndësi të dorës së parë. Këtu lexonjësi heq dorë edhe prej mendimit, se autori ka dashur të kallëzojë si formohet karakteri i një njeriu nën ndikimin e ambientit e të rrethanave. Dhe, me të vërtetë, shkrimtari, në pjesën e dytë, heq dorë prej qëllimit që ka pasë në pjesën e parë.

Me të nisur pjesa e dytë na del përpara një e papritur tjetër. Pasi ka braktisur rrjedhën e natyrëshme të kallëzimit, autori kalon në një plan tjetër kompozicional dhe kështu vazhdon deri në kapitullin e gjashtë. Edhe në kapitullin e katërbëdhjetë ndodh e njëjtë gjë. Në roman

pra, mungojnë lidhjet organike ndërmjet ngjarjeve, episodeve dhe personazheve. Ato shkrimtari i ka zëvëndësuar me lidhje të jashtëme, të rastit, duke dëmtuar thurjen artistike të subjektit.

Megjithëse gjuha, përgjithësisht, është e pasur dhe korekte, stili i romanit ka lëkundje dhe disnivele. Këto vrehen në ndryshimin ndërmjet pjesës së parë dhe pjesës së dytë të romanit. Ndërsa në pjesën e parë shkrimtari rrëfen, në pjesën e dytë dhe në ndonjë kapitol të pjesës së parë, *përshkruan drejtpërdrejt aksionin*.

Natyra e stilit të Vedat Kokonës është e qetë dhe kjo ka anën e vet të mirë dhe të keqe. Ana e mirë e saj ëshë se autori nuk përpinqet, siç ndodh nganjëherë në letërsinë tonë, të flasë me enfazë e me një ngrohtësi të stisur përgjera që mund të flitet thjesht e me natyrësi. Nga kjo pikpamje në të reflektohet qëndrimi përgjithësisht realist i shkrimtarit ndaj jetës. Ana e keqe është se, disa herë, sidomos në pjesën e dytë të romanit, vërehet një qëndrim jo emocional ndaj gjërave që përshkruan dhe shpesh hasen në faqet e veprës së Vedat Kokonës edhe fraza stereotipe, përsëritje mënyrash të thëni, ndonjë përshkrim manierist, etj.

Romani «*Me valët e jetës*» me gjithë këtu tē meta, paraqet mjaft vlera për tē cilat folëm më lart. Nëse theksuam tē metat, nuk kemi aspak ndërmënd tē mohojmë shkëlqimin e aftësisë krijonjëse tē autorit në dhjetra faqe tē romanit. Për shëmbull, tē bie në sy që, përvëç Tilit, Larinasit e ndonjë tjetri, Vedat Kokona ka dhënë në romanin e vet disa personazhe episodikë shu-

më të goditur, si Esmaja, Frosina e Ollga, sidomos Esmaja, ajo grua e bukur, e urtë, e ndrojtur, me kërkesat e veta modeste e me idealet e gruas *tipike* të popullit tonë në atë kohë. Ideali ynë për gruan është shumë i ndryshëm nga ky personazh dhe i afërt me idealin e shkrimtarit, i cili ka zbuluar nëpërmjet Sofikës zgjimin e vajzës shqiptare, të vajzës me ideale shoqërore, aktive në jetë. Po, megjithëkëtë, Esmanë ne e duam dhe e mëshirojmë. E duam, se ajo është e mirkë, e pastër në shpirt dhe, me naivitetin e një gruaje të pakulturë, na tërheq e na bën përvete. Ne e duam atë që dha për dashurinë dhe ndërimin që ka për të shoqin, Ismail Kamberin, mbasi në këtë dashuri e nderim zbulojmë atotipare të larta morale të gruas sonë, që janë burim i gjithë ndryshimeve të mëdha në profilin e saj, se Esmaja, ndonse më e pasur nga burri, e çmon shumë kulturën dhe pozitën shoqërore të tij, sa që i duket vetja shumë e vogël në krahasim me 'të. Ne e mëshirojmë atë, mbaq nëqoftëse është grua pa *ideale* të mëdha dhe pa kulturë, kjo nuk ka ndodhur përfaj të saj, po përfaj të atyre zakoneve të mykura patriarkale, që u bënë burim edhe i fatkeqësisë së saj të dytë: martesës me Ismail Kamberin. Kur e krahasojmë me heroin e romanit, ajo na duket edhe më afër dhe na shtyn të mendojmë, që është më vështirë të jesh njeri i mirë, se sa njeri «*me kulturë*».

E një temperamenti me Esmanë është edhe Ollga, gruaja që mban mbi shpatulla barrën e shtëpisë dhe jeton si e ve me burrin gjallë. Ajo na kujton qindra e qindra gra të mrekullueshme të vëndit tonë, që kanë shkuar buzëplasur dhe

kanë hequr të zezën e ullirit, që të mbajnë shtëpinë, të rrisin fëmijët dhe të ruajnë «nderin» e burrave kurbetlinj.

Skenat, në të cilat veprojnë këta personazhe, janë pjesët më të bukura të romanit, ndër mjet të cilave dallon përshkrimi i natës së parë të martesës, si një nga copat më të mira të gjithë prozës sonë. Dhe, prandaj, duke u mbështetur në anët më pozitive të romanit, ne shpresojmë që Vedat Kokona do të krijojë në t'ardhmen vepra më me vlerë, ku të ndihet i fortë pulsi i jetës sonë dhe të pasqyrojë me realizëm e me frymë revolucionare të shkuarën e të sotmen e popullit.

(*Botuar në revistën «Nëndori»,  
Nr. 5, 1962*)

## «QYTETI I FUNDIT»

Petro Marko, një nga prozatorët tanë më interesantë e më të rëndësishëm, pas «*Hasta la Vistës!*», që u prit aq mirë prej lexonjësve, na dha edhe një vepër tjetër të bukur: romanin «*Qyteti i fundit*». Kjo vepër na tërroqi vëmëndjen si për temën, ashtu edhe për trajtën e përshtatëshme që ka zgjedhur autori për të gërshtuar prirjet e theksuara realiste me notat romantike-lirike, analizat psikologjike me ske nat narrative, botën tonë që lind me botën e rënuar fashiste, idealet e larta dhe perspektivat tona me të kaluarën e mallkuar të robërve italianë dhe të ardhmen e tyre të pasigurt.

Baza e subjektit të veprës është e thjeshtë: po riatdhesohen robërit e luftës, të cilët patën ardhë më 1939 në Shqipëri si pushtonjës e po kthehen tani në Itali të mundur, të çgënjenyer, të rënë shpirtërisht e të dëshpëruar, për të dje shmen, të sotmen e, sidomos, të ardhmen e tyre. Ky subjekt është aq i thjeshtë në pikëpamje artistike, sa ç'është edhe i thellë, i gjërë, ga-

ti, i paformë. Në këtë veçori formale të subjektit zbulohet një nga meritat kryesore të prozatorit, i cili, pa u ngushtuar, ka arritur të gjeje elemente të atilla kompozicionale, nëpërmjet injave, personazheve dhe episodeve të ndryshme, që i kanë lënë dorë të lirë të vërtitet pa ekstravaganca e mjete primitive ndërtimi, në të gjithë hapësirën e pakufi të temës së rëndësishme që ka trajtuar: të pasqyrojë tragjedinë para heroizmit, poshtësinë përballë dashurisë, humanizmin pranë kriminalitetit, viktimat bashkë me xhelatët e tyre, njeriun e ri që ngjitet dhe të vjetrin, që ka marë tatëpjetën, optimizmin dhe pesimizmin të lidhur me dy kohë, me dy sisteme shoqërore, me dy vënde, me rrugë krejt të kundërta të ndjekura në jetë prej heronje të librit.

Me pak fjalë, në «Qyteti i fundit» janë vënnë krashi njera-tjetrës dy botë nëpërmjet aspektheve më të ndryshme e më të rëndësishme të çfaqjes së tyre. Autori pohon dhe mohon. Ai i drejtohet botës së vjetër dhe kapitalizmit të sotëm me fjalët e njeriut të ri — qytetarit të ndërgjegjshëm të një vëndi socialist — dhe ne, nëpërmjet radhëve të romanit, duke ndjekur udhët e ndryshme dhe fatet e personazheve, zbulojmë karakterin çnjerëzor dhe të poshtër të jetës borgjeze, të moralit borgjez, të dashurisë borgjeze, të sentimenteve fetare hipokrite të borgjezëve, të çfrytëzimit të plotë e të gjithanshëm borgjez. Të gjitha këto Petro Markona i ka dhënë me anë të portretit kolektiv të robërve italianë dhe të peripecive të tyre në jetë, veçanërisht gjatë vjetëve të fundit të luftës së dytë botërore.

Kur themi «portreti kolektiv i robërve ita-

lianë», kemi parasysh se romani nuk ka një hero kryesor në kuptimin e saktë të fjalës. As toger Leka, as Ana Maria Monti, as Karlo Peroni, nuk mund të meren si të tilë, derisa tema e romanit, biles, subjekti i tij, nuk mbështetet në rrugën a fatin e ndonjerit prej tyre. Një gjë e tillë nuk është e metë, po veçori e romanit, i cili qoftë për këtë veçori, qoftë për gërshtimin me shkathtësi të episodeve e të motiveve të ndryshme, mund të krahasohet me një mozaik plot ngyra e figura, të cilat, në tërësinë e tyre, janë harmonike.

Edhe portreti kolektiv i italianëve nuk sundohet prej ndonjë ngjyre të vetme. Nëpër të gjejmë të harmonizuara ngyra nga më të ndryshmet, të cilat, — të gjitha së bashku, — na jepin, më tepër se një galeri tipash, historinë e një populli, që fashizmi e hodhi në humnerën e varfërisë, të mjerimit, të luftës e të rënimit. Realizmi i autorit gjëndet pikërisht në paraqitjen me sens artistik e me mprehtësi politike të kësaj mase heterogjene njerëzish. Lexon përfatim e tyre dhe pushtohesh herë mbas here, nga ndjenja urrejtje, dhëmbshurije, dashurije, krenarije, neverije, mëshire... S'mund të mos i urresh *Karlo Peronin* e fashistët e tjerë, që na dogjën e na vranë, s'mund të mos ndjesh dashuri përf<sup>Ç</sup>ekantonin e çiltër dhe është e pamundur të mos të dhimbet *Ana Maria Monti*. Dhe, kur mendon përf luftën tonë, përf fitoren e saj dhe, njëkohësisht përf humanizmin që karakterizon popullin e partizanët tanë, provon njeriu një ndjenjë krenarije të ligjëshme. Po, më në fund, pasi niset vaporë dhe mbaron romani, të mbetet në shpirt një ndjenjë e çuditëshme mëshire e

trishtimi, kur mendon se ata njerëz, — në mos të gjithë, shumica, — janë viktimat e fashizmit dhe nuk do ta përshkojnë aq lehtë jetën, sa q'përshkojnë udhën e kthimit në atdhe, ku edhe sot sundon po ai kapitalizëm, po ai burim shtypje, varfërimi, kriminaliteti e degjenerimi. Gëzo-hesh kur kujton se edhe ndërmjet tyre ka Çekantona e pjesëtarë të brigadës antifashiste «Antonio Gramshi»!...

Në përshkrimin e robërve italianë të luftës autori mund t'i ishte shmangur ndonjë episodi me natyrë eventurëske, që mer proporcione gati të pabesueshme, si historia e këngëtores dhe punëtorit të «Skalës» së Milanos, apo edhe ndonjë skene vulgare dhe kjo shmangie do ta forconte bazën realiste dhe qëndrueshmërinë kompozicionale të veprës. Po kështu mund të mos ishin çrytëzuar deri në tepri hieja e *Malombrës* orguzi (ose të ishte plotësuar ajo) dhe motivi i këngëtorit, këngët e të cilat do të shërbenin më mirë, si intermezo të vërteta lirike në roman. Përgjithësisht romani në këtë vështrim, zhvillohet në një vijë horizontale dhe kapitujt e rindë, nuk sjellin kurdoherë diçka të re.

Përballë italianëve është vënë portreti kollektiv i partizanëve me toger Lekën në krye, të cilët sapo kanë dalë nga lufta dhe vështrojnë drejt të ardhmes me besim. Edhe në këtë rast shkrimtari nuk i ka kursyer ngjyrat në përshkrimin e heronjve, megjithëse në paraqitjen e portretit të përbashkët të partizanëve larmia nuk është aq e madhe dhe e menduar sa në paraqitjen e italianëve edhe për arësy, se ky kollektiv nuk është aq heterogen sa i pari. Prapse-prap të térheqin vëmëndjen *Bejkua* i thjeshtë,

pakëz naiv, pa kulturë, po me dëshirë të madhe për të mësuar. Ai personifikon tipin e fshatarit tonë atdherdashës, i cili ka luftuar për liri dhe, pasi e ka fituar atë, nuk ka ideal tjetër veç që të kthehet prapë në fshat e të punojë i qetë. Kështu mendonin shumë njerëz më 1945! Sot revolucionimi socialist i vëndit u ka çelur atyre perspektiva të reja, i ka ngritur lart, i ka pasruar shpirtërisht. Merita e autorit është që tipin e Bejkos n'a e ka dhënë me realizëm, pa e zbuluar, po me dashuri. Pas tij vinë toger Leka, që ze më tepër vënd se të tjerët, Mara dhe Bedrija. Tipar i përbashkët i tyre është humanizmi. Të gjithë kujdesen për italianët dhe pikëllohen për fatin e tyre, megjithëse secili ka ndjerë mbi shpatullat e veta peshën e rëndë të pushtimit fashist dhe, në mos drejtpërdrejt, tërthorazi janë shtypur e shfrytëzuar prej kësaj turme italianësh që janë mbledhur në «*qytetin e fundit*» për t'u kthyer andej nga kanë ardhë. Ndonjë prej partizanëve nuk e kupton deri në fund ç'kuptim ka ky humanizëm apo pse u dashka kujdesur aq shumë për gratë e paturpëshme publike, po sjelljet e tyre ndaj armiqve të humbur diktohen prej vetë realitetit tonë të ri, prej parimeve të larta të moralit tonë komunist, që kultivoi në njerëzit e thjeshtë Partia qysh gjatë vjetëve të luftës kundër fashizmit. Edhe këtë aspekt Petro Markua e ka pëershruar me realizëm

Krahas tragjedisë së italianëve të mashtruar prej fashizmit, shkrimitari ka paraqitur deri diku edhe heroizmin e popullit tonë, vuajtjet dhe trimëritë, urrejtjen ndaj fashizmit dhe dhëmbshurinë ndaj njerëzve të mashtruar apo

të detyruar prej tij. Ashtu si Ipaemëri ka shumë e shumë ushtarë italianë, të cilët ja detyrojnë jetën fshatarëve tanë, që i mbajtën me bukë, fshehnë në shtëpitë e tyre, dhe i mbrojtën prej xhelatëve hitlerianë. Ky shëmbull i lartë i ndjenjave humanitare të popullit tonë është përshkuar mirë në veprën e re të Petro Markos. Do t'ishte e dëshirueshme, që krahas anës tragjike, të ishte nënvizuar më tepër ana heroike e luftës sonë çlirimtare, sidomos kundër pushtojnësve italianë. Në këtë mënyrë edhe e vërteta historike do ishte dhënë më e plotë, edhe efektet e kontrasteve, që përshkojnë romanin, do ishin më të theksuara.

Në pasqyrimin e luftës sonë antifashiste autori ka përdorur me efekt parafytyrimet dhe përshkrimet poetike, ndër të cilat të bën si mos pér vete figura e bukur dhe e pastër e Malisë, në krijimin e së cilës Petro Markua duket se është nisur nga një këngë popullore e kohës së luftës. Krejt natyrshëm fundi tragjik i Malisë është përdorur njëkohësisht si akuzë e tmerrshme kundër fashizmit dhe si simbol i dashurisë së pastër, i shpirtit të kulluar dhe i vetmortimit. E vënë përballë Ana Maria Montit. ajo shkëlqen si një yll i vërtetë, që duhej të kish patur më tepër reperkursione të forta në shpirtin e toger Lekës.

Një nga elementët kryesorë, në mos kryesorë, që shërben si bosht kompozicional pér romanin, është lidhja e toger Lekës me Ana Maria Montin dhe marëdhëniet e kësaj me Karlo Peronin. Ky bosht nuk ka vetëm karakter formal, po është njëkohësisht një nga elementët më të rëndësishëm të brendisë së veprës. Nga një anë

kemi kriminelin, të pashpirtin e të degjeneruarin Karlo Peronin, tipin e saktë të fashistit, që ka punuar të nëndëdhjetenëndat në Shqipëri dhe ka marë më qafë, bashkë me shumë të tjera, edhe të mirën e të mjerën Ana Maria Monti. Nga ana tjetër kemi toger Lekën, oficerin e D.M.P., i cili kujdeset aq për italianët po që ka aq urrejtje të thellë e plotësish të natyrëshme kundër kriminelëve të luftës. Në mes tyre qëndron Ana Maria Monti, viktima e Karo Peronit, vajza më e bukur me të kaluar të neveritëshme e rrënqethëse, gruaja me të ardhme të pasigurtë. Me vuajtjet, poshtërimet, dëshpërimet dhe pasigurinë ajo personifikon fatin e mijra vajzave italiane dje dhe sot. Në shpirtin e kësaj gruaje zien një urrejtje e pakufi kundër fashizmit dhe fashistit Karlo Peronit, po këtë urrejtje nuk e lë të shpërthejë pllaka e rëndë e shpirtit skillavëror dhe, veçanërisht frika për të ardhmen, e cila i fanitetit me ngjyra më të errëta dhe me monstruoze se e kaluara. Ana Marijen e sundon ankthi, ankthi i rinisë së përenduar e të poshtëuar, ankthi i takimit me Karlo Peronin, që ajo e kujtonte të vrarë, ankthi i kthimit në Itali, në djepin e në varrin e saj.

A mund të ketë shpëtim? — duket sikur pyet autorri. Nëqoftëse ai nuk i ka dhënë **një zgjidhje** të këndëshme kësaj pyetje nuk është faji i tij. Faji është i vetë historisë së Ana Maria Montit, i realitetit ita ian, që e lindi, e përdhunoj dhe, më në fund, e vrou këtë vajzë të bukur.

Toger Leka bëri gjithçka për 'të. Me luftën e vet dhe të popullit ai dha një kontribut të çmuar edhe për çlirimin e Ana Maria Montit

prej fashizmit. Në çastet e fundit ai e shpëtoi atë edhe prej kthetrave të Karlo Peronit. Ç'mbetet pér të bërë më? Çdo gjë që mund të bëhej do t'i jepte kësaj linje një zgjidhje sentimentale, prandaj mendojmë se autori ka vepruar drejt.

Në qoftëse ka gjë, që nuk shkon në marëdhëniet e Ana Marisë me Lekën, ky është ankthi dhe notat, pothuajse tragjike, që përshkojnë qëndrimin, takimet dhe fjalët e këmbyera ndërmjet tyre. Kuptohet që në sjelljet e fjalët e Ana Marisë të kumbojnë nota ankthi e të ndihet një atmosferë skandaloze, po në shpirtin e Lekës nuk gjejmë asnjë motiv që mund t'i përligjë ato. Ç'është gjith ai ankth në takime? Ç'janë ato biseda me vetveten? Ç'janë ato parafytyrime tragjike si në kllapi? Këto nuk i shkojnë tipit të Lekës të krijuar prej Petro Markos,

Lidhur me këtë vlen të shënojmë se shkrimtari në krahasim me «Hasta la vistën», në romanin e tij të ri e ka përpunuar, e ka krehur, e ka stabilizuar dhe e ka çliruar stilin nga shumë elemente gjysëm romantike, gjysëm sentimentale. Ai ka përdorur një stil kryesisht realist, plot figura poetike e fantazi, pa zbukurime të tepërtë, pa mendime të gjata e fraza të ngaterruara sintaksore, pa mani gjuhësore, ndonse akoma tingëllojnë false pasthirmat e tepërtë, prej të cilave nuk ka mundur të heqë dorë plotësisht. Krahas kësaj, prirja e autorit pér një gjuhë sa më të thjeshtë ka shpënë deri në heqjen dorë prej bukurisë dhe muzikalitetit të frazës, si një element i domosdoshëm i krijuimtarisë letrare. Është e vërtetë që sot ka shkrimtarë në botë, të cilët nuk e vrasin mëndjen pér

hijeshinë e frazës, apo që i shmangen enkas kësaj, por letërsia mbetet kurdoherë arti i fjalës dhe muzikaliteti i gjuhës, pa zbulimet e tephruara anakronike, vetëm e shton vlerën e veprës dhe rrit forcën emociononjëse të saj.

Në pajtim me elementët dhe ambientin e përshkruar autorit nuk është kufizuar as në përdorimin e fjalëve banale. E gjejmë një gjë të tildhë edhe në romanin e tij të mëparshëm. Sigurisht s'kemi të bëjmë këtu me një problem të rëndësishëm dhe as që duam t'u hyjmë në pjesë moralizonjësve, po do t'ishte e dëshirueshme, që shkrimtari të mos e kishte mani përdorimin e fjalëve vullgare e banale. Biles, nga pikëpamja artistike, sa më rrallë të përdoren, aq më efekt bëjnë edhe ato, si gjithë fjalët e tjera.

Sidoqoftë, kryesorja është se Petro Markua na dha edhe një roman me vlerë. Ai na shtyn të dëshirojmë e të presim vepra të reja të rëndësishme të shkruara me frymëzim e mjeshteri.

(Botuar në gazetën «Drita»  
15 janar 1961)

## **LUFTA PER LIRI — E VETMJA BRUGE**

*(Shënime mbi romanin «Për Mëmëdhenë»  
të Thoma Kacorit)*

### **1**

Pas vëllimit «Jetë me brengë» dhe tregimit të gjatë «Ditë që s'harrohen», romani «PËR MËMËDHENË» është vepra e tretë në prozë e Thoma Kacorit, i cili, ndonse nisi të botojë vetëm para pesë-gjashtë vjetëve, tanë është bërë autor i njojur prej lexonjësve tanë. Në të tre librat e tij si sfond ka shërbyer jeta e fshatrave të Korçës e veçanërisht të Kolonjës në etapa të ndryshme të historisë sonë kombëtare. Ndërsa në dy librat e para shkrimtarin e kanë interesuar problemet shoqërore dhe pasqyrimi i vuajtjeve dhe brengave të fshatarit të varfër, në roman arështë tërhequr prej fazës së fundit të luftës për liri dhe indipendencë kombëtare në kohën kur vepronin çetat e lirisë — forca e armatosur e lëvizjes së zgjimit kombëtar.

Romani është pjesa e parë e një vepre më të gjerë, (ndofta e një trilllogjije) dhe shënon një nismë të mirë për letërsinë tonë, si përpjekje që të pasqyroj gjerësisht një etapë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare: fundin e robërisë pesëshekullore dhe fillimin e jetës së lirë, e cila nuk ishte e qetë dhe paqësore, po e mbushur me çqetësimë, me intrigë të huajsh, me përleshje kundër pushtonjësish dhe tradhëtarësh. Ajo ishte një kohë kur jetohet *me pushkë në dorë*, që të luftohej për jetën dhe për vëndin Në këtë kuptim, si pasqyrë e gjerë e ngjarjeve historike të asaj periudhe, romanit i Thoma Kacorit, megjithëse nuk ka në qëndër të vet ndonjë personalitet historik, është *roman historik*, dhe si i tillë do çmuar e shqyrtuar.

Në plan të përgjithëshëm autorit ka arritur të na japë, nëpërmjet ngjarjeve që shtjellon në vepër, gjithë kompleksitetin e situatës dhe karakterin kritik të saj për të ardhmen e Shqipërisë, sidomos të krahinës së Korçës. Ai ka përshkruar me vërtetësi dhe drejt gjëndjen e popullit, sidomos të fshatarësisë dhe luftën e komitëve, duke u lënë vënd, aty-këtu, edhe problemeve shoqërore. Ashtu si në realitet, në roman thuren ndërmjet tyre tre momentet e një kohëshme të luftës qëllimtare në pragun e independentencës: *lufta kundër pushtimit turk, të cilat po i vinte fundi, por që mbahej akoma më këmbë; lufta kundër propagandës së megalidhesë dhe intrigave e banditizmit të shovenistëve grekë, që synonin tu zinin vëndin pushtonjësve turq dhe, së fundi, lufta kundër feodalizmit jo aq në plan shoqëror, sa në plan patriotik.*

Si element organizonjës në roman shërben

fati i familjes së madhe të Resul Çelimarës, kështu që lexonjësi interesohet njëkohësisht edhe për 'uftën në tërësi, duke ndjekur betejat e komitëve, edhe peripecitë e pjestarëve të kësaj familje. Me anë të këtij kombinimi, shkrimtarë ka nën vizuar një të vërtetë të madhe të çdo kohe: *fatë i individit është i lidhur dhe varet prej fatit të vëndit* dhe se, rruga e çdo njeriu të ndershëm nuk mund të jetë kursesi e ndryshme, aq më pak e kundërt, nga rruga e popullit të tij. Ndërmjet figurës së Resul Çelimarës dhe historisë së shtëpisë së tij është treguar në roman edhe zgjimi i ndërgjegjes kombëtare të masave të gjera të fshatarësise sonë, e cila që një nga shtyllat Kryesore të luftës për liri.

Një anë tjetër e lëvizjes kombëtare, që ka tërhequr vëmëndjen e shkrimtarit dhe që është pasqyruar mirë në roman është kalimi prej simpatisë së pandërgjegjëshme ndaj komitëve, në pozitat e tyre luftarake. Gjatë tërë romanit figura e Resul Çelimarës vjen duke u rritur e duke u bërë gjithënjë e më e madhërishme. Lufta popullore, fatkeqësitë e njëpasnjëshme dhe brengat që shkaktojnë ato, shërbejnë bukur si një sfond epik-dramatik për të nxjerrë më në pah ndjenjat e thella atdhetare të këtij personaliteti popullor, forcën e karakterit të tij burrëror, ndjenjat e pastra dhe mëndjekthjelltësinë e tij.

Me pasqyrimin e luftës çlirimtare autor i romanit na ka dhënë disa tabllo me forcë epike, që të emocionojnë dhe të mbeten në mëndje. Ë tillë është, për shëmbull, beteja në kishën e Milecit. Megjithëse autor i nuk e ka motivuar dot plotësisht domosdonë e saj, sidoqoftë ajo

ëshë skenë prekëse dhe e madhërishme, në të cilën gërshetohen elementet e marrëdhënieve intime ndërmjet komitëve, dhëmbja për humbjen e shokëve, qëndrimi vërtet heroik e i palëkundur i tyre, dramaticiteti i episodit dhe shpirti patriotik. Në roman, kjo betejë është një prej pasazheve, ku shkëlqen dashuria e shkrimitarit për heronjt e tij dhe stima që ka për 'ta. Interesante janë edhe pëershkrime të tjera të jetës në luftë si, bie fjala, çasti pas betejës, në kapitullin e parë të pjesës së dytë, qëndrimi në roje i Taflit me Selmanin, (kapitulli i gjashtë; pjesa e dytë), aksioni i Qafës së Qarrit, (në kapitullin e dymbëdhjetë), plagosja e Resul Çelimarës, në kapitullin e katërmëdhjetë, etj. Në këto copa të veprës shkrimitari ka shkrirë më sukses elementet e përgjithëshme të temës, (luftha për liri), me elementët individuale, (fati i heronjeve). Lexonjësi interesohet më tepër për një personazh të pëershkuar mirë, ashtu siç interesohet në jetë më tepër për një të njojur.

Po disa herë, në një pjesë të mirë të romanit, autori nuk na e ka pasqyruar luftën (rië plan të përgjithëshëm) në mënyrë emocionale. Pëershkrimet e tij shpesh janë të thata dhe ngjajnë më një kroniqë historike. Në këtë dobësi të veprës janë reflektuar disa të meta themelore të vetë konceptimit të subjektit, të cilat ligështojnë forcën emociononjëse të tij

Siç e thamë, shkrimitari është nisur të pasqyrojë, nëpërmjet fatit të familjes së Resul Çelimarës dhe nëpërmjet luftës së çetave të lirisë, fatin e vëndit n'atë kohë. Duke patur si piksynim të reflektojë, jo vetëm episodë të kësaj lufte, po të

krijojë edhe një tabllo të përgjithëshme të saj, ai ka çfrytëzuar deri në tepri lidhjet e jashtme të subjektit dhe përshkrimin kronikal të ngjarjeve. Është e vërtetë që lidhjet e jashtëme kanë siguruar gjerësinë e pasqyrimit të luftës, po ato kanë dëmtuar depërtimin në thelli të fenomeneve jetësore dhe kanë cënuar vlerën emociononjëse të veprës. Si pasojë e këtij parashtrimi të subjektit shumë episode, — duke përfshirë këtu edhe episode interesante e të rëndësi-shme, — nuk kanë dalë si *domosdo* e shtjellimit të ngjarjeve dhe si përfundim i ndeshjes së të kundërtave, po si gjëra të rastit, që edhe mund të mos ndodhnin ashtu. Le të kujtojmë varjen e Nuçi Martinës dhe atentatin e Resul Çelimarës kundër *kajmekamit*. Megjithëse fakti në vetvete ka elemente tragjike, (vdekja e Nuçit Martinit), dhe elemente heroike, (atentati i Resul Çelimarës), ai nuk na lë mbresa emocionale, mbasi është diçka e rastit, (Resuli rastësisht uđodhet në Ersekë), është i papërgatitur dhe i shpejtë, (ai nuk dimë të ketë arritur deri në atë shkallë ndërgjegjeje), është kaluar lehtë, (se vendimi i Resultit është përshkruar fare përcipitas).

Dobësi të tilla vrehen sidomos në përshkrimin e aksioneve të çetës dhe të komitëve të vëçuar, gjë që vjen edhe prej mungesës së antagonistëve të caktuar, individualë, të cilët do të shërbenin si elemente për thurjen emociononjëse të subjektit. Veprimet e çetës, (me përjashtim të betejës së Qarit, që ka shkaqet dhe pasojet e veta, e të ndonji rasti tjetër nga fundi i romanit), janë dhënë me një gjuhë jo emociononjëse dhe me hollësira të tepërtë e të thata, në mëny-

rë kronologike. Romani ka shumë personazhe episodikë, të cilëve u përmëndet vetëm eméri dhe nuk i thonë asgjë lexonjësit, ashtu siç nuk i thotë gjë edhe kronika e ngjarjeve. E njëjtë gjë mund të thuhet edhe për personazhe të dorës së parë, si *Themistokli Gërmjenji*, ose për personazhe historike, si *Mihal Gramenua*. Këta njihen prej lexonjësit, po autor i veprës letrare nuk duhet të niset prej një pozite të tillë, po prej të kundërtës: jo t'ua paraqesi lexonjësve të panjohurën si të njojur, po të njojurën si të panjohur, ndryshe ai i heq vetes mundësinë e paraqitjes së thellë e të gjithanëshme të personalitetit të heronive dhe bie në kronikë.

Ja dy shembëlla:

«...pleqtë zunë të vdesin njëri pas tjetrit. Sefte vdiq xha *Thimi i Markollarëve*, që ankohej se mbeti pa *Xhëkon* e tij. Vdiq edhe plaka e xha Ndonit. Edhe plaka e xha Ndrios.

— More ç'është kështu sivjet, po na vdesin plakat dhe pleqtë! — ja bënин burrat.

Por më vonë ra një bark që vdiqën nja katër fëmijë.

— I shkoi sot *djali* të gjorës *Marigo!* — i thoshin njëra tjetrës gratë.

— Sonte vdiq edhe çupa e Ci'es!

— Është keq dhe po heq shpirt edhe *djali* i *Ristos!*...» (f. 255).

Ose:

«Fshatarët zunë t'i pyesnin:

— E, mo Dhimo, si është fshati?

— Në vënd është, s'ka luajtur! — u përgjigjej Dhimoja, që ishte shakaxhi i madh.

— Folë ti, *Josif*, se ky kështu e ka patur gjithënje.

— Si shkretirë është! — u përgjigjej Josifi.

— As mace, as kone nuk ka mbetur! — u tha Kosta. — Po askeri ka ikur!» (f. 256).

Të gjitha emrat që përmënden në dy copat e cituara nuk i thonë asgjë lexonjësit, veçse rëndojnë romanin dhe ulin vlerën emociononjëse të tij.

Një rast tjetër:

«...Kur erdhi *Fani Qafzezi* dhe u tha komitëve me tertip për asqerin e avxhi taborit, ay (Tafil Çelimara) e mblodhi veten dhe u nis përpara me komitët me pushkë në dorë dhe me zjarrin në gji për hakmarrje.

Në pëleshjen që u bë mbi Shënkollin e Vodicës, ay u tregua trim dhe për një qime nuk u vra nga askeri i turkut. Po kur u nisen komitët për te kaliv' e Nashos, Tafilit iu qepëni përsëri mendimet e para», (f. 193).

Këtij stili kronikal i shtohen edhe karakterizimet e përgjithëshme, që pengojnë përshkrimin realist të episodeve e të situatave.

«Në Vodicë i priten e i gostitën si kudo gjekët».

«Komitët i ndiqnin mësimet me zell të madh se ishin të etur për të nxënë».

Subjekti i romanit dhe thelbi i tij emociononjës, që çfaqet në fatin e familjes së Resul Çe imarës e në lidhjen e këtij me fatin e vëndit, përbanë në vete shumë elemente, të cilat autori nuk ka mundur t'i çfrytëzojë sa duhet mbasi është dhënë ca si tepër pas krijuimit të tabllosë së përgjithëshme. Ai është shtrirë tepër në gjërsi, duke rënë në deskriptivitet.

Sidoqoftë, në këtë kuptim, veprat e Thoma

Kacorit ka vlerë të madhe njohëse dhe shërben, jo vetëm për të transmetuar te lexonjësit rrëthanat e kohës, luftën dhe përpjekjet e popullit, po edhe si nismë e mbarë për prozën e gjatë me tema historike. Duke pasqyruar me vërtetësi realitetin e atyre vjetëve shkrimtari na ka dhënë një vepër që tingëllon aktuale edhe sot, po të kemi parasysh propagandën dhe pretendimet absurdë të shovinistëve grekë për krahinat tona të jugës.

## 2

Krahas pasqyrimit të përgjithshëm të luf-tës, familja e Çelimarëve zë vëndin kryesor në vepër. Ndërsa lufta e çetës së komitëve nuksështë e lidhur ngushtë e në mënyrë organike me fatin e kësaj familjeje, kjo eshtë e lidhur me luftën çlirimtare dhe fati i saj nuk mund të kuptohet i çkëputur prej luftës. Kjo do të thotë, që në përshkrimin e luftës autori na ka dhënë edhe shumë gjëra që nuk lidhen me Çelimarrët, kurse për Çelimarët ai gjithçka e ka dhënë, duke patur si sfond të përgjithshëm luftën. Bile, do guxoni të thoshim që, po t'i kishte qëndruar më besnik kësaj së dytës, autori do ta kishte shpëtuar veprën prej shumë të metave që ka dhe, para së gjithash, do kish patur mundësi të thehoj më tepër, duke paraqitur *njerëzit* në luftë dhe jo luftën në vetvete, siç ka bërë me Çelimarët.

Familja e Resul Çelimarës eshtë një familje e madhe patriarkale, në të cilën spikasin tipa si nëno Zadeja, Resul Çelimara, Tafil Çelimara

dhe gatuhen fate të ndryshme si ai i Vese'it, i Ikes dhe i Hodos.

Përshkrimi i rrethanave historike dhe i ngjarjeve e përligjin plotësisht egzistencën e kësaj familje, që tamam së është e madhe, arrin t'u bëjë ballë gjithë stuhive që i bien mbi kokë. Rregullat dhe zakonet patriarkale, që sundojnë në atë shtëpi, vihen në shërbim të mbajtjes më këmbë të saj dhe ndikojnë, jo vetëm për administrimin dhe mbarëvajtjen e ekonomisë *gjysëm natyrale*, po përcaktojnë edhe fatin e secilit prei pjestarve të familjes. N'atë kohë krijimi ose ruajtja e familjes së madhe me shumë kurorë që ende një ideal shoqëror dhe prishja ose cenimi i saj ishte i pamoral. Thoma Kacori në romanin e vet na e ka dhënë drejt këtë të vërtetë historike.

Nië gjë e tillë nuk ka rëndësi, vetëm se na jep të vërtetën historike për zhvillimin e shoqërisë shqiptare të asaj kohe, po edhe se është pikërisht morali dhe rregulli patriarchal që ndikojnë edhe në shtjellimin e linjës kryesore të subjektit.

Në këtë qëndrim të shkrimit tarit duhen dalluar gjithashtu dy anë: vërtetësia historike dhe pasojat artistike të saj. Për vërtetësinë historike fo'ëm më sipër dhe e quajtëm si vlerë të romanit. Po, duke e parë familjen patriarkale qoftë edhe si *ideal shoqëror*, a do të thotë të mos zbulohen disa kontradikta të brëndëshme, që janë në vetë natyrën e familjes patriarkale? Shkrimtar, si çdo gjë edhe familjen e ka paraqitur në plan patriotik dhe, mbase, mund të thotë ndokush: pse kërkohet prej tij diçka që ai s'ka dashur ta pasqyrojë në veprën e vet? Pse kërk-

hen analiza shoqërore në një vepër me frymë patriotike?

Së pari do thënë, që edhe fryma patriotike, sado e fortë dhe e dobishme që të jetë, nuk duhet të kthehet në një pengesë për pasqyrimin e gjithanshëm realist të jetës. Kjo është një pozitë e përgjithëshme. Përsa i takon vetë romanit të Thoma Kacorit, elementet patriotike dhe patriarkaliteti i familjes së Çelimarëve, në disa raste, kanë dëmtuar krijimin e tipave dhe thellimin e ndonjë momenti mjافت interesant.

Lind pyetja: pse familja e Çelimarëve u bashkua me luftën e çetave? Cilat ishin motivet që i dhanë zjarr zgjimit të ndërgjegjes së tyre atdhetare? Për Resul Çelimarën, — megjithëse të kaluara cekët, — këto motive janë: simpatia për komitët, që e shpëtuan prej hajdutëve dhe pasoja e kësaj simpatie: vrasja e kajmekanit, që aty për aty, kthehet prej pasojës në motiv lufte të mëtejshëme. Po të tjerët? Ata shkojnë si hallka të një zinxhiri pas Resulit dhe një gjë e tillë, mund të kuptohet si çfaqje konkrete e autoritetit të vëllait më të madh dhe si pasojë e veprimeve të tij. Mirëpo, as njera, as tjera nuk mund të shërbenin si themel për *veprime* të *ndërgjegjëshme* luftarake dhe, aq më pak, mund të shërbejnë si mjet për ndryshime të mëdha e të menjëherëshme, siç ndodhin te véllezërit Çelimara. Ky problem i rëndësishëm krijonjës nuk e ka çqetësuar autorin e romanit, i cili në rrëthanat e përshkruara, që të nxirrte në pah më së miri tiparet e përbashkëta dhe vëçoritë individuale të heronjeve, do t'ishte dashur ose të thellohej më tepër në forcën têrheqëse të zakonevë patriarkale që mund të kishin hedhur

rrënje të thella te vellezërit, ose, përkundrazi, të zbulonte kundërthëni e brëndëshme, që mund të lindin në të tilla raste. Në këtë pikpamje është interesante figura e Tafil Çelimarës, birit të Resulit, i cili, ndonse nuk është motivuar sa duhet në fillim, nis e na tërheq vëmëndjen me dashurinë për të bijën e Caco beut dhe me qëndrimin jo aq të ngurtë ndaj botës së ndjekjave. Ky është një element i ri që lind në familjen patriarchale dhe përfaqëson të ardhmen e zhvillimit shoqëror. Deri ku do të arrijë me këtë hero, është herët të thuhet që tanë.

Përveç Resul Çelimarës, për të ci'in folëm disa herë gjer tanë, nëno Zadeja është një prej figurave të skalitura me mjeshtëri prej autorit. Duke e përshkruar me dashuri dhe duke vënë në plan të parë karakterin e saj të fortë, autoritetin dhe zgjuarësinë e nuhatjen, shkrimitari ka zbuluar tek ajo edhe ashpërsinë e një zonje shtëpie me kyçe në brez dhe me hije të rëndë. Edhe vetë Resuli, kur është çështja për ndonjë punë me rëndësi, nuk bën dot pa pyetur plakën. Nga fundi i jetës së saj, kjo figurë impresiononjëse mer forcë dhe proporcione tragjike. Shpërndulja nga shtëpia, pas atentatit kundër kajmekamit, meraku për Resulin, për Hodon e për Tafilin, që janë bashkuar me çetën, djegia e shtëpisë dhe, më në fund, çdukja e Veselit, — djalit të saj të metë. — i bien mbi kokë si goditje të rënda e të njëpasnjëshme, që ajo nuk mund t'i durojë. Vdekja e saj është përshkruar me forcë dhe janë zbuluar disa anë të rëndësishme të shpirtit të një gruaje tipike shqiptare, e cila ka qënë në shtëpi edhe burrë, edhe grua.

Ana tragjike e luftës është dhënë edhe në-

përmjet të fatit të Veselit, të Ikes dhe të Hodos — tri figura që, në momentet kryesore, janë përshkruar me ngjyra të theksuara humaniste.

Shkaku i «rrëmbimit» të Veselit prej turqve i ngjan çibukut të Taras Bulbës. Ndërsa Tarasi sakrifikohet për çibukun e humbur, Veseli shkon për dhjamë qeni, që të marë papuçet e nëno Zadesë. Është e kotë të kërkojmë edhe për episode të tilla motive të thella shoqërore. Pse t'i kërkojmë njerëzit në letërsi, ndryshe nga ç'janë në jetë? Gjëra të tillë ndodhin, ndaj s'ka pse të mos çfrytëzohen rrallë e tek. Ashtu si nëno Zadesë, edhe neve na vjen keq për Veselin, pikërisht se nuk ishte njeri normal dhe ndodh kështu se shkrimtari nuk e ka karikaturizuar, po e ka paraqitur me dashuri e me njerëzi këtë figurë fakeqe. S'ka pse të tallemi me fatkeqësinë e njerëzve!

Edhe Hodua të tërheq vëmëndjen pas plagosjes. Ndryshe prej Resulit ai është dhënë në plan më njerëzor. Është luftëtar, po vuan prej plagëve, rënkon dhe, prej dhëmbjeve të forta, i mërzitet edhe jeta. Këtu nuk humbet elementi heroik dhe patriotik, po, përkundrazi, pasurohet me vërtetësi jete dhe me ndjenja njerëzore, ndaj është edhe më i besueshëm.

Në përgjithësi jeta e familjes: shpérndarja, vuajtjet, brengat dhe fatkeqësitet janë pasqyruar me vërtetësi — edhe pse nuk janë refektuar sa duhet në ftyrat e tre burrave luftëtarë, — prandaj sakrificat e saj na i japid më me forcë dhe më në mënyrë më bindëse heroizmin e popullit në luftë kundër pushtonjësve, se sa përshkrimi i veprimeve të çetës. Kjo ndodh se elementet emocionale dhe thurja dramatike e ngjarjeve u

kanë dhënë pjesëve të romanit, ku përshkruhen peripecitë e Çelimarëve, forcë më të madhe ndikimi te lexonisit, se sa përshkrimi deri diku descriptiv i ngjarjeve luftarake. Ato janë më njerëzore dhe kjo është një prej vlerave kryesore të veprës.

(Botuar në revistën «Nëndori»  
Nr. 5, 1962)

## **NJEREZ, JINI VIGJILENTÉ!**

(*Shënim për romanin «Kali i mbretit  
dhe kalorës të rinj» të Qamil Buxhelit*).

### **1**

«*Kali i mbretit dhe kalorës të rinj*» është ro-  
mani i parë i Qamil Buxhelit dhe i pari krijim  
i rëndësishëm i tij, që sheh dritën e botimit.

Tema e romanit është historikisht reale, e  
afërt për ne dhe e freskët në kujtesat tona. Ajo  
është një prej temave më të rëndësishme të je-  
tës sonë si popull dhe është aq e gjerë, e pasur  
dhe madhështore, sa që nuk do mjaftonin as  
përpjekjet e përbashkëta e të gjithë shkrimita-  
rëve tanë për ta eksploruar.

Veprat letrare, që i kushtohen revolucionit  
popullor ngjallin interes te lexonjësit e çdo ka-  
tegorie, sepse, një pjesë shohin në 'to luftën dhe  
përpjekjet e tyre, një pjesë zbulojnë më mirë e

më thellë kohën në të cilën kanë jetuar, kurse pjesa tjetër, të rinxjë, njihen me një epokë të lavdishme të popullit dhe provojnë emocionet që lindin prej pasqyrimit artistik të saj.

Lufta Nacional-Çlirimtare nuk është hera e parë që pasqyrohet në vepra të letërsisë sonë. Bile, vlen të shënojmë që edhe romanet e para («Çlirimtarët» të Dh. S. Shuteriqit dhe «Përmbyssja» e F. Gjatës), këtë temë trajtuan. Megjithatë për luftën revolucionare mbetet shumë e shumë për të shkruar, pa lindur rreziku i përsëritjes, nëqoftëse autorë të ndryshëm do trajtojnë anë të ndryshme të kësaj lufte, duke e vështruar atë në aspekte dhe nga pozicione të ndryshme, nga piksynime të ndryshme artistike. Një nga vlerat e romanit të Qamil Buxhelit është pikërisht zbulimi i disa anëve të reja të luftës Nacional-Çlirimtare dhe trajtimi i kësaj teme në plan e në mënyrë tjetër, në krahasim me autorët e mëparëshëm. Shkrimtarin, për shëmbull, nuk e ka interesuar qëndrimi i shtresave shoqërore, të vëndit ndaj luftës, siç ndodh në romanin e Dh. S. Shuteriqit; nuk e ka tërhequr parashtrimi i thjeshtë i aksioneve luftarake, si në romanin e Fatmir Gjatës; ai nuk është marë me luftën ilegale të rinisë, siç ka bërë Ali Abdihoxha në romanin «Vjeshtë me stuhi». Qamil Buxhelin e ka tërhequr më tepër përpjekja e armiqëve për të depërtuar në radhët tona dhe lufta kundër këtyre armiqëve të kamufluar në terrenin e luftës kundër armiqve të hapët për çlirimin e vëndit dhe për fillimin e transformimit socialist të tij. Kjo është në krahasim me veprat e tjera, ana e re e subjektit të romanit. «*Kali i mbretit dhe kalorës të rinxjës*». Në shtjelli-

min e këtij subjekti, ne vëmë re edhe prirjen e autorit që të na japë sa më shumë hollësi realiste nga koha e luftës, nëpërmjet episodesh të ndryshme, që duken të parëndësishme për tërësinë e veprës, po që krijojnë bukur atmosferën e atyre vjetëve. Hollësi të tillë gjejmë edhe në pasqyrimin e jetës së vendit fill pas çlirimt.

Ana e dytë e rëndësishme e subjektit të veprës së Qamil Buxhelit është momenti historik që ai ka zgjedhur si sfond për ngjarjet e romanit. Kalimi prej luftës Nacional-Çlirimtare në periudhën e ndërtimit të shtetit të ri demokratik popullor është një moment që të jep mundësi të mëdha për të bërë përgjithësime artistike, duke paraqitur heronjtë e veprës në dy situata aq të ndryshme prej njera-tjetrës. Gjithashtu ky moment vë pranë njeri-tjetrit *idealin*, *jetësimin e këtij ideali* dhe lindjen e *idealeve të reja* prej realitetit të ri. Nuk dua të them që në romanin e Qamil Buxhelit kjo realizohet plotësisht dhe pa dobësi, po dua të vë në pah meritën e autorit për zgjedhjen e këtij momenti dhe për orvatjen e tij serioze që të pasqyrojë në roman këtë dialektikë të jetës, e cila duhej të kish qënë më tepër burim edhe për ndryshime në psikologjinë, botkuptimin dhe karakterin e heronjve.

Tjetër vlerë interesante e subjektit të romanit «*Kali i mbretit dhe kalorës të rinj*» është edhe *gërshtimi i pasqyrimit realist me aventuren*, (le ta marim këtë fjalë në kuptimin e saktë të saj dhe jo në kuptimin e keq që ka fituar ajo prej përdorimit të përditëshëm.) Kjo vëçori e veprës së Qamil Buxhelit, nuk më duket të jetë e metë, apo dobësi, po më ngjan të

jetë më tepër meritë, ose, më mirë të themi, shprehje e pashmangëshme e vetë karakterit të subjektit, i cili, siç thamë, krahas pasqyrimit të luftës çlirimtare dhe të përpjekjeve për ngritjen e shtetit të ri, pasqyron edhe veprimtarinë e armiqve në radhët tona dhe luftën kundër këtyre armiqve të kamufluar. A nuk janë elementet *adventureske*, (prap në kuptimin e saktë të fjalës), veçori objektive të spiunazhit e të veprimtarisë diversioniste? A mund të meret me mënd një veprimtari e kësaj natyre, pa elemente adventureske, që rrjedhin prej karakterit të fshehtë, prej kombinimit dhe ndrimtit të varianteve të ndryshme, prej veçantive që kanë lidhjet ndërmjet njerëzve në punë të tilla dhe prej frikës mos zbulohen? Pra, gjersa në jetë e kemi një element të tillë objektiv, pse të mos njohim të drejtat e qënies së tij edhe në letërsi?

Në romanin e Qamil Buxhelit, duke u nisur prej vetë përpjekjes së shkrimtarit që të gërshtetojë pasqyrimin realist të jetës me aventurën, çështja shtrohet ndryshe: deri në ç' shkallë ka arritur autori t'i shkrijë këto dy elemente të veprës së vet? Një bazë të tillë kanë vrejtjet që mund të bëjmë.

Para së gjithash vlen të shënojmë se, me gjithëqë në mënyrë ca të lehtë e të sipërfaqëshme, realiteti i luftës dhe i fillimit të jetës së lirë është dhënë me vërtetësi, duke zbuuar para lexonjësve vështirësitë, sakrificat dhe pengesat e shumta me të cilat përpiken në çdo hap të jetës së tyre heronjtë e romanit. Shkrimtari ka vepruar drejtë, sa herë që, nëpërmjet personazhesh të ndryshëm dhe me anë të qëndrimeve të tyre, ka synuar të pasqyrojë këto vështirësi, penge-

sa e sakrifica. (Personazhe të tillë si *Mërkuri*, *Vitoria*, *Maria*, *drejtoresha e shtëpisë* së fëmijëve dhe, deri në një farë mase, edhe *Latifi*, janë mishërim i çfaqjeve të botës së vjetër dhe përfaqësonjës të luftës aktive ose të heshtur kundër botës së re, njerëzve të saj, moralit dhe idealeve të saj). Gjithashtu ka vepruar drejt shkrimtari edhe kur është përpjekur të na japë sa më tepër hollësi prej asaj kohe, duke krijuar kështu një atmosferë bindëse dhe të vërtetë. Po, mungesa e analizave shoqërore, ose, më sakt, pamjaftueshmëria e këtyre analizave, rendja pas ngjarjeve dhe kujdesi i pamjaftueshëm për të dhënë me thellësi momentin dhe procesin e transformimit shpirtëror të heronjve e kanë dëmtuar vlerën realiste të romanit, ashtu siç e ka cënuar atë edhe dhënia e ambienteve pak të papërcaktuar, pa individualitet.

Edhe në figurën e Mërkurit, peripecitë e të cilët i japid romanit elementet aventureske, autori është përpjekur të jetë realist. Le të kujtojmë arrestimin, torturat, kthesën dhe motivet e kësaj kthese, iluzionin e tij, se mund të shpëtonte prej kthetrave të spinazhit, kalimin e tij përfundimisht në pozitat e armiqëve, pas vrasjes së të jatit etj. Të gjitha këto tregojnë se autori nuk ka mbetur brënda kufijve të ngushëtë të aventurës, po e ka treguar heroin edhe në plan psikologjik dhe *shoqëror*, prandaj figura e Mërkurit ka elemente dhe ngjyra realiste. Sido mos momenti i lëkundjeve të tija në burg, pas propozimit të prefektit për tradhëti, arësyetimet dhe mendimi i gabuar, se po të shpëtonte prej burgut, mund të shpëtonte edhe prej detyrimeve ndaj Gestapos, janë dhënë me vërtetësi, e në

mënyrë bindëse. Disa çaste të mëvonëshme në figurën e Mërkurit, (motivet, që ai nuk denon-cohet para shokëve, kalimi përfundimisht në anën e armiqëve, arrestimi dhe «aratisja» e dytë nga burgu, shumica e veprimeve të tij pas clirimt), janë dhënë në plan thjesht adventuresk dhe më të shumtën e herës nuk janë mbështetur në themele të shëndosha e bindëse. Që të spjego-hemi: ato janë të mundëshme, pra, artistikisht të vërteta, po ndihet nevoja e thellimit në 'to. Për shëmbull, vrasja e babait prej partizanëve, që shënon kthesën përfundimtare, është një çast tepër i rëndësishëm, që vetëm sa është regjistruar në roman.

Ndërsa elementët rea'istë kanë depërtuar në linjën adventureske të romanit, elementet adventureske nuk kanë depërtuar në linjën realiste, sidomos në dy pjesët e para të veprës. Kjo nuk është një dobësi thjeshtë formale, po është e lidhur drejtpërdrejtë me brendinë. Në dy pjesët e para autorit i ka shpëtuar nga dora një gërshtim më interesant i subjektit. Ndërsa Mërkurin e ka paraqitur me gjerësi, duke na e dhënë edhe si armik, po edhe si njeri, që objektivisht, është i detyruar të punojë për ne, duke luftuar kundër armiqve tanë, (ndryshe s'kish si të bënte), partizanët, sidomos Besniku, janë paraqitur vetëm në një plan: në luftën me armë. Besniku krijon disa dyshime, po nuk vete më tej se kaq. Po kështu partizanët, ndryshe prej Mërkurit, janë paraqitur të çkëputur prej luftës ilegale në qytet, prandaj nuk studjojnë me hollësi ngjarjet e atjeshme, arrestimin e shokëve ilegalë në kohën e mungesës së Mërkurit, etj. Në plan të përgjithshëm lufta është pasqyruar

me gjerësi, kurse po ta shohim lidhur me subjektin e veprës, ajo sikur është kufizuar dhe ngushtuar ca. Kjo e metë korigojhet në dy pjesët e fundit të romanit, kur vëmëndjen e shkrimitarit, krahas pasqyrimit të jetës, të fatit të heronjve, të veprimtarisë armiqësore, etj. e tërheq edhe veprimtaria e organeve të sigurimit. Veçse, pjesa e fundit, sidomos përpjekja e Mërkurit që të arratiset dhe arrestimi i tij, sikur është marë shumë pranë objektivit dhe momentet kanë dali të tepër të mëdha, në krahasim me momentet ekuivalente të pjesëve të tjera. Në këtë rast autori është marë thjeshtësisht me linjën e ngushëtë adventureske dhe e ka lënë mënjanë karakterin e gjerë të romanit.

Një element tjetër që të bie në sy te romani i Qamil Buxhelit është humor. Autori, që edhe në disa tregime të shkurtëra e fejtone, ka provuar se ka prirje si humorist, e ka përdorur me efekt të qeshurën, shakanë dhe talljen në shumë raste. Po të përjashtonim ndonjë episod tepër grotesk, humor i ka dhënë gjallëri romanit, e ka bërë tërheqës, të këndëshëm e të lehtë në të lexuar. Në këtë rast vlen të flasim për humorin, si mjet për dhënien e atmosferës së kohës, dhe si element i gjëndjes së mirë shpirtërore, i zbulimit të të metave në njerëzit e rinj. Kështu, për shëmbull, në paraqitjen e partizanëve të rinj para Besnikut dhe në sjelljet e tyre ka diçka qesharake, si dhe në qëndrimin e Besnikut ndaj tyre. Po kështu mund të zëmë në gojë figurën e xha Shemetit, kryetarin e Komitetit Ekzekutiv, që flë mbi tryezën e punës; ngjarjen e Linditës me karrocierin, grindjen e fëmijëve me shoferin, spikerin e Radio Tiranës,

që në vënd të Shopenit vë një valle popullore, etj.

Humori në roman sikur pajtohet edhe me stilin përgjithësish të lehtë dhe jo analistik të shkrimtarit, i cili gjithçka mundohet ta japë me anë po himesh të thjeshta, pa hyrë në analiza të hollësishme dhe në arësyetime të gjata. Kjo është një veçori stili, një mënyrë të shkruari, po disa herë ajo bëhet mbartëse e caktësisë dhe e kalimit të shpejtë ose të panënvizuar të situatave dhe të momenteve nganjëherë edhe të rëndësishme. Pa hequr dorë edhe prej këtij stili, Qamil Buxheli mund të kujdeset për gjetjen e hollësive ekspressive, të afta për të dhënë gjëndje të ndryshme shpirtërore, ose për të karakterizuar momente, pa qënë nevoja që të hyjë në analiza e në arësyetime.

Romani «Kali i mbretit dhe kalorësit të rinj», veç të tjerave, dëshmon që autori i tij është mjeshtër në thurjen e linjave dhe interlinjave dhe në kombinimin e situatave, në gëreshetimin e rrugëve, që ndjekin heronjtë dhe në pasqyrimin e kontradiktave, qofshin këto kontradikta themelore, qofshin edhe kundërshtime të dorës së dytë. Në roman, krahas luftës në terrenet e ndryshme dhe intrigës kryesore, që përshkon romanin, të tërheq vëmëndjen edhe thurga e intrigës së dytë, që përfaqësohet prej raporteve që kanë me Linditën tre heronjtë kryesorë të romanit: Besniku, Agimi dhe Mërkuri. Kjo intrigë është thurrur në mënyrë interesante dhe llogjike, por nuk ka freskinë jetësore ndaj duket edhe e trilluar. Kjo vjen para së gjithash, ngaqë qëndrimi i Besnikut dhe Agimit, pasi zbulohet mosmarëveshja, kur e shohin se kanë da-

shur të njëjtën vajzë, është kaluar shpejt e në mënyrë të përciptë. Edhe qëndrimi i Linditës, e cila më parë e ka dashur Agimin, nuk është motivuar sa duhet. Autori i romanit në këtë rast do kish qënë mirë t'i jepte më tepër rëndësi zbulimit të botës së brëndëshme të heronjve. Edhe përdhunimi i Linditës prej Mërkurit nuk është fort bindës, ndonse i ngjashëm. Autori, siç duket, ka dashur ta nxijë ca më tepër portretin e Mërkurit dhe të lehtësojë Linditën, duke e dehur, po rruga e nisur prej tij më parë: heqia dorë nga ajo edhe e Agimit edhe e Besnikut do kishin shpënë në atë përfundim në mënyrë të natyrëshme; aq më tepër se Lindita nuk kish ndonjë mendim të keq për Mërkurin. Edhe përdhunimi do qe paraqitur më realisht, po të mos ish kryer duke qënë Lindita pa vetëdije.

Qëndrimi ideal i Agimit dhe i Besnikut në këtë rast, po të kemi parasysh temperamentin tonë mesdhetar, nivelin e zhvillimit të tyre e shoqërisë sonë dhe, sidomos karakterin e Besnikut, zorr të meret si i vërtetë, ndonse i drejtë. Ky qëndrim më tepër se pasqyrë e kohës që përshkruhet në roman, është një ideal i autorit, një vëgim i së ardhmes.

## 2

Në roman veprojnë katër heronj kryesorë: Besniku, Agimi, Lindita, Mërkuri dhe mjafth personazhe episodikë, ndër të cilët dallohen xha Shameti, doktor Hamiti dhe doktor Gjerasi, shefi gestapos, Mërjemja, Latifi dhe ndonjë tjeter.

Qamil Buxheli personazhet i përcakton në-përmjet situatave dhe rrethanave në të cilat ata veprojnë. Vetëm më të rrallë ai kërkon ndihmën e karakterizimeve të përgjithëshme dhe qëndrimit të autorit. Edhe kjo është një veçori e stilit të tij dhe ka të bëjë me natyrën e përgjithëshme të veprës, si roman situash.

Një karakteristikë e paraqitjes së persona-zheve prej këtij autori është, se ai, pothuajse se çdo personazh të rëndësishëm të veprës, e ka në funksjon të një ideje dhe e përdor si mjet artistik pér pasqyrimin e një skaji të caktuar të jetës njerëzore dhe të atij realiteti, që ka zgjedhur pér veprën e vet. Heronjtë e tij nuk ndryshojnë aq prej temperamentit apo prej karakterit të tyre, — megjithëse ndryshime të tillë kanë, — sa ndryshojnë prej fatit dhe rrugës që përshkojnë në jetë e që, në një masë të kondiserue-shme, nuk varet prej veçorive individuale të se-cilit. Kështu ndodh, pér shëmbull, me fatin e Besnikut, të Agimit, të Merjemes, të Linditës, dhe deri diku, edhe të Mërkurit. Ana pozitive e këtij qëndrimi ndaj heronjeve është, se autori nxjerr në plan të parë ndikimin e jetës tek një-rëzit dhe ndikimin e kushteve konkrete në sjelljet dhe në veprimet e tyre. Pra, shkrimtari qëndron deri këtu në pozita realiste. Ana negatiive e këtij qëndrimi është reflektuar, siç e kemi shënuar edhe më parë, në kujdesin e paktë që ka treguar autori pér zërthimin e botës së brëndëshme të heronjeve me mënyrën e vet të të shkruarit dhe në dobësinë që vrehet në përcak-timin psikologjik e shoqëror të tipave. Nuk duam të themi se romani nuk ka tipa, po që karakteristikat e këtyre tipave nuk janë gdnëndur

qartë dhe, sidomos heronjtë kryesorë, duke qënë rezultat të përgjithësimit, nuk janë sa duhet edhe çfaqje konkrete të këtij përgjithësimi. Ndër personazhet episodikë kjo e metë nuk është aq e theksuar, bile, as mund të flasim për 'të në disa raste.

Le të krahasojmë *Besnikun* me *Agimin*. Ata janë dy tipa të ndryshëm. Besniku është kokëfortë, anarhist, i vrellshëm, trim i marrë, kurse Agimi është i qetë, i rregullt, i matur e me kulturë. Sikur autori t'i kishte qëndruar besnik deri në fund Besnikut, këta dy tipa, edhe nëpërmjet marëdhënieve me njëri-tjetrin, do ishin skalitur shumë më mirë, do bëhej e pashmangëshme ndeshja ndërmjet tyre dhe nuk do kishin humbur aq shpejt ndryshimet e kundërshtimet e tyre. Megjithëkëtë Besniku është më i vërtetë dhe më i goditur si tip, kurse Agimi, më tepër se njeri i gjallë, ngjan si mishërim i mirësisë, i urtësisë dhe i drejtësisë.

Edhe *Mërkuri* të tërheq vëmëndjen si tip letrar deri pas «arratisjes» së parë prej burgut, ndërsa më vonë, me përjashtim të marëdhënive me Viktorinë, përpjekjes që të shtjerë në dorë Linditën, përdhunimit të saj dhe intrigës pëpunë dashurie, gjithë veprimet e tjera i kryen i shtyrë prej detyrate e prej rrethanave. Kjo, siç thamë, përmban në vetvete edhe diçka pozitive dhe, në rastin e Mërkurit, nënviron të vërtetën që, po i lëshove pë armikut dhe po nuk arrite ta marësh veten me burräri, do të shkosh gjithënjë e më thellë në llumin e tradhëtisë. Ky është mësimi kryesor që del prej romanit dhe, sidomos, prej fatit të Mërkurit. Autori nuk i ka

çfrytëzuar sa duhet e si duhet disa veçori të Mërkurit: etjen për lavdi, të dhënët pas femrave, prejardhjen shoqërore. Ato vinë njëra mbas tjetrës fill pas kapitullimit të tij dhe ndaj të lënë me përshtypjen se shkrimtari ka dashur me qëllim t'i nxijë fytyrën këtij personazhi. Prezantimi i tij si tip duhej të kish qënë më i plotë që më parë, që të delte më i besueshëm. Megjithëkëto edhe pas kapitullimit, Mërkuri na tërheq me disa tipare: me dashurinë e singertë për Linditën, (në shërbim të së cilës përdor dredhítë më të liga), dhe dëshira që të shpëtojë prej kthetrave të spiunazhit, jo se është penduar, po se është mërzitur dhe kujton që me paret e grumbulluar, mund të jetojë i qetë diku jashtë shtetit.

*Lindita* gjithashtu zë vënd të rëndësishëm në roman dhe është qëndra e intrigës, që thurret ndërmjet tre heronjve kryesorë. Si të thuash, krahas veprimtarisë së Mërkurit, ajo është një prej shtyllave bazë, që mbajnë më këmbë ndërtesën e romanit dhe kureshtjen e lexonjësve. Edhe *Lindita* konceptohet si tip më tepër nëpërmjet fatit të vet, se sa nëpërmjet të dhënavë shoqërore-psikologjike. Disa raste me rëndësi për karakterizimin dhe për zbulimin e botës së brëndëshme të saj autori i ka kaluar lehtë dhe pa lënë gjurmë. Të tilla janë: tentativa e Mërkurit për ta shtënë në dorë, takimi me Agimin, të fejuarin dhe të dashurin e saj, pasi ajo është dashruar me Besnikun, momenti pas prishjes së marëdhënieve edhe me Besnikun edhe me Agimin dhe, më së fundi, vendimi që të martohej me Mërkurin. Llogjikisht të gjitha këto janë të përligjura, po kjo është e pamjaftueshme. *Lindita*, si vajzë dhe si partizane, mund të ka-

rakterizohej më mirë: të zbuloheshin te ajo edhe rrënjet e së vjetrës, edhe filizat e së resë, të cilat përcaktojnë qëndrimin e saj.

Prej personazheve të dorës së dytë më interesanti është *xha Shameti*, nëpërmjet të cilit shkrimtari na ka dhënë psikologjinë, *bon sensin*, mentalitetin dhe humorin karakteristik të popullit. *Xha Shameti*, — edhe pse ka disa anë qesharake, — është i afërt, i kuptueshmëm dhe i dashur për lexonjësit. Ai të kujton të kalluarën, të mirat dhe të këqiat e saj, po njëko-hësisht është edhe shprehës e përfaqësonjës i së resë, me të cilën e lidhin atdherashuria, shpirti luftarak dhe etja për liri. Shkrimtari *xha Shametin* na e ka paraqitur në plan thjeshtësisht njerëzor dhe realist.

Në roman të tërheq vëmëndjen edhe fati i dy mjekëve: *Hamitit* dhe *Gjerasit*. Ndërsa doktor Hamiti shkrihet e shuhet në punë, duke luttuar kundër vdekjes në radhët partizane, doktor Gjerasi është humanist, po nuk ka dëshirë të pérzihet në politikë. Me naivitet ai bie në kurthin e përgatitur prej Gestapos dhe del si fajtor për vdekjen e kolegut të vet. Nëpërmjet *Gjerasit* shkrimtari ka arritur të krijojë momente prekëse dhe interesante, duke pëershruar përpjekjet djallëzore të fashistëve, dyshimet që lindën te njerëzit tanë për *Gjerasin* dhe qëndrimin e drejtë që mbahet në shqyrtimin e çështjes së tij pas çlirimit. Ky qëndrim bëhet burimi i punës së palodhur dhe i përtëritjes morale të *Gjerasit*, i cili sheh me syt e vet, që po lind një rend i ri shoqëror, ku njeriu dhe dinjiteti i tij nuk meren më nëpër këmbë dhe ku puna e mundi kthehen në burim kënaqësie e gjëzimi.

*Historia e Merjemes*, që gërshtohet me intrigën kryesore të romanit nëpërmjet Mërkurit, është një copë tjetër e mozaikut që ka krijuar shkrimtarisë në vepër. Ajo është historia e një gruaje të vuajtur e të thjeshtë, që u qëndron besnikë idealeve të larta të të birit dhe që lufton me të gjitha mundësitë e mënyrat për të ndihmuar realizimin e këtyre idealeve. Fati dhe udha e saj në jetë, janë fati dhe rruga e qindra nënave tona gjatë luftës Nacional Çlirimtare dhe tiparet morale të saj janë rezultat i përgjithësisë mit artistik të shumë figurave të tilla. Merjemen, sikurse xha Shamenin, lexonjësi e do dhe e simpatizon gjatë tërë romanit, po ajo rritet para nesh si figurë e madhe, sidomos në çastin kur takohet me zonjën e saj të dikurëshme. Ndonse vëndi është çliruar, zonja është ende zonjë, kurse Merjemenja, jo vetëm që është e veshur keq, po është pushuar edhe nga puna si e paaftë. Zonja akoma e mban hundën përpjetë dhe e thërrret prap Merjemen si shërbëtore, se nuk është e zonja të shohë ç'ndryshime ka sjellë revolucioni në shpirtin e njerëzve, ndaj vren vetëm leckat. Kurse Merjemenja, — edhe pas fatkeqësisë në punë, — e ndien veten krenare dhe e kuption, siq mund ta kuptojë një grua pa shkollë, se jeta ka marë tjetër udhë e se zonja, bashkë me klasën e vet, po shkon tatëpjetë. Revolucioni e ngriti shumë lart ndjenjën e dinjitetit personal të njerëzve të thjeshtë. Tani bashkë me urrejtjen ndaj klasëve të pasura drejtohet edhe përbuzja. Ka ardhë koha, kur siç thoshte Majakovski «*mbi borgjezinë ne shikojmë nga lart*».

Figura e Merjemes do kishte qënë më harmonike dhe shumë më e vërtetë, sikur autori të

mos e kishte ngarkuar aq tepër në kapitujt që flasin për jetën dhe veprimtarinë e saj në kampin e përqëndrimit, ku lidhjet e Merjemes me partizanët dhe, sidomos, kthimi i saj në kamp, pasi çlirohet prej partizanëve, janë ca si të pabesueshme dhe, në vënd të një gruaje të thjeshtë, me të cilën jemi njojur gjatë shtjellimit të ngjarjeve, na del përpara një fytyrë tjetër, e cila kthehet prap tek e para pas ardhjes në Tiranë.

*Latifi* hedh dritë në një skaj tjetër të realitetit të asaj kohe. Ai personifikon njerëzit e gënjer, të cilët reaksiuni i tërroqi në arrati, që t'i kthente pastaj si diversantë e si terroristë. Si i tillë vjen Latifi në Shqipëri, në ditët kur do kryhej reforma agrare dhe kur i biri i tij mje-kohet falas prej ekipit shëndetësor. Ky, — momenti shoqëror-ekonomik, — është motivi kryesor, që shënon kthesën dhe ç'gënjinin e tij. Një motiv tjetër është edhe qëndrimi i familjes ndaj pushtetit të ri dhe fryma entusiaste që sundon ndër të afërmit. Ç'duhej bërë? Latifi kthehet përsëri në jetë, duke shkeltuar tradhëtinë e frikën me burrëri.

Interesant është edhe majori i Gestapos. Në romanin e Qamil Buxhelit, ndryshe nga rastet e tjera të prozës sonë, majori nazist nuk është xhelat-xhahil, po njeri i zgjuar, i dhënë për të krijuar kombinime dhe për të ngritur kurthe. Ai «sillet mirë» me njerëzit dhe u lë përshtypje të mira, duke i komprometuar, si doktor Gjerasin, duke i shtënë në dorë, si Mërkurin ose duke i dërguar drejt vdekjes. I ngjashëm me 'të është edhe prefekti, i cili është më largpamës dhe hedh një dorë në revani, një në bakllava, duke

u shërbyer njëkohësisht edhe gjermanëve, edhe anglezëve. Po «dargpamja» e tij nuk i qëndroi dot kohës, se fatin e Shqipërisë e vendosi revo ucion i popullor dhe jo kombinimet e diplomatëve e të spiu nëve.

Sic shihet prej kësaj analize të shkurtër, romani i Qamil Buxhelit pasqyron shumë aspekte të ndryshme të jetës, (lufta për liri, lufta e armiqëve, lufta kundër armiqëve të fshehur, dashuria dhe ndjenjat e miqësisë, urejtja dhe neveria, vuajtjet dhe gëzimet, dhëmbjet, fitoret, disfatat), po tingulli i saj përfundimtar duket se mund të përmblidhet në fjalët: *Njerëz, jini vijgjilentë!*

(*Botuar në revistën «Nëndori» Nr. 5 1962*)

## **ÇOBO RRAPUSHI**

(*Shënim kritik*)

Nuk më ka takuar të këndojo vepër letrare, në të cilën të përshkruhet me aq vërtetësi dhe aq bukur karakteri i labit, sa në tregimin «Isha unë Çobo Rrapushi» të shkrimitarit Shevqet Musaraj. Është një tregim, që këndohet me një frymë dhe që të mban në një gjëndje shpirtërore të lehtë e të gëzuar me thjeshtësinë, kthjellësinë dhe humorin e hollë e, gati-gati, të padukshëm në disa vënde.

Është vepër e shkurtër, apo «e vogël», siç është bërë zakon të quhet gjinia e tregimeve, po në krijimtarinë artistike të autorit zë vëndin e dytë pas poemës «Epopeja e Ballit Kombëtar» dhe në letërsinë tonë të sotme zë, pa dyshim, vënd krahas veprave «të mëdha».

Ky tregim ka gjithçka që mund të kërkohet prej një vepre letrare në kohën tonë dhe përgjithësisht nga një vepër artistike. Vërtetësia e

paraqitjes së heroit e të situatave nëpër të cilat ai kalon, stili çuditërisht i thjeshtë, elokuent, i tejdukshëm dhe elegant, sensi i masës në përshkrime, harmonia e tërësisë kompozicionale, idetë themelore të veprës, që nuk bërtasin, që dalin vetiut, humor, që nuk ta shuan buzëqeshjen gjatë leximit, po që nuk të shtyn kurrë të qeshësh me të madhe, gjuha e pasur dhe krejt individuale e heroit, — një gjuhë me ngjyra të theksuara lokale, po prej të gjithëve e kuptueshme, — disa momente të goditura lirike, — ja si mund ta karakterizonim në vija të përgjithëshme këtë vepër të re të Shevqet Musarajt.

Po, mbi të gjitha, sidomos atyre që e njohin Labërinë, u lë mbresë figura e Çobo Rrapushit, i cili besoj se do ketë fatin e lumtur të përmëndet kurdoherë si një nga tipat më të realizuar të prozës sonë, — të gjithë prozës sonë, — dhe si një nga heronjtë e përshkruar vërtet me dashuri të sinqertë e me t'ón kritik prej shkrimtarit.

Kush është Çobo Rapushi?

Që të kuptojmë Çobo Rrapushin dhe të njo him vlerën e këtij tipi letrar, na duket me arësye të themi dy fjalë për vëndin e tij — për Labërinë. E kanë quajtur Labërinë «shkëmb i thâtë», vënd ku «ha pula stra'lë», vënd «shkëmb e gurë»... Dhe, ashtu është. Kushdo që dëgjon për natyrën e Labërisë i parafytyron lebërit si malësorë e mer me mënd se kryesisht ata i janë dhënë blektorisë e... dojenë patjetër njerëz të pushkës. Pushka nuk ka heshtur kurrë në ato anë, ashtu siç nuk është shuar kurrë dashuria për liri, ashtu siç nuk kanë shteruar asnjëherë meloditë e mallëngjyera të fyellit dhe këngët e vallet po-

pullore me karakter tē theksuar burëror, pakëtë ashpër, si gérxhet e Kurveleshit. Për trima — lebërit tē marin gjak nē vetull dhe pér luftë janë tē parët. Marëdhëniet shoqërore që kanë sunduar aty para çlirimt, nē kohën kur u formua Çobo Rrapushi, kishin karakter tē theksuar patriarkal, megjithëse tē një natyre më tē zbutur, se nē malësitë e Shqipërisë së Veriut. Dashuria pér liri ka hedhur rrënje tē thella nē shpirtin e tyre, jo vetëm nē kuptimin e lirisë kombëtare, po edhe nē kuptimin e lirisë së personalitetit, tē pavarësisë së personit.

Historia i ka theksuar më tepër këto vëgorët tē lebërve. Luftat e vazhdueshme kundër turqve, kundër italianëve, kundër grekëve, kundër fashizmit italian e gjerman, kanë transmetuar nga një brez nē tjetrin stafetën e burrësisë, tē guximit e tē trimërisë. Zhvillimi i ngadaltë shoqëror ka shkaktuar, nga ana tjetër, tē rrënjosen më thellë zakonet patriarkale, mentaliteti i njerëzve tē pushkës dhe mënyra e jetesës si fshatarë tē lirë, tē lidhur me ekonominë e vogël gati natyrale e primitive dhe tē ketë çfaqje negative si krenaria e tepruar dhe sedra e sëmurë.

Lufta Nacional-Çlirimtare dhe transformimi socialist i vëndit sollën ndryshime tē mëdha edhe nē Labëri. U përbysën raportet e vjetra, u krijuan raporte tē reja shoqërore, ndodhën ndryshime nē jetën e fshatit, u krijuan kooperativat e para bujqësore. Si pasojë e drejtërdrejtë e këtyre transformimeve ekonomiko-shoqërore do ndronte patjetër edhe mentaliteti e psikologjia e njerëzve, pra, edhe e labit, edhe e Çobo Rrapushit.

Këtu e ka kërkuar temën e tregimit Shevqet

Musaraj. Transformimet revolucionare socialiste dhe njeriu! A nuk do ishte, me pak fjalë, kjo tema e veprës?

Çobo Rrapushi nuk është indiferent ndaj transformimeve socialiste. Përkundrazi, ai ka luftuar (domosdo jo krejt i vetëdijshëm për triumfin e socializmit) dhe ka luftuar si burrat me armë në dorë, me trimëri. Ja ç'thotë ai për vreten:

«...Gjer aty përpara se të fillonte lufta, unë isha shumë i përpjekur në punë bujqësije dhe shokët më qanin hallin që gjithë ai mundim e gjithë ajo punë e ime i bëheshin dhjam, here Sefedin Agajt në fshat, herë pashallarëve të Llakatundit...

Edhe në luftë e bëra beli që isha lab. Vrava sa munda dhe kur u plagosa, s'desha të dija, as për doktor, as për ilaçe, po mora përsëri malet me copën e murtajës në trup.

Vetëm pas luftës nuk isha më ai Çobua që më njihnin. Fillova të qahem herë nga stomaku, herë nga një dhëmbje në shpatulla dhe s'më jepoj fare për punë...

...Që t'i bie shkurt, mua më ish mbushur mëndja në kohën e luftës se, kur të vinte lirija, do ja shtronim për gjithënjë «ku leh qen e ku del tym» dhe, sa për punë, as që do e vinim ujët në zjarr».

Në këto pak radhë jepet bukur portreti moral i Çobo Rrapushit dhe nënvizohen, si tiparet pozitive të labit, ashtu edhe krenaria pakëz kryeneçe dhe... duhet ta themi... mungesa e dëshirës për punë.

Ky Çobo Rrapushi, që e bëri beli trimërinë në luftë dhe nuk pyeti për copën e mortajës

që kishte në trup, pas luftës endej nëpër Tirani, mbrëmje për mbrëmje, i veshur me pallto e poture shajaku dhe me një fanellë të leshtë, që nuk e hiqte as në vapën e korrikut. I kishte zënë derën të nipit, i cili ishte në punë të mirë dhe, me paret që kish marë për një truall, që trashëgonte nga e shoqia, ja shtonte me të ngrënë e me të pirë për shtatë palë qejfe.. Dëshirë që të kthehej në fshat e t'i vihej punës nuk kishte, megjithëqë e merte malli sidomos për burimet e ftohëta, për fushën me lumin ndanë dhe për të përpjetën e malit me shkëmbënj. Po ky mall nuk kishte fuqi zoteronjëse. Në moshën pesëdhjetëvjeçare, ai kish vendosur të vegjetonte e të mposhtej prej jetës së amulltë. Mund të zgjohej, — dhe me siguri do zgjohet, — vetëm po t'ja bënte përsëri pushka bam!

Mirëpo, sidomos sot, dëshira e njerëzve nuk përcakton kurdoherë rrugën e tyre në jetë. Nëqoftëse kjo dëshirë ndesh në rrjedhën e përgjithshme të jetës sonë socialiste, nëqoftëse ajo bie në kundërshtim me prirjen kryesore të zhvilimit historik, njeriu që e përfaqëson këtë dëshirë është i detyruar ose të dështojë, të bjerë poshtë e të humbasë, ose të ndryshojë e të vihet përkrah luftëtarëve të vendosur të ndërtimit të sociáлизmit.

Çobo Rrapushi ishte në udhëkryq. E tërhiqnin nga të dy anët, po ai s'desh të shkon te, as andej, as këndejej. I pëlqente më tepër të qëndronte në hava, i mbajtur prej térheqjes së dy forcave, të dy tendencave, të dy mënyrave të jetesës, të dy mentaliteteve.

Në formë tepër të kamufluar dhe të pakupuar për 'të personaliteti i Çobo Rrapushit

ngrihet mbi një kundërthënie. Nga një anë kemi Çobo Rrapushin punonjës, që ishte shkrirë në punë për të tjerët dhe luftëtar e, nga ana tjetër, Çobo Rapushin kapadai, me mentalitet patriarkal, me sedër të tepruar, të pavullnet-shëm për punë.

Paraqitja e heroit në një plan të tillë është meritë e vërtetë artistike dhe përcakton sfondin realist të veprës. Procedimi i sigurtë në përshkrimin e heroit dhe të situatave tregojnë se shkrimtari e ka njojur gjerësisht temën, e ka konceptuar atë në gjithë tërësinë e saj dhe ka hyrë thellë në ndryshimet që janë bërë në botë-kuptimin e psikologjinë e njerëzve pas çlirimis!

A ka patur bazë shoqërore kundërthënia që përmëndëm? Po. Le të përmëndim se Çobo Rrapushi ka të gjitha tiparet karakteristike të labit. Ai ka punuar për të tjerët dhe ka ndier mbi shpatulla vetëm peshën e rëndë të punës skllavëronjëse. Ai ka luftuar për liri, pa e ditur që kësaj radhe lufta kishte karakter të theksuar revolucionar, bile ka ushqyer iluzione të kota. Ai është produkti i marëdhënieve shoqërore patriarkale dhe mbështetet deri në fund mbi mbeturinat e tyre. Përvetësimi i pareve të truallit, largimi nga fshati, qëndrimi për një kohë shumë të gjatë tek i nipi, janë shprehje konkrete të regëtimave të fundit të patriarkalizmit; si nga ana e tij, ashtu edhe nga ana e të tjerëve. Pra, ky Çobo Rrapush nuk mund të ishte ndryshe, veçse ashtu siç e ka përshkruar shkrimtari.

Po jeta ecte, megjithëse Çobo Rrapushi qëndronte në vënd e kështu, pa e kuptuar, mbe-tej prapa e s'kish me se të mburrej veç me trimëritë e luftës. Fshati i tij kish ndruar: ishte

krijuar kooperativa. Edhe njerëzit kishin ndryshuar: miku i tij *Xhezua*, ishte bërë brigadier, kurse *Asimi* i *Xhelos* ishte rritur dhe qe bërë korier. Gjithashtu ndryshime të tilla kishin ndodhur edhe në shtëpinë e Çobos. Në vënd të kasolles, ai gjeti shtëpi të re. Nusja e urtë e mesy përdhë fliste serbes-serbes dhe qe pranuar në Parti... Vetëm Çobo Rapushi nuk kishte ndruar, prandaj u ndodh ngusht kur u kthye në fshat dhe e ndiente veten të huaj.

Situata e krijuar prej shkrimtarit në këtë çast është e mrekullueshme. Errësira e mbrëmjes, vetëmia, shtëpia e ndërtuar diku gjekët, dera e mbyllur dhe... më në fund, qeni plak, i cili mezi e njohu të zotin. Toni humoristik i tregimit bie pa u kuptuar, në mënyrë të natyrëshme, duke i lënë vëndin, po kaq natyrëshëm, notave malëngjenjëse, që të ngashërojnë:

«...U nxitova e i fola qenit dhe ai, sikur ngriu përnjëherësh në vënd, u ngul mbi këmbët e prapse dhe, me të dy këmbët e para në hava, më vështroi një copë herë, pastaj nisi të tundë bishtin me ca të kuisura, që mua më thernë në zëmër.

«Eh, Ballan, Ballan! Ç'kohëra e ç'halle më kujton ti! As në operacione, kur iknin të vegjël e të mëdhenj nga fshati, nuk u ndave nga ne. Malin more dhe ti me njerëz bashkë; roje bëje rrëth e rrëth shpellës, ku kishim fshehur fëmi-jët dhe, sikur e kuptoje hallin, nuk jepje asnje shenjë kur të vinte koha e taimit tënd... Ktheheshe në shpellë, i shikoje të gjithë në sy një e nga një, i shihje që s'kishin as përvete dhe ikje prapë, duke tundur bishtin, gjoja i gjëzuar, sikur s'të shkonte mëndja përbukë. Dhe neve na du-

*kej sikur thoshje: «punë e madhe! Do bëjmë edhe kështu!...» Nashi je plakur, ti, Ballan. Dhe ke hallet e tua edhe nashti, se të gjallë e pa halle s'paska! Po prapë vazhdon detyrën tënde. Haj-haj».*

Kështu u kthye Çobo Rrapushi në fshat dhe për shkrimtarin kështu lind një çështje tjetër: cila do jetë udha e mëtejëshme e heroit? Këtu dalin në plan forca të reja tërheqëse.

Ndryshimet në fshat dhe në familje i lanë përshtypje të mira Çobos, ndonse me disa gjëra, sidomos me kritikat nuk pajtohej lehtë. Njerëz ishin dhënë pas punës dhe, veç katër-pesë dembelëve, askush s'ja kishte ngenë të merej me Çobon, të cilat ky qëndrim i dukej fyterës. Po, më e madhja është se, disa zunë edhe ta tallnin e t'i hidhnin romuze. Dhe, së fundi, kur shkon që të kërkojë me krenari tesrën e Frontit, kryetari e pret me këmbët e para dhe, në vënd që t'i thotë «urdhëro e mere», siç pat kujtuar Çobua, i përgjigjet ftohet, duke i premtuar se do ta shqyrttonin çështjen e tij. E si mund të vihej në diskutim çështja e Çobo Rrapushit? Ishte parë kjo? Ai... Ai ishte e ç'nuk ishte!

Ja si e kujton Çobo Rrapushi këtë moment:  
«Një ditë, se si erdhi fjala për triskat e Frontit. që duheshin përsëritur. Kërkova edhe unë të më jepesh triske e re.

— Të shohim një herë, — tha kryetari pa e bërë qejfin qeder.

— Si more të shohim? Pak kam luftuar unë për çështjen e Frontit?

— Ke luftuar, shoku Çobo, atë s'ta mohon njeri. Po anëtari i Frontit ka edhe detyra të tjera sot.

— Ç'detyra, more! — u talla unë.

— Detyra, pos!.. Ku ke parë ti anëtar të Frontit të kërcasë gjishterinjtë gjithë ditën e Perëndisë në një kohë kur populli po e bën natën ditë?..

Kisha dëgjuar kritikë, po kritikë si kjo s'më kishte zënë veshi ndonjëherë. M'u errën sytë e m'u turbullua mëndja; goja m'u muarr, s'qesh i zoti të bëj dy fjalë bashkë. Bëra të iki, po as derën nga të dilnja s'po e gjenja dot...»

Është e qartë që Çobo Rrapushi s'kish nga t'ja mbante. Donte, s'donte, duhej t'i shtrohej punës, se ashtu e kërkonte e mira e tij dhe nderi i emërit. Tani kishin ardhur kohë të tjera dhe të tjera detyra shtroheshin. Patriotizmi, ashtu siç ishte provuar dhe siç mund të provohej me armë, ashtu duhej provuar edhe me punë, sig bënин të gjithë fshatarët.

Kështu ngjau që ai, siç thotë vetë, «të hyjë përsëri në udhën e njerëzve». Më vonë Cobon e shohim fshatar të dalluar, Fotografia e tij bo-tohet në gazetë dhe, më në fund, e dërgojnë edhe në Tiranë, si delegat të kooperativës, bashkë me fshatarët më të mirë. Po akoma mbetet diçka nga Cobua i parë dhe, ndër ato që mbeten, është domosdo edhe ajo e shkretë sedër dhe dë-shira për t'u dukur, për të mos e bërë punën heshtur, po patjetër me pakëz bujë. Prandaj shënuam në fillim të artikullit se në tregimin e Shevqet Musarajt karakteri i labit është dhë-në bukur e me vërtetësi.

Tregimi është ndërtuar në formë rrëfimi Heroi kryesor flet vetë për gjithë peripecitë e jetës së vet dhe e sheh të kaluarën në mënyrë kritike. Përfundimi kryesor që nxjerr ai dhe që

bashkë me 'të e nxjerrim edhe ne është se puna e kthen Çobo Rrapushin në radhën e njerëzve më të mirë, në radhët e atyre me të cilët luftoi krah për krah kundër fashizmit. Nëpërmjet qëndrimit autokritik të heroit është shprehur vetvetiu në tregim edhe qëndrimi i autorit të veprës.

Humori i gjuar që përshkon tregimin e ka burimin pikërisht në mposhtjen e amullisë e të veseve që kishin nisur të nxirnin kokë te Çobo Rrapushi. Pasi ka fituar mbi 'to dhe e ndien veten të çliruar prej prangave të tyre, heroi nuk ka turp, biles, ndihet edhe krenar, kur tallet me një fazë të kaluar të jetës së vet. Është kjo arësyeja që humori në këtë tregim nuk është vetëm një element «lezetonjës», po është shprehje e drejtërdrejtë e brendisë së veprës dhe është i lidhur ngushtë me frymën optimiste që përshkon atë.

Në tregimin «*Isha unë Çobo Rrapushi*» ka edhe disa momente deri diku të rëndësishme që kapërcehen lehtas dhe në mënyrë të sipërfaqëshme, ashtu siç ka edhe ndonjë moment që cënon realizmin (paraqitje e fshatit), dhe ndonjë zgjatje, sidomos nga fundi i veprës, po këto s'prishin shumë punë. Kryesorja është se Shevqet Musaraj ka krijuar një tip, emëri i të cilid do shënohet në rregjistrin themeltar të personalzheve më të realizuara të letërsisë sonë të realizmit socialist.

(Botuar në «Zëri i Rinisë», gusht 1960)

**« JETË ME BRENGA »**

Letërsisë sonë të re iu shtua kohët e fundit edhe një vepër tjetër me vlerë: vëllimi me tregime «Jetë me brengë» e shkrimtarit të ri Thoma Kacori, të cilin lexonjësi ynë nuk ka shumë kohë që e ka njojur nëpërmjet shkrimeve të botuara vitin e kaluar në revistën «Nëndori». Po kështu në konkursin e shpallur për nder të dyzetë vjetorit të Revolucionit socialist të Totorit ai u nderua me çmimin e dytë për tregimin e gjatë «Kujtime të hidhura».

Botimi i vëllimit të parë me tregimet e Thoma Kacorit na lejon të themi me siguri se ai është një nga prozatorët tanë të rinj më të talentuar, që zotëron mirë mjeshtërinë e vështirë të prozatorit dhe që ka mundësi në të ardhmen të shkruaj vepra të tjera më me vlerë.

Që në shkrimet e para të tij ai dallohet prej shumë të tjerëve për mënyrën e thjeshtë të kapjes së temave dhe për zgjedhjen e disa subjekteve *minimal*, të cilët në vështrim të parë, të

duket se nuk përbajnjë kushedi se çë, po kur i lexon me vëmëndje zbulon ndër 'ta, kurdoherë, një mendim të rëndësishëm dhe një problem jetësor, që ka çqetësuar autorin. Kjo, mund të themi, është një gjë e re që sjell autorin i vël i-mit «Jetë me brenga» në tregimin tonë të shkurtër të pasluftës. Në këtë drejtim tregimet e tij mund të krahasohen në letërsinë tonë të sotme vetëm me tregimet e bukura të Jakov Xoxës të botuara në revistën «Nëndori». Të dy këta autorë, pavarësisht nga njëri tjetri, kanë arritur, pak a shumë, në të njëjtin përfundim artistik dhe kanë të njëjtën mënyrë në kapjen e temave dhe në trajtimin e subjekteve.

Thoma Kacori nuk tërhiqet nga konfliktet efektuzë dhe sentimentalë, siç bëjnë mjaft të rinj e, për fat të keq, edhe ndonjë shkrimitar i njohur. Ai ka zgjedhur një rrugë të vetën që, për mendimin tonë, është mjaftë artistike dhe që i jep mundësi shkrimitarit të thellohet sa më tepër në fenomenet e jetës. që ka marë përsinër të pasqyrojë në vepër. Në themel të çdo tregim të vëllimit «Jetë me brenga» ndodhet një fakt i vogël, po shumë shprehës, nëvoërmjet analizës së gjithëanëshme të së cilët autorin i kumton lexonjësit mendimet e veta për jetën dhe për njërezit, që përshkuan në shkrime. Duke mos e shpërndarë vëmëndjen në shumë njodhira duke mos u shtrirë shumë në sipërfaqe, Kacori ka patur mundësi të thellohet më tepër në subjektit e tregimeve të veta dhe ka ditur të zgjedhë për secilin syresh një kompozicion të përshtatshëm e të thjeshtë, që u shkon për bukurit tregimeve të shkurtëra.

Le të marim, për shëmbull, subjektin e tre-

gimeve «Kau» dhe «Dordoleci». Në të parin autor i na kallzon si një fshatar shkon në mërgim dhe, pas një kohe të gjatë e pas një pune raskapitëse, kthehet në fshat. Me gjithë paret që ka fituar ai blen një ka për të lëruar arat dhe mer rishtaz udhën e mërgimit. Një ditë prej këtësh kaun e vrasin qet e fshatit dhe në shtëpi pllakos dëshpërimi... Në tregimin tjetër, që kemi marë si shëmbull, trajtohet gjithashtu një subjekt mjaft i thjeshtë: në fshat ka rënë një thatesirë e madhe dhe grunjërat po thahen në ara. Beu i fshatit ka zaptuar të vetmen vijë uji. Vajzat e fshatit, ndër 'to edhe heroina e tregimit, i bëjnë lutje zotit për t'i shpëtuar nga e keqia. Vajza vishet me gjethë e me kulpra, si dordolec, dhe, e shoqëruar nga shoqet, shkon derë më derë. Në çdo shtëpi asaj i hedhin nga një kovë me ujë sipas zakonit. E bërë quall dhe e dërmuar nga lodhja, ajo bije në shtrat dhe, pas disa ditësh, vdes.

Sic shihet, këtu s'kemi të bëjmë me asgjë të jashtëzakontë, dhe ndokush mund të thotë, bile, se tregimeve u mungon baza shoqërore, që është një kusht i domosdoshëm për artin realist. Kjo nuk është aspak e vërtetë! Merita e autorit të tregimeve duhet kërkuar pikërisht në zotësinë e tij për të na dhënë, nëpërmjet rasteve të zakonëshme e të natyrëshme, tabullo të gjal'a realiste dhe emociononjëse të nxjerra ngajeta e përditëshme. Ajo që është e rastit në jetën e përditëshme i ka shërbyer shkrimitarit si mjet i mirë artistik për të paraqitur fenomene tipike të jetës së fshatit shqiptar në kohën e sundimit feudo-borgjez të Ahmet Zogut.

Kjo, pa dyshim, është vetëm një mënyrë e kapjes dhe e trajtimit të subjekteve dhe n' duam të themi se të gjithë tregimet e shkurtëra duhet të ishin shkruar dhe të shkruheshin në këtë mënyrë, mbasi, çdo tregimtar ka preferencat e veta artistike, stilin e vet. Puna është se Thoma Kacori që në tregimet e para, e ka përcaktuar mirë profilin' e tij si shkrimitar dhe, para së gjithash, si autor tregimesh të shkurtëra. Ngordhja e kaut dhe vdekja e fshatarkës së re nuk janë gjëja kryesore në tregimet që përmëndëm. Ato janë vetëm rastet nëpërmjet të cilave autori ynë zbulon në formë artistike rrënjet e vërteta dhe çfaqjet kryesore të jetës së mjerë të fshatarësisë sonë punonjëse në kohën e errët të skllavërisë feudale-borgjeze.

Me sa duket, në krijimtarinë e autorit të ri, ka ndikuar për mirë vepra e shkrimitarit klsaike bullgar Elin Pelin dhe stili i tregimtarisë popullore e i modeleve të saj të shkruara, që nuk janë aq të rralla në letërsinë tonë të vjetër dhe të re.

Ky ndikim pozitiv vrehet edhe në lehtësinë e kapjes së subjektit nga autori ynë i ri dhe në natyrshmërinë e zhvillimit të ngjarjeve në vepren e tij. Po, duhet thënë që, në disa raste, si te tregimet «*Pandua me Selmanin*», «*Malli i vatanit*» dhe «*Fshati ynë ballëpërballë me fashistët italienë*» ai ka rënë në përshkrime të thjeshta që të kujtojnë reportazhet e gazetave. Në të tre këta tregime shkrimitari nuk është përpjekur për të bërë përgjithësim artistike, po është mjaftuar me paraqitjen e një ndodhie a të një bisede, e cila, megjithëse në vete mund të jetë interesante, nuk e ngroh lexonjësin. Kjo,

besojmë, është arësyjeja që këta tregime janë më të dobëtit e vëllimit, megjithëse, në tregimin e fundit ndihet edhe mosnjohja e realitetit të përshkruar.

Një karakteristikë tjeter e tregimeve të Thoma Kacorit është edhe tematika e tyre e përbashkët dhe e përcaktuar mirë. Shkrimtarin e ri e ka tërhequr shumë jeta e fshatit tonë para çlirimt ihe, përgjithësisht, gjëndja e mjeruar e masave tona punonjëse në atë kohë. Përsa i takon tematikës vepra e Kacorit arrin deri në pragun e luftës Nacional-Çlirimtare, që është pasqyruar vetëm në tregimin «*Fshati ynë ballëpërbal'lë me fashistët italianë*». Më tej ai nuk ka shkuar dot me që është shkëputur nga zhvillimi i jetës në vëndin tonë gjatë këtyre pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit. Prandaj ai ka vepruar shumë drejtë që ka trajtuar në tregimet e vëllimit «Jetë me brengë» tematikën që ka njojur më mirë, mbasi kështu, ka kontribuar me sukses për edukimin komunist të masave punnojëse, sidomos të rinisë sonë, e cila nuk ka patur rastin ta njohej mirë jetën e vështirë e plot brenë që kalonte populli ynë para çlirimt të atdheut.

Në tregimet e vëllimit «Jetë me brengë», jeta e fshatit nuk është paraqitur vetëm në anët e saj të zeza e të errëta, siç pasqyrohet në disa vepra skematike. Autori i vëlimit ka ditur ihe ka mundur përgjithësisht mirë të dallojë sistemin shoqëror shtypës të feudalëve e të borgjezëve që ishte burimi i të gjitha fatkeqësive, nga jeta e njerëzve të thjeshtë, të cilët, megjithëse mbanin mbi shpinë gjithë barrën e rëndë të shtetit e të interesave egoiste të klasëve sun-

njëse, dinin ta gëzonin jetën, ndienin ngazëlli-min e punës dhe luftonin për ta bërë atë sa më të bukur për vete dhe për bijtë e tyre. Po, shpesh, edha gëzimet e vogëla të jetës shkrimtari ka arritur t'i vejë në funksion të ideve themelore të veprës. Duke na treguar gëzimin që njien fshatari kur blen kaun apo kur hedh mënjanë një dorë gjë për dimër, autori ka theksuar artistikisht, jetën e tij të varfër, që del në tregim q edhe nëpërmjet pasqyrimit të kërkessave të ulta të katundarëve të varfër. Lexonjësi mund të bëjë vetë krahasimin ndërmjet këtyre kërkessave minimale dhe kërkessave të sotme të fshatarësisë sonë, e cila, pasi është çliruar njëherë e përgjithmonë nga zgjedha e bejlerëve dhe agallarëve dhe është vënë në rrugën e socializmit, nuk mendon më pér kafshatën e gojës dhe as pér kafshën e punës, po pér arritjen e rendimenteve të larta, pér futjen e metodave të përparuara në bujqësi, pér organizimin e një jete sa më të kulturuar dhe pér rritjen e vazhdueshme të mirëqënies së vet.

Kështu ndodh në tregimin «*Shpresat e Lekrave*», në të cilin autori shkruan:

«Tërë fshati i mbante në gojë dhe thosh:

— S'kanë parë kafshë me sy, të gjorët, Lakra, dhe i gëzohen më shumë demit se sa djalit të tyre...»

Ky është burimi i gëzimit të familjes së fshatarit të varfër! Ky gëzim i ka rrënjet të futura thelë në jetën e mjeruar dhe të varfër të tyre dhe prandaj është edhe jetëshkurtër «zgjat sa mban vesa e mëngjezit!», mbasi mbytet nga sistemi i rëndë shoqëror, që i ka hedhur kthet-

rat në fyt Lipes, ashtu si gjithë katundarëve të tjerë.

Në tregimin «*Nëna*» autori na jep një përshkrim të hallevë të qytetarëve të varfër që vuajnë pér kafshatën e gojës në kohën e krizës ekonomike. Dhe, ja ku na del një tabllo tjetër e jetës së vëndit tonë në atë periudhë. Pasi kemi njojur mjerimin e fshatarit shohim se vuajtjet e punëtorëve dhe hallet e tyre janë shumë më tronditëse. Po, nuk është ky gjithë tregimi. Në 'të janë ngjeshur me njera tjetrën pér buku-ri dhe krijojnë një të tërë harmonike shumë aspekte të jetës njerëzore: hallet e prindërve me shumë fëmijë, dëshira e fshatarit pér të patur një djalë, dhëmshuria e nënës dhe gatishmëria e saj pér sakrifica, qëndrimi i fshatarit ndaj qytetit, greva e bukës në Korçë... Shumë, mba-se, pér një tregim të shkurtër, që nuk i kalon të pesë faqet, po shkrimitari ynë, ka ditur të zgjedhë, ka ditur të seleksionojë dhe të përdorë me mjeshtëri aspektet më shprehëse të temës që ka trajtuar. Ai kurdoherë është i kursyer, nuk fut në tregime gjëra të tepërtë, nuk zgjatet në ndodhi e përshkrime të parëndësishme dhe, në të njëjtën kohë, na jep çdo gjë të domosdoshme dhe të nevojëshme pér vepra me të vërtetë artistike.

Një meritë tjetër e Thoma Kacorit është mënyra e gjithanëshme dhe e plotë e kapjes së temave dhe subjekteve. Tregimet e tij janë plot jetë, të mbushur me nuanca dhe hollësi shprehëse artistike. Kjo ka bërë që vepra e Kacorit të lexohet me ëndje dhe të pëlqehet prej lexonjësve, të cilët gjejnë në seicilin tregim, jo vetëm një mbarshtrim të thjeshtë të subjektit, po edhe

shumë vërejtje artisti për jetën e për njerëzit.

Edhe gjuha e tregimeve të Kacorit është për t'u lavdëruar, si për pasurinë, ashtu edhe për forcën shprehëse të saj. Frazeologjia e pasur popullore, figurat e thjeshta e të këndëshme stilistike dhe ritmi i ngadalëtë i të treguarit, shkojnë për bukuri me përbajtjen e tregimeve të vëllimit «*Jetë me brengë*». Është për t'u vënë re se kjo mënyrë të shkruari po zë gjithënjë e më tepër vënd në letërsinë tonë të re, sidomos në tregimet e shkurtëra të frymëzuara ngajeta e fshatit. E takojmë këtë në tregimet e Jakov Xoxës, në ato të Naum Priftit, të Sotir Andonit e të ndonjë tjetri. Të gjithë këta autorë i bashkon jo vetëm stili, po edhe tematika e veprave të botuara kohët e fundit, megjithqë secili syresh ka edhe diçka të vetën, që e dallon nga të tjerët. Kështu, për shëmbull, frazat e stolisura të Xoxës, ja lënë vendin një stili të thjeshtë e pakëz të thatë në «Tregimet e fshatit» të Priftit dhe, në tregimet e Kacorit një lirizmi e humori shumë të lehtë, karakteristik e tregimtarisë popullore, ndërsa në ato të Andonit lirizmi është më i dukshëm dhe humori më i drejtpërdrejtë.

Nga gjithë sa thamë del qartë se vëllimi me tregime i Thoma Kacorit është jo vetëm sukses për autorin e ri, po edhe një nga vëllimet më të mira me tregime, që janë botuar ndër ne gjatë këtyre katërmëbëdhjetë vjetëve të fundit.

(*Botuar në gazeten  
«Zëri i Popullit, 1957»*)

## **NOVELE PER NJEREZIT NE LUFTE**

Lufta jonë çlirimtare ka lënë gjurmë të pashlyeshme në jetën e në kujtesën e njerëzve dhe këto gjurmë janë ende të freskëta, prandaj edhe pasqyrimi i luftës në veprat letrare dhe artistike nuk është punë e lehtë. Karakteri popullor dhe thellësisht revolucionar i luftës Nacional-Çlirimtare, që nuk përbysit vetëm shtypjen kombëtare dhe ekonomike, po që tronditi nga themellet gjithë ndërtesën e botës e të mentalitetit të vjetër, e detyron shkrimitarin të matet mirë para se të ulet që të shkruajë, qoftë dhe për ngjarje episodike të saj, të cilat do të zbulojnë domosdo anë të rëndësishme të revolucionit, nëqoftëse janë vërtet vepra me vlerë artistike. Nga ana tjetër, lufta partizane ende nuk është bërë legjendë, siç mund të mendohet nga njëherë, gjersa ata që e bënë luftën janë gjallë dhe s'ka si të mos i krahasojnë veprat me realitetin e kohës së luftës. Dhe, pastaj, vetë zhvillimi ynë shoqëror si dhe përparimi i letërsisë, kanë nxjerrë kohët e fundit edhe probleme të reja të karakterit shoqëror e artistik për veprat, që pasqyrojnë luftën.

Më duket se novelë e Nasho Jorgaqit «*Endëra dhe plagë*», që është ndër veprat e mira në grumbullin e botimeve tonë të këtij viti, i shtron dhe pretendon t'u përgjigjet këtyre kërkesave me tërësinë e brendisë së vet emocionale dhe me hollësitë artistike, që përbëjnë apo që plotësojnë subjektin e saj.

Para së gjithash autor i novelës është nga të parët në letërsinë tonë të re që e trajton temën e luftës për liri, jo në plan thjesht luftarak, (*batalist*, në mund të shprehemi kështu), po i jep një karakter më të gjerë shoqëror e njerëzor. Dhe nëqoftëse flasim pér *vështrim* të *ri*, në kuptimin letrar të materialit jetësor të kohës së luftës dhe në përgjithësi, të së kaluarës, kjo, — trajtimi i temës në plan shoqëror, — është nga elementet më të rëndësishme dhe nga kriteret më kryesore të vlerësimit, gjë që përcaktohet edhe prej nivelit të sotëm të letërsisë, edhe përfunduara, mund të gjykohet kurdoherë më me gjakftohtësi, se për proceset në zhvillim e sipër.

Në novelën e Nasho Jorgaqit elementi heroik shkrihet me elementet dramatike dhe tragjike të luftës clirimtare dhe, prandaj, veprangjall te lexonjësit dhëmbje e krenari. Dhëmbje përfunduara, mund të gjykohet kurdoherë më me gjakftohtësi, se për proceset në zhvillim e sipër.

Në këtë novelë, si në të gjithë letërsinë tonë, ndryshtë nga ç'ndodh

sot në disa letërsi të tjera, problemi i sakrifica-ve njerëzore shtrohet dhe zgjidhet drejt, nga pozita thellësish humaniste, jo me vajtime e britma filistine për «*jetën e papërsërithëshme*», po me afirmimin e heroizmit e të sakrificës, si një prej çfaqjeve më sublime të ndjenjave e të idealeve humaniste të heronjve, të cilët, megjithëse e duan jetën, megjithëse ëndërojnë për lumturinë, megjithëse ende nuk kanë jetuar, nuk dridhen para vdekjes, kur mendojnë që vdesin për lirinë e për lumturinë e popullit. Kjo do t'ishte brendia emocionale e veprës së Nasho Jorgaqit, e mishëruar në subjektin e thjeshtë të novelës, i cili do të kishte fituar shumë dhe do të tingëllonte më i fuqishëm, më kuptimplotë e më realist, sikur të mos kishte patur atë përfundim efektuoz, që ka përdorur autorii dhe që të detyron të qëndrosh ftohët para gjithë episodit që e kurorëzon. Në novelë ne shohim dashurinë e madhe të heronjve për jetën, dëshirën e tyre të zjarrtë për të jetuar, shohim shpërthimin e dashurisë së tyre dhe këto na shtyjnë të mendojmë që ata, jo vetëm kanë të drejtë të rrojnë, po edhe për të tjerët jeta do t'ishte më e bukur me njerëz t'atillë të mrekullueshëm. Po a luftojnë heronjtë e novelës «*Endra dhe plagë*» për të jetuar? A luftojnë ata që t'i shpëtojnë vdekjes? A bëjnë ata gjithçka që mund të bënin para se vdekja e tyre të bëhej e pashmangëshme? Ata presin gjersa ushtarët gjermanë i vënë flakën shkollës, ku janë fshehur dhe, vetëm atëherë, për të shpaguar *veten* dhe jo për të luftuar, (gjë që do t'ishte absurde n'ato rrethana) e as për të shpëtuar, (gjë që do t'ishte më e natyrë-

shmja, më e mundëshmjëa dhe më kuptimplotja n'ato rrrethana). Autori, për të përligjur pashtangmërinë e fundit të novelës, na i tregon heronjt të dobët e të pafuqishëm në kapitullin e fundit (Ramizi rrëzohet, duke ardhur rrotull në tavan), po ky, më ngjan, është vetëm një justifikim për të mbajtur më këmbë fundin e novelës, se duke parë fshatin që digjej dhe duke menduar se do të digjeshin, (këtë frikë të heronjve autorë e ka dhënë), është e pakuptueshme, si këta njerëz nuk u përpoqën të shpëtonin, qoftë edhe duke u fshehur diku, aty pranë. Edhe po të diktoheshin, edhe po të vriteshin në të tilla rrrethana, jo vetëm që do të justifikohej gjithçka, po novela do t'ishte më realiste dhe më e fortë (ata do të luftonin për të jetuar) dhe do të kishte humbur vetëm efektuzitetin romantik të fundit të menduar. Edhe tragjiciteti i subjektit do të kish qenë më konsequent, se nuk ka tragjizëm, po nuk pati luftë kundër fundit të dhimbshëm, po nuk pati përpjekje dhe rezistencë. Pastaj, ndoshta nga pakujdesia, ndoshta nga moszotërimi i plotë i materialit jetësor, autori i ka paraqitur heronjtë në dy kapitujt e mëparshëm në gjëndje t'atillë shpirtërore, që askujt nuk i shkon në mëndje, që ka të bëjë me njerëz që vuajnë fizikisht. Dhe, c'është e vërteta, Kristina është plagosur në shpatull, kështu që mund të ecë, kurse Ramizi, i cili nuk do të largohet, vetëm që të mos braktisë shoqen, provon gjithashut se mund të lëvizë. Të na falë lexonjësi që po e mërzitim me hollësi të tilla po mendojmë që këto janë të rëndësishme dhe më kot autorë i novelës i ka lënë mënjanë, duke pëlqyer më tepër efektuzitetin

romantik të fundit, që shton artificialitetin e novelës dhe dobëson brendinë emocionale të saj, duke ua lënë vëndin e hollësive realiste me përbajtje të thellë, tymit dhe flakës.

Novela «Endëra dhe plagë» është një vepër, subjekti i thjeshtë i të cilës është konceptuar në formë poetike dhe autorit, ka zgjedhur rru-gën e përgjithësimit artistik, jo me anë të ngarkesës me episode, po me anë të thellimit në subjektin episodik të veprës dhe me zbulimin e të gjitha anëve emocionale të tij. Në prozën tonë ky është një fenomen i kohëve të fundit dhe, megjithëse nuk është më tepër se një formë pasqyrimi e përgjithësimi artistik, bën pjesë në çfaqjet e pjekurisë së prozës dhe sjell me vete kërkesa artistike më të mëdha, sidomos për analizën e plotë e të gjithanëshme të subjektit, për zbulimin nëpërmjet hollësive të botës shpirtërore të heronjve dhe për vlerësimin e plotë dhe zgjedhjen me kujdes të detajeve artistike, të cilat, në raste të tillë, duhet të kenë forcë të veçantë shprehëse dhe emociononjëse. Prandaj është meritë e Nasho Jorgaqit, i cili edhe pse nuk ka ndonjë përvojë të madhe letrare e jetësore, e vuri veten përballë një prove të tillë +ë vështirë dhe, në përgjithësi, doli jashtë kufijve të provës, duke na dhënë një vepër që lexohet me èndje, ndonse edhe nga kjo pikpamje me të meta.

Dy partizanë të rinj në moshë largohen nga beteja të plagosur dhe strehohen nënë çatinë e një shkolle fshati. Atje lind dhe shpërthen dashuria e tyre gjatë tri ditëve, që rrinë të fshehur, gjersa digjen të dy bashkë me ndërtesen. Ky është subjekti. Nga pikpamja letrare prof-

sionale, kushdo që mer vesh nga letërsia, i kupton vështirësitë e mëdha që i është dashur të kalojë autor i për të shkruar në bazë të këtij subjekti një novelë prej njëqind e ca fajqesh. Si i ka kaluar autor i këto vështirësi?

Për të mbushur e për të pasuruar subjektin e novelës shkrimtari ka përdorur kryesisht dy mënyra: *kujtimet* dhe *bisedat arsyetonjëse*, nëpërmjet të cilave është dhënë portreti moral i heronjve në raport me kohën dhe është gjetur zgjidhja e elementit kryesor të subjektit, dashurisë. Në disa raste, sidomos nëpërmjet kujtimeve të Ramizit, motivet janë interesante dhe emociononjëse, kurse në raste të tjera, siç është biseda për romanin «*Lulja e kujtimit*», motivet duket sikur meren si ndihmë për të shtuar tregimin e jo për t'a pasuruar atë. Ka momente kur autor i përdor me mjeshtëri edhe hollësitë artistike, siç është rasti i ndrimtit të plagëve, i pastrimit dhe i këmbimit të armëve ose edhe ndonjë hollësi tjetër, po, në përgjithësi, ndryshe nga ç'e kërkon një vepër e kësaj natyre, detajet artistike nuk përdoren dhe, herë-herë janë libreske, si hyrja e harabelit ose çelia e dritarës në çati, të cilat autor i është munduar t'i çfrytëzojë tepër. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për detajet psikologjike, prej të cilave mbasë të bën përshtypje ndonjë prej momenteve të kllapisë në fillim të novelës e disa çaste të pakta në bisedat e në lidhjet e krijuara ndërmjet heronjve, kurse në tërësi nuk gjen diçka të freskët e të re, diçka që të mos e kesh lexuar tjetër herë e të jetë e veçantë për heronjtë dhe përsituatën në të cilën ata ndodhen.

Thamë se dashuria është një prej elementeve kryesore të subjektit të veprës dhe, prandaj, nëpërmjet manifestimeve të kësaj ndjenje autori është orvatur të na japë një portret sa më të plotë të heronjve dhe, nëqoftëse nuk mundemi t'a konceptojmë novelën «*Endëra dhe plagë*» pa dashurinë e përshkruar, kjo do të thotë se autori i ka dhënë asaj një vënd të natyrshëm në tërësinë organike të veprës. Mendohet disa herë që dashuria e pasuron domosdön brendinë emocionale të veprave dhe, mbasë përkëtë arësy, është e vështirë të gjesh krijime letrare kushtuar luftës që të mos kenë, siç thuhet, edhe linjën e dashurisë. Më duket se ky është një mendim i padrejtë, që e ka burimin më tepër në dëshirën e disa autorëve për të tê têrhequr lehtë vëmëndjen e lexonjësve, se sa në pasqyrimin realist të kohës së luftës ku, siç dihet, mendohej përgjithësisht ndryshe nga sot për dashurinë. Po në novelën e Nasho Jorgaqit nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë. Ai, përkundrazi, është përpjekur t'i japë edhe dashurisë së dy të rinxje një kuptim më të gjerë, duke e vënë atë në kontrast me ashperzinë e luftës dhe duke na e afirmuar, si një shpërthim romantik të dëshirës për jetë e për lumturi. Nga ana tjetër, autori i novelës, sidomos nëpërmjet fjalëve të Kristinës, ka dashur të pasqyrojë edhe qëndrimin e rreptë që mbahej atëhere kundrejt dashurisë. Mirëpo, megjithëqë piknisja e autorit ka qenë e drejtë, realizimi i idesë së tij nuk është në tërësi realist është i natyrshëm.

Le të kujtojmë se dy heronjtë e veprës janë të plagosur dhe, megjithëse autori, duke gërmuar në të kaluarën e tyre, kërkon të nxjerrë

në pah se edhe më parë kanë patur simpati reciproke, në të vërtetë, prej qëndrimit të tyre kundrejt njëri-tjetrit, neve nuk na mbushet mëndja t'a pranojmë këtë si të vërtetë, ndaj edhe nuk na pëlqen orvatja për të provuar të kundërtën, si një përpjekje për t'iu shmangur vështirësive të situatës së krijuar. Ramizi, sipas të dhënavë t'autorit, rreh me këmbëngulje e me mëndjeftohtësi t'a bindë Kristinën që t'i japë fjalën dhe të krijojë raporte dashurie me 'të. Ç'e shtyn atë? Ai nuk është njeri i epsheve dhe nuk gjejmë asgjë, që të na provojë se ai lakmon apo kërkon të çfrytëzojë rastin e volitshëm, që iu krijuar dhe kjo është jo vetëm morale, po edhe e bukur. Po, nga ana tjetër, autori nuk nq ka dhënë të drejtën as që të mendojmë se hero është njeri me ndjenja djaloshare romantike, të cilat do të prisnin rastin të shpërthenin. Ai është i ftohët, bile edhe i rreptë e nuk e dimë ç'e shtyn t'a zejë Kristinën në fjalë dhe, nëpërmjet arësyetimeve, t'a bindë se mund dhe duhet t'a duan njëri-tjetrin. Kështu, Ramizi i ngjan më tepër njeriut që i është mbushur mëndja të martohet me një vajzë, se sa djaloshit me ndjenja të thella, që provon çastet më çqetësonjëse të dashurisë. Ai preokupohet shumë se si do t'ja thotë Kristinës mendimin e vet, po nuk preokupohet pothuajse fare për ndjenjat, që i zgjon prania e Kristinës.

Edhe Kristina, ndonse i jep fjalën Ramizit, s'na duket se e dashuron me gjithë mënd atë. Ajo vihet në pozitën e vajzës, së cilës i zë rrugët një djalë i padëshiruar dhe që, për të shpëtuar prej tij, e gënjen, duke i dhënë fjalën se ka

për t'i vajtur në takim. Dhe, bile, ndonse autori ka dashur të na e japë atë, si vajzë të cilët e pakëz naivë, që nuk e njeh jetën, Kristina, në raport me Ramizin, duket një vajzë tepër praktike dhe shpirt-thatë. Përpjekjeve të djaloshit për të çelur bisedën ajo u përgjigjet në formë tepër banale, do të thoshim: «*E ku është ajo kohë tanis...*» (f. 81), «*ti i di punët më mirë se unë, i di ligjet tona të rrepta*», (f. 88). Me fjalë të tjera ajo i thotë: po të ishte *kohë tjetër* dhe po të mos ishin «*ligjet tona të rrepta*», atëherë mund të bënim q'të doje ti. Po Ramizi është më i shkathët në fjalë dhe ajo detyrohet të pranojë, se pas luftës do të martohen bashkë. Autori na thotë që Kristina «*kish pasur një përmbyssje të mendimeve. Përmbyssja kish qënë e vështirë, me dhëmbje, plot vuajtje...*», (f. 100). Po këto janë vetëm fraza. Lexonjësi nuk sheh asnjë përmbyssje reale në shpirtin e vajzës. Veç kësaj, në kapitullin e fundit të novelës, ndodh një transformim i menjëherëshëm në karakterin e heroinës. Ajo shpërthen dhe, e rrëmbyer prej frikës e prej pasionit, nuk e kontrollon më vreten, bile, nuk e ndjen më as *p'agën* (?) po «*mbështillej* (?) *pas gjoksit të tij dhe e puthte ku mundëte. Ai përpiqej t'a largonte me kujdes...*», (f. 124). «*Edhe në çastet e fundit ajo u mat t'a përqafonte, po nuk arriti dot. Ai nuk u afroa*», (f. 116). Një atmosferë e tillë sundon në novelë prej faqes 110, deri në faqen 116. Kjo atmosferë, ndonse autorи ka vepruar me qëllim kështu, e ul vlerën e veprës për disa arësy. Së pari, temperamenti i Kristinës dhe lidhjet e saj me Ramizin janë t'atil'a që edhe në momente aq tragjike nuk do të shpinin në shpërthime

t'atilla të pakontrolluara, gati-gati histerike. Përkundrazi, logjika e karaktereve dhe e rrerhaneve të paraqitura prej autorit do të shpinin në mënyrë të natyrëshme në një qëndrim stoik edhe në çastet e fundit para vdekjes, gjë që do të ishte më e bukur e më realiste dhe do ta kishte shmangur përdhosjen e figurës së Kristinës. Nga ana tjetër, një qëndrim më artistik e më besnik ndaj së vërtetës e ndaj karaktereve, do të kishte evituar edhe përgjasimin e tepruar të këtyre skenave me disa shkrime e filma, ku elemente çekuilibrimesh të tilla janë përdorur me tjetër logjikë e me të tjera që lime.

Në tërësinë e vet novelës «*Endëra dhe plagë*» ka një tingull lirik-romantik dhe pëershkohet nga ndjenjat e thella të dashurisë e të dhëmbjes së shkrimtarit për gjithë ata të rinj, që luftuan dhe vdiqën për atdhe. Edhe nëpërmjet episodësh të veçantë ndihet atmosfera e luftës, ashpërsia dhe romantizmi i saj, sidomos në kujtimet e Ramizit për operacionin e dimrit. Po kaq është pak. Autori i novelës nuk ka mundur të na japë shumë hollësi për luftën, për psikologjinë e për mendimet e partizanëve dhe, për të mbushur boshillëkun, është larguar disa herë nga realiteti i kohës dhe u ka imponuar heronjve arësyetime jo tipike, siç janë bisedat për revolucionin, parafytyrimi i së ardhmes, kritika e romanit «*Lulja e kujtimit*», etj. Edhe ndonjë episod konkret stonon. Kështu, për shëmbull, Ramizi i rrëfen shoqes si dolën një herë nga rrëthimi dhe si ai i çeli varrin shokut të vrarë me *bajonetë*. Kjo holësi, e huajtur nga vjershat, nuk qëndron nga çdo anë që ta marësh. Dhe mungesa e holësive konkrete jetësore i ka dhënë novelës në

mjaft raste karakter libresk, gjë që, aty-këtu, mer forma shumë të theksuara dhe manifestohet në faqe të tëra të veprës. Ja një rast, që bie ndesh me të vërtetën:

«Partizanët, para se të largoheshin, u ulën në gjunjë, kokëzbuluar me armët shtrënguar dhe u përkulen përpara kujtimit të shokëve të tyre», (f. 120).

Po letrarizmi theksohet më tepër, jo në përdorimin e hollësive të huajtura, po në «frazeologjinë e bukur», që rreh të fshehë mungesën e hollësive, siç e gjejmë, bie fjala, në faqet e para të kapitullit të katërt, (shih f. 99-100), ose në fraza të tillë:

«Ishte dora e saj! Ajo dorë magjistare sikur e ngriti që aty partizanin dhe e çojë në një botë tjetër...», (f. 110).

«Duart e tij ishin ngjitur pas kurrit (?! ) të saj. Sytë e partizanit ishin një det në stuhi», (f. 111).

«Befas plaga skuqi si një trëndafil i madh», (f. 67).

«Një dorë e padukëshme çeliku sikur ja shtrëngonte pa mëshirë trupin e sidomos kockat», (f. 19).

«Diellin atë çast e mbuloi tymi i predhave dhe pluhuri i tokës», (f. 16), etj. etj.

Siç shihet, meritat dhe anët e mira të novelës «Endëra dhe plagë» shkrihen dhe bëhen një me të metat e saj: konceptimi poetik me romantizmin fa's e të papërligjur, subjekti i thjeshtë dhe përpjekja për analizë të gjithanëshme e të thellë me mungesën e hollësive artistike dhe me letrarizmin, analiza psikologjike dhe zbulimi i karaktereve me trajtimin jo rea-

list të heronjve, afirmimi i gjithanshëm i romantikës së luftës me mospasovrimin e vërtetë të saj, përpjekja për të shkruar në një gjuhë të zgjedhur me figura të konsumuara e të vjetërura e me pasaktësi fjalori. Ky unitet ndërmjet të mirave e të metave mbasë ka ardhë nga në shkrimtari është nisur më tepër nga dëshira dhe nga parafytyrimet e veta, se sa nga materjali jetësor..

*(Botuar në gazetën  
«Drita» 10 nëndor 1961)*

## **PROZA E NJË POETI**

«Unë kam tani një ushtëri të tërë të vdekurish... Vetëm se ata tani, në vend të uniformës, kanë secili nga një thes najloni. Thasë të kaltërt me dy vija të bardha dhe një shirit të zi, prodhim special i «Olympias». Dhe këto thasë pastaj futen në arkivole. Në arkivole të vegjël, me dimensione të caktuara, sipas kontratës me komunalen. Në fillim ishin vetëm ca skuadra arkivolesh pastaj u krijuan kompanitë, pastaj batalionet dhe tani po plotësohen divizionet dhe regjimentet. Një ushtri e tërë e mbëshjellë me najlon».

Kështu mendon gjenerali i Ismail Kadaresë, i cili ka ardhur në Shqipëri nga një tjetër shtet, për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të rënë në luftën për robërimin e për mbajtjen në sklavëri të vëndit tonë. Ata thasë najloni mbushur me kocka janë një prej rezultateve të rëndësi shme e rënqethëse të luftës së zhvil'uar ndërmjet pushtonjësve dhe popullit, që është ngritur të mbrojë lirinë dhe të ruajë dinjitetin e vet

kombëtar. Kjo është ideja e madhe që autor i romanit «*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*» ka mi- shëruar nëpërmjet subjektit të veprës dhe episodeve që e mbushin dhe e plotësojnë atë, duke theksuar mendimin se kushdo që përpinqet të shtypë e të skllavërojë popujt, herët a vonë, në fund të funtit, do të detyrohet të mbledhë eshtrat e ushtarëve të rënë në tokë të huaj të turpëruar e të mallkuar. Këtij mendimi të rëndësishëm, që përcakton fizionominë e veprës, i nënshtrohen të gjitha mendimet e tjera, që nuk janë të pakta e më pak të rëndësishme.

Në roman, të gërshetuara natyrshëm, si reflekset e rrezeve në faqet e shumta të një prizmi, përshkruhen anë dhe aspekte të ndryshme të luftës dhe vështrohet ky<sup>i</sup> fenomen tronditës i jetës shoqërore nga pikshikime të ndryshme. Në radhë të parë autorin e romanit, siç është e natyrëshme, që ka preokupuar natyra e luftës dhe, duke i dhënë rrugë këtij problemi, ai me të drejtë ka nënvizuar mendimin, se shqiptarët eshtrat e bijve të tyre i kanë brenda kufijve të Shqipërisë, domethënë, ata janë vrarë e kanë vrarë, të detyruar prej atyre që janë munduar t'i shtypin e t'i gjunjëzojnë. Janë të huajt që vinë në Shqipëri për të mbledhur eshtrat e bashkatdhetarëve të tyre, mbasi kanë qenë ata, që dikur kanë dërguar ushtarë e armë dhe kanë dashur të nënshtrojnë dhe, për të nënshtruar, të djegin e të vrasin. Duke qenë një vepër kundër luftës, që njeh dhe pasqyron karakterin e egër të ndeshjeve të armatosura, romani i Ismail Kadaresë është, nga një anë, afirmim i luttës çlirimtare të popujve dhe, nga ana tjetër, dënim dhe paralajmërim për agresorët, cilëtdo qof-

shin këta. Pasi gjenerali dhe prifti (ose, më mirë të themi, ai që hiqet si prift) kanë mbledhur të gjitha eshtrat dhe po gatiten që të kthehen në atdhe, qetësinë e dy gjeneralëve të dehur, të cilët luftojnë kundër njëri tjetrit me «ushtritë e vdekura», e prish zhurma që vjen nga jashtë prej reparteve të ushtrisë sonë, që përgatiten për paradën, që do të zhvillohet me rastin e përvjetorit të çlirimt. Ky fakt artistik, emocional dhe i përdorur me vënd, është edhe shumë i pasur në ide, mbasi thekson njëkohësisht rezultatin e luftës-çlirimin e Shqipërisë, — dho lë të nënkuptohet, që, po të guxojnë gjeneralët e huaj të na sulmojnë, ata do të detyrohen përsëri, pas disa vjetësh, të vinë e të mbledhin eshtra fushave e maleve tona.

Afirmimi i luftës çlirimtare të popullit shprehet edhe në qëndrimin emocional të shkrimit tarit ndaj heroikës së luftës popullore, ndaj trimërive dhe akteve burrërore të njerëzve të thjeshtë. Megjithëse tema e romanit është e një plani tjetër, autori, nëpërmjet disa episodeve të rralla, po shprehëse e kuptimplotë, ka arritur të japë edhe madhështinë e heroizmit, sidomos nëpërmjet përshkrimit të trimërisë së malësorit, Nik Martini, ditën e parë të pushtimit.

«Atë ditë, — rrëfen prifti, — ai doli dhe luftoi i vetëm në katër pika të ndryshme gjersa u lodh e u këput. Thonë se kur iu mbaruan fishekët dhe pa si kamjonet me ushtarë po vraponin drejt Tiranës, qau. E rrethuan nga të gjitha anët dhe e coptuan me kama. Varr nuk ka. Ka vetëm një këngë për 'të», dhe, me këto fjalë poetike, siç është i gjithë përfytyrimi i luftës

së Nik Martinit, që tërhiqet, po nuk pushon luf-tën e nuk dorëzohet, e kurorëzon autori trimëri-në dhe atdhedashurinë e njerëzve tanë të thjesh-të, të cilët, kur atdheu vihet në rrezik, vveteti u e quajnë veten ushtarë dhe mobilizohen në luftë. Në këtë kuptim si dhe në kuptimin e përgjasimit të largët me një të vërtetë konkrete të jetës, Nik Martini mbetet në kujtesën e lexonjës-ve si simbol.

Ndër më tronditësit është në roman fati dhe gjesti i plakës fshatare (Nicës), nëpërmjet të eilës arrihet pika më e lartë e dramatizmit të romanit dhe mbështetet një prej ideve themelore të tij. Në atmosferën e dasmës, duke vështruar unifòrmën e gjeneralit të huaj, vjen e ndizet në shpirtin e zhuritur të Nicës dhimbja e nënës dhe e gruas së mbetur vejushë dhe urrejtja e pashuar e njeriut, që tmerret e kanë bërë nervaprishur e zemërgur. Gjithë kjo përtëritje e dhimbjes dhe e urrejtjes është dhënë bukur nëpërmjet monologut të brendëshëm të plakës, monolog që mbaron me një britmë, kur gjenerali, bashkatchetari i vrasësit të burrit e të vaj-zës së saj, bën të ngrihet në valle.

Gjeneralit, thotë shkrimitari: «i shpjeguan se plaka Nicë ishte një plakë e shushatur, mbe-tur qyqe, sepse në luftë batalioni ndëshkimore i kolonelit Z., i kishte varur të shoqin. Pastaj i thanë se koloneli i mori vajzën e saj në çadrën e tij dhe se vajza ishte katërmëdhjetë vjeçë dhe u mbyt në pus pa arritur akoma në shtëpi, tek po kthehej në mëngjes heret nga çadra e kolonelit. Pikerisht natën tjetër koloneli u zhduk. Thoshin se ai shkoi përsëri natën tek shtëpia e Nicës, sepse nuk e dinte që vajza kish vdekur...»

Kurse në mëngjes në shtëpi nuk kishte asnjerë  
dhe asnjeri nuk mori vesh ku shkoi koloneli...»

Dhe më poshtë:

«...Plaka Nicë se g'tha diçka tjetër që priftë  
nuk arriti ta përkthente, sepse fjalët e fundit të  
saj u mbuluan nga një murmuritje e fuqishme  
dhe para se të ndalte njeri ajo hodhi në dyshe-  
me në mes ulurimave të grave mu në këmbët e  
gjeneralit, thesin që mbante në kurrit. As që  
ishte nevoja që prifti të përkthente diçka dhe  
as që duhej më asnje përkthim sepse çdo gjë  
ishte e qartë dhe as gjë nuk mund të ishte më e  
qartë dhe më e tmerrëshme se ai thes që ra me  
zhurmë të shurdhër në dysheme, llangosur me  
copa të mbëdha balte të zezë e të lagur. Gratë  
u hodhën të llahtarësura mënjanë dhe mbuluan  
fytyrën me duar, kurse plakat bë-  
në kryq dhe përshpëritën me tmerr.

— E kish varrosur tek praku, — se kush  
bërtiti.

— Korba ti, moj Nicë!

Plaka Nicë u kthye dhe iku e lagur quill dhe  
e ndotur me baltë siç ishte dhe asnjeri nuk men-  
doi më ta ndalonte sepse ajo që ish pér t'u bëre  
u bë».

Ky episod, (të cilin nuk po e analizoj nga  
ana gjuhësore, mbasi gjithë romani lë shumë pér  
të dëshiruar nga kjo anë) që ka ngjallur interes,  
aprovim e mosaprovim, edhe kur u botua tregimi  
«Gjenerali i ushtrisë së vdekur» në revistën  
«Nëndori», ka vërtet një ngjyrë makabre, po më  
makabre se kapitulli i romanit, mijra herë makabre,  
është vetë lufta me tmerret dhe mon-  
struozitetet e saj, prej të cilave në veprën e Is-  
mail Kadaresë, si në çdo vepër artistike, nuk

është pasqyruar veçse një pjesë fare e vogël. Po nuk është vetëm kjo arësyjeja që na shtyn të flasim për historinë e Nicës, të cilën lufta e vrapo dhe e nxirosi. Në radhë të parë, duke çfletuar romanin e duke u rënqethur, lexonjësi, që e ka njojur dhe që e kupton luftën, s'ka si të mos mendojë, se Nica vrapo vrasësin e burrit e të bijës së vet, ashtu si i gjithë populli ynë vrapo ata që e vrapë dhe që deshën ta mposhtnin, në mos ta çduknin fare. Kriminel nuk është çdo njeri që vret. Kriminel është ai që vret pa faj, në emër të egoizmit të tij e të klasës së tij dhe, prandaj, të vrasësh kriminelin, në fund të fundit, është një akt shoqërisht pozitiv e, do të thosnim, humaritar, përderisa ndëshkon krimin dhe çliron njerëzit prej krimeve të tjera të mundëshme. Nica nuk ka menduar kaq thellë kur i ka rënë kolonelit me sëpatë kokës, po, megjithkëtë, akti i saj qoftë edhe i pa argumentuar në këtë mënyrë, po i nxitur prej dhimbjes e urrejtjes, e ka të plotë vlerën shoqërore pozitive.

Po, mund të pyesim, a bëri mirë ajo që çvarroosi kolonelin dhe i hodhi kockat e tij para këmbëve të gjeneralit? Ka që thonë se nuk bëri mirë, veçse çështja s'mund të shtrohet kështu, duke u nisur prej arsyetimesh abstrakte.

Nica e romanit të Ismail Kadaresë është një grua fshatare e thjeshtë, e fortë, grua që për t'u hakmarrë ka vrarë një burrë, oficer madhor të ushtrisë armike dhe që njëzet vjet ka jetuar, duke mbartur në shpirt brengën e madhe të nënës e të bashkëshortes kërcure dhe peshën e vrasjes së kolonelit Z., të cilin e ka

varrosur vetë për të humbur gjurmët. Një grua e tillë, në rrëthanat konkrete që janë përshkruar në vepër, nuk mund të vepronë ndryshe. Shpërthimi i saj, jo vetëm është mbrujtur gjatë njëzet vjetëve, po vetë gëzimi i dasmës, nga një anë dhe prania e gjeneralit, nga ana tjetër, që asaj i duket se sillët ndryshe nga ç'duhej të sillej përfaqësonjësi i një ushtrie që dikur i ka vrarë e i ka shkretuar, bëjnë të çfryjë furishëm e në mënyrë të pakontrolluar gjithë vleri i një shpirti të brengosur. Pra, nga pik-pamja psikologjike, gjesti i Nicës, sado tronditës, është një gjest që duhej pritur. Në gojën e të pranishmëve, autori i romanit, e ka vlerësuar këtë gjest vetëm me katër fjalë:

— Korba ti, moj Nicë!

Po ç'pasuri mendimi e ndjenjash fshehin në vetvete këto fjalë. që aq në mënyrë 'të pa-përcaktuar, po konçize, flasin për dramën e madhe të familjes së Nicës, për vuajtjet e gruas fatsezë, për aktin e vrasjes e të fshehjes së kolone-it, për shpërthimin e saj 'të papritur dhe për sjelljen e kockave të kolonelit në dasëm. Shkrimtarit nuk i ka shpëtuar edhe një hollësi tjetër e rëndësishme psikologjike: gjendja shpirtërore e plakës, pasi i ka hedhur eshtrat e kolonelit në këmbët e gjeneralit.

«Plaka Nicë, — thuhet në roman, — u kthye dhe iku e lagur dhe e ndotur me baltë siç ishte dhe asnjeri nuk mendoi më ta ndalonte sepse ajo që ish për t'u bërë u bë».

Në këtë përshkrim fare të shkurtër lexonjësit, në vënd të gruas me shpirt të revoltuar dhe të egërsuar, që nuk është në gjendje të

kontrollojë vetveten i del përpara një njeri me nerva të çkrehura pas një tensioni të lartë nervor, që tanimë, jo vetëm nuk ka pasion të bëje diçka, po qëndron krejt indiferent edhe ndaj asaj që ka bërë.

Romani i Ismail Kadaresë është një roman episodesh, që, duke mos patur lidhje të drejt-përdrejtë me njëri tjetrin, prap janë të shkrirë me njëri tjetrin, si shprehës të ideve themelore të veprës, si reflektime anësh të ndryshme të të njëjtit fenomen, si ndodhi të kaluara me të cilat ndeshin mbledhësit e kufomave. Ndryshe nga episodet e tjerë, sjellja e eshtrave të kolonelit Z. dhe ngjarjet që pasojnë, janë përgatitur prej shkrimitarit në të gjithë veprën, kështu që për lexonjësin shpërthimi i Nicës nuk është një rrufe në qiell të pastër. Veç kësaj, nëpërmjet kapitullit të dasmës dhe gjithë ekspozimit të fytyrës kriminale të kolonelit Z. autori i romanit, mbështetur një prej ideve më të rëndësishme të veprës: qëndrimin e tij të diferençuar ndaj dhunës e luftës.»

Koloneli Z. është përfaqësonjësi më tipik i pushtonjësve fashistë dhe mishërimi i egërsisë, gjakësisë dhe poshtërsisë. Sa herë përmëndet emri i tij në roman e, sidomos, sa herë që mbledhësit e kockave bijen në gjurmët e tij, lexonjësi e sheh me urrejtje emrin e kolonelit dhe kjo urrejtje shtohet e forcohet gjersa mer formë të plotë në skenën e gjetjes së eshtrave të tij. Plaka Nicë, duke e çvarrosur dhe duke i hedhur eshtrat në dysheme, duket se i thotë gjeneralit: «*Merrni eshtrat e kësaj bishe të neveritëshme, se ato iu përkasin juve, shokëve të*

*tij, që duke zbuluar varret na çelni plagë dhe duke mbledhur eshtrat, mblidhni e nderoni krimet dhe poshtërsitë e bashkatdhatarëve tuaj».*

Këtë ide e gjejmë të mishëruar në roman edhe në përshkrimin e fytyrës enigmatike të kolonelit — prift, i cili, pa u thënë shprehimisht në vepër, duket se ka qenë i një dore me kolonelin Z., kriminel e shpirkazëm, njeri me bindje thellësishët reaksionare, që justifikon shtypjen kombëtare, vrasjet e poshtërimet, duke gjetur përkrahjen e disa arsyetimeve teorike nga më ciniket e më absurdet. Fizionomia e këtij njeriu me veshje prifti është zbuluar mirë në vepër dhe ndonse me fjalë të kursyera, është dhënë diçka që e shtynë lexonjësin të përfytyrojë vetë se ç'mund të ketë qenë e ç'mund të ketë bërë ky prift gjatë luftës e ç'mund të bëjë më tej, po t'i takojë të hyjë përsëri në luttë. Prifti, ashtu si koloneli Z., është mishërim i shtazërimit shpirtëror të eksponentëve të imperializmit, mishërim i asaj kategorie njerëzish, që kriminalitetin instinktiv të tyre, mundohen ta mbështjellin me fletë librash teorike të har-tuara prej ideo'ogëve të tyre. Kjo fytyrë bëhet edhe më e neveritëshme se koloneli Z., kur marrim vesh, se mbi kufomën e kolonelit të vrarë, prifti vërtitet si krymb plehërash, duke lakuuar pasurinë e nënës së kolonelit dhe vejushën e tij.

Prifti dhe koloneli Z. janë prej atyre njerëzve në ndërgjegjen e të cilëve rëndojnë, jo vetëm krimet e kryera kundër popujve të tjerë, po edhe kundër popullit të tyre, se ata, si përfaqësonjës të bindur të egoizmit imperialist, njëzet vjet më parë, kanë sjellë në Shqipëri di-

vizonet e regimentet, të cilave tani u mbledhin eshtrat. Ne nuk mund të jemi indiferentë ndaj atyre mijra e mijra dramave rënqethëse të njerëzve të thjeshtë e të familjeve të tyre, edhe pse e kuptojmë fare qartë, se në luftë ushtari armik meriton vetëm të asgjësohet, nëqoftëse nuk dorëzohet. Fajtorë për humbjen e mijra njerëzve në luftë janë pikërisht ata që i kanë dërguar kundër nesh dhe që tani dërgojnë njërejt për t'u mbledhur eshtrat, ata që i kanë dërguar drejt vdekjes, që i kanë vrarë, që i kanë tallur, duke i quajtur «*të rënë për atdhe*», e që, pasi i kanë vrarë, bëjnë sikur i nderojnë, duke u mbledhur kockat. Historia e luftave ka pruvuar më se një herë, se për të shpëtuar prej dramave të tilla të përgjakëshme, popujt nuk kanë udhë tjetër, veçse të hedhin pushkën nga një krah në tjetrin, t'i kthejnë armët kundër atyre që i dërgojnë drejt vdekjes. Një rrueë dalje e tillë nuk jepet në roman, se as që ndodhi diçka e tillë gjatë luftës, që pëershkrumet, po i gjithë romani është një thirrje kundër nxirrave të luftës, kundër atyre që dërgojnë ushtarë e mbledhin kufoma. Ndoniëherë kjo ide jenë edhe shprehimi, si për shëmbull, në rastin, kur nxirren eshtrat e ushtarëve që kanë luftuar përkrah partizanëve tanë. Kur grupi i varrmihësve gërmont në një varrezë dëshmorësh, giejmë në roman edhe këtë pasazh:

«*Erdhi një grua e shkuar në moshë me bucelë në kurriz.*

— *Do t'i marrin? — pyeti me zë të ulët.*

— *Do t'i marrin, — iu përgjegjën shumë pëshpëritje.*

*Plaka rrinte në këmbë pa e zbritur buce-*

*lën nga kurrizi dhe vështronte si të tjerët. Pastaj ajo bëri ca hapa përparrë dhe iu drejtua punëtorëve të komunales:*

— I thoni atij që të mos i përzijë këta me të tjerët, — biro, — tha plaka. — I kemi qarë me ligje si djemtë tanë», se lufta ka edhe kriminelë, edhe viktima edhe heronj e ndaj tyre nuk mund të mbahet i njëjtë qëndrim e, nga ana tjeter, ndërsa ndërmjet viktimave ka njerrëz, që bien në llogoret e betejave, duke zbruzur armët, që u kanë dhënë në dorë e të tjerë, që përpiken si varfanjakë të shpëtojnë lëkurën, heronj mund të jenë vetëm ata që e kupojnë të keqen. dhe ngrihen kundër saj, duke marrë anën e të shtypurve kundër shtypësve, qofshin këta edhe bashkëatdhetarët e tyre, se e vëtmja armiqësi reale ndërmjet njerëzve është armiqësia klasore, që shpie edhe në armiqësi kombëtare.

Në fatin e «ushtarit» që ka mbetur pa emer, se të gjithë e quanin «ushtar», autori i romanit ka zbuluar edhe një anë tjeter të luftës: *dezertimin*, i cili si çdo fenomen nuk mund të gjykohet drejt, po nuk u pa karakteri i luftës dhe po nuk u mbajt një qëndrim i drejtë shoqëror ndaj tij. Të largohesh nga lufta imperialiste nuk është gjithçka mund të bëhet kundër luftës dhe autorëve të saj imperialiste, po, sidoqoftë, është një akt që dëshmon karakterin antipopullor të kësaj lufte dhe dëshirën e singertë të njeriut të thjeshtë për të jetuar i qetë e që të mos vritet për hesap të kapitalistëve. Kështu ndodh sa herë që njeriu i thjeshtë i popullit dërgohet në luftë kundër dëshirës së vet, kundër interesave të klasës së tij, pa ndonjë ideal. Fizionominë

morale të këtij «ushtari», të qetë, që kujton se ka shpëtar prej vdekjes, e shohim qartë në fletët e ditarit të tij, kurse batalioni ndëshkimore i kolonelit Z., duke e vrarë këtë «ushtar», sipas ligjeve të luftës, i thotë atij: «*Me që nuk deshe të vriteshe për ne, ne po të vrashim*».

Ana tjetër e çështjes, që e afron veprën e Ismail Kadaresë, si edhe në ide të tjera, me romanin «*Qyteti i fundit*» të Petro Markos, është afirmimi i qëndrimit humanitar të popullit tonë ndaj ushtarëve të mundur armiq, të cilët gjatë luftës së fundit gjetën strehë e bukë në shtëpitë e fshatarëve tanë dhe shpëtuan prej vdekjes e prej urisë.

Në radhët e «*ushtrisë së vdekur*» Ismail Kadareja ka futur edhe «soldatesën» (prostitutën), që vdes në mënyrë shumë të dhimbëshme e vrarë prej babait, i cili është prekur në mentalitetin e në sedrën e vet patriarkale prej marrëdhënieve që ka krijuar biri i tij me kurvën e bukur, duke braktisur edhe të fejuarën. Episodi është tronditës dhe akti i babait revoltojnës, kriminal, po ngjarja e pëershkuar duket më tepër si një shpërthim i autorit kundër mentalitetit patriarkal (po në mbrojtje të kuit?), se si një ngjarje që pajtohet me realitetin dhe me logjikën e sendeve. Duke u nisur edhe prej ndonjë tregimi të Ismail Kadaresë na shkon mendja të themi se atij i pëlqen disa herë të vejë përballë njëra tjetrës forca e mentalitete diametralisht të kundërta dhe të notojë ndërmjet tyre, duke ja lënë lexonjësit të mendojë e të givkojë. Në rastin tonë ai ka vënë përballë mentalitetit patriarkal të qytetit të vogël shtë-

pinë publike, të cilën me të drejtë, nëpërmjet fjalëve të kafexhiut, e ka gjykuar si një pasojë të okupacionit dhe po me kaq të drejtë i ka parë edhe prostitutat si viktima të sistemit shoqëror. Po kur vjen puna tek vrasja e prostitutës së bukur, ai vihet kundër logjikës së situatës e të karaktereve dhe ndërhyr arbitrarisht si autor e, me qenëse prostitutat i ka dhënë si viktima të sistemit shoqëror, vrasja tingël'on jo si një vetmbrojtje e «nderit» të qytetit, po si një protestë kundër konceptit që ka qyteti për «nderin». Nuk duam të hyjmë në pjesën e atyre që ia nënshtrojnë letërsinë etnografisë, po megjithëkëtë vetë mentaliteti patriarkal, është në kundërshtim me atë që përshkruhet në romanin e Ismail Kadaresë. Logjika e do që babai ta ngrejë armën kundër të birit, se ai ja ka prishur nderin dhe jo kundër prostitutës së pafajshme. Ndryshe s'kemi të bëjmë me një plaki patriarkal, po me një personalitet të çoroditur, që nuk përfaqëson asgjë. Mirëpo, me sa duket, autori i romanit nuk ka dashur të meret me një njeri dosido, po me përfaqësonjësin e një kategorie shoqërore të caktuar, që me aktet e veta shpreh një qëndrim e një mentalitet të caktuar shoqëror. Shumë-shumë mund të mendohet që shkrimitari ka dashur të vejë Shqipërinë e prapambetur përballë degjenerimit borgiez, pambjatur anën e asnjerës, po, ndoshta, edhe padashjen e tij, në këtë rast, ai ka anuar më tepër nga e dyta dhe ka dëmtuar v'erën ideore të veprës, ndonse edhe e ka zgjeruar.

E lamë për në fund atë që mund ta kishim thënë që në fillim: mendimin për figurën mora-

le të «gjeneralit të ushtrisë së vdekur», i cili në vijat e sipërfaqëshme të romanit, zë vëndin kryesor dhe, përveç heronjve e personazheve episodike të veprës, është një prej gjykatësve të ngjarjeve, që i dalin përpara e që kanë ndodhur në kohë të luftës. Në tërësi figura e gjeneralit është unike dhe e kuptueshme e, prandaj, nga ana thjesht artistike formale, është një nga realizimet e mira të prozës së Ismail Kadaresë. Ai është një tip flegmatik, i ekilibruar, i qëndrueshëm dhe që, pasi vëndos të bëjë diçka, e bën me bindje, pa zhurmë, me siguri. Kjo natyrë theksohet edhe më tepër prej misionit të tij të trishtuar e prej shoqërimit prej priftit të ngurtë e ogurzi, i cili sa i egër cinik e i lig, është edhe i thatë e nuk do të hyjë në botën e ndjenjave të tjetrit e të bisedojë me përzëmërsi. Po personalitetin shoqëror të heroit të romanit ç'ë përcakton? Si çfaqet ky personalitet në raport me subjektin e romanit dhe me idetë e veprës?

Para së gjithash kemi parasysh se ai është *gjeneral i një ushtrie imperialiste*, që ka marë pjesë në luftën imperialiste në Afrikë, e në rastin tonë, ai është përfaqësonjës i një ushtrie, që ka luftuar kundër nesh për të na skllavëruar. Nga ana tjeter, ai është përfaqësonjës i një ushtrie të mundur, i dërguar të mbledhë kockat e ushtrisë së tij, e cila, veç «*armatës së vdekur*» të mbështjellë me thasët e nejlonit të «Olympias» ka edhe «*armatën e gjallë*», të armatosur e që, *eventualisht*, mund të nisë një aventurë tjeter të përgjakëshme. Të gjitha këto, krahas tipit psikologjik, nuk mund të mos kihen parasysh në përcaktimin e qënies objek-

tive të personalitetit të gjeneralit dhe të qendrimit tonë ndaj tij e të atij ndaj nesh. Aty këtu, në roman janë bërë disa piketime interesante. Në një vënd gjenerali flet për kolegët e tij «*budallenj*», që e shpunë ushtrinë drejt çfarosjes e në tjetër vënd, thotë se atij nuk i intereson aspak se ç'ndodh në Shqipëri. Ne fund të romanit, bashkë me gjeneral-majorin revanshist të një ushtrie të NATO-s, pasi është dehur me konjak, i nxiten instinktet e luftëtarit dhe hedh përsëri në luftë armatën e të vdekurve. Po, në përgjithësi, autori na ka dhënë një «*gjeneral të mirë*», në kundërshtim me të gjitha ato që thamë më sipër. Vetëm plaka Nicë, në monologun e saj të brendëshëm, duke iu drejtuar gejneralit thotë:

*«Të ikësh sa më parë, sepse edhe ti je i mallkuar... Tani rri urtë si një qëngj dhe të qesh buza tek shikon se si kërcejnë njerëzia por unë e di se ç'ke në mëndje. Ti mendon si do të vijë dita që të sulesh në anët tona me ushtri dhe të na djegësh e të na pjekësh dhe të na vrasësh siç bënë shokët e tu...».*

Ky përcaktim i Nicës na duket më i drejtë dhe duhej të kish qenë platforma në krijimin e figurës së gjeneralit, pika politike e shoqërore nga duhej ta kish parë heroin autori i romanit. Mirëpo në vepër ndodh pothuajse e kundërtë. Ne nuk shohim një gjeneral që «*mendon... të sulet në anët tona*» dhe as një bashkëfajtor të krimeve që kanë kryer pushtonjësit e huaj në Shqipëri, prandaj fjalët e Nicës ngjan se janë shënuar që autori të tregojë diferençën ndërmjet një të ashtuquajturi «*qëndrim objektiv*» dhe qëndrimi të atyre që gjykuakan me

«*pasion*». Kështu të bën të mendosh vetë romani. Autori, mund të kishte analizuar më mirë idenë e veprës, pa rënë në vulgaritet e skematizëm, duke na dhënë një figurë letrare me dinjitet të gjeneralit armik, i cili, në fund të fundit, edhe skandalizohet kur mer vesh poshtërsinë e kolonelit Z. Bile skandalizimi do të kishte më tepër vlerë, sikur të mos kish qenë revoltim i një generali «të mirë». Po ç'mund të thuash për gjeneralin e një ushtrie kurdoherë agresive, që bën pjesë në NATO, kur mendon aq drejt për karakterin e luftrave dhe u jep të drejtë shqiptarëve, që kanë shpartalluar ushtrinë e tij? Autori i romanit ka dashur t'i qëndrojë ideve të shëndosha të veprës, nënpërmjet diferencimit që ka bërë ndërmjet gjeneralit, nga një anë dhe priftit e gjeneral-majoret, nga ana tjetër dhe, mbasë në këtë përpjekje për *diferencim politik* (nuk flasim për *diferencim moral*) është burimi i kësaj dobësie ideo-po'itike të romanit.

Kjo e metë ka edhe anën e vet letrare. Duke ndjekur gjeneralin e Ismail Kadaresë, vetve-tiu të vinë në mëndje personazhe të Hemingueit e të Remarkut, që pinë konjak, që janë ngaherë të trishtuar, që janë shpesh të papërcaktuar në ndjenja e në mendime, që janë «të mirë» në «kotësinë» e tyre. Ky ngjasim është larg çdo imitimi, po, sidoqoftë, është një ndikim i theksuar letrar. Dhe e keqja nuk është kryesisht tek ndikimi në vetevete, po tek përpjekja e Ismail Kadaresë që t'i nënshtrojë këtij ndikimi një personazh, që nga pozita e vet shoqërore objektivisht nuk ka asgjë të përbashkët me heronjtë «e brezit të humbur» dhe, nga ana

tjetër, duke ndjekur formën heminguejane ne do të gabonim rëndë po ta shihnim botën e njerëzit me sytë e Hemingueit, i cili, megjithëse shkrimtar i dëgjuar, ka patur shumë kufizime e gabime në botkuptimin e tij.

Prap se prap, tingulli i përgjithshëm i veprës së re të Ismail Kadaresë është i fortë dhe vlera ideo-artistike e saj e padiskutueshme. «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» është një prej atyre veprave, që dëshmojnë se letërsia jonë e re po lulëzon e përparon vazhdimit.

(Botuar në gazetën  
«Zëri i Rinisë» 21 mars 1962)

## **BUKURI E ASHPER E JETËS SHQIPTARE**

Tregimi «*Kënga dhe pushka*», që Dhimitër Shuteriqi e ka përfshirë në vëllimin e vet të fundit, mbasë do të kish qënë më mirë të mos ishte botuar, po titulli është i gjetur dhe nuk do të kishte patur fjalë të tjera që të shprehnin aq shkurt e aq mirë fizionominë e librit, bren-dinë e tij të pasur, nëpërmjet së cilës zbulohet bukuria e ashpër e jetës shqiptare.

Vë limi «*Kënga dhe pushka*» është në të-rësi një veprë unike. Tregimet që përbëlidhen në 'të, edhe pse të shkruara në vite të ndryshme, shprehin gati të njëjtat kërkime artistike të autorit, që janë afirmuar më së miri në realizimet më të bukura, — zakonisht më të vonat — e që spikatin edhe në të gjitha shkrimet e këtij shkrimtari. S'do mënd që secili prej tregimeve të vëllimit ka edhe veçoritë e veta, si veprë e veçantë, po të marë së bashku, ata plotësojnë njëri-tjetrin në zbulimin e disa ideve të rëndësishme, që kanë çqetësuar autorin dhe,

në këtë kuptim, çdo njeri prej tyre ngjan si pale e një lulje shumëngjyrëshe. Para së gjithash, në tregimet e Shuteriqit të bije në sy dashuria për jetën, një dashuri edhe kjo e ashpër, do të thoshnim, që lidhet e bëhet një me luftën për jetën, me përpjekjet për ta bërë këtë jetë më të mirë e më të bukur, për ta claruar atë nga çdo gjë çnjerëzore, që në fund të fitojë dashuria më njerinë, nëpërmjet clarimit të tij të plotë e zhvillimit të gjithanshëm. Duke çfletuar librin, këtë piksynam ideor të shkrimtarit e gjejmë të manifestuar gjithënjë me forcë nëpër ato copa të mëdha jete, që janë pasqyruar në tregime dhe jo vetëm në tregimet që flasin për kohën tonë, po edhe në ato që kanë një fillim gjysëm legjendar, edhe në ato që rrëfejnë histori të moçme. Dhe, prandaj, vëllimi «*Kënga dhe pushka*» të ngjan, në këtë kuptim, si një poemë në prozë, nëpër këngët e pavarura të së cilës, duke gjetur nga herë diçka të re, vazhdon të jetosh me ato ide të bukura e të mëdha, që të kanë tërhequr vëmendjen që në fillim, vazhdon të plotësosh diçka, që nuk të është thënë më parë dhe, nëpërmjet episodeve e heronjve, të gjesh, në aspekte të ndryshme, afirimin e pasjonuar të jetës e të luftës për jetën, në emër idealesh të mëdha shoqërore e kombëtare (jo veëm shoqërore dhe jo vetëm kombëtare, po të dyja së bashku kurdoherë). E théksojmë këtë, mbasi jemi të mëndjes, që në letërsinë dhe në artin e realizmit socialist, në vëndet socialistë, ndryshtë nga ç'ndodhë më parë e nga ç'ndodh tanë në leërsinë e në artin e vëndeve kapitaliste, idealet shoqërore të shkrimtarit nuk mund të jenë të çkëputura e aq më

pak të kundërtë me idealet kombëtare, ashtu si edhe këto të fundit nuk mund të kuptohen të pashkrira e të paplotësuara me idealet shoqërore socialiste. Krijimtaria e Dhimitër Shuteriqit dhe jo vetëm e këtij, po edhe e të tjerëve, është një shëmbull i mirë i demonstrimit të kësaj të vërtete të madhe, që nuk rrjedh prej nocionesh teorike, po që buron nga vetë jeta.

Kujtoni tregimet «*Fyelli i Tanës*», «*Zot e rob*», «*Venuzi i alpeve*», «*Trandafilat ndër avllia*» dhe keni për të parë afirmimin e jetës e të dashurisë më njerinë në më të ndryshmet çfaqje të tyre. Ndërsa «*Fyelli i Tanës*», me atë natyrën e vet gjysëm legjendare, është konceptuar e të tyre. Ndërsa «*Fyelli i Tanës*», me atë natyrën realizuar si një poemë lirike e gjërë dhe e pasur, në të cilën hymnizohet prirja e përjetëshme e popullit tonë drejt lumturisë dhe bukurisë dhe nënvizohet përjetësia e idealeve të mëdha njerëzore, të cilat, sa realizohen lindin ideale të reja e gjithënjë më të reja, që shtyjnë njerëzimin përpara, duke e shtuar bukurinë e jetës, në «*Zot e rob*», që do t'ishte një tjetë-kryevepër e prozës sonë, po të mos kishte atë fund ca të nxitur, kapen vetëm dy momente prej këtij këmbimi dialektik të idealit në realitet e të realitetit në ideal. *Uani* i tregimit është mishërim i shtypjes ekonomike dhe shpirtërore të varfanjakëve, të cilët, pa mundur t'u gjejnë e të shohin udhë tjetër në jetë, humbasin jo vetëm ndërgjegjen e klasës, po edhe ndjenjën e dinjitetit personal dhe bëhen shtojca të zotërinjve të tyre. Dhe jeta e tyre, pa e ditur as ata vëtë, bëhet e mjerueshme, e turpëshme, si jetë shërbëtorësh të skllavëruar shpirtërisht

E kaluara na la trashëgim edhe të tillë shërbëtorë, po edhe në qënien e tyre të prishur e të vrarë depërtuan rezet e jetës sonë, të cilat, pasi davaritën shtresën e shpirtit skillavëror, zbuluan atë pak gjë që kishte mbetur e paprishur dhe zgjuan ndjenjën e dinjitetit personal edhe tek Uani, i cili kish kohë që rronte pa e kuptuar se mund të ishte edhe ai njeri si gjithë njerëzit e tjerë. Jeta, pra, fitoi mbi skillavërinë dhe mbi shpirtin prej skillavi dhe, ndonëse autor i është treguar i ashpër ndaj Uanit (ai vritet, pasi ka vrarë zotin e tij) dy vdekjet nuk u ngjajnë dy jetëve. Ndërsa *Asllan efendiu* vulos me vdekjen fizike fundin e botës së tij, Uani vdes, pasi ka arritur të ngrejë dorë kundër shtypësit të vet, pasi ka ndier që bukuria e jetës i përket edhe atij, pasi ka kuptuar mbesën, që luftoi dhe ka njohur gëzimin që sjell vazhdimi i jetës njerëzore, jo më si një zvarrisje shterpore, po si një rendje e gëzuar përpara, ashtu siç ishte edhe vrapit i tij i fundit drejt qytetit, që nuk e arrijti dot.

Tjetër aspekt i bukurisë së ashpër të jetës përshkruhet në tregimin «*Venusi i alpeve*», në të cilin shkrimitari, vec të tjerave, diskuton pën kuptimin e lumturisë dhe të përgjegjësisë shoqërore të artistit dhe theksion me të drejtë, që nuk është kurdoherë i lumtur ai që rron mirë, mbasi mirëqenia s'është gjithë lumturia, po vetëm një pjesë e saj, një pjesë që edhe mund të mos pajtohet me lumturinë e vërtetë. Fati i heronje të tregimit, i *Poli Montjanit* dhe *Flamenit* rrëfen më së miri, jo vetëm sakrificat që kërkon arti i vërtetë në botën kapitalistë dhe detyrimet shoqërore të artistit, po edhe rrugët

e ndryshme që mund t'u japë e njëjta jetë njerëzve. Ndërsa Flameni i përballon me stoicizëm privacionet dhe varfërinë, Poli tradhëton idealitet e veta dhe i nënshtronhet kërkesave të tregut borgjez. Jeta ishte e bukur kur qe plot punë, përpjekje e dashuri, kur kishte ideale, ndërsa, kur vëndin e tyre e zuri nënshtrimi dhe etja përfitime, duke braktisur gjithçka, atëhere, — megjithëse shkrimtari hesht, — ne e kuptojmë se edhe vetë jeta do t'i përngjasë atij sfungjeri monstruoz që rreh të jetë portreti i Poletës së bukur, të dashur, gazmore e trime. Poli është njeriu që thyhet e shtypet nga jeta dhe ushqen iluzionin se ka fituar mbi 'të.

Mbase tepër i kërkuar dhe i papërligjur gjer në fund, tregimi «*Trandafilat ndër avllia*» është një tjetër shëmbull i burrërisë përtëjetuar e përtiu gëzuar jetës edhe kur ajo bëhet e padurueshme, sic do të thoshte Nikollai Ostromski. Subjekti, më tepër simbolik se realist i tregimit, na shtyn të besojmë singherisht në bukurinë e jetës, që egziston gjersa egziston dashuria dhe solidariteti, ndjenja sublime e sakrififikimit përlumturinë e tjetrit, vendosmëria përtë hedhur çdo hendek dhe bindja e thellë se edhe në fatkeqësi jeta mund të bëhet dhe duhet bërë e bukur. «*Ne shohim dhe për njëri-tjetrin*» — thotë heroi i tregimit dhe në këto fjalë përfshihet ideja e madhe e veprës, mendimi se duhet t'i japim dritë prej dritës sonë atyre që nuk kanë mundësi tjetër dhe të mos e braktisim kurrë njeriun, në fatkeqësinë e vet. Një fatkeq i vëtmuar është ngahera fatkeq, po një fatkeq, që mbështetet në krahë të sigurta e që

ka vullnet e vendosmëri, s'ka pse të mbahet e të quhet i tillë në kohën tonë, në shoqërinë tonë, që është më njerëzoria. Kjo ide e shëndoshë dhe e fiksuar mirë e ka shpëtuar tregimin prej përlotjeve sentimentaliste, që karakterizojnë shumë shkrime me subjekte të atilla. Bile, ta duket se Shuteriqi, prej sigurisë në kuptimin e drejtë të fenomenit, ka folur në tregim jo për një, po për dy të verbër.

Kështu ndodh që, megjithëse disa subjekte janë të rënda e dramatike, si në rastet që përmëndëm, edhe tek «*Xha Demi*», «*Një natë në Rogozhe*» e «*Kujtim i paharruar*», në tregimet e Dhimitër Shuteriqit sundon drita dhe optimizmi, besimi tek jeta e tek mirësia, që patjetër do të fitojnë mbi vdekjen e mbi të keqen, dashuria për njerëzit, fryma e shëndetëshme humaniste që i përshkon fund e krye. Është kjo një dashuri e atil ë, që i bën të natyrëeshme fjalët: «*njeriu nuk vdes kurrë; vdekje s'ka*», të cilat po t'i analizosh me mëndje të ftohtë e jo me zemër, zor se mund t'i afrosh.

Tregimet e vëllimit «*Kënga dhe pushka*» kanë si element tjeter të përbashkët ideor edhe pasqyrimin në secilin prej tyre të fateve historike të popullit tonë, gjë që spikat më tepër tek «*Farë trimash*», «*Xha Demi*», «*Dy letra*», «*Shtatë vjet pas*» dhe, mbi të gjitha, tek tregimi monumental «*Ditët e sprasme të Gjorg Golemit*», që nuk është vetëm një ndër kryeveprat e prozës shqipe, po edhe një sintezë artistike e krenarisë kombëtare, e dhimbjes përfatit e ashpër që i rezervoi historia popullit tonë të vogël dhe e mendimit, se dora e vogël bëhet e fuqishme, po të mblidhet grusht e të godasë me forcë.

Nuk është aspak e rastit që në pjesën më të madhe të tregimeve përmëndet ose zë vënd me rëndësi lufta, se, në të vërtetë, është e pëmundur të flasësh për të kaluarën e popullit tonë dhe të mos përmëndësh luftën, që të fanitet në çdo faqe të historisë e në çdo kujtim. Që prej kohëve gjysmë legjendare («Fyelli i Tanës») është deri në ditët më të vona («Dy letra») toka jone është larë pareshtur me gjak: me gjak trimash, që luftonin për liri, me gjak armiqsh që kanë ardhur të na robërojnë. Po, siç shprehet Gjorg Golemi, «*nuk është e thënë që Arbëri të shuhet. Dhe po s'u shua, s'u pushtua!*». Ne i ndiejmë fort këto tregime, se ato shprehin një pjesë të ndjenjave e të mendimeve tona kombëtare dhe, si të tillë, janë prej atyre veprave, që rëndojnë si guri në vënd të vet.

Në tregimin «Takime paqe», duke folur në miting, *Vehbi Gurakuqi*, duke patur pranë kolonel *Sabatinin* thotë:

«*Zotin Sabatini nuk e hodhi lufta në Shqipëri. Po sikur ta kishte hedhur, mund të qëllonte që të gjëndeshim ballëpërballë dhe unë ta vrissja këtë ose ky të më vriste mua. Unë do ta kisha vrarë me të drejtë, se mbroja atdheun tim, popullin tim; ky do të kishte bërë një krim në emër të Duçes dhe të fashizmit.*

Të vrasësh kurrë nuk është gjë e bukur dhe as të përshkruash vrasjet nuk është ndonjë kënaqësi. Po, sikur të lemë mënjanë profkat e predikimit të «paqës midis bijve të Zotit», zhvillimi i deritanishëm i shoqërisë njerëzore nuk ka

mundur t'i japë fund dhunës dhe nuk do të mundet t'i japë fund, gjersa t'ekzistojë imperializmi. Dhe, gjersa është kështu, në çdo rast, njeriu do të shoh kush e përdor dhunën me të drejtë, për të mbrojtur popullin dhe të drejtat e tij dhe kush dhunon popullin për të nëpërkëmbur të drejtat e tij. Këtë provon historia dhe logjika e zhvillimit të shoqërive me konflikte antagoniste, prandaj edhe në letërsi, qëndrimi ideologjik dhe emocional i shkrimtarëve kurrsesi nuk mund të jetë i njëjtë karshi çdo dhune, mbasi artisti nuk mund të jetë një spektator i paanshëm i ngjarjeve tronditëse të historisë. Çdo pozitë e tillë do të ishte e rreme dhe hipokrite.

Tek Dhimitër Shuteriqi gjejmë disa raste interesante dhe kuptimplotë. Në tregimin «*Fyelli i Tanës*» «një nga ato çetat e *Kralit*» vret Mirin, duke ja këputur në mes këngëna gjepsëse, atë këngë që shprehte në tinguj dufin e dashurisë dhe etjen e pasuar për jetë dhe, prandaj, qëndrimi emocional i shkrimtarit dhe yni manifestohet nëpërmjet dhimbjes. Po «*vdekje s'ka*» gjersa këngët e «*fyellit të Tanës*» kalojnë nëpër jetën, «që mbruhet përditë e përvit me helm e me mjaltë» dhe kapërcen shekujt. «*Ceta e Kralit*» e vrau Mirin, po ajo nuk mund të vriste këngën, shpirtin e popullit, që mbeten të gjalla edhe paskëtaj dhe në këtë rëvërtetë mbështetet optimizmi ynë dhe i shkrimtarit, besimi në përjetësinë e në ngadhnjimin e këngës së jetës. Po kështu, në tregimin «*Kujtim i paharruar*», që ngjan më tepër me një shënim në bllok, se me një tregim, — Shuteriqi ka provuar jo vetëm një herë ta përdorë këtë for-

më pa arritur gjer tanë të na japë diçka që të mbetet, — flitet gjithashtu për dhunë e përvdekje, po theksi kësaj radhe bije, sa mbi aktin kriminal të fashistëve, aq edhe mbi trimërinë e vajzës shqiptare, prandaj në qëndrimin tonë emocjonal nuk ndihet dhimbja, po edhe krenaria, edhe dashuria e, sidoqoftë, nuk ndihet pesimizmi. Ajo luftoi për një botë të re dhe kjo botë fitoi.

Kurse në tregimin «*Shtatë vjet pas*», në të cilin prap ndiejmë krisma pushke kemi të bëjmë me afirmimin e domosdosë së dhunës revolucionare për të mposhtur reaksionin e armatosur e kështu t'iu jepet fund, jo vetëm vrasjeve, po edhe vdekjes nga uria e nga mjerimi, me atë domosdo historike, prej së cilës mund të shmanget vetëm skullavi i bindur ose ata që duan ta shohim këtë skullav gjithënë të këtillë, që nuk duan Uanin të ngrejë dorë kundër padronit të vet. Ndryshe është puna me tregimin «*Farë trimash*». Le të citojmë:

«... *U dëgjuan këmbë dhe hyri Seferi si i dalldisur.*

— *Haxhi Baba!* — *tha ai, duke iu marrë zëri,* — *Ka shpëtar nga burgu Dervish beu!*

*Haxhiu u gjënd në këmbë, me karadaklljen në dorë.*

— *Ka shpëtar! Ehë! Ka shpëtar!* briti. — *E mbushe kupën gjarpër!* Po s'do kafshosh më! *U kthye ai nga Shaban Sallaku, që vuri dorën në kobure,* po nuk arriti, se *Haxhiu ia zbrazi të shtatat, dhe gjëmoi oda, si prej shtatë rrufesh.*

*Pastaj Haxhiu u ul prapë këmbëkryq mbë belcën e tij të kuqe, me koburen që i lëshonte*

*akoma tym në dorë, duke u qetuar thuajse fare menjëherë, sikur të mos kishte ngjarë gjë».*

E kuptojmë aktin e Haxhiut dhe prap nuk pajtohemë me 'të. Nuk pajtohemë me egërsinë orientale të tij, ashtu si nuk jemi plotësisht me 'të edhe në çfaqjet e mirësisë e të drejtësisë; po me atë ngjyrë të theksuar Anadolli Në rastin që cituam të ngjeth mishtë, jo vetëm zbrazzi e kobures dhe përmbyssja e Shaban Sollakut, po më tepër Haxhiu që «*u ul këmbëkryq... duke u qetsuar thuajse fare menjëherë, sikur të mos kishte ngjarë gjë».* Këtu ka diçka prej krimineli me të cilën nuk mund të pajtohemë kurresesi, as ne, as shkrimitari, ndaj edhe Haxhi Xha-fën nuk mund ta pranojmë të gjithin, ashtu siç nuk mund edhe ta përligjim.

E tillë ka qënë jeta dhe letërsia s'ka pse ta «zbukurojë» duke e shtrëmbëruar me paramendim, po duhet të zbulojë bukurinë e saj nëpër atë mori të madhe çfaqjesh konkrete, në të cilat shpesh gazi është me helmin bashkë. Edhe humanizmi këshfu do kuptuar, se nuk kemi të bëjmë me humanizëm sa herë e vërteta e ashpër e jetës latohet e lëmohet që t'u përshtatet disa formulave teorike të dyshimta mbi «humanizmin». Për të fituar humanizmi i vërtetë njerëzimit i është dashur dhe do t'i duhet të ndeshet shpesh herë në beteja të përgjakëshme me armiqt e vërtetë të tij, që kurdoherë janë përfaqësuar prej klasëve çfrytëzonjëse. Vetëm kur njerzit të jenë realisht të barabartë mund të flitet për «vëllazëri» e për «harmoni të gjithë njerëzimit». Tregimet e Dhimitër Shuteriqit janë një afirimim tjetër i kësaj të vërtete të ashpër të jetës. Ai, duke i parë gjërat ashtu siç janë,

duke mos u gënjer të besojë se është arritur, ajo që praktikisht nuk është arritur, ka bindje tē thellë në realizimin praktik tē marrëdhënieve tē plota humaniste midis njerëzve dhe sheh filizat e krijimit tē këtyre marëdhënieve në shoqërinë tonë socialiste.

Si tregimtar, sidomos në librin «*Kënga dhe pushka*», Dhimitër Shuteriqi tërhiqet më tepër prej ngjarjesh tē «jashtëzakonshëme» dhe, mba-se, në shumë raste ai tē kujton Viktor Hygonë, me tē cilin duket se ka afinitet edhe në frysmin romantiqe që përshkon krijimet e tij në prozë. Po, në këtë mes, s'ka asgjë tē jashtëzakonëshme. Kërkimi dhe pasqyrimi i ngjarjeve tē «jashtëzakonëshme» është i dëmshëm vetëm n'ato raste kur shkrimtarë që s'kanë asgjë tjetër pér tē thënë, ropaten tē habitin lexonjësin me episode «tronditëse». Përkundrazi, Dhimitër Shuteriqi, na duket që tërhiqet prej ngjarjeve tē «jashtëzakonëshme», se kërkon ato ngjarje, që shprehin më së miri jetën dhe shprehin më me efikasitet mendimet, ato ngjarje që përbajnë në vvetvete, jo vetëm një potencë tē madhe jetësore, po që shprehin vëtë edhe qëndrimin e shkrimtarit ndaj tyre e ndaj jetës në përgjithësi. Veç kësaj, na duket se autori i tregimeve ka tē drejtë kur mendon se «*mrekullitë ngjasin dhe janë më njerëzore nga ç'pandehet*» dhe lexonjësi i mer pér siguri fjalët: «*Çdo gjë tē jashtëzakonëshme që ju kam treguar e kam marrë ngajeta, ka ngjarë*». Siç shihet këtu nuk kemi tē bëjmë me diçka tē rastit dhe aq më pak me një tē metë, po kemi tē bëjmë me një piksynim ideo-estetik tē menduar e tē brumosur plotësisht, me

një realitet artistik të padiskutueshëm, që pajtohet me të gjitha konceptet e tjera artistike të shkrimtarit e që është vënë për bukurin në shërbim të mendimeve të tij. Pra, nga një anë, kemi të bëjmë me personalitetin e shkrimtarit dhe, nga ana tjetër, me një realizim artistik nga më të mirët e prozës sonë, me një pjesë të rëndësishme të pasurisë së letërsisë sonë të realizmit socialist. Tregimet e vëllimit «*Kënga dhe pushka*», nga kjo anë, duke lënë mënjanë konsideratat e veçanta për seclin prej tyre, janë shëmbulla që provojnë edhe një herë, se një nga punët më të rëndësishme është vështira për shkrimtarin, është që të gjejë e të përcaktojë vetveten (jo për hir të origjinalitetit, po që të arrijë edhe lexonjësi të bindet se aksh shkrimtar do të shkruajë kështu e jo ndryshe) dhe të mundet, pastaj, për çdo rast të përcaktojë drejt pikën e vështrimit të ngjarjeve dhe mjetet e pasqyrimit artistik të tyre.

Krahasoni, për shëmbull, «*Fyellin e Tanës*» me «*Ditët e sprasme të Gjorg Golemit*». Është i njëjti shkrimtar (jo si emër, po si personalitet artistik) dhe prap është i ndryshëm. Ndërsa në tregimin e parë sundon lirizmi i harmonizuar me natyrën gjysëm legjendare të subjektit dhe ngjarjet jepen në *dy shtresa* (historia e Tanës dhejeta e sotme), që tregojnë se shkrimtari e ka gjetur edhe këtë herë mirë pikën e vështrimit nga mund të shihte e të jepë idenë e përfjetësisë e të prirjes drejt mirësisë e bukurisë, në tregimin e dytë kemi të bëjmë me një stil të matur, të fiksuar si figurat në një basoreljev dhe gjithë tregimi të përnjan me një monument. Përgjithësisht Shuteriqin nuk e tërheqin

hollësitë artistike, megjithëse ka momente të qëlluara konstatimesh të holla ngajeta. Me një stil të punuar mirë e me kujdes ai dalton ash-për, duke evidencuar format që i tërheqin më tepër vëmëndjen dhe që i japid më qartë lexonjësit karakterin e heronjeve dhe të ngjarjeve. Vet ai thotë në një prej tregimeve: «*Nuk dua t'ju rrëmbej me përshkrime dhe marifete stilin*», ndonse këtë pohim s'mund ta marim pa rezerva.

Një tjetër tipar dallonjës i prozës tregim-tare të Shuteriqit, që vrehet sidomos në vëllimin që po shqyrtojmë, është shkathësia në ndërtimin kompozicjonal të tregimeve dhe krijimi i tërësive artistike harmonike. Është e vërtet që kompozicioni nuk duhet «shënjtëruar», siç nuk duhet «shenjtëruar» asnjë mjet i shprehjes artistike, po më duket se mjeshtëria dhe zotësia e shkrimit tarit shprehen edhe në aftësinë që ka ai për të gjetur atë ndërtim kompozicjonal të rregullt, i cili do t'i shërbente më së miri për të shprehur gjithçka dëshiron të shprehë, pa ngushtuar idetë dhe pa cunguar pasqyrimin e gjithanshëm të jetës. Shuteriqi, sipas qëllimeve ideo-artistike që i ka vënë vetes, ka zgjedhur edhe kompozicionin e veprave. Atij i pëlqen sidomos të gërshtetojë, nëpërmjet shtresash të ndryshme, ngjarje që ndodhin në kohë të ndryshme, po që plotësojnë njera-tjetrën. Një ndërtim i tillë tregimesh i ka dhënë krah shkrimit tarit që të paraqesë në vepra perspektivën e kohës dhe, nëpërmjet saj, të tregojë edhe qëndrimin aktual ndaj ngjarjesh të herëshme, duke lidhur e shkrirë të djeshmen me të sotmen. Në disa raste («Një natë në Rogozhe», «Takime

paqe») shtresat e subjektit (ngjarjet aktuale dhe ato që kanë ndodhur më parë) gërshetohen edhe me kombinimin e episodeve të ndryshme, që nuk kanë një linjë të vetme, po që i bashkon vetëm ideja e veprës ose vetëm korniza e saj, që në të shumtën e herës, është një element artistik aktiv.

Në pajtim me këtë thurje të veprave, Dhimitër Shuteriqi ka provuar të bashkojë në tre-gimet e veta subjektin artistik me elemente të reportazhit e të publicistikës në përgjithësi dhe ndonjëherë i ka dalë mb'anë me sukses kësaj prove interesante, po që na duket se është një kërkim që nuk i përshtatet aq pësonalitetit të tij si shkrimtar, ndaj edhe ka dalë pa sukses.

Edhe heronjtë e pjesës më të madhe të trëgimeve të Shuteriqit janë copa shkëmbi të daltuara ashpër. E kanë tërhequr shkrimtarin, ashtu si ngjarjet e «jashtëzakonëshme» edhe karakteret e forta (zaten, nuk mund të ketë ngjarje t'atilla, pa karaktere të forta). Dhe mërita më e madhe e tij, në krijimin e tipave, mendoj se është, që ai ka mundur të na japë një galeri personazhesh *plotësisht shqiptare*. Në vëllimin «*Kënga dhe pushka*» Shuteriqi del para lexonjësve si njohës i thellë i veçorive tona kombëtare, i «*konstitucionit shpirtëror*» të vëçantë të popullit tonë, që është çfaqur e është përpunuar gjatë shekujve, që ka ardhë duke u lëmuar e duke u ndryshuar në pajtim me zhvillimin historik. Krahas kësaj, nëpërmjet tregimeve të ndryshme të vëllimit, ne e shohim këtë karakter shqiptari ballë pér ballë me stuhitë e kohës, më tepër përballë vështirësive dhe fatkeqësive, se gjëra e tij bukura dhe situatave të

qeta, të cilat duket sikur janë goditje që provojnë fortësinë e materialit prej të cililës shtë gatuar ky popull, që nuk e ka ulur kurrë kokën, që ka ditur të vdesë më këmbë dhe që, sado i prirë ndaj bukurisë dhe ndjenjave delikate, e ka bërë zemrën gur dhe veten shkëmb, kur e ka dashur puna. I tillë shtë *Gjorg Golemi* e *Nikodimi*, të tillë janë heronjtë e tregimeve «*Një natë në Rogozhe*», «*Shtatë vjet pas*», «*Dy letra*», etj. Veç, ndoshta për t'i evidencuar më tepër shkrimtari ka tendencën që të zgjedhë e të përshkruajë përgjithësisht heronj të vetëmuar, që jeta i ka lënë të vetëm. Pothuajse në të gjitha tregimet gjen personazhe, shpesh heronj kryesorë, që janë të vetëm në jetë. Kështu ndodh me heronjtë e tregimit «*Fyelli i Tanës*», që rrojnë të ndarë e të veçuar nga bota, kështu ndodh edhe me *Xha Demin* e me të tjerë. Në këtë preferencë mbaše fshihet edhe ideja, që njerëzve më parë u shtë dashur vetë t'u bëjnë ballë rrebeshevë të jetës, po, sidoqoftë, jeta shtë komune dhe, aq sa ka rëndësi përshkrimi me realizëm i heronjve, aq ka rëndësi edhe përshkrimi i marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Bile asnjëra prej këtyre nuk mund të arrihet pavarësisht nga tjetra. Këtë e provojnë edhe vetë tregimet e librit «*Kënga dhe pushka*», në të cilin «*Xha Demi*» mund edhe të mos ishte botuar i pa rishikuar, mbasi, kështu siç shtë, duket se nuk e shpreh plotësisht atë që ka dashur të thotë shkrimtari dhe momentet kyçë që përcaktojnë karakterin e *Xha Demit* nuk janë përfillur sa duhet e, prandaj, ky shtë një prej atyre rasteve të jashtëzakonëshme që ngjan se përshkuhen vetëm se janë të jashtëzakonëshme.

Po kështu mbasë duhej rishikuar edhe tregimi: «*Një natë në Rogozhe*», që tanimë nuk qëndron në radhën e tregimeve më të mira të autorit, i cili zë një vënd me rëndësi në letërsinë tonë të sotme sidomos si novelist.

(*Botuar në gazetën «Drita»*  
19 prill 1964)

## **ZEF SEREMBE**

E ka vështirë njeriu të flasë për poetët, sidosmos për poetët që do shumë, veprat e të cilëve i këndon e i rikëndon, pa arritur të mbetet ndonjëherë i ftohtë kundrejt tyre. E ka vështirë, se pothuajse kurrë nuk mbrrin të thotë gjithçka që do të thotë e asnjëherë nuk është i sigurtë, se ka shprehur shpirtin e poetit, që ky vetë e ka shkrirë në vargjet e tij...

Kështu po më ndodh edhe mua me Zef Seremben. Para se të merja penën për të shkruar, mendime të shumta më vërtiteshin në kokë, kurse tani e shoh, që s'do të mund t'i them këndonjësit as një të dhjetën e mendimeve e as një të qindën e stimës për këtë poet të mrekullueshiëm, për këtë njeri të lindur që të këndonte, po që jeta e shtrëngoi të qante e të këndonte njëkohësisht.

### **I**

Zef Serembe lindi në Strigar, afro tre shekuj e gjysëm pas shpërnguljes së shqiptarve për në Itali. Fshati i tij, me natyrë që të kujton

natyrën e Shqipërisë, gjendet në brigjet e detit Jon dhe i ka sjellë ndërmend poetit atdheun «*m'at anë të detit*» i cili vuante aso kohe nën thundrën barbare të turqve.

Jeta e poetit qe e dhimbëshme dhe e mbushur plot me fatkeqësi, që nuk e lanë të ngrinte kokën njëherë. Gota e fatit të tij ndodhi plot helm. Pesë momente të qënies e të jetës së Serembes na kanë dhënë poetin që njohim sot dhe që do ta kishim njohur shumë më mirë, sikur ai të kish patur mundësi t'i botonte të gjitha veprat e veta, ose, së paku, të na kishin mbetur trashëgim më shumë dorëshkrime prej tij.

*Momenti i parë:* Varfëria, që nuk iu nda kurrë dhe që e ndoqi këmba këmbës, që i solli mjerim pas mjerimi, po që i holloi më tepër ndjenjat dhe i forcoi më shumë mendimet demokratike dhe idealet përparamtare, që përshkojnë veprën e tij fund e krye.

*Momenti i dytë:* dashuria për atdhenë e të parëve dhe dëshira e zjarrtë për ta parë më së fundi të lirë Shqipërinë e Skënderbeut, atë vend, ndaj të cilët prireshin mëndjet e shpirti i çdo arbëreshi. Këtë dashuri Serembia e njohu në fëmijëri prej prindërve dhe e përforcoi kur ndjeu këngët mallëngjenjëse të De Radës, të Santorit e të Darës, kur këndoi lavdinë e të parëve dhe kur nisi vetë të hedhë në letër ato ndjenja të zjarrta, që e çqetësonin dhe e shtyinin të mos e hiqte kurrë mëndjen prej Shqipërisë.

*Momenti i tretë:* që ndikoi pothuajse në të gjithë letërsinë arbëreshe, ishin ngjarjet e mëdha revolucionare në Italinë e asaj kohe, sidomos lufta kundër Burbonëve dhe lëvizja e Ga-

ribaldit, në të cilat shqipëtarët e Italisë morën pjesë vepronjëse e shumë prej tyre u shquan si luftëtarë trima. Këto ngjarje të mëdha e theksuan fryshtat luftarake të letërsisë arbëreshë, forcuan prirjet e saj demokratike revolucionare. Ato ndikuan për mirë edhe në krijimtarinë poetike të Serembes. Kjo ndodhi edhe për shkak, se arbëreshët jetonin në kushte të atilla ekonomike, politike e shoqërore, që e ndienin më tepër se vëndësit peshën e shtypies e të varfërisë dhe nevojën e luftës së vendosur kundër tyre.

*Momenti i katërt:* Sëmundja që e përcollideri në varr. Ndoshta edhe këtë fatkeqësi ka patur parasysh Serembia në vjershën «Fati», ku thotë se vitet e para i shkoi me hare dhe jetë i dukej si pasqyrë, po pastaj:

*Nga mali u vrejt dhe egëras gjëmoi,  
U ktheva e pashë se ish me pika lot,  
U hap e zeza re dhe mua më mbuloi,  
E, pra, kështu më mundi e zeza shqotë...*

Një dhëmbje veshi i jepte atij trazime të mëdha dhe shpesh i shkaktonte kriza të forta shpirtërore, që arrinin deri në turbullime të rënda e që, më në fund, ja morën mëndjen e jetën bashk. Kjo gjëndje nuk kish si të mos ndikonte edhe në krijimtarinë poetike të Serembes, sidomos për të shtuar dëshpërimin dhe notat pessimiste e fataliste në poezinë e tij. Po, as kjo fatkeqësi nuk mundi ta shuaj në vjershat e tij dashurinë për jetën dhe për njerëzit, nuk mundi ta largojë poetin prej dëshirave të bucura, idealeve të larta dhe ndjenjave humanitare. Ai

nuk u mbyll në guaskën e vet, po shumë kshpërtheu me vrull shpirti djaloshar, si njeri me zemër të madhe e me qëllime fisnike.

*Momenti i pestë:* dashuria e pafat, së cilës Serembia i kushtoi disa prej poeziave të veta më të bukura e më të frymëzuara. Historia e dashurisë së tij është e dhëmbëshme sijeta e tij. Prej vjershavës dhe shënimave biografike marrim vesh se ai donte një vashë, e cila u mërgua në Brazil, duke i lënë edhe një brengë më të madhe se mospërfillja e dashurisë dhe, njëkohësisht, edhe një burim frymëzimi për krijime romantike. Vdekja e kësaj vajze e dëshpëroi akoma më tepër Seremben, i cili, i mjerë e fatkeq, deshi të gjente ngushëllim, duke i gjetur varrin në Brazilin e largët, ku ai ndeshi në vuajtje shpirtërore e mospërfillje të reja dhe, tek e fundit, vdiq në gjëndje shumë të keqe mendore.

Dashuria e pafat ka domosdo lidhje me sëmundjen e tij dhe është një element tjetër jetësor që ka ndikuar fort në krijimtarinë e tij poetike, sidomos për të theksuar frymën romantike dhe ndjenjën e dëshpërimit në mjaft prej poeziave të tij.

Këto pesë momente të jetës së Serembës përbëjnë burimin frymëzonjës për pjesën më të madhe të vjershavës që njohim prej tij dhe, ashtu siç ishin të gërshetuara në jetën e poetit, ashtu i gjejmë të gërshetuara në mjaft prej krijimeve të tij e të shkrira në frymën e përgjithëshme që përshkon veprën e tij poetike.

## II

Zef Serembe është poet romantik. Në poezinë e tij, që është një nyje këngësh e brengash,

shprehen me duf hovet e shpirtit të çqetësuar të poetit, i cili e do jetën me zjarr, megjithëse ajo nuk i fali asnjë qast gëzimi e lumturie, ëndëron për dashurinë e pastër dhe shkrihet në ekstazë, ndonëse dashuria e tij nuk u përfill prej vashës, së cilës ai i kushtoi mjaft vjersha e mjaft peripeci të guximëshme e të mundimshme të jetës së vet; aspiron për lirinë e Shqipërisë, që e gjeti dhe e la të robëruar, pa mundur t'ja arrijë ditës kur të shihte të lirë e që të shkëll-qenin nën rrezet e diellit katundet e qeshur të Arbërisë; éshtë i etur për çlirimin e përparimin shoqëror dhe këtu, mbasë gjen një prej ngushëllimeve të pakta, kur sheh garibaldinët apo kur dëgjon se ngrihen në luftë popujt e shtypur; urren robërinë e despotizmin dhe çohet me zëmërim kundër tyre edhe kur përfaqësohen prej ndonjë njeriu, që éshtë edhe i dashur për 'të, siç ndodh, për shëmbull, në sonetën «Ali Tepe'enasit.» Romantizmi i Serembes nuk mund të themi që éshtë i palëkundëshëm. Diku ai éshtë i qetë si det i fashitur, diku zien përbrënda e ngryset, në tjetër vënd rrëmbehet e thërret me gojën plot, si luftëtar zemërhekur e, aty këtu, bije, rrëzohet e shkon thellë në humnerën e dësh-përimit, që i shkakton pleksja e shumë dhëmbjeve e fatkeqësive në një nyje të vetme. Sikur të mos ishin këto ndryshime shpirti, të reflektura në format e tiparet që mer hera-herës romantizmi i tij, ndoshta nuk do njihnim në vjershat e Serembes një poet aq të madh e aq njerëzor, mbasi në këto luhatje pasqyrohet një shpirt i çqetësuar dhe i pasur, një zemër njerëzore, që aspiron për lumturi edhe kun ndodhet në fund të humnerës, një mëndje, e cila gjen bukurinë

e jetës edhe kur kjo bëhet e padurueshme, një poet që nuk mbyllët dot përgjithnjë në guaskën e vet, po kërkon të shpërthejë e shpërthen, si përfaqësonjës luftëtar i idealeve të humbura e të larta kombëtare e njerëzore. Prandaj nuk është e drejtë ta quajmë Seremben poet pesimist, ashtu siç nuk është e drejtë të mohohen apo «të fshihen» ato elemente pesimizmi që gjeljmë sidomos në vjershat e dashurisë. Poetët e mëdhenj si Serembia, nuk kanë nevojë për ata kritikë «zemërmirë», që kujtojnë se janë aq të mëdhenj, sa i jepin të drejtë vetes të «mëshirojnë» kollosët e poezisë.

Në pesimizmin e në dëshpërimin e Serembes ne gjeljmë një qfaqje legjitime të shpirtit të poetit, i cili hoqi aq shumë gjatë jetës së vet. Atje ne zbulojmë tragjedinë e një njeriu e të një talenti në shoqërinë kapitaliste, dramën e një arbëreshi, i cili shihet si i huaj në vëndin ku lindi ai e ku patën lindur prindërit e tij. Mendoni për një çast një njeri të këputur, të sëmurë, të braktisur e të huaj në vëndlindje, një njeri pa mbështetje dhe, aq më tepër, pa shpresuar dashurinë e për të gjetur një vend, ku të ndihet si në shtëpi të vet! Nuk besoj të gjëndet lexonjës që të mos e marë pesimizmin e një njeriu të tillë, si shprehje të dhëmbëshme të një të vërtet të hidhur. Pesimizmi i Serembes nuk i ngjan aspak pesimizmit të romantikëve reaksionarë, të cilët dërdëlisin për kotësinë e jetës, kërkojnë vënde egzotike, bëjnë thirrje që të kthehet bota prapa e predikojnë si priftërinj jetën e përtej varrit e u këndojnë varreve. Përkundrazi! Pesimizmi i Zef Serembes, buron nga

jeta e poetit dhe pohon jetën, buron nga dashuria e pafat dhe pohon dashurinë, buron nga privacionet e njeriut në jetë dhe pohon dashurinë më njerinë.

Dhe jo vetëm kaq. Poezia e Zef Serembes është poezi e antitezave të fuqishme. Pothuajse në asnjë rast ai nuk pushtohet fund e krye prej pesimizmit. Gjithënë ndjenja e dëshpërimit të tij është në kontradiktë me bukurinë e jetës, me kujtimet e ndritura të fëmijërisë e të rinisë, me shpresat dhe me pamjen e madhërishme të natyrës. Gati kurdoherë ai ka diçka për të po-huar dhe vjershat e tij, edhe kur motivet janë të zymta, pohojnë lidhjet e ngushta shpirtërore të poetit me gjithçka njerëzore. Fati e goditi Serember, po nuk arriti kurrë ta mposhtë e ta çarmatos. Mendimet e tija për botën, për jetën në tërësi dhe për njerinë, janë mendime të shëndosha, ashtu siç janë të shëndosha edhe mendimet e tij për dashurinë e për miqësinë, që burojnë prej ndjenjave të thella humaniste të poetit. Idealet e çlirimt kombëtar e shoqëror janë kurdoherë më të fuqishme, se ndjenja e dëshpërimit personal dhe triumfojnë në mënyrë t'a-tillë, sa që në shumë vjersha të Serembes, nuk vrehet as hieja më e vogël e dëshpërimit, kurse në ndonjë vjershë tjetër, si «*Elegjia*» ai gjen rast të shkrijë në një të vetme brengën personale me fatkeqësinë kombëtare të popullit të vet. Prandaj romantizmi i Serembes është romantizëm përparimtar dhe fryma e vjershavë të tij është shoqërisht e mirë, jo vetëm se giysma e krijimtarisë së tij poetike nuk ka shënja dëshpërimi e pesimizmi, jo vetëm se idealet që fry-mëzojnë poetin janë përparimtare, po edhe pse

në dëshpërimin e pesimizmin e tij nuk shohim asnjë përpjekje për të ulur njerinë, për të mohuar jetën apo për të përbuzur e fyer ndjenjat e bukura njerëzore. Në asnjë prej krijimeve të veta Zef Serembia nuk u përngjan poetëve skandalozë të dekadentizmit, në vjershat e të cilëve gjemjë shpesh britma e ngërdheshje tragjikomike. Përkundrazi! Tingëllimi përfundimtar i këngëve të Serembes është thellësisht shoqëror, përparimtar dhe njerëzor.

Te vjersha e gjatë «*Elegji*», e cila është një ndër krijimet më mallengjenjëse të Serembes dhe e vetmja poezi e tij e shkruar me metër krejt të lirë, më tepër se kudo ndiejmë dëshpërimin dhe brengat e poetit, i cili... *ecën rrugë më rrugë, pa gjetur pushim, duke kujtuar malin që shkoi e vate.*

Ai i drejtohet të dashurës me këto vargje të dhimbëshme:

*O vashëzë, posi yll,  
Ne jemi shokë, të ndodhur  
Bashkë në mjerimet e dheut...*

Po në këtë vjershë, Serembia çfaqet para nesh me tërë gjerësinë e shpirtit të një poeti e të një njeriu të madh. Në mes të dëshpërimit, duke kujtuar fëmijërinë e rininë e parë, buza e tij qesh dhe hyn drita në vjershë:

*Ahere kjo botë  
Ish si dashuria për mua: i zhytur  
Unë rrija në atë gëzim të madh.*

Apo nuk janë të mrekullueshme vargjet kushtuar Shqipërisë dhe trimave të saj? I dësh-përuar prej humbjes së dashurisë dhe i goditur prej vdekjes së «vashëzës posa yll», ai nuk e harron Arbërinë e të parëve:

*Dhe m'erdhi keq që nuk munda...  
Të shihja të bëheshin të lirë  
E të shkëlqenin nën rrrezet  
E dielli katundet e qeshur  
Të Arbërisë sonë, me njerëzit  
Fatbardhë nëpër shtëpira... ose:  
...deti, që shtrihet i gjëre...  
Oh, sa mendime të bukura  
Trimash, që shkuan e vanë  
Më zgjon në mëndje...*

I tillë poet romantik është Serembia edhe në trajtimin e motivit të dashurisë së pafat dhe të vdekjes së të dashurës! Sa i gjerë, sa njerëzor, aq edhe i fuqishëm e tronditës!

Romantizmi i Serembes shprehet edhe në aspekte të tjera; në evokimin e së kaluarës heroike të popullit, në thirrjet e flakta për luftën çlirimtare, në frymën e përgjithështme të poezi-së së tij dhe në mënyrën subjektive të trajtimit të motiveve e temave objektive, gjë që është karakteristike për letërsinë romantike, e që mbetet ende si veçori e poezisë lirike në përgjithësi.

Zef Serembia është kryesisht poet lirik. Po të lëmë mënjanë vjershat «*Për lirinë e Venetisë*» dhe «*Zonjës Elena Gjika*», në të cilat lirizimi pasurohet me elemente e momente epike, të gjitha vjershat e tjera janë vjersha lirike. Zaten shumë rrallë mund të gjejmë vepra epike, ose më mirë të themi, «*thjeshtësishët epike*» në kri-jimtarinë e poetëve romantikë.

Si poet lirik, në historinë e letërsisë sonë, ai zë një nga vendet e para krahas emrave më të nderuar dhe është një prej atyre poetëve tanë, që mund të barabitet pa frikë me shumë poetë të tjerë të letërsive të njoitura. Serembia është origjinal në zgjedhjen e në trajtimin e temave, është spontan në shtjellimin e ideve e në parashtrimin e motiveve, është ngaherë i frymëzuar, përshkohet prej një atmosfere përgjithësisht elegjake, është mjeshtër i përdorimit të vargut, të figurave e të fjalës artistike. Ai arrin një nga kulmet e poezisë sonë kombëtare dhe, krahas De Radës së madhërishëm, Darës së pasjonuar dhe Santorit të shkathët, i ka sjellë letërsisë dhe kulturës sonë një kontribut të çmuar me veprën e vet poetike. Si gjithë arbëreshët e tjerë të mëdhenj, edhe Serembia banonte në Itali, po jetonte me Shqipërinë, me *mallin që s'ka të thënë*» për dheun e të parëve, me lavdinë luftarake të *motit të madh*, si i thonë arbëreshët kohës së Skënderbeut, me brengat e me hallet e Shqipërisë së robëruar, me krenarinë e Atdheut të parë, me dëshirën flakëronjëse e me shpresën ngazëllonjëse për t'ja arritur ditës së madhe të çlirimt, e cila për fat të keq, erdhë

vetëm njëmbëdhjetë vjet pas vdekjes së poetit.

Në shumë prej krijimeve të veta Zef Serembia i këndon Atdheut. Vargjet kushtuar Shqipërisë në mos janë më të frymëzuarit e më të bukurit, janë, pa tjetër, ndër më të singertët e më të fuqishmit. Këto aspekte të rëndësishme zbulojnë në motivet patriotike të vjershave të Serembes: hymnizimin e lavdisë luftarake, për shkrimin e gjëndjes së vëndit të robëruar, mallin e mërgimtarit dhe dëshirën për të parë Shqipërinë të lirë, dëshirë që shprehet disa herë me hove e thirrje të fuqishme luftarake, ose me ndonjë notë të dhëmbëshme dëshpërimi e padurimi.

*Arbëria, matanë detit, na kujton*

*Se ne të huaj jemi te ky dhe!*

*Sa vjet shkuan! E zemra nuk harron*

Që turku na la pa mëmëdhe... — shkruan në vjershën «*Vrull*», kurse në vjershën «*Për lirinë e Venetisë*» thotë:

*Skënderbeu edhe gëzon*

*Në parajsën ku pushon,*

*Sheh se shpresa jemi e qemë*

*T'Arbërisë ku, oh!... nuk lemë... — ndërsa*

në vjershën kushtuar Elena Gjikës, në të cilën flet gjerësisht, edhe pse me jo aq mjeshtëri sa në vjershat e tjera, për Shqipërinë e për shqiptarët, na jep këtë tabllo rrënqethëse të luftës e të mjerimit:

*Sa të zeza, q'lemeri!  
Oh, sa lufta ndër luadhe!  
Vëndet na mbetën në zi,  
Gjaku shkoi rrëke e madhe!*

Në trajtimin e motiveve patriotike, Zef Serembia shkon më përpara se bashkëkohësit e tij, kur i gërshton e i shkrin këto motive, me elementë të shëndosha e të fuqishme shoqërore. Mahnitëse për bukurinë e saj të ashpër dhe rrënqethëse për forcën e madhe të kontrastit është soneti «*Ali Tepelenasit*», në të cilën na jepet aq drejt, preraz dhe me mjeshtëri portreti i luftëtarit të patundur dhe despotit të madh. Si ka mundur poeti të shprehë gjithë atë pasuri ndjenjash të fuqishme e mendimesh të mëdha brënda kufijve të ngushtë të një soneti? Si ka arritur të zbërthejë ai vetëm në katërmëdhjetë vargje atë kontradiktë historike në personalitetin e Ali Pashait dhe të krijojë kontraste aq të rrepta artistike? Kjo është mrekulli! Të magjepsin edhe me bukurinë e tyre sonetat «*Pjetër Irianit*» dhe «*Koroneut*», në të cilat poeti tregon het sa i pasur në ndjenja e në mendime, aq i matur e i kursyer në fjalë.

Folëm shkarazi më lart për motivet e dashurisë në krijimtarinë poetike të Serembes dhe shënuam, se ai është «*këngëtar i dashurisë së pafat*», Do ishte me vënd ta zbërthenim sado pak më tepër këtë mendim. Me përjashtim të «*Këngës së mallit të parë*», në të cilin krijuhet një atmosferë gazmore, të «*Këngës gazmore*», të gjitha vjershat e tjera me motive dashurije sundohen prej një toni elegjiak dhe i kushto-

hen një dashurije të perënduar ose të parealizuar. Elementi kryesor artistik i këtyre vjershave është kontrasti, kontrasti ndërmjet gjëndjes së mjeruar të poetit dhe kujtimeve të hareshme, që i fali prirja ndaj një vajze, kontrasti ndërmjet natyrës dhe gjëndjes së tij shpirtërore, kontrasti ndërmjet të kaluarës e të kohës, në të cilën rron poeti. Nëpërmjet këtyre kontrasteve të goditura, Zef Serembia u ka dhënë forca emociononjëse vjershave të veta dhe i ka pasuruar motivet e trajtuar me nuanca të reja, duke u dhënë edhe një bazë shoqërisht të shëndoшë, mbasi ai, nëpërmjet kujtimeve flet për bukurinë e dashurisë dhe gazin që i fal ajo njeriut, kurse nëpërmjet fundit të dhimbshëm të kësaj dashurie vajton fatin e vet, që e privoi prej kësaj lumturie. Prandaj edhe vjershat e dashurisë së Zef Serembes kanë vlerë, jo vetëm si dokumenta të ndjenjave intime të poetit, no edhe si këngë për një dashuri të madhe, të fortë e të sinqertë. Megjithëse të ngrysura, ato janë thellësishët njerëzore dhe, nëpërmjet motivesh të dhëmbëshme, nxjerrim në pah vlerën dhe kuptimin e dashurisë.

Zef Serembia shkroi edhe mjaft vjersha me tema fetare, prej të cilave na kanë mbetur një katër a pesë. Në këto vjersha ndihet gjithashtu personaliteti i poetit dhe talenti i tij i sigurtë. Ato janë vjersha të frymëzuara dhe që shprehin raportin e poetit me shenjtërinë e shenjtorenët.

Në vjershën «*Feja*», Serembia shpreh iluzionin se në mësimet e fesë gjeti dritën e vërtetë, kurse në vjershën «*Shën Mëria Virgjér*» ai parashtron një ide interesante e të rendësishme. Duke iu drejtuar Shën Mërisë, ai i thotë se as

lutjet e as besa që i mbajti nuk ja lehtesuan dhëmbjen e nuk ja pakësuan mundimet, pra, është e kotë besa dhe të padobishme lutjet; shënktorët nuk ndihmojnë. Ndoshta pse ishte i singertë në besimin ndaj zotit, Zef Serembia arriti të shkruaj në fund të jetës së vet panfletin poetik «*Kundër zotit*», në të cilin ngre grushtin e zemëruar dhe sulmon perëndinë, shënktorët dhe padrejtësitë shoqërore që bëhen «në emër të zotit, nën hijen e tij». Vetëm një i çgënjer mund të ngrihet me kaq zemërim kundër gënjeshtës. Ky krimj poetik i fuqishëm e luftarak ishte më të vërtetë një epilog i denjë për poetin tonë të mrekullueshëm, me të cilin lexonjësi ynë i ri do të njihet për herë të parë nëpërmjet botimit që u dërgua në shtyp me rastin e gjashtëdhjetë-vjetorit të vdekjes së tij. Na gjëzon pa masë besimi se kushdo që do marë në dorë vëllimin me vjersha të Serembës do dashurohet me 'të. Madhështia e poetit do fshehi edhe ndonjë të metë të punës sonë në përgatitjen e këtij botimi.

(*Parathënie për librin  
«Vjershë» të Z. Serembës*)

## KRYEVEPRA E MJEDES

Nuk e di pse Mjeda e quajti më të mirën vepër të tij «*Andra e jetës*», por kur e këndova rishtaz këto ditë, m'u duk se titulli ka të bëjë, me një mendim të madh filozofik, që poeti nuk e ka shprehur me fjalë, po që e ka lënë të kuptohet vetë, të nënkuptohej.

Prej kohësh, që në lashtësinë më të thellë, ka patur shumë njerëz, të cilëve jeta u shëmbëllente me një ëndër. Disave u dukej ëndër e bukur që përfundonte keq, kurse të tjerët e mernin për një ëndër plot trazime, që kurorëzohej bukur prej vdekjes, e cila çelte dyert e jetës së amëshuar. Në të vërtetë jeta është realitet, një realitet i gjithanshëm, në të cilin' pleksen e përleshën e vërteta me ëndërën, fatkeqësia me lumturinë, gëzimi me hidhërimin..

Një realitet të tillë ka pasqyruar Mjeda në poemën e vet të cilën vërtet e ka quajtur «*Andra e jetës*», po jetën e ka parë si njëmëndësi, që shihet me sy e preket me dorë, si të vetmin realitet egzistonjës. Kuptimi i vetëm që e lidh

titullin e veprës me brendinë, janë kufijtë e ngushtë të jetës së individit, përballë përpjete-sisë së egzistencës, në kuptimin e gjërë filozofik. Duke e quajturë ndër poeti nuk na e jep jetën, si një vizion ideal, po si një të vërtetë tokësore, që përmbyedh në vetvete gjithçka provojmë, dëshirojmë e mësojmë në këtë botë, gjithçka aspirojmë dhe përpinqemi të realizojmë.

Romantikët në përgjithësi janë orvatur t'i japid vdekjes një kuptim misterioz. Realizmi, ashtu siç sheh jetën, ashtu shëh edhe vdekjen drejt në sy dhe, jo vetëm për artin, po për gjithë shoqerinë, çlirimi i njeriut prej tmerrit të vdekjes dhe prej iluzjoneve rreth saj, është një fitore shumë e madhe. Shkrimtarët realistë, në vënd që të filozofojnë për jetën e për vdekjen, janë marë më shkaqet e vdekjes dhe kani të tjerë hequr vëmëndjen e shoqërisë në burimet e shuarjes së parakohëshme të njeriut: në shtypjen ekonomike, në punën e skllavërronjëse, në varfërinë dhe imjerimin e masave punonjëse në botën me klasa çfrytëzonjëse.

Poemën «Andra e jetës» Mjeda e nis dhe e ribaron si me vdekje. Në pjesën e parë vdes Trina, kurse në pjesën e tretë përshkruhet fundi i Lokes plakës Ky andërtim i poemës është mbështetur më mendimin e madh filozofik që ka spatur poëti dhe është një shprehje e fuqishme e realizmit në poezinë tonë.

Trina ferishte u takën nga duart papritë pakujtuaf, megjithëse poeti na le të kuptojmë, që nuk kemi të bëjmë me një vdekje të papritur, por me një venitje qhe shuarje, të ngadalta, të cilën nuk janë mëngjendje ta spikatin as i Loka, ja, as tëptjerëtët i imitquci që përfundon

«Ish lodhë i dhimbte njëje, e et kishte moll zat gjak» — thotë poeti duke e parrë Trinën me sytë e Lokes që «e muler për bri». Lexonjësi e mer vesh lehtë perse bëhet fjalë, kurse Lokes i ngjan se e bija «ish lodhë». Kjo është për prej nyjeve më të fortë dhe më rrënqethëse dramatike të poqemës. E mjera nënë as nuk e mori vesh nga se i vdiq vajza. Mjerimi ndihet padija që sundonin prej shekujsh në malësitë tonë i vrissnin njerezit ngadalë dhe pa u kuptuar. Mjedja i zbuloi këto dy plagë në jetët tonë të ratëherëshme dhe nuk klithi, as që u mëndua t'iu shkaktonte lötë dhe pshëritima sentimentale e lexohjësve. Ai, me thellësinë e një poeti të madh realist, nuk du muar me *intrigën* e vogël, që po arrëfeu, nqë në vëndin tonë, jetë që bërë e jo padurëshme, gjersa kishë hyrës në skenë fliftim me njerezit, të cilët nuk jetonin, po luftonin me thonjë e më dhëmbë për të jetuar. Figura dhë fati i Trinës është pasqyrë e anës tragjike të jetës; është reflektimi i konfliktit ndërmjet mjerimit dhe jetës. «Mjerimi pjetë fëmine para se të burruhet, don ta msojë t'i hiki grushtit q'i kërcnhet... — dhe fityrën e fëmises e mblon hij e vdekjes, nji stoli e kobshme në vend të buzëqeshjes, sikuante Migjeni, duke patur edhe ai parasysh fëmije si Trina, që të njomë shtërgohen të hyjnë në luffën e ashpër të jetës.

Vdekja tjeter, mbarimi i hidhur i Lokes, pasqyron fundin e natyrshëm të njeriut. Realizmi i Mjedës mer këtu një forcë të re, të ashpër dhe të rëndë. Duke ndjekur çastet e fundit të Lo-

**kes**, pa dashje, na shkon mëndja tek Zoga e lumi-  
tur dhe presim, të trokasi dera dhe e bija t'i  
gjëndet pranë nënës. Po nuk ndodh kështu,  
mbasi Mjeda nuk mund të zgjidhte një rrugë  
tillë sentimentale, që do të tingëllonte false kra-  
has frysës realiste që përshtkon veprën. Na vjen  
keq për Trinën, që nuk e shpëtoi njeri, megji-  
thëse kishte njerëz pranë, kurse për plakën pra-  
nia e t'afërmëve do të kishte qënë vetëm një  
ngushëllim e asgjë tjetër. Sot, duke e parë vepr-  
rën nga lartësia e shoqërisë sonë socialiste  
nën prizmin e jetës e të idealeve tonë, ne  
zbulojmë edhe një anë tjetër të shëmtuar të je-  
tës së mëparëshme: braktisjen e njeriut në fa-  
tin e vet, si u pat braktisur Lokja, jo prej Zo-  
gës, po prej shoqërisë.

Më kot janë munduar «ta zbutin» përshtyp-  
jen e rëndë të këtyre dy vdekjeve, gjoja për  
të shpëtuar Mjedën prej «pesimizmit». Kurse  
merita e Mjedës është që pati guximin ta shohë  
jetën drejt në sy: as nuk e idealizoi, as nuk e  
nxiu. E pasqyroi ashtu siç ishte n'atë kohë, du-  
ke i hequr vellon sentimentale dhe, duke i larguar  
mjegullën romantike prej fytyrës. Nëqoftë-  
se ka një të vërtetë të pérjetëshme, që do të  
térheqë kurdoherë vëmendjen e njerëzve në poe-  
mën e Mjedës, kjo e vërtetë shprehët pikërisht  
nëpërmjet dy vdekjeve. Poeti duket se na tho-  
të: «Edhe sikur njeriu ta pijë deri në fund gotën  
e vet, si Lokja,jeta e tij është aq e shkurtër  
para pérjetësisë, sa ngjan si një èndër. Pse të  
vdesin fémijët prej punës së rëndë, prej të ftoh-  
tit e prej mjerimit? Pse njerëzit të mos kenë  
mundësi ta gjëzojnë jetën dhe të vjelin të gjithë  
së bashku të mirat e saj » Thirrja për drejtësi

dhe për një jetë më të mirë, ndonëse e pashprehur me fjalë, përshkon gjithë poemën dhe është një me idetë dhe idealet humaniste të poetit. Nëpërmjet pasqyrimit të vdekjes, Mjeda ka po-huar jetën dhe të drejtën e njerëzve për të jetuar. Gjykimi se në fundin e poemës «*mund që fshihet prap se prap mendimi kristjan mbi kotezinë e kësaj bote përparrë* «jetës së pasosur», (shih: «Historia e letërsisë shqipe», vëll. 2 f. 417) si dhe karakterizimi i këtij fundi si *protestë kundër jetës vetë, një protestë që shkon më tej se protestat shoqërore» (po aty) mendoj se e shtrëmbërojnë kuptimin e veprës dhe, duke vlerësuar jo drejt një moment të shkëputur prej tërësisë së poemës tingëllojnë si një përcaktim i padrejtë i filozofisë së Mjedës. Në të vërtetë as Mjeda, dhe as krijesa e tij — Lokia nuk e ka zënë në gojë «jetën e pasosur», po janë të lidhur tërësisht me jetën tokësore. Vdekja, pra, nuk shkon më tej se protesta shoqërore, po shërben si bazë filosofike e kësaj proteste.*

Autori i studimit për Mjedën në «Histori e letërsisë shqipe», siç duket, e ka ndier themelin e dobët të arsyetimeve të veta dhe, prandaj, nga një anë ka po-huar se «*Mjeda është prift, besimtar*», gjë që nuk ka lënë shenja në poemë dhe, nga ana tjetër, është përpjekur të zbutë përshtypjen e fjalëve të cituara, duke shtuar se «*një mendim i tillë nuk del asnjëherë, sadopak shprehimisht nga teksti dhe nuk lihet për t'u nënkuptuar domosdo*». Dhe kështu krijohet një ekuivok për të qeshur: nga një anë cfaqet mendimi se «*mund që këtu fshihet prap se prap mendimi kristjan mbi kotezinë e kësaj bote...*» dhe, fill pas kësaj, vjen dyshimi tjetër se një

gjë e tillë, «nuk lihet pér t'u nënkuptuar domos, do...» që shumë rëndësishme. Një hollësi e pjesës së lirës: Lokia mbetur vetëm nuk thërret Zogën, që enkë gjallë, po Trinën e vdekur. Si shumë hollësinë të tjera të poemës, edhe kjo ka një kuptim të madh filozofik-psikologjik. Në dëshpërim e sipër, nëna nuk i ka zili dhe nuk do t'i prishë lumturinë Zogës, por kujtoj bijën e vdekur, burimin e brengës së vet dhe, megjithëse e di që ajo nuk kthëhet më, e kërkon, lëtët. Pastaj, le të vështrojmë përshtkrimin figurativ të vdekjes: «Përmbi plakën krähët i uli e n'grykë t'shuemen e shtërngoi: — buzët t'shpul-pueme n'ball ia nguli — u ndal drita e ajo mbaroi.

Ky përshtkrim i vdekjes nuk ka të bëjë aspak me mendimin kristian mbi kotësinë e kësaj bote. Vec kësaj, këtu s'kemi të bëjmë as me vëtërasje, as me paraqitjen e vdekjes si të vëtmen udhë-shpëtimi, që çel portat imaginare të parajsës. Kjo është një vdekje e natyrëshme, e pashmangëshme, por poeti shpreh keqardhjen, jo aq pér vdekjen e Lokes, sa pér jetën e saj, që pat qenë e rëndë dhe e mjerë. Vdekjes nuk i shpëtovjmë dot, po jeta mund të jetë më e mirë dhe më e bukur pér të gjithë. Kjo është një pik-pamje filozofike humaniste e mishiuar në figurë të fuqishme dhe të thella realiste. Lotët nuk e ndrojnë rrjedhën e jetës, prandaj Mjeda nuk e ka përlotur as fatin e Trinës, as atë të Lokes.

Pjesë përbërëse e idesë së përgjithëshme të poemës është edhe fati i Zogës, që me forcën e një simboli përfaqëson një lulëzim e ngadhnjim

te natyrshëm dhetë domosdashëm, pësqë buronë  
prej vetë natyrës së jetës i njerëzore. Nuk kemi  
të bëjmë këtu mëndonjë klinjë romantike ushtë  
poemës, as është një vizioni tempavërtetë, që donat  
kështë krijuar poeti, për t'jan vënë përballe anë  
ve të errëtar që ka përshkruar që opjesët e tjera  
por është mëndimi i thelëri Mjedës që jetë si  
dëqoftë është e shbukur dhe është slumturi të jetë  
tosh. A ka patur çastëtë tillë gjëzimi edhe Lokja,  
gjatë jetës së vet. Dhë a nuk do të ketë për Zog  
gjë e lumtur i çasteqë brengashojë hidhërimesh?  
Sidoqoftë moti po andronte. Më fatmirë se Zoga  
do të jetë foshnjë e saj, avull e njohur i cili  
Nëqoftës opjesë e dytë poemës është gati  
sa dy të tjera si dherët e saj përhapët në jetë  
giithë veprën, kjo ndodhi për shkak se Mjeda, të  
vërtetët e jetës që mund ta jepte vetëm me  
një hero kryesor, na ka dhënë nëpërmjet atyre  
personazhevë, që përfaqësojnë tretë moshard dhe  
tre breza. Lokes, Zogës, dherë foshnjës Zoga është  
njeriu në lulën e jetës, vajzë që ka shpëtuar  
kthetravë të vdekjes së parakohëshme. Lokja  
është grua e ithyer në moshë që ka rrroitur, ka  
gëzuar, sic gjëzon tanin e bija (ndonse më pak e  
ndryshe), ka kryer detyrën e vet përparrë së bi-  
jës dhe s'i mbetet një pietër vecse të ydesë.  
Kurse foshnjë që il qeshet nanës kur mbështet  
përkulet nuk ka jetuar ende. Ajo ka jetën  
përparrë, që është gjithë përparrë, që është  
Pra, poema si është plan i tij gjérë filozofik,  
ashtu edhe në planin shoqëror, është shumë më  
e gjërë nganjc'mund të na duket në vështrim të  
parë. Ajo kalon shumë larg kufive të ngushtë të  
kronikës së një familje të varfës dhe duke mos  
u shkëputur prej saj, ka një forcë përgjithëso-  
njëse që të mahnit.

Në poemë nuk është vetëm Zoga që pohon jetën dhe gjëzimin. Mjeda ka zbuluar para nesh bukurinë e natyrës dhe të jetës së përditëshme fshatarake. Këto janë dy elemente të tjera që plotësojnë ose, më mirë të themi, që *integrohen* në kuptimin e përgjithshëm të poemës. E si mund të thuash për një vepër, në të cilën është zbuluar bukuria, gazi dhe poezia e punës dhe e kujdesjeve të përditëshme se në të fshihet... «mendimi kristjan mbi kotësinë e kësaj bote»? Tek «Andra e jetës» sundon poezia e jetës, ndihen zërat e bukura të natyrës, gurgullon përrrot, përhapet aroma e luleve, shkëlqen drita e dieillit, bërlyket viçi... Dhe poeti, i ekzaltuar shpesh prej hijeshisë së «botës sonë», u ka dhënë vargjeve të veta, ngjyrat më të bukura të një pozie të frymëzuar. Trina vjen me një «*qingj* të sykës *ngryk*», Lokja «*moli tue këndue lopën*» dhe bën përshest me kollomoqe «*t'mirë edhe për zotni*»; Zoga ndien së pari afshin e vajzërisë dhë kotet në èndëra të hareshme dhe në zemër të saj «*bashkë me lule len dashnija*», kurse foshnja i «*qeshet nanës, kur mbi të përkulet*». Dhe mundim të përmendim shumë hollësi të tjera prej të cilave nuk do ta kishim vështirë të nxirrnim përfundimin që Mjeda, jo vetëm nuk ka shkruar për kotësinë e kësaj bote, po, përkundrazi, e ka dhënë atë si të vetmen botë reale, të bukur dhe të denjë për t'u kënduar në poesi. Aq është e vërtetë kjo, sa që shprehjet fetare në poemë të ngjan se janë përdorur vetëm për forcë të zakonit, ose për të karakterizuar personazhet. Dy momente të vetme (shorti i shtojzolleve në pjesën e parë dhe skena e vdekjes, në pjesën e fundit) janë të vetmet që

kanë karakter mistik — figurativ, po edhe atonuk kanë ndonjë rëndësi të posaçme për tërësinë e veprës. Pastaj nuk gjen edhe sot poetë që flasin për shtojzovallet? Dhe nuk na lejohet t'i marrim edhe figurat e Mqedës si konvencione poetike?

Kanë kaluar shumë vjet që nga koha kur Mjeda shkroi «Andrën e jetës». Në jetën shoqërore, politike dhe artistike kanë ndodhur ndryshime shumë të mëdha. Megjithatë «Andra e jetës», sidomund të spikaten aty këtu disathinja, mbetet e freskët dhe e re, si një vepër e rëndësishme e poezisë sonë realiste, si një shëmbull i bukur që na fton të shkëputemi gjithënjë e më vendosmërisht prej idileve fshatarake, prej notave sentimentale dhe prej mjergullës romantiqe. «Andra e jetës» na fton ta shohim dhe ta pasqyrojmë, jetën ashtu siç është, nëpërmjet figurash emociononjëse dhe përgjithësonjëse realiste.

(Botuar në gazeten  
«Drita» 29 Korrik 1962)

ote edhe që vithurpi është shkrimtar i njohur shqiptar, i cili u bë aktor i kulturës shqipe. Në vitin 1870, ndiqet që është përfshirë në klasën e parë të shkollës së mesme të Tiranës, ku u bënë pjesë e klasave të tjera. Në këtë klasë, ndiqet që u bënë pjesë e komunitetit të shqiptarëve, që ishte i rëndësishëm për zhvillimin e shkollës.

Edhe përsëri, qëndrueshmëri i tij gjatë viteve të rinj, është një nga shembujt më të rëndësishëm të zhvillimit të shkollës së mesme të Tiranës. Në këtë klasë, ndiqet që u bënë pjesë e komunitetit të shqiptarëve, që ishte i rëndësishëm për zhvillimin e shkollës.

### **PROZA E NDOU NIKAJT**

Ndodhë që është një ndër më të shquarit, mbasi është më i pari, që shënohet në kapakët e të parave novela e romanca, siç i quan autori krijimet e veta në prozë. I nisur si shkrimitar prej fundit të shëkullit të kaluar, ai vazhdoi rrugën e krijimtarisë letorraine deri afér mesit të shekullit tonë, pa pushuar kurrë së shkruari, pa e lënë pér asnjë çast penën mbi tavolinë. Ishte punëtor i palodhur, njeri enthusiast, i dhënë me mish e me shpirt pas letërsisë artistike, të cilën, siç na i rrëfejnë veprat e shumta, që na ka lënë trashëgim, e ka patur kurdoherë si një mjet të sigurt e të fuqishëm në synimet e veta atdhetare e si një armë të mprehtë kundër armiqve të kombit dhe feudalëve. Mjafton të përmëndim se prej vitit 1888, kur botoi veprën e parë e deri nga viti 1940, Ndoc Nikaj shkroi tridhjetë

Në historinë e prozës shqipë, emri i Ndoc Nikajt është një ndër më të shquarit, mbasi është më i pari, që shënohet në kapakët e të parave novela e romanca, siç i quan autori krijimet e veta në prozë. I nisur si shkrimitar prej fundit të shëkullit të kaluar, ai vazhdoi rrugën e krijimtarisë letorraine deri afér mesit të shekullit tonë, pa pushuar kurrë së shkruari, pa e lënë pér asnjë çast penën mbi tavolinë. Ishte punëtor i palodhur, njeri enthusiast, i dhënë me mish e me shpirt pas letërsisë artistike, të cilën, siç na i rrëfejnë veprat e shumta, që na ka lënë trashëgim, e ka patur kurdoherë si një mjet të sigurt e të fuqishëm në synimet e veta atdhetare e si një armë të mprehtë kundër armiqve të kombit dhe feudalëve. Mjafton të përmëndim se prej vitit 1888, kur botoi veprën e parë e deri nga viti 1940, Ndoc Nikaj shkroi tridhjetë

pesë, veprave shumica rentë cilave në prozë është më përbajtje e patriotike ne shqërore, i që të kuptojmë se ç'shkrimitar i paisionuar është çpuñetor. Si palodhur ishte t'i shkruhe vobin si qendër tematike Ndore Nikaj futi më i historinë e letërsisë së sotitë vitin 1899 me botimin e të parës romancë në gjuhën shqipe. Para tij i proza shqipe ishte shumë e pazhvilluar, që të mos themi se nuk ishte dukur ende në fushën e letrave. Ai, i pranë hoddit një hap të guximshëm i përpëra, në krijimtarinë letrare të vëndit dhësyky nuk ishte një hap i pasigurtë i pamiatur. ja është tematikët e shkrimitari syrië ishte i prift, katolik, i prandaj njihet edhe me emrin Dom Ndoc Nikaj. Po, i priftëria, nuk ka mundur të depërtojë thellë në krijimtarinë e tij letrare, ashtu sic mund të ketë depërtuar në krijimtarinë e ndonjë shkrimitari tjetër prift t'asaj kohe Atchedashuria, krenaria kombëtare, urrejtja e thellë për pushtonjësit e huaj, dhe për armiqjt e panumurt të Shqipërisë, etja për dituri e përparim, dashuria për popullin, sidomos përmalësorët tanë, ndjenjat e mendimet demokratike, dhe dëshira që të shohë vëndin e vet në radhën e kombeve të përparuar — të gjitha këto kanë hyrë me vrull e me dinjitet në veprat e tij, dhe kanë shtyrë mënjanë ndjenjat dhe mendimet e priftit, të cilat mund t'i hasim tepër rrallë e shkarazi në librat e tij të shumta.

Burimet kryesore të frysmezimeve të tij janë kryesisht dy: historija e Shqipërisë, që nga fundi i epopezës së lavdishme të Skenderbeut e deri në fillimin e shekullit njëzetë dhe jeta shqërore e qytetit të Shkodrës dhe e krahinës rrëthsaj, në të njëjtën periudhë historikë; po moti-

vet që gërshetohen në temat dhe subjektet e veprave të tij janë të shumta e, do të thosnim, të gjithëanëshme. Ç'nuq na takon të gjejmë në krijimet letrare të Ndoc Nikajt? Trimërinë e guximin, dashurinë e urejtyjen, besën e tradhëtinë, zakonet e bukura e fisnike të malësisë dhe paragjykimet, urejtyjen ndaj feudalëve dhe simpatinë ndaj njerëzve të thjeshtë, jetën e avtitetit e të fshatit, bukuritë e natyrës dhe karakterin rrënimtar të luftës, anën epike dhe tragjike të ngjarjeve historike që përshkruan, dashurinë ndaj jetës dhe çqetësimet që sjell ajo kur bëhet e padurueshme, ëmbëlsinë e dashurisë dhe forcën e karakterit...

Në trajtimin e temave historike, të cilat mund të themi se zënë vëndin kryesor në krimtarinë e shkrimitarit, para së gjithash, të bën përshtypje mënyra e gjerë e të kuptuarit dhe të pasqyrimit të problemeve e të jetës së personazheve lidhur ngushtë me rrethanat historike, në të cilat atyre u duhet të jetojnë. Kjo vrehet çitas sidomos në romanin «*Shkodra e rrethueme*», në të cilën trajtohet një fazë shumë e koklavitur e historisë sonë kombëtare.

Shefqet Turgut Pasha, në krye të reparteve të shumta ndëshkimore të ushtërisë turke, pas shpalljes së hyrjetit, kalon si një murtajë e keqë në Malësinë e Veriut dhe shkatërron e shkretton çdo vënd, ku shkel këmba e tij. Shqipëtarët përmënden nga ajo èndër e këndëshme që panë më 1908 dhe rrëmbejnë përsëri armët, që të vazhdojnë më tej luftën e vendosur për çlirimin e dheut të vet kundër armiqve të egjér, që e hoqën rishtaz maskën dhe ckermitën dhëmbët,

si një ujk që ka ndëruar qimen, po nuk ka harruar zakonin e vjetër. Në kulmin e ashpërsisë së luftës, kundër garnizoneve turke, që ndodheshin në rrethet e Shkodrës, hidhen trupat e krajl Niko lës së Malit të Zi e, më vonë, edhe repartet ushtarake serbe.

Një mik në kohë rreziku është kurdoherë i çmuar, prandaj edhe malësorët tanë, të gjëzuar se u doli përkrah një aleat në luftë, i bashkuar armët e tyre me ato të ushtrive malezeze, të sigurtë që fjalët e bukurë që kishin dëgjuar prej aleatëve, ishin fjalë të dala nga zemra e që nuk do t'i merte era, siç pat marë kurdoherë fjalët e shteteve të Evropës, në kohën kur Skënderbeu mbante me gjoksin e disa mijra burrave vërrshimin e tmerrshëm turk, që ishte drejtuar për në zemër të kontinentit tonë... Po, nuk ishte e thënë që t'i giëndej edhe kësaj rade një mik besnik Shqipërisë!

Ç'duhej bërë? Në rrethana të tilla, të luftojë kundër turqve, që ndodheshin të rrethuar në Shkodër përkrah malazezëve, do të thoshte të luftoje kundër një të vdekuri, të cilin mund ta qitje jashtë shtëpie pa ndihmën e kujt dhe të vije në krye të vatrës një armik të ri, po aq të egër e po aq barbar, sa edhe i pari... Qëndrimi që zgjodhën shqiptarët dhe që e ka paraqitur me simpati Ndoc Nikaj në veprën e tij ishte një qëndrim i drejtë, mbasi asnje kuptim nuk do kishte të luftoje për lirinë e Shqipërisë, kundër pushtonjësve turq e njëkohësisht, me zjarrin e armëve të tua, të ndihmoje që atdheu të binte në një robëri tjetër. Malazest e serbët, në veri, dhe grekërit në jugë, nuk luftonin që të ndihmonin popullin tonë të çlrohej nga zgjedha oto-

mane, i pohorvateshin të shtinin në duart e tyre krahina, të tjerat të Shqipërisë.

Këtëj prjedh edhe simpatia e autoritit të Shkodrës së rrrethueme ndaj Hasan Riza Pashës, i cili, megjithëse përfaqësonjës e komandant i një ushterije, deri atëherë armike, objektivisht luajti rol pozitiv në çastet e inbrapinë të jetës së vet, duke mbrojtur Shkodrën prej synimeve pushtonjëse të Malit të Zi.

Ndoc Nikaj, që nuk gjente dot fjalë për të shprehururrejtjen e madhe kundër turqvë, tashati e ka vështirë të shprehë zëmërimin e vet kundër armikut të ri të Shqipërisë, megjithëse përdor të gjithë fuqinë e fjalës së vet për të demaskuar e për të mallkuar rrustrinë e pabesë e gjakatare, që, jo vetëm synon të shkelë Shkodrën, po përdor të gjitha mjetet dhe vë në jetë bárbarizma të pashqeq kundër popullsisë civile, që të thyej qëndresën heroike të Shkodrës.

Trajtimi historik i çështjes i ka dhënë veprave të Ndoc Nikajt edhe në këtë drejtimi një përbajtje demokratike e përparrimit, në frymën e Rilindjes sonë kombëtar, ashtu siç pat bërë poëti ynë i madh kombëtar në veprën e tija «Dëshirat e vërtetë e shqiptarëve».

I rrëptë është qëndrimi i Ndoc Nikajt edhe ndaj shteteve të tjera të Europës, të cilët, në vënd që t'i delnin mbrojtës Shqipërisë, përkrahnin të gjitha manevrat e të huajve kundër saj, duke e bërë përfundim tona një monedhë këmbimi në tregun ndërkombëtar.

Një aspekt i rëndësishëm i botkuptimit demokratik të Ndoc Nikajtë është urrejtja e tij kundër feudalizmit, që shpërhet sidomos në ato vepra të tij, që trajtojnë subjekte të qëmaran nga

kohë, më të vona. Tipari kryesor që spikat në figurat e feudalëve të krijuara prej shkrimitarit, është, egërsia, dhe egoizmi i tyre i cfareuar e pakufi, që i bën të lakmojnë e të përdorin, të gjitha mënyrat e mjetet që u vinë ndore, per të realizuar qëllimet e tyre, të poshtera e cnjerezorë.

Një, shëmbull i ciltë përkëtë është romanca «Burbugia», në të cilën përshkruhen ngjarje të viteve të para të shekullit të kaluar. Abdyl Rahmani Beu nuk ndalet para as një ndjenje e para asnjë mendimi, po gjithë forcën, pasurinë pushtetin dhe djallëzinë e vet e vë në shërbim të realizmit të interesave të veta teper egoiste e të egëra. Për të nuk egziston asgjë ne ketë botë; as detyrimet bashkëshortore, as respektimi i të drejtës së të tjereve për të qenë të lumtur, as dashurija e ciltër e dy të rinjve, as frika e ndëshkimit dhe e mallkimit, që ta ndalojnë përtu dhënë shfrim instikteve të tij shtazarake.

Në një kontrast të madhi i paraqet Ndoci Nikaq bejlerët e feudalët shqiptarë të vënë në shërbim të pushtonjësve turq, përballe fisnikëve të kohës së Skënderbeut, që përlirinë e tokave të veta e përdheun e të parëve, hidhen trimërisht në luftë e ngrihen para syve tonë me rrijë madhështi kreshnike. Gjithë synimi i të parëve mbështetet në padrejtësitet shoqërore, në ligjet e hekturta të përandorisë Otomane, në shpatat, në heshtat e jenicerëve, në prapaskenat djallëzore e në gjakderdhjet e pamëshirshme, në kurthet e përgatitura më kujdes e në burgjet e errët, ku mbyllen këmbahen stërmidhur me sekurajmata që kanë guximin e burrërinë të ngrihen, haptaz në mbrojtje të të drejtave të tyre.

Të tjerët, fantazia e shkrimtarit na i paraqit me ngjyrat e ndritura të letërsisë së Rilindjes evropiane, duke ndjekur shëmbullin e të madhit Marin Barleti. Ata janë, para së gjithash, kreshnikë, njerëz që gjithçka e bëjnë fli për të mirën e vëndit dhe për të ruajtur nderin e armëve të tyre. Asgjë nuk do t'i ndalonte ata: as numuri i madh i armiqve, as armët e tmerrshme e me shumicë, që kanë në duar ushtritë turkesha, as barbarizmat e hordhive të sulltanëve, as rreziku me mbet të vdekur në fushën e betejave, as humbja e rrënimisë i pasurive të tyre, — asgjë nuk do t'i ndalonte të viheshin në krye të tubave të ushtrisë shqiptare e t'i delnin përballë armikut të egër, atje ku të ishte më e rreptë përleshja me 'të. Fytyra të tilla fisnikësh shqiptarë kalojnë para nesh edhe tek «Bukurusha».

Megjithëse ishte demokrat borgjez, kur e sjell hera shkrimtari nuk kursen edhe njerëzit e klasës së vet. Ai dënon prirjen e tyre që të pasurohen, pa vënë re rreziqet që i kërcënohen vëndit dhe ndihmën që mund të jepin për shpëtim të tij. Në «Shkodra e rrethueme» të bije në sy kjo prirje e shkrimtarit, kur çfleton fletët që flasin për Shtjefnin, i cili përpjekjet e shqipëtarëve për liri i quan ëndëra fëmijësh, tamam ashtu siç i patën quajtur më vonë, bejlerët e tregëtarët e mëdhenj ëndëra fëmijësh edhe përpjekjet burrërore të popullit gjatë luftës së dytë botërore kundër fashistëve italianë e gjermanë. Përtregëtarin e pasur shkodranëvetëm Austrija mund ta shpëtojë Shqipërinë, duke e futur në rrethin e kujdesit të vet, domethënë

duke e pushtuar. Ndryshe nga klerikët katolikë reaksionarë, Ndoc Nikaj, nëpërmjet figurës së Shtjefnit, si dhe të fjalëve të veta, e bën pluhur këtë ëndër të kotë dhe të gjenjeshtër të mbësh-tetur në demagogji dhe demaskon me ironi të hollë të gjithë ata që, për një arësy e për një tjetër, të gjenjyer nga demagogjija, apo të prishtur nga shpërblimet orvaten të pengojnë lëviz-jen çlirimtare të popullit e të shpien ujë në mu-lili të Austrisë. Dhe, me gjithë mënd, një pjesë e mirë e atyre që kishin kthyer sytë nga Austria, ishin ose klerikë të lartë ose tregëtarë të pasur... Demaskimi në këtë mënyrë i tendencave kozmopolite të borgjezisë sonë që në krye të he-rës, është një kontribut i mirë i shkrimtarit, në lëmin e lëvizjes demokratike të vendit tonë.

Ndoc Nikaj është humanist. Pikërisht në terrenin e kapërcimit të asketizmit fetar, të paragjykimeve e në luftën kundër moralit hipokrit të klerikëve fanatikë e të njerëzve me formim anadollak, vrehet ngritja e shkrimtarit mbi pikëpamjet e shoqërisë zyrtare të kohës dhe mbi mësimet e moralit fetar. Vec disa shprehjeve të rëndomta e të ndonjë skene tepër të rallë, në të cilën shprehet devocioni fetar i ndonjërit prej personazheve të tij, — dhe kjo është e natyrë-shme për njerëzit që ai përshkruan në veprat e veta e për kohën në të cilën ata jetojnë, — në krijimtarinë e Ndoc Nikajt asgjë nuk të kujton priftin në tërësinë e pikpamjeve ideologjike të tij, të shprehura në veprat letrare. Krahas pa-triotizmit, idealet e bukura humaniste, e kanë shtyrë atë të hymnizojë jetën toksore dhe të përpipet të gjejë diçka të bukur edhe kur kjo jetë

bëhet e rëndë e tragjike. Një ndër ata që kanë studjuar veprën e Nikajt, ka theksuar se ai ka vënë në qendër të veprave të veta «*me nji guxim paksë të tepruem për atë kohë themelin e jetës — dashuninë*». Nëpërmjet dashurisë së një vajze të bukur me një trim, shkrimtari ka goditur njëherësh disa murre të vjetëruar, prej të cilëve përmëndim: asketizmin fetar, moralin anadollak, që sundonte fatkeqësisht në një pjesë të popullsisë myslimanë, zakonet e këqia të jetës patriarchale dhe moralin patriarchal, moralin e borgjezisë së pasur, që dashurinë e martesën i konsideronte në esencë, si një akt të thjeshtë këmbimi. Dhe, në luftë kundër gjithë këtyre të këqijave, ka hymnizuar personalitetin e lirë të njeriut, të drejtën e tij që të jetojë i lumtur dhe synimin e tij që t'a gëzojë këtë jetë, pa menduar as për mora in hipokrit të klerikëve e të feodalëve, as për mëkate, që mund t'i rëndojnë mbi shpinë «në jetën e përtëj varrit.»

Dashuria për Ndoc Nikajn nuk është një histori sentimentale dhe diçka në vetvete, e çkë-putur nga jeta shoqërore e politike e kohës. Përkundrazi! Dashuria për të është një fuqi e madhe, që fisnikëron shpirtin e njeriut, që i bëri njerëzit më të mirë, që i shtyn të kryejnë vepratë mëdha e të luftojnë për realizmin e ëndërave të tyre të bukura kundër çdo armiku. Dashuria për 'të është një fuqi e atillë, që e nxjerr njerinë nga guaska egoiste dhe e hedh në sferat e altruizmit, e bën të gatshëm të sakrifikojë gjithëçka për atë që dashuron. Në romanet me bazë historike heronjt e dashuruar të shkrimtarit janë njerëz, që lumturinë e tyre personale e lidhin ngusht me fatin dhe lumturinë e atdheut

të tyre, ndaj edhe janë luftëtarë të vendosur në su'met e në betejat kundër turqve dhe në luftimet për mbrojtjen e kështjellave të lirisë nga mësymjet e armiqvë. Në romanet me sfond shoqëror ata janë njerëz të gatshëm që ngrihen kundër çdo pengese e qdo përpjekje për të prekur lumturinë e tyre dhe, në këtë mënyrë, vihen në radhët e luftëtarëve të përparuar përnjë shoqëri të re e për një moral të ri, megjithëse as ata dhe as krijonjësi i tyre nuk e kanë patur të qartë një objektiv të tillë.

Humanizmi i Ndoc Nikajt shprehet i qart e i fuqishëm edhe në paraqitjen e anës tragjike të luftës dhe në përshkrimet rënqethëse që u ka bërë masakrave dhe tmerreve, që u kanë shkaktuar armiqtë popullsisë civile. Në «Rrethimi i Shkodrës» kjo shprehet në qëndrimin e ashpër e të zemëruar që mban autori ndaj barbarive të Shefqet Turgut Pashës, ndaj ma'azezve, që bombardojnë me top qytetin, ndaj përfaqësonjësve të Austrisë, që krijojnë «shpella» që të mbrojnë kokën e tyre dhe as që marin mundimin të ngrenë zërin e protestës kundër kësaj masakre çnjerëzore, ndaj murgeshave se-vjane, që lëshojnë në mes të katër udhëve vajzat jetime, që kishin nën mbrojtje në kohën më të vështirë dhe vetë shkojnë të ruajnë lëkurën... Ai me të drejtë e ka përshkuar luftën «tragjike dhe epike». Krahas egzaltimit të patriotit, që përshkuat mirë në mënyrë epike qëndresën burrërore të shqiptarëve, në librat e tij gjëjmë dhëmbjen e njeriut, i cili vështron si shkatërrohen qytetet, si vdesin njerëzia prej urisë dhe si gjajnë fundin' gra e fëmijë të pambrojtur nga veprimet shtazore të armiqve të vendit.

Një nga anat e rëndësishme të krijimtarisë letrare të Nikajt, që duhet theksuar në mënyrë të posaçme dhe që ka vlerë shoqërore, është qëndrimi i tij i papajtuar ndaj rendit patriarkal dhe dokeve, zakoneve dhe ligjeve të tij. Në atë kohë, sigurisht, ai nuk mund të gjente një zgjidhje të plotë e përfundimtare të këtij probemi që ka shtruar në veprën e vet, po, fakti që e ka shtruar dhe është munduar t'i japë rrugë, duke vënë në plan të parë guximin e venodsmërinë e heronjve të vet në luftë kundër këtij rendi dhe ligjeve e zakoneve të tij, nuk është një meritë e vogël. Përpjekja që të gjejë një rrugë dalje, qoftë edhe për raste të veçanta, pa u ngritur në nivelin e të shtruarit të problemit në plan të përgjithshëm shoqëror, tregon se shkrimtari nuk mbante një qëndrim fatalist, po u bënte thirrje njerëzve të ngriheshin kundër atyre zakoneve e ligjeve patriakale, që kanë qënë burim i pashteruar fatkeqësishë e gjakderdhjesh, siç përshkruhet në romancën «*Lulet në thes*» e gjetiu.

Ndoc Nikaj, si asnje shkrimtar tjetër nga tanët, është i lidhur shumë me qytetin e vet, Shkodrën. Vepra e tij, në një farë kuptimi, është histori e këtij qyteti, të cilin ai e ka përshkruar me dashuri. Shkodra e mesitetës, pas vdekjes së Skënderbeut, Shkodra e fillimit të shekullit të kaluar, Shkodra e ngjarjeve historike të atij shekulli, Shkodra e fillimit të shekullit tonë ka qënë sfondi në të cilën janë piktuar ngjarjet e shumta të veprave të Ndocit. Duke u përqënë druar në qytetin e vet, ai është përpjekur të gjyshkruajë, të vejë në dukje, të analizojë, të gjyshkruajë... Edhe një lexim i vetëm i veprës së tij do kjojë...

mjaftonte që njeriu të arrijë në përfundimin, se shkrimtari e ka ndjekur me vëmëndje të madhe e me interes, jo vetëm jetën aktuale të qytetit të vet, po është munduar të depërtojë edhe përtej perdes së historisë së panjohur deri atëherë dhe të zbulojë para lexonjësve të vet, ashtu siç zbulon një restaurator, bukurinë e madhështinë e jetës trimërore të bashkëqytetarëve të vet. Nëpërmjet këtyre tabllove të jetës historike e shoqërore të Shkodrës, ai ka paraqitur disa aspekte të rëndësishme të zhvillimit të qytetit dhe ka shprehur qëndrimin e vet ndaj klasave e shtresave të ndryshme shoqërore. Është rasti të theksojmë këtu se Ndoc Nikaj, si edhe të tjerë shkrimtarë patriotë e aktivistë shoqërorë të asaj kohe, nuk ka një mendim të saktë për klasat shoqërore dhe as për qëndrimin klasist të njërzve. Qëndrimet e heronjve të tij janë, para së gjithash, qëndrime individësh, megjithëse, nuk duhet mohuar, që nëpërmjet këtyre qëndrimeve individuale të heronjve, ne të arrijmë në përfundime më të thella nga ato që ka dashur të nxjerrë autori. (Kjo ka ndodhur jo vetëm nga pa aftësija e tij që t'i bëjë autopsinë shoqërisë së kohës, po edhe nga mungesa e forcës së përgjithësimeve artistike në veprat letrare të tij). Prej këndej rrjedh edhe besimi e simpatia që ka autori ndaj të rinjve, pavarësisht prej klasës a shtresës shoqërore që s'ata përfaqësojnë, gjë që tregon se ai, nuk mendonte se një klasë e re do t'i çdukte nga faqia e dheut gjithë të këqijat, që shkrimtari ka sigmatizuar në librat e veta, po kujtonte se kjo ishte një detyrë e brezit të ri, i cili duhej të shkonte më tej nga ç'kishin shkuar pa rardhësit e tij.

Nëqoftëse ka diçka për të cilën mund të qërtohet Ndoc Nikaj është qëndrimi që mban ai, disa herë, ndaj klerit katolik. Duke qënë vetë prift, mbasë ka qënë edhe i detyruar, apo nuk ka patur guximin ta thotë edhe në këtë rast qiltas mendimin e vet, siç e ka thënë gjithëherë. Nuk e kemi fjalën as për *Dom Gjinin*, që është një famulltar shpirtmirë, as për priftin domenikan, që u jep zemër të rrethuarve në kështjellën e Shkodrës, as për devocjonin naiiv fetar të Rozës në «Shkodra e rrethueme», po pëmheshtjen e autorit, kur vjen fjala për të treguar qëndrimin e klerit katolik reaksionar të Shkodrës, i cili i nxitur nga Austria, në periudhën e kryengritjeve shqiptare të fillimit të shekullit tonë e në kohën e luftës ballkanike, luajti lodrën e Turqisë e të Malit të Zi. Me demaskimin e Austrisë, Ndoc Nikaj ka treguar se nuk ishte në një mëndje me ta, po kur vjen fjala përqëndrimin konkret të tyre, ose hesht, ose e kation përciptas, ose, së fundi, orvatet të gjejë ndonjë çikërrimë që të tregojë, se edhe klerikët nuk i qëndruan larg lëvizjes çlirimtare. Po kjo është një e metë, që duket sheshit, se nuk ka rrjedhur nga bindjet e tij, aq sa ka rrjedhur prej rrethanave në të cilat ndodhej, e, mbasë, edhe nga dëshira e një kleriku të ndershëm, përtë mos sharë, kur s'mundët të lavdëronte, «njerezit e zotit», në radhët e të cilëve edhe ai bënte pjesë.

## II

Kur këndon veprat e Ndoc Nikajt vetveti u arrin në përfundimin, se proza artistike në vën-

din tonë nuk mund të fillonte ndryshe, veçse ashtu, si e gjejmë tek ai, që është i pari prej shkrimtarëve tanë, që lëvron gjininë e gjatë të prozës.

Para Ndoc Nikajt poezia jonë kishte arritur kulme me krijimtarinë e poetëve tanë të mëdhenj të Rilindjes dhe dramatugjia kish bërë çapat e para, kurse proza pothuajse nuk egzistonte, po të lëmë mënjanë disa lexime spjego-njëse, ca përpjekje për të kriuar tregimin e ndonjë orvatje, që të shkruhet diçka më e gjatë e më e plotë prej Kristoforidhit, Papa Kristo Negovanit e ndonjë tjetri. Deri në fillim të shekullit tonë nuk bëhet ndonjë hap përpara, përveç një vepre të vogël që ka botuar Ndoc Nikaj më 1889 dhe që e ka quajtur romancë. Pas dhjetëvjeçarit të parë të këtij shekulli çfaqen në fushën e letrave shqipe dy prozatorë, ndër më të parët, njëri në Jugë e tjetri në Veri: Mihal Gramenua dhe Ndoc Nikaj. Duke qënë të parët, që iu vunë punës në këtë drejtim, ata kanë dhënë një kontribut të çmuar dhe, për kohën në të cilën shkruan zënë kreun e vëndit në historinë e shkurtër të prozës sonë letrare artistike. Pas tyre erdhi Fojion Postoli dhe, më pas akoma, proza çeli rrugën e vet përfundimisht, pasi kish kalluar çereku i parë i këtij qindvjeçari.

Të shumta janë tiparët që i afrojnë dy prozatorët tanë më të vjetër. Temat patriotike, lufta e tyre kundër armiqve të jashtëm të Shqipërisë dhe tendencave shoviniste të fqinjëve tanë imperia istë, urrejtja kundër feudalizmit, trajtimi i temave shqërore, gërshtimi i motivit të dashurisë me motivet patriotike e me gjëndjen historike të vëndit, orvatja që të trajtojnë gjini-

të e mëdha të prozës etj. Megjithëkëtë ka ndërmet tyre edhe ndryshime.

Ndoc Nikaj është më primitiv se Mihal Gramenua dhe, mbasë, në këtë primitivizëm të tij, fshihet një nga vlerat e një nga veçoritë më interesante të krijimtarisë letrare të këtij shkrimtarit. Kur e lexon ai të le përshtypjen e një prozatori, që ka nisur të shkruaj spontaneisht dhe që, kur ka filluar veprimitarinë e vet, nuk ka patur parasysh asnje model dhe asnje preferencë nga letërsia e huaj. Ka shkruar ashu siç ka ditur vetë, ashtu siç ja ka diktuar zemra dhe, me sa ka mundur, është përpjekur të krijojë edhe tipat, edhe stilin, edhe kompozicionin e veprave të veta, në mënyrën më të thjeshtë dhe, nganjëherë në mënyrën më primitive.

Kjo veçori e Ndoc Nikajt sikur shkon përbukuri me paraqitjen e qartë e pa shtrëmbëri-me të malësorëve shqiptarë e të njerëzve të vëndit tonë në romancat e tij. Në personazhet e Ndoc Nikajt, në veprimet, në gjykimet, në qëndrimet e në psikol'ogjinë e tyre, pavarësisht nga vlera artistike e secilit, nuk ndihet asnje notë false, nuk ta vret syrin asnje ngjyrë e huaj, sa do e zbehtë që mund të jetë ajo.

Gjithkund në krijimtarinë e Ndoc Nikajt bije erë Shqipëri. Kjo është pa dyshim merita kryesore artistike e veprave të tij, mbasi është kjo që tregon zotësinë e tij për të krijuar diçka, jo duke imtuar dhe duke importuar tendencia e modele nga jashtë, po duke u nisur ngajeta e vendit të vet e duke pasqyruar me besnikëri pikërisht këtë jetë e jo diçka tjetër që do të ishte trillim fantazije. Në këtë drejtim mbetesh me përshtypjen se ai qëndron më lart nga Mihal

Gramenua e Fojion Postoli, në veprat e të cilëve trillimi, të papriturat, koincidencat skenat sentimentale dhe njëfarë mospërcaktimi e moskonkretësije nuk janë të pakta, sidomos tek i fundit.

Në prirjen e përgjithëshme të krijimtarisë së vet, Nikaj përpinqet të jetë realist, në kuptimin më të gjërë të kësaj fjale. Realizmin e tij, domosdo primitiv, e gjejmë në marjet e temave prej jetës reale të popullit, në trajtimin shoqëror të ndodhive e të fenomeneve, në analizën objektive të ngjarjeve, në prirjen e tij nga e reja, në të shtruarit konkret të problemeve e në synimin që të krijojë «ambjente tipike në rrethana tipike».

Po, krahas kësaj prirje që të paraqesë temat e subjektet me vërtetësi, pak a shumë realisht, ndihen në 'të, sidomos në veprat me tema historike, edhe disa shenja romantike, jo aq në stil, sa në qëndrimin që mban ai ndaj temave, subjekteve e heronjve. Kështu, për shëmbull, në romancat me tema historike, mungojnë pothuaj krejtësisht analizat shoqërore dhe vrehet tendenca e autorit, jo për një paraqitje pak-sa të gjithëanëshme të shoqërisë së atyre etapave, që janë vënë në themel të veprave, po për paraqitjen e tyre të njëanëshme e të idealizuar. Kjo vëgori e Nikajt, që s'është karakteristike vetëm për 'të, është e lidhur ngushtë me faktin se ai ka trajtuar temë patriotike, i nisur nga qëllimi që t'u vejë përballë bashkëkohësve të vet, një etapë të ndritur të historisë kombëtare, të cilën duhet ta kenë si shëmbull. Këtë utilitarizm të artit e gjejmë edhe në poezinë patriotike të Naimit, në poemën e tij «*Historia e Skënder-*

**beut», si edhe në disa vjersha të Çajupit e të autorëve të tjerë të Rilindjes. Në raste të tilla egzaltimi romantik i shkrimitarëve, në pajtim të plotë me mendimet, idealet dhe qëndrimet e tyre patriotike, ka triumfuar mbi kërkesën për të paraqitur në mënyrë të gjithanëshme etapat e kaluara historike.**

Dhe kjo, megjithëse në dëm të vlerës artistike e, nganjëherë, në dëm edhe të së vërtetës historike, mund të përligjet, nëqoftëse mendojmë që ata, nuk niseshin nga qëllimi, që të analizonin në mënyrë critike epokat e kaluara, po nga dëshira, që të ngrinin lart flamurin e madh të idealeve patriotike të atyre epokave dhe të nën vizionin, bile, në mënyrë sa më të theksuar, humanizmin e demokratizmin e prijsave të atyre kohëve.

Një tjetër veçori, që e mban larg Ndoc Nikajn prej realizmit, është edhe një farë aristokratizmi, që vrehet sidomos në zgjedhjen e ambjenteve prej të cilave autori ka nxjerrë heronjtë e veprave të veta. Në përgjithësi Nikaj i ka kërkuar heronjtë e vet në ambjente pak a shumë më fisnike e të pasura. Bile, nganjëherë, edhe për personazhe, që s'janë as të dorës së parë, as të dorës së dytë, ai nxiton të theksojë, se vini nga familje «e mirë, pasanike». Kjo e dëmton vërtetësinë e veprave të Ndocit dhe është një minus për pikpamjet e tij përgjithësisht demokratike dhe bije ndesh me të vërtetën historike. Rolin e masave punonjëse, sidomos të fshatarësishë, Ndoc Nikaj është munduar t'a paraqesë, jo nëpërmjet heronjve kryesorë të veprave të veta dhe as nëpërmjet figurave të tjera, po

vetëm me anë të skenave masive dhe të fjalëve të tija si autor.

Po kjo karakteristikë e krijimtarisë letrare të Ndoc Nikajt, as nuk duhet egzagjeruar, as nuk duhet marë e shkëputur nga koha në të cilën jetoi e krijoj shkrimtari. Futja e njerëzve të thjeshtë në letërsi, si heronj kryesorë të veprave artistike, nuk mund të përkonte me atë periudhë të historisë sonë kombëtare dhe as me botkuptimin, formimin kulturor e gjëndjen shoqërore të shkrimtarit tonë. Një hap më parë në këtë drejtim bën Mihal Gramenua, e sidomos, Foqion Postoli në romanin «*Lulja e Kujtimit*», në të cilin heroi kryesor është marë nga shtresat e ulta të qytetit.

Në aspektin shoqëror njerëzit e thjeshtë të popullit, ose mëshirohen prej autorit nëpërmjet skenave masive, ku vizatohen mjerimi e varfërija e tyre në momente të caktuara historike, ose paraqiten si shërbëtorë e shërbëtore besnikë, rëqëndrojnë lart moralisht, po që me jetën e tyre nuk tërheqin vëmëndjen e autorit. Në ndonjë rast, si tek «*Lulet në thes*» shkrimtari ka pikasur edhe korupsionin moral, në të cilin bien vajza e malësorëve të varfër që për të siguruar jetën, detyrohen të plotësojnë epshet e të tjerëve. Më tej Ndoc Nikaj nuk ka shkuar.

Primitivitetin e, mund të themi, edhe një farë diletantizmi në krijimtarinë e tij, e gjymë gjithash tu në mënyrën e kapjes e të trajtimit të temave e të subjekteve. Ai, zakonisht, është tepër i kufizuar në temat që zgjedh dhe, i rrëmbyer prej tyre, harron rrëthanat historike në të cilat zhvillohen dramat e heronjeve të tij. Kjo e metë vrehet, për shëmbull, në romancën «*Burbuqja*», në ë cilën pas-

qyrohen me vërtetësi e në mënyrë bindëse kushtet shoqërore feudale, mbasi një gjë të tillë e kërkon tema e subjekti i veprës, po harrohet krejtësisht sfondi historik në të cilin zhvillohen ngjarjet e veprës, harrohet gjendja e Shqipërisë nën Turqinë dhe qëndrimi i njerëzve ndaj kësaj gjëndje. Në romancat me sfond historik, kjo e metë nuk vrehet, po i lë vëndin, disa herë, mungesës së analizave shoqërore. Veç kësaj, në këto vepra lidhja ndërmjet jetës intime të heronjve dhe sfondit historik nuk është kurdoherë rezultat i një shkrirje organike të dy 'injave, po bëhet në mënyrë pak a shumë mekanike.

Në «Shkodra e rrethueme», — më tepër se në veprat e tjera, autori është për pjekur të krijojë një kompozicion të atillë, që t'i lejojë të paraqesë sa më gjerë rrethanat e koklavitura historike dhe rrjedhën e shpejtë të ngjarjeve luftarake e politike. Atij i duhet ta shpjerë lexonjësin nga ledhet e ushtarëve të rrethuar në Shkodër, në malësinë e Veriut, nga pozicionet e ushtrive malazeze në gjëndjen e qytetit të rrethuar e prej këndejej në Lezhë, në gjëndjen e jashtme politike, në Stamboll. Në këtë mënyrë ai ka shtruar para vetes një detyrë të vështirë artistike për të zgjidhur, po kjo detyrë ka mbetur vetëm e shtruar dhe e pazgjidhur plotësisht, mbasi autori nuk na i jep të gjitha këto në formë artistike. Ai përdor shpesh herë informacionin e thatë, nganjëherë letrat që këmbejnë heronjt ndërmjet tyre, kështuqë pjesët, në të cilat shkrimtari mundohet të japë rrethanat historike, marin formën e një kronike të thjeshtë.

Veprat e tjera të Ndoc Nikajt janë shumë të thjeshta në kompozicion. Në 'to nuk vrehet gati asnje përpjekje e autorit pér të ndërtuar, po ndiqet prej tijë me një natyrësi të madhe, vazhda e zhvillimit të ngjarjeve dhe rruga e fatisë të personazheve kryesore të veprave. Kjo vëçori i afron romancat e Ndoc Nikajt me format e tregimtarisë së shtruar popullore pér të cilën janë të huaja kthimet prapa, krijimi i brylave kompozisionale, tërthorimet dhe thurrjet e nata-tëruara të subjekteve etj. Lidhur me këtë karakteristikë të kompozicionit është edhe fakti, që në veprat e tij nuk lëvizin shumë personazhe. Vec heronjve kryesorë, të cilët, me ndonjë përjashtim, nuk janë antagonistë, në 'to, mund të gjesh shumë-shumë, edhe tre ose katër personazhe të tjerë, që zënë një farë vendi. Bile, duke ndjekur rjedhën e ngjarjeve, autori shpesh fut në veprat e veta personazhe të shumtë episodi të cilët, pasi dalin njëherë në vepër, çduken pér të mos u dukur më. Këta personazhe të dorës së tretë zakonisht janë të pakarakterizuar artistikisht, po njihen prej lexonjësve vetëm nëpërmjet certifikatave që jep shkrimtari pér ta. Përpjekje serioze autori bën pér karakterizimin e heronjve kryesorë ose të ndonjë personazhi tjetër, që i vlen të vejë në dukje ndonjë nga idetë kryesore të veprës, apo ndonjë anë të rëndësishme të kohës e të rrethanave historike-shoqërore.

Pa u përpjekur të bënim një analizë të plotë të Ndoc Nikajt, u munduam të shënojmë në këto radhë disa nga tiparet kryesore të veprimtarisë së tij letrare, që meriton me të vërtete-

të vëmëndje të posaçme nga ana e studjonjësve tanë të letërsisë dhe, do të thoshim, se i përket asaj edhe një vënd i veçantë në tekstet shkollore të letërsisë, në të cilat deri tani emëri i këtij prozatori të v'efshëm e shumë interesant, është përmëndur vetëm në ndonjë shënim të shkurtër sqaronjës apo me karakter informativ.

Veprat e Ndoc Nikajt është shumë e pasur. Ajo është një pasqyrë e historisë së vëndit tonë në disa etapa të caktuara të zhvillimit të saj dhe përmban në vetvete elemente të shumta me vlerë letrare, shoqërore, morale, që mund dhe duhet të përdoren edhe sot për edukimin e masave punonjëse e të brezit tonë të ri, të cilët partija i ka mësuar të çmojnë e të vlerësojnë çdo gjë të bukur e të vlefshme në traditat tona të passura kombëtare dhe të përfitojnë prej tyre, duke i përdorur si mjete të fuqishme morale në luttë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut nga të gjitha përpjekjet e armikut të jashtëm e të brëndëshëm të tij.

Vepra e Ndoc Nikaj meriton vëmëndje edhe për faktin se është një vepër luftarake, në kuptimin e plotë të kësaj fjale, mbasi shkrimitari ka trajtuar në 'të probleme nga më aktualet e kohës së vet, ka prekur çështje nga më çqetësonjëset e ditëve, në të cilat rronte dhe është munduar me mish e me shpirt që t'u japë përgjigje, ndërmjet krijimtarisë artistike.

Me botimin e dy veprave të Ndoc Nikajt në këtë vëllim, i cili me siguri do pasohet në të ardhmen edhe prej botimeve të tjera të këtij autori, lexonjësi ynë, sidomos të rinxjtë, që nuk

kanë patur rastin t'a njohin më parë këtë shkrimtar, duke fletuar librin, nuk do kënaqin vetëm kureshtjen, po do kenë rastin të plotësojnë edhe një boshllëk në kulturën e tyre letrare.

(*Parathënie për veprat «Shkodra e rrethueme» dhe «Bukurusha»*)

## **MESONJES DHE ATDHETAR I SHQUAR**

Emri i Petro Nini Luarasit është një prej atyre emrave të shquar të historisë sonë kombëtare, që na është ngulitur në mëndje që prej fëmijërisë dhe që ka mbetur ngaherë para nesh si një shëmbull i ndritur i atdhetarisë dhe i luftës burrërore për idealet e mëdha të çlirimt e të përparimit të kombit.

Më parë mjaft anë kryesore të këtij personaliteti të lëvizjes sonë çlirimtare e demokratike ishin lënë në haresë dhe as që përmëndeshin. Po edhe ato pak gjëra që thuheshin e shkruheshin për 'të, për mësonjësin pionier të gjuhës shqipe dhe për dëshmorin e ndritur të shkollës sonë, mjaftonin për të ngjallur në zëmrat tona një dashuri dhe një stimë të pakufi ndaj tij. Jo vetëm dje, por edhe sot, edhe nesër, dashurija e Petro Ninit për Shqipërinë, lufta e tij këmbëngulëse dhe burrërore kundër armiqve tanë, urrejtja ndaj ksenomanisë e sidomos ndaj grekomanisë, puna e tij e palodhur dhe vetmoho-

njëse për përhapjen e kulturës në masat e popullit, prirja e tij demokratike dhe luftarake, kanë qënë dhe do të mbeten shëmbull i gjallë e i ndritshëm për t'u ndjekur.

Atdhedashurija është tipari kryesor i personalitetit të Petro Nini Luarasit. Si mësonjës, si agjитator, si organizator, gazetar dhe vjershëtor ai luftoi shumë vjet me radhë, — edhe kur mbe-ti vetëm, edhe kur u ndodh i rrethuar prej armiqve të tij, që ishin armiq të Shqipërisë dhe të popullit tonë, — pa e ulur kurrë kokën, pa u përkultur dhe pa hequr dorë për asnjë çast prej idea'eve të tij të mëdha, të cilave u kishte kush-tuar jetën. Ai, si pak të tjerë prej intelektualëve tanë të asaj kohe, punoi dhe u përpoq në rrethanat shumë të vështira, që ishin krijuar në Toskëri prej pushtonjësve turq dhe prej ndër-hyrjeve të egra e intrigave djallëzore të shov-nistëve grekë. Duhej luftuar njëkohësisht kundër dy armiqve të liq dhe kundër gjithë duar-ve të tyre të ndyra brënda vëndit: kundër kle-rit antishqiptar, kundër grekomaneve dhe kundër bejlerëve, të cilët u ndodhën përkrah njëri-tjetrit në anën e kundërt të barigadës së luftës çlirimtare të popullit. Petro Nini u bëri ballë trimërisht të gjithave stuhive dhe rrëbeshevë, që u përplasën egërsisht mbi 'të dhe gjithnjë, prej çdo rrëbeshi, doli i përtërirë. Sa më e egër bëhej lufta e armiqve kundër tij, aq më e ven-dosur bëhej lufta e tij kundër armiqve, aq më e vetëdijshme bëhej qëndresa e tij shëmbullore, në të cilën ka diçka kreshnike.

«Dhe nëntëdhjetënëntë herë të rrëzohemi, përsëri duhet të ngrihem!» Kështu u thosh ai

nxënësve të vet dhe këtë pati si deviz të jetës së tij prej martiri stoik.

Në lëvizjen tonë të çlirimt kombëtar Petro Luarasi, si ideollog dhe luftëtar aktiv, ka dhë-në një kontribut të posaçëm e të një rëndësije të madhe, duke luftuar me të gjitha mjetet e me të gjitha mënyrat e mundëshme kundër shovinizmit grek dhe kundër veprimtarisë çkombëtarizonjëse të kishës orthodokse greke, që ishin një rrezik i dorës së parë për pavarësinë dhe sovranitetin e popullit tonë. Besnik i idealit të gjithë rilindasve që donin të rronin në miqësi me fqinjët, Petro Luarasi, pa rënë në shovinizëm, dënon ashper dhe me zgjuarsi të gjitha orvatjet e grekëve për çkombëtarizimin e orthodoksëve dhe për mohimin e shqiptarisë së tyre. Legjendës, sipas të cilës Krishti paskish qënë grek dhe, prandaj, grek janë dhe orthodoksët, ai i përgjigjet bukur dhe pa frikë:

*Edhe Krishti ndë na thëntë  
Se «jam grek, jakni pas meje!»  
Do t'i themi: «Pa mblith mëntë  
Se shqiptari s'vjen pas teje!»*

Nuk ka asnjë dyshim që Petro Luarasi ishte afetar dhe ateist. Ç'ka shkrojtur dhe ç'ka punuar flasin kthjelët për këtë. Po, sidoqoftë, kur lufton kundër grekomani të e kundër shovinizmit grek, sidomos në «Mallkimi i shkronjave shqip...» ai të lë përshtypjen, se nuk del jashtë kufijve të Biblës. Në këtë fakt ne zbulojmë një

nga zotësitë e tij të rralla, jo vetëm si polemist i fortë po, edhe si politikan i mirë. Pse?

Së pari, duke demaskuar klerikët shovinistë me anë të Biblës, të cilën ata e predikojnë, ai nxjerr në shesh hipokrizinë e tyre dhe i paragjet këta «*njerëz të perëndisë*» para opinionit publik si vegëla të ndyra të politikës shoviniste të qeverisë greke. Pra, kështu del më qartë fizionomija e tyre e vërtetë, si njerëz që e kanë vënë Krishtin dhe kishën në shërbim të politikës ekspansioniste, përfaqësonjës të së cilës janë.

Së dyti, duke mos luftuar kundër tyre si përfaqësonjës të klerit, po duke i ekspozuar si njerëz e si klerikë të liq, ai nuk prek sentimetet fetare të popullit (gjë që mund të shkakton te edhe reaksion), po përkundrazi siguron edhe simpatinë e besimtarëve të gjenjyer.

Sipas Petro Luarasit ata «*të ashtuquajturit përfaqësonjësit e Krishtit u shërbenin dy zotëve: Krishtit dhe grekërizmit; dhe se Krishtin e dëshironin me vullnet dhe natyrë greku...*», ata dëshironin: «*Jo predikimin e ungjillit, po grekëzimin e shqiptarëve, duke ndaluar rreptë çdo predikim dhe mësim me gjuhën shqipe në kishë*»; ata kanë hequr dorë nga predikimet e ungjillit e nga mirëbërjet dhe «*tanimë çquhen me anën e luksit të pasqylisë së përbotëshme me anë të rasos së zezë e mëngëggjérë të tyre, me anë të njerimëritjes (misanthropizmit), me anë të pakujdesimit të Ungjillit dhe me anë të qëndrimit armiqësor ndaj çdo kombi që s'është grek*»; ata përdorin fenë si gogol kundër shqipetarëvet». Duke iu drejtuar Patriarkanës ai i thotë se kjo politikë

«dhe nga Perëndia të largoi dhe në njerëzit të bëri të urejtur». Kështu, Petro Nini e kthen mallkimin që i bëri Patriarkana gjuhës shqipe dhe shqiptarëve në mallkim kundër klerit të vë-në në shërbim të shovinizmit grek dhe, në këtë mënyrë, e dënon botërisht këtë kler, që «grekizmit i është kolitur me gjithë zëmër e shpirt».

Si atdhetar i kulluar, pasonjës i denjë i idealeve të mëdha të Rilindjes, Petro Luarasi, me punën dhe shkrimet e veta, duke u ndeshur në çdo hap me «të ndyrën fanaticë» dha një kontribut shëmbullor për realizimin praktik të bashkimit të krishterëve e myslimanëve nën flamurin e madh të shqiptarisë.

Në veprimtarinë atdhetare të Petro Luarasit, puna e tij si mësonjës zë kreun e vendit. Ose më mirë të themi që: gjithë veprimtarija tjetër e tij, si ideolog, si publicist e si vjershë-tor ka patur bosht punën e tij si mësonjës, mbasasi asgjë nuk është e çkëputur prej qëllimit të predikimit të ideve patriotike dhe të edukimit të popullit në frymën e atdhedashurisë, të përparimit e të demokracisë. Me të drejtë «Dielli» i vitit 1926 e karakterizonte Petron si mësonjës që «as lodhej, as trëmbej». Që nga viti 1883 e deri sa mbylli sytë, i helmuar nga agjentët e Patriarkanës, ai s'pushoi për asnjë çast së mësuari në gjuhën amtare të miturit e të rriturit. Nuk e lodhën mundimet e shumta të asaj pune të vështirë; nuk e dobësuan mungesat e mëdha materiale; nuk e trembën rreziqet e të papritur, kanosjet e pritat, grindjet me bej'erët e me grekomaniët, mallkimet e mitropolitit dhe përfolja. Ai do të kishte qënë vërtet gati të derdhët

gjakun, po të qe se ky gjak do të përdorej përtë shkruar shqip.

Dhe kjo punë nuk vazhdoi një vit, as dy, as dhjetë, po gati tridhjet vjet. Është një kohë aq e gjatë, sa ndonjë tjetër, edhe në kushte të mira e rrethana normale, do të qe lodhur. Si mësonjës Petro Nini nuk është martir, po është hero, mbasi askush s'mund ta rradhitë atë përkrah njerëzve, që shënjtërohen vetëm prej vdekjes. Fundi i tij prej martiri është kurora e asaj vepre heroike, që u krye gjat dhjetra vjetësh. Dhe s'kemi të bëjmë këtu me një akt heroizmi, po me një jetë heroike, me një veprimitari të pandërprerë shumëvjeçare, që, në çdo moment t'a marësh, karakterizohet prej vetmohimit, guximit, trimërisë dhe besimit të patundur në realizimin e idealeve fisnike, për të cilat ai luftonte dhe që kanë qënë dhe mbeten ndër idealetona më të bukura kombëtare. Duke folur në mënyrë figurative, ai shkruante më 1908:

«Në vënçim re mundimet e udhës, buçitmat dhe tmerret e valëve të oqeanit dhe brengat e lodhjes, nukë do guxojmë të vemi në vënde të largëta për fitim».

Dhe, jo vetëm kaq. Për 'të, as gjëzimet dhe të mirat e jetës, s'kanë kuptim, kur nuk vihen në shërbim të Atdheut. Petro Nini, që s'vuri gjë më lartë se dashurija për Shqipëri, kishte plotë drejtë t'i thoshte djemërisë fjalë si këto:

«Oh! Ç'i doni këngët e hijëshme, bukurinë djaloshare dhe fuqinë e levendërinë trimërore, kur s'e keni për Shqipërinë e për vehten tuaj?».

Janë fjalë të dala nga zëmra këto, nuk janë letërsi!

Si mësonjës dhe propagandist Petro Nini ka

punuar tepër që të hidhej fara e diturisë dhe e përparimit në një vënd dikur të lulëzuar, po atëhere të mbuluar me hithrat e ferrat e mbjetllura prej të huajve, prej armiqve tanë. Si gjithë patriotët e çquar të Rilindjes sonë, ai mendonte se, «*duke patur trimërinë me një krah, me tjetrin krah le të mbajmë urtësinë*». Për 'të, luftha për kulturën kombëtare ishte niesë përbërëse e luftës së përgjithëshme popullore për çlirimin kombëtar. Si të gjithë rilindasit e tjerë, edhe ky përfaqësonjës i vonë i asaj plejade të lavdishme, pasqyroj gjithë ato anë të bukura të lëvizjes së çirimit kombëtar, në të cilën lufta për gjuhën e diturinë ishte ndër karakteristikat më kryeso-re e më të rëndësishme. Dhe ai nuk ishte vetëm autor librash diturake, mbasi fati e solli, të përpipet e të luftonte, jo larg atdheut e, si përfundim, larg rreziqeve e betejave të përditëshme, po në truallin tonë të asaj kohe, në të cilin plik-seshin në format më të mprehta, kontradikta të shumta politike, ekonomike, shoqërore e feta-re. Petro Nini, mbase prej vet karakterit të tij të fortë burrëror, mbase pse e ndjente dhe e shikonte më afér realitetin, mbase nga që provonte në çdo hap baltën e vëndit të vet, mbase pse njihte nga afér armiqtë dhe pozitat e tyre të gjenjeshtëra — mbase prej të gjitha këtyre e më tepër prej besimit të patundur që, pas di-mërit do vinte «*pranvera shqiptare*», u ngri- mbi të gjitha këto kontradikta dhe ndriçoi si yll në qellin e errët të Shqipërisë së atëherëshme. Merita e tij e madhe është se nuk i mohoi, as që i kapërceu kontradiktat, po duke i marë parasysh të gjitha, dijti të shkojë me trimëri dhe

urtësi në drejtimin e kundërt të «tmerreve të valëve të oqeanit».

Petro Luarasi nuk ishte vetëm atdhetar i flaktë dhe luftëtar i paepur i kulturës sonë kombëtare, po edhe demokrat i bindur. Në pozita të tilla atë e kanë shpënë, jo studimet, po llogjika e jetës, vetë lufta. Ai është aq tolerant sa edhe i rreptë. Ai kërkon bashkimin e të gjitha forcave kombëtare kundër pushtonjësve turq dhe shovenistëve grekë. Për t'ja arritur këtij qël'imi, si shumë rilindas të tjerë, edhe Petro Nini u drejtohet sentimenteve kombëtare dhe këtë e bën, jo nga që nuk njeh dallimet shoqërore, po nga që, sikurse në punë të fesë, e të klerit, nuk do të bëhet «shkaktar» i ndonjë përçarje. Thirrjet e tij të pasjonuara drejtuar klerit e parësisë shprehin dëshirën, vlerësimi i veprimeve konkrete të klerit e të parësisë paraqet realitetin, kurse qëndrimi i tij i rreptë ndaj tyre, shpreh pikëpamjet e tij demokratike revolucionare: besim tek populli, urejtje ndaj armiqëve të popullit. Kurdoherë ai del, jo vetëm si atdhetar, por edhe si përfaqësonjës i popullit.

«Atë, që na ndihmon në hallin tënë, le ta kemi për nder për jetë! Po atë që na ndalon le ta shkelmojmë!» Ose:

...Nëqoftëse parësija e Shqipërisë do të rrrijë gjakftohtë përpara nevojave të nderit shqiptar... do të shtonjë urejtjen' e vogjëlisë kundër parësisë tradhëtore kaqë, saqë, kur të pendohetë përfajnë e saj parësija të mos ketë vënd ku të ngushëllohet dhe të mos gjejë derman».

Sigurisht ai nuk del jashtë kufijve të lëvizjes për çlirimin kombëtar, por kjo nuk e pengon

të shprehë disa herë mendime të përparuara shoqërore. Kur lexon shkrimet e tij të mbetet përshtypja, se Petro Luarasi kishte për të thënë akoma diçka të rëndësishme, por këtë e ruante për një kohë më të vonë, për atë kohë, të cilëni nuk e lanë ta gëzonte dot.

Duke përkujtuar sivjet pesëdhjetë vjetorin e vdekjes së tij tragjike ne e ndjejmë Petro Nini Luarasin pranë, si luftëtar aktiv në radhët e luftëtarëve për lulëzimin e kulturës sonë kom-bëtare, për përhapjen e arsimit në skajet më të largëta të vëndit, për mbrojtjen e lirisë e të paravarësisë së Atdheut tonë të shtrenjtë, për të cilin ai dha jetën.

*(Botuar në gazeten «Drita»,  
27 gusht 1961)*

## **FILLIMET LETRARE TE ANDREA VARFIT**

*«Duhet ndruar mënyrë. Duhet më gjallëri. Vaji dhe brenga, gjersa mbetën vetëm n'atë stad, gjersa nuk japid shkas për sulme të reja, s'janë gjë. Duhet më militantizëm!»*

Kështu shkruante një çerek shekulli më parë Andrea Varfi, në një prej artikujve të vet kushtuar çështjeve të letërsisë së re, për të cilën përpinqeshin e luftonin letrarët e rinj me prirje revolucionare. Në mos i marrçim fjalët e cituarë më lart, si thirrje për krijimin e letërsisë së realizmit socialist, të paktën jemi të sigurt se autori i tyre, duke luftuar kundër dekadentizmit e formalizmit dhe duke çfaqur pakë-naqësinë e vet ndaj letërsisë sentimentale t'asaj kohe, lufton për një poezi revolucionare, për një art militant, i cili, përvèç përshkrimit me rea i-zëm të vajit e të brengave, të përbajë edhenotat kushtrimtare për sulme të reja.

Fjalët e përmëndura më lart, nuk janë një shprehje e rastit, as një egzaltim i çastit në kri-jimtarinë e Andrea Varfit, po janë një sintezë e

saktë dhe e qartë e mendimeve dhe e piksynimeve ideologjike dhe artistike të tij n'atë periudhë. Në forma të tjera, herë nëpërmjet analizave herë nëpërmjet gjykimeve, ato mendime i gjejmë edhe në shkrimet e tjera të Andrea Varfit. I gjejmë ato edhe në krijimtarinë letrare artistike të këtij shkrimtari. Pra, kemi të bëjmë me një koncept të formuar mirë, jo me një ndikim leximesh, as me një rrëmbim djaloshar, po me një shprehje të përcaktuar të vetvetes dhe të së vërtetës objektive.

Lexonjësit tanë kanë patur rastin të njihen gjatë vjetëve të fundit pothuajse gjerësisht me letërsinë tonë demokratike të periudhës 1930-1940. Janë botuar shkrimet e zgjedhura të Gaspër Palit, të Kol Mirditës, të Migjenit dhe të Qemal Stafës. Janë botuar ose do të botohen së shpejti shkrimet e Nonda Bulkës, të Dhimitër S. Shuteriqit, të Petro Markos, të Sterjo Spasses, të Kristaq Cepës. Edhe libri i Andrea Varfit është një prej tyre.

Në letërsinë tonë t'asaj kohe nisi një luftë e vërtetë ndërmjet drejtimeve të ndryshme krijonjëse, një luftë që u pasqyrua edhe në kritikë, po që u shpreh, para së gjithash, në vetë krijimtarinë letrare. Kërkimi i shtigjeve të reja letrare ishte në rend të ditës dhe nuk diktohej prej ndikimeve të jashtme, aq sa përcaktohej prej zhvillimit shoqëror e letrar të vëndit. Ishte kohë kontradiktash të forta e të ashpëra ekonomike, ideologjike dhe shoqërore. Ndërsa k'asët sundonjëse dhe përfaqësonjësit e tyre zyrtarë ndiqnin gjurmët e sundimit otoman dhe orvateshin të gërshetonin në forma tragjikomike orien-

tin mesjetar me oksidentin borgjez, një pjesë e mirë e intelektualëve qenë oksidentalistë të vendosur dhe përpiqeshin, duke propozuar reforma e duke shpikur shkolla «të reja» ideologjike, ta vinin vëndin në rrugën e zhvillimit kapitalist duke patur si yll rrëfenjës, disa Italinë fashiste, një pjesë Gjermaninë naziste, e ca të tjerë Francën e dikush Turqinë e Mustafa Qemalit. Këta intelektualë «reformatorë», që luanin kumar në kafe «Kursal», në «Bela Venecia» e gjetkë dhe që ishin mysafirët më të preferuar në *Chat-Noir*, nuk e humbisnin rastin, kur qe puna përtë zbuluar prirjet «qytetëronjëse» të mbretit dhe «përparimin» e Shqipërisë, pikërisht në shtimin e kafeneve luksoze dhe të pallateve të zotérinjve deputetë, ministra e pasunarëve të tjerë.

Do të duket që ishin përparimtarë gjithë ata intelektualë, të cilët rronin në një vënd gjysmë feudal dhe vështronin nga perëndimi kapitalist. Dhe, vërtet, kishte vërtet diçka përparimtare, sado të përciptë e të parëndësishme, në mendimet e tyre, siç kishte ndërmjet tyre edhe njerëz të bindur në pikpamjet e veta dhe që përpiqeshin ndershmërisht për ngadhnjimin e atyre pikpamjeve. Po ata nuk delnin jashtë suazës së shtypjes e të çfrytëzimit. E vetmja gjë që kërkonin ishte zëvëndësimi i një forme çfrytëzimi me një formë tjetër.

Intelektualët e rinj, (shumë prej të cilëve as që kishin kryer studimet e larta), që kishin ndjenja dhe mendime revolucionare, u afroan n'atë kohë me idëtë socialiste dhe me grupet komuniste. Ata e kuptuan, që duhej gjetur tjetër udhë shpëtimi, udha e çlirimt revolucionar të masave punonjëse prej çfrytëzimit ekonomik

dhe shoqëror, prandaj, duke luftuar kundër feudala izmit, kulturës klerikale, injorancës dhe patriarkalizmit, ata luftonin njëkohësisht edhe kundër orientimit borgjez e fashist, kundër depërtimit të kapitalit e të kulturës dekadente përendimore, kundër degjenerimit dhe çthurjes morale. Qënia e Bashkimit Sovjetik dhe përhapja e ideve marksiste-leniniste, u tregonin atyre të vetmen udhë shpëtimi.

Këtë pikpamje ideologjike dhe politike ndikuani mjaft edhe në lëmin e kulturës, të letërsisë dhe të mendimit kritik. Duke luftuar për çirimin shoqëror, nuk mund të pajtohesh dot, as me tradicionalizmin dhe patriarkalizmin e Gjergj Fishtës, as me akademizmin e shkollës së klerit katolik, as me formalizmin dhe me tendencat estetizante të poetëve t'asaj kohe. Aq më pak mund të pajtoheshe me letërsinë zyrtare pseudopatriotike, që u shërbente mbretit dhe klasave sundonjëse. Lufta për çirimin shoqëror është edhe luftë për çirimin e mendimit e të krijimit prej prangave të ideo'ogjive reaksionare dhe prej anarshisë, që sundon në shoqëritë me klasa antagoniste. Intelektualët me prirje revolucionare socialiste përbënë krahun më të përparuar të letërsisë e të kulturës sonë kombëtare t'asaj kohe. Pranë tyre qëndronin shkrimtarët e publikistët përparimtarë që mbasë as nuk e pranonin revolucionin dhe socializmin, po e domin popullin, qenë të lidhur me punonjësit e thjeshtë dhe luftonin për të mirën e tyre, duke goditur çdo çfaqje të shtypjes shoqërore, të varfërisë, të mjerimit, të papunësisë. Këta gjithashu përpinqeshin për një letërsi realiste, të lidhur me popullin dhe që i drejtohej popullit.

Ky është një qëndrim i qartë, i saktë dhe i drejt për një letërsi realiste, me karakter popullor dhe me frysme demokratike, që shpreh, jo vetëm mendimin e përparuar estetik të asaj kohe, po edhe prirjen përparimtare të letërsisë sonë t'atyre vjetëve.

Andrea Varfi, siç mund ta vrejnë vetë lexonjësit e këtij libri, si në krijimtarinë letrare artistike, ashtu edhe në veprimtarinë publิกistike e kritike, qëndron në pozita kryesisht luftarakë revolucionare, të cilat dalin, herë çiltas, herë në trajta të mjegullta e të papercaktuara mirë. Po, sidoqoftë, frysma e përgjithëshme e shkrimeve është luftarakë. Ai godet ashpër, mbron me guxim, aludon qartë dhe ka piksynime të shëndosha, të cilat pajtohen me gjëndien e atëherëshme të letërsisë e të jetës sonë shoqërore dhe që, ndonse në forma të ndryshme nga ato që parashikonte Andrea Varfi, janë vërtetuar prej kohës.

Në poezi, në skicat, panfletet dhe artikujt publicistikë, në artikujt për çështje të letërsisë dhe për libra e shkrimitarë të veçantë, autori i librit ka një profil të përcaktuар mirë, është koherent dhe intransigjent në pikpamjet e veta. Atë që ka këruar nëpërmjet artikujve e ka mishëruar edhe në krijimtarinë e vet.

Cilat janë tiparet karakteristike të krijimtarisë së Andrea Varfit n'atë kohë?

Së pari, si për gjithë rrymën e përparuar të letërsisë sonë të vjetëve 1930-1940, edhe për Andrea Varfin, është karakteristike trajtimi i temave shoqërore. Kjo përbën një prej kontributave më të mëdha të letërsisë s'asaj kohe, si në kup-

timin ideologjik e politik, edhe në kuqtimin artistik. Temat patriotike, që karakterizonin letërsinë e Rilindjes Kombëtare, nuk qenë më aktuale dhe nuk mund të trajtoheshin më, pa u përzier me elemente të theksuara shoqërore, se edhe vetë qëndrimi i vërtetë patriotik në atë kohë, nuk mund të ishte i njëjtë me qëndrimin patriotik të periudhës së luftës për çlirimin kombëtar. Patriotët e vërtetë t'asaj kohe, duke luftuar përuajtjen dhe forcimin e pavarësisë kombëtare, s'kish si të mos luftonin edhe kundër klasëve sundonjëse, që e minonin këtë pavarësi dhe që e kishin katandisur Shqipërinë monedhë këmbimi për dëlavaret e tyre. Ata që nuk e kuptionin kështu patriotizmin, ose qenë tepër naivë, ose qenë përkrahës dhe ndiekës të regjimit monarkik të Zogut. Elementët më të përparuar e, në radhë të parë komunistët, e pasuruan patriotizmin me fryshtën revolucionare të luftës së klasëve dhe me domosdonë e shëmbjes së regjimit të urryer të feudalëve e të pasanikëve. Kështu i ka trajtuar temat patriotike edhe Andrea Varfi në shkrimet e veta të djalërisë. Duke vënë në pah vlerat patriotike dhe atdhetarizmin e popullit, ai dhe shkrimtarët e tjerë me prirje revolucionare, tërhiqnin vëmëndjen e lexonjësve, jo aq në aktet patriotike në vërvete, sa në realitetin e hidhur të kohës, në të cilën flitej me fraza bombastike për «patriotizëm», që të fshihej tradhëtia e kërçeve dhe mjerimi i popullit. Pra, edhe temat patriotike trajtoheshin në plan shoqëror. S'më ngjan të kenë të drejtë ata që egzaltohen prej çdo klithjeje «patriotike» n'atë kohë, mësi më duket se çdo britmë e atillë, në rastin më të mirë, nuk qe gjë tjetër veçse jehonë e vonu-

ar e një kohe të perënduar dhe, drejtpërdrejt ose tërthoraz, lidhej me orvajtjet për të larguar vëmëndjen' e njerëzve prej jetës dhe prej problemeve të mëdha të kohës.

Patriotike është, për shëmbul', vjersha «Zjarr Atdheut» e Andrea Varfit, po është më parë edhe revolucionare. Pyetja retorike: «*Gjer kur trolli shqipëtar — do durojë krim e dhunë?*», përbën esencën e vjershës dhe thelbin e patriotizmit të vërtetë gjatë asaj kohe.

Bashkë me këtë pasurim të temave patriotike, në letërsinë tonë t'atëherëshme, u hodë edhe hapat e para të kapërcimit prej romantizmit në realizëm. Zaten nuk mund të kuptohet dhe as që mund të arrihet realizmi në art pa trajtimin e temave shoqërore. Përveç vjershave, Andrea Varfi, ashtu si Nonda Bulka, nuk është marrë asaj kohe me *krijimtari artistike*, (e nën-vizoj, se çuditem pse analizohet publicistika e Nonda Bulkës si letërsi artistike). Shumë-shumë, ai ka arrijtur gjer tek skica letrare-publicistike. Sidoqoftë, tanë që ajo periudhë e zhvillimit të letërsisë sonë ka mbaruar, nuk mund ta kuptojmë realizmin në letërsinë e mëvonëshme, pa ato vëzhgime dhe skica, që btoheshin shpesh prej Nondës, Andresë, Petros, Qemalit e prej disa të tjereve. Mbase qe e domosdoshme të nisej me 'to, ashtu siç ka qënë e domosdoshme të nisej prej të rinjve kjo punë, për të arritur më vonë në letërsinë realiste. Ato skica e vërzögjime me tema shoqërore të ditës patën për letërsinë të njëjtën rëndsi që patën edhe për zgjimin e ndërgieges revolucionare të masave. Ashtu siç tërhiqnin vëmëndjen e lexonjësve ndaj problemeve çqetësonjëse të ditës edhe mbillnin urrejtjen e

ngjallnin zëmërim e revoltë, ashtu tërhiqnin edhe vëmëndjen e shkrimtarëve dhe, si një rrymë e holë po e fortë uji, çanin tokën argjilore dhe çel-nin shtratin e lumiit të ardhëm.

Këtu dalim te një tipar tjeter dallonjës i veprimtarisë së herëshme të Andrea Varfit: te trajtimi realist, — në kuptimin e përgjithshëm dhe letrar të kësaj fjale, — të temave shoqërore, duke iu shmangur pothuajse krejt sentimenta izmit, që përshkonte shkrimet e disa letrarëve të tjerë dhe që gjente vënd edhe në vepra nga më të mirat e prozës së atëherëshme. Në periudhën 1930-1940 është ende herët që të merret sentimentalizmi si fenomen negativ në letërsi, se ai ishte në fillimet e veta, kishte brendi demokratike dhe sillte diçka të re në letërsinë tonë, po, me që egzistonte, qoftë edhe në lindje e sipër, prirja realiste, egzaltimi në vlerësimin e veprave sentimentale nuk do të qe punë me mënd. Andrea Varfi, — edhe për vetë natyrën e tij si shkrimtar, — qëndron larg sentimentalizmit. Asnjë prej shkrimeve të tij nuk të derdh në shpirt keqardhje e nuk të zgjon mëshirë, po të zëmëron, të revolton dhe, në rastet më të mira, sidomos në vjershat e pabotuara, të ngjall shpresë e besim, të mobilizon për luftë dhe, jo përmë çdo luftë, po për «sulme të reja», ose, siç thotë ai, për t'i vënë «minat botës së vjetër».

Pra, krahas trajtimit realist të temave shoqërore, poezia e Andrea Varfit përshkohet edhe nga një frymë e përcaktuar revolucionare. Në vjershën «Punëtorët», të shkruar më 1935 dhe të pabotuar atëhere, ai thërrret: «Ta çojmë grushtin! Minat botës vjetër! Se ne do farkëtojmë përmbi dhé, një botë më të mirë: botën tjetër!»

Më parë (1932), në vjershën alegorike «*Shih si rrëh*» duke iu drejtuar dallgës, poeti pyeste: «*Mos je dallgë e gjithësisë, që të vjetërën shëmb mbi dhé, pér të shkrepur dit' e re, gaz i gjithë njerëzisë?*»

Më vonë, më 1937, ai u këndon grevave të Kuçovës dhe të Korçës dhe u thur lavde hymazonjëse mitrolozit e granatës së revolucionarëve spanjollë. Nuk është puna të kërkojmë e të gjej-më citate. Gjithë fryma e poezisë së Andrea Varfit është revolucionare.

Fatkeqësia është që pjesa më e mirë e vjershave revolucionarë të Andrea Varfit, si edhe ato të Petro Markos e të Dhimitër S. Shuteriqit, nuk patën mundësi të njihen e të botohen në kohën kur u shkruan dhe pér të cilën u shkruan. Ato kanë rëndësi të madhe pér njohjen dhe karakterizimin e autorëve të tyre, siç kanë vlerë artistike edhe sot e kësaj dite, po, nga që nuk u botuan, sh'kish si të ndikonin në procesin e zhvillimit t'atëherëshëm të letërsisë sonë dhe sot, jemi të detyruar të gjurmojmë në veprat e botuara, elementët e gjenezës së realizmit socialist në Shqipëri, megjithëse më në fund, do thënë me plot gojën, që shkrimtarët e përmëndur më lart, si edhe Shevqet Musaraj e Aleks Çaci, ndër të gjallët, së bashku me Migjenin, janë prekurso-rët e kësaj letërsie tek ne. Nuk ka qënë dhe nuk është hiç me vënd që në studimet pér letërsinë këtyre autorëve u mohohet e kaluara.

Edhe në artikujt pér shkrimtarët, pér letërsinë dhe pér veprat letrare, Andrea Varfi përfaqësohet si një ndër më të përparuarit e asaj kohe. Kujdesi i tij i përhershëm pér t'i analizuar veprat edhe në planin politik dhe ideologjik, u jep

shkrimeve një vlerë të posaçme. Megjithëse trajta e këtyre shkrimeve është e rëndë dhe stili tepër i vështirë e gjer diku i ngurtë, ndonse, në mjaftë raste vlerësimet janë larg analizës dialektike dhe të çmuarit marksist të fenomeneve letrare, ato janë një tjetër dëshmi e qartë e pozitave të shëndosha, në të cilat ndodhej Andrea Varfi në kohën kur i ka shkruar. Vlera e tyre shtohet dhe dobësitë, deri diku përligjen, po të kemi parasysh, që ato janë botuar në shtypin e kohës.

Libri «*Në zgjim*», për të cilin u shkrua kjo parathënie, flet vetë. Lexonjësi, jemi të sigurt, që do zbulojë më tepër vlera, nga ç'mundëm të radhitnim në këto pak faqe, të cilat s'mund të merren si analizë e gjithanëshme e krijimtarisë së herëshme të Andrea Varfit.

(Parathënie për librin e A. Varfit  
«Në zgjim»)

## PASQYRA E LËNDËS

### PROBLEME LETRARE

Fillimet e letërsisë sonë të realizmit socialist .....	5
Në udhën e lulëzimit të mëtejshëm .....	28
Lenini — kultura dhe arti .....	89
Një e vërtetë që do thënë .....	100
Logjikë e çuditëshme .....	108
A ka shkrimtarë të gjinisë asnjanëse? .....	120

### AUTORË DHE VEPRA

«Këngë» — poezi të DH. S. Shuteriqit .....	133
Një vepër poetike me rëndësi .....	143
Hapi i hedhur me siguri .....	154
Katër vëllime poetike .....	163
«Me valët e jetës» — roman i Vedat Kokonës .....	175
«Qyteti i fundit» .....	187
Lufta për liri — e vetmia rrugë .....	196
Njerëz, jini vigjilentë!	209
Çobo Rrapushi .....	225
«Jetë me brenga» .....	235
Novelë për njerëzit në luftë .....	243
Proza e një poeti .....	255
Bukuri e ashpër e jetës shqiptare .....	272

### NË GJURMËT E TRADITAVE

Zef Serembe .....	291
Kryevepra e Mqedës .....	305
Proza e Ndoc Nikajt .....	314
Mësonjës dhe atdhetar i shquar .....	336
Fillimet letrare të Andrea Varfit .....	345